UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË

Buletini shkencor

Numër 2, Vëllimi 2, 2015
ISSN 2310-6719

BULETINI SHKENCOR
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Numër 2, Vëllimi 2, 2015
ISSN 2310-6719

Bordi Editorial

Redaktore e gjuhës angleze:
Ma. Erida Prifti

Redaktore letrare:
MSc. Etjona Hoxha

Person Kontakti:
Ma. Erida Prifti

Editore:
MSc. Roksana Nowak
MSc. Ina Çobani

Bordi Shkencor

Prof. Dr. Albert Qarri, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Shqipëri (Kryetar)
Prof. David M. Kemme, University of Memphis, Tennessee, USA
Prof. Ronald W. Spahr, University of Memphis, Tennessee, USA
Prof. Dr. Dhori Kule, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Jorgo Kaçani, Universiteti Politeknik i Tiranës, Shqipëri
PhD. Bill Croft, Sandhills Community College, North Carolina, USA
Prof. Dr. Llukan Puka, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Shezai Rrokaj, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Genci Burazeri, Universiteti i Mjekësisë, Shqipëri
Prof. Dr. Sulo Hadërri, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Aurela Anastasi, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
PhD. Aleks Konomi, Seattle University, Washington, USA
Prof. Dr. Sherif Bundo, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Bardhosh Gaçe, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Shqipëri
Prof. Asoc. Kristofor Lapa, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Shqipëri
Prof. Asoc. Mira Shehu, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Shqipëri
Dr. Arjan Gjonça, the London School of Economics and Political Science, Londër, Angli
Prof. Dr. Fatmir Mema, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Mynyr Koni, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Pranvera Lazo, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Kozeta Sevrani, Universiteti i Tiranës, Shqipëri

Buletini shkencor / Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Email: buletini.shkencor@univlora.edu.al / Tel. 00355 33 22 49 52

INFORMACION

Buletini Shkencor boton punime origjinale që sjellin njohuri të reja dhe të rëndësishme për avancimin e shkencës.

Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të gjetjeve shkencore të akademikëve shqiptarë brenda dhe jashtë mjedisit universitar shqiptar. Rëndësia e botimit të buletinit disa herë në vit qëndron në dhënien e mundësisë për të gjithë kërkuesit akademik dhe jo vetëm të bëjnë të njohura gjetjet më të reja në fushat përkatëse të tyre si dhe në përditësimin në kohë të gjetjeve të mëparshme.

Dërgimi i dorëshkrimit nënkupton që punimi i paraqitur në të nuk është botuar më parë (përveçse në formën e një përmbledhjeje, leksioni apo tezave akademike), nuk është në shqyrtim për t'u botuar gjetkë dhe se botimi është aprovuar nga të gjithë autorët, si dhe autoritetet përgjegjëse ku hulumtimi është kryer. Autorëve do t'ju kërkohet që të paraqesin, nëse ka ndonjë konflikt interesash, si dhe ndonjë burim financiar të veçantë të përdorur për kryerjen e kërkimit. Nëse dorëshkrimi pranohet për botim ai nuk mund të botohet në të njëjtën formë diku tjetër pa marrë më parë leje me shkrim nga Bordi i Buletinit Shkencor.

Plagjiatura nuk lejohet dhe do t'u raportohet si autorit, ashtu edhe autoriteteve përkatëse. Konkluzionet duhet të justifikohen nga skema eksperimentale dhe të dhënat e paraqitura. Informacioni duhet të jetë i detajuar në mënyre që të lejojë përsëritjen e punës nga shkencëtarë të tjerë të së njëjtës fushë. Autorët duhet t'i ruajnë të dhënat eksperimentale dhe t'ia paraqesin Këshillit Botues, nëse u kërkohen. Shkrimi duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm, konçiz dhe korrekt nga ana gramatikore. Autorët mbajnë përgjegjësi për anën shkencore dhe formale të materialeve që paraqesin, si dhe për çdo korrespondencë me redaktorët.

Të interesuarit të paraqiten me arritjet më të reja nga fushat e angazhimeve të tyre profesionale – shkencore.

Artikujt duhet të jenë origjinale (të pakumtuara në ndonjë aktivitet tjetër), të pabotuara dhe jo në proces vlerësimi ose botimi (në ndonjë redaksi tjetër).

Autorët janë përgjegjës për redaktimin gjuhësor të tekstit të përmbledhjeve të tyre, qoftë në shqip, qoftë në anglisht.

Të gjithë autorët e interesuar për të botuar në Buletinin Shkencor të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë mund të na kontaktojnë në adresën email: buletini.shkencor@univlora.edu.al

Përmbajtja

METODA MONTE CARLO NË VENDIMET FINANCIARE
MSc. Elena Bardhaj, MSc.Arsjola Dodoveci

KORRELIMI TREGTAR I EKONOMISË SHQIPTARE ME EKONOMI TË TJERA
Fjona Zeneli

RAPORTET FINANCIARË SI PËRCAKTUES TË MIRË TË KTHIMIT
MSc.Blerina Dervishaj

BUXHETI DHE ECURIA E TË HYRAVE BUXHETORE NË KOSOVË
Dr.Agim Berisha

NDËRMJETËSIMI NË ÇËSHTJET PENALE
Artur Malaj

DOMOSDOSHMËRIA PËR RIORGANIZIMIN E NDARJES ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE NË KUADRIN E AUTONOMISË SË PUSHTETIT VENDOR
MSC Oljana Hoxhaj

NJË VËSHTRIM KRAHASUES I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR ME ATË TË DISA VENDEVE NORDIKE NË LIDHJE ME FITIMIN, HUMBJEN, RIFITIMIN DHE SHTETËSINË E SHUMËFISHTË
Ulvin Veizaj

E DREJTA E AUTORIT NË BE
MSc Belinda HALILAJ, MSc Oljana HOXHAJ

LEGJITIMITETI I PËRFAQËSIMIT POLITIK NË KUADRIN E NJË DISKURSI TË MUNGUAR
Jonida Mehmetaj

VLERËSIMI I MODELIT TË LIDERSHIPIT TE OFICERËT DETARË
Prof.Asoc. Kristofor Lapa, Doc. Ermal Xhelilaj

SISTEMET E INFORMACIONIT NË MESIMIN UNIVERSITAR
MSc.Dorina Mino

RENDERING POLITICAL ALLUSIONS FROM ALBANIAN INTO ENGLISH
ARJAN BILO

COMPARATIVE FEATURES BETWEEN PROVERBS IN ALBANIAN, ENGLISH AND GREEK
Evis CELO (Ph.D), Lorenc Danaj (Ph.D)

FJALORI DHE NDIKIMI I TIJ NË MËSIMIN E GJUHËS ANGLEZE
PhD Kozeta Hyso

PËRPARËSITË DHE TË METAT E TIK NË MËSIMDHËNIEN E GJUHËVE TË HUAJA
PhD. Veneranda Hajrulla

FENOMENE FONOLOGJIKE NË TË FOLMEN E LABËRISË
Zamira Alimemaj

GLOBALIZMI DUKURI QË LIDHET ME ZGJERIMIN E HAPËSIRAVE TË KOMUNIKIMIT
Msc.Bukuroshe ISUFAJ

VLERËSIMI I REALIZIMIT TË NEVOJAVE BAZË TË PACIENTËVE NË SPITALIN RAJONAL TË VLORËS PËR PERIUDHËN 15 MAJ-15 QERSHOR 2013
Msc. Ms Rozeta Luci, Msc.Brunilda Subashi, Msc. Glodiana Sinanaj, Mnd. Denada Selfo, Msc. Saemira Durmishi

RËNDËSIA E RUAJTJES SË PRIVATËSISË SË PACIENTËVE TË HOSPITALIZUAR
Rudina Çerçizaj, Emirjona Kiçaj

KUSHTET JO TË MIRA TË PUNËS DHE STRESI NDIKOJNË NË RRITJEN E PAKËNAQËSISË NË PUNË
B. Subashi[1], R. Luçi[1], D. Selfo[1], R. Lalo[1], G. Sinanaj[1], Ll. Subashi[2].

ALBANIA: BETWEEN PATRIOTISM AND NATIONALISM
Erida Prifti

KUJTESA SOCIALE DHE KULTURA E SHKRIMIT PËR LUFTËN E VLORËS, 1920 NË OPTIKËN BASHKËKOHORE
MSc. ALBERT HABAZAJ

THE IMPACT OF PEER RELATIONS IN THE ACADEMIC PROCESS AMONG ADOLESCENTS
Irma LEKA (PEZA) PhD Candidate

PRIORITETET DHE NEVOJAT PËR REFORMIM TË PUSHTETIT VENDOR NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE. MANAXHIMI I BURIMEVE UJORE.
Prof Assoc Dr. Alba Robert DUMI

BUXHETI DHE ECURIA E TË HYRAVE BUXHETORE NË KOSOVË

Dr.Agim Berisha
Profesor: Kolegji BIZNESI
agim.berisha74@hotmail.com
Adresa: No. 29 Rr.Motrat Qiriazi,
Ulpian, 10000 Prishtinë
Kosovë

Abstract

In postwar Kosovo in 1999 began to establish a system of collected tax revenue and budget, that budget was initially created as a reaction to urgent problems. Within the paper will focus mainly on budget revenues, including revenues and border revenues collected within the country. In Kosovo since the postwar structure of budget revenues is mainly dominated by border revenues, noting increased participation of border revenues in filling the state budget, versus internal revenue.

Keywords: budget, taxes, budget revenues.

Përmbledhje

Në Kosovën e pasluftës së vitit 1999 filloi të vendoset sistemi tatimor dhe të vilen të ardhura buxhetore, që fillimisht buxheti është krijuar si reaksion ndaj problemeve emergjente. Në kuadër të punimit do të fokusohemi kryesisht te të hyrat buxhetore, duke përfshirë të hyrat kufitare dhe të hyrat e mbledhura brenda vendit. Në Kosovë që nga periudha e pasluftës struktura e të hyrave buxhetore kryesisht dominohet nga të hyrat kufitare, ku vërehet pjesëmarrja më e madhe e të hyrave kufitare në mbushjen e buxhetit të shtetit, kundrejt të hyrave të brendshme.

Hyrje

Menjëherë pas luftës, që nga shtatori i vitit 1999 filloi të vendoset sistemi tatimor dhe të vilen të ardhura buxhetore. Në këtë mënyrë filloi të ndërtohet sistemi i ri buxhetor i Kosovës që fillimisht buxheti është krijuar si reaksion ndaj problemeve emergjente.
Vështirësitë kanë qenë objektive, sidomos në mungesën e të dhënave solide për indikatorët makroekonomikë dhe lëvizjet e tyre. Kjo ka vështirësuar shumë planifikimin real të të ardhurave buxhetore dhe zakonisht është përcjellur me teprica të konsiderueshme buxhetore.
Administrimi i sistemit fiskal dhe buxhetor në tërë këtë periudhë karakterizohet me një ndikim të madh të administratës ndërkombëtare dhe me një marrje graduale, por shumë të ngadalshme të përgjegjësive nga institucionet kosovare. Varshmëria e të hyrave buxhetore nga të hyrat kufitare dhe niveli i ulët i të hyrave të brendshme, vazhdon ta përcjell ekonomin kosovare që nga paslufta e në vazhdimësi, kjo tregon së pari nivelin e ulët zhvillimor në vend dhe

karakterin kryesisht fiskal të politikës fiskale në vend dhe së dyti varshmërinë e ekonomisë së vendit nga importi.

Materiali dhe metoda

Për finalizimin e këtij punimi, materiali i paraqitur ka mbështetje si vijon:

a) Studime dhe literaturë vendëse dhe të huaj, si dhe raporte e publikime nga Ministria e Financave ku trajtohen çështje të buxhetit dhe ecuria e të hyrave buxhetore në Republikën e Kosovës.
b) Është përdorur burimi statistikor vendas, metoda e analizës dhe sintezës, tabelare, e shqyrtimit në dinamikë të çështjeve, metoda krahasuese, etj.

Rezultate dhe diskutime

Buxheti është një instrument financiar i shtetit nëpërmjet të cilit shteti siguron dhe administron burimet monetare me interes të nevojave të përbashkëta të ekonomisë dhe zhvillimeve të vendit. Në buxhet pasqyrohen shpenzimet dhe të ardhurat e parashikuara nga qeveria për një periudhë një vjeçare. Buxheti përfaqëson një plan financiar që përmbledh të ardhurat dhe shpenzimet qeveritare të parashikuara për vitin e ardhshëm.[1]
Buxheti i shtetit është një dokument apo program vjetor i cili miratohet nga organi legjislativ (Kuvendi), në të cilin përfshihen të gjitha të hyrat dhe shpenzimet publike.[2] Dokumenti juridik dhe kontabël që përmban shumat e të hyrave dhe të shpenzimeve të shtetit, si rregull, për një periudhë vjetore quhet buxhet i shtetit.[3] Pra, buxheti është plan i të hyrave dhe shpenzimeve të shtetit, që i përgjigjen një periudhe kohe të caktuar. Buxheti qeveritar është një deklaratë vjetore e shpenzimeve të parashikuara dhe të ardhurave gjatë vitit të ardhshëm së bashku me ligjet dhe rregulloret që do të mbështesin shpenzimet dhe të hyrat.[4]
Buxhetet qeveritare ndryshojnë në madhësi dhe detaje, por të gjitha kanë komponentë të njëjta. Tre komponentët kryesore buxhetore (Parkin Powell Matthews, Economics) janë:

1. Të ardhurat,
2. Shpenzimet dhe
3. Balanca buxhetore.

Duke pasur parasysh se buxheti është i përbërë nga pjesë jo domosdosmërisht të barabarta siç janë shpenzimet dhe të ardhurat, mund të themi se shërben për të regjistruar dhe kontrolluar si kryerjen e shpenzimeve ashtu edhe realizimin e të ardhurave të planifikuara.
Në buxhet dy pjesët kryesore të tij si shpenzimet ashtu edhe të ardhurat parashikohen me kohë dhe duhet të paraqiten të detajuara.
Shteti kryen një varg të detyrave dhe funksioneve në bazë të kuadrit ligjor brenda ekonomisë së vendit. Për kryerjen e detyrave dhe funksioneve në ekonomi dhe ofrimin e shërbimeve publike nevojiten mjete financiare.
Në shtetet moderne pjesa kryesore e të hyrave publike përbëhet nga ato tatimore. Tatimi është instrumenti themelor financiar për sigurimin e të

---

[1] Guidë për qytetarët, Tiranë 2002, f. 26.
[2] Sherif Bundo & Gentiana Cane, Financë, Tiranë, 2003, f. 226.
[3] Prof. dr. Sabah Hilmia, Prof. dr. Anastas Angjeli, Financat publike, Tiranë, f. 103.
[4] Parkin Powell Matthews, Economics, Sixth edition, f. 555.

ardhurave të buxhetit të shtetit.[5] Mjetet financiare të nevojshme për mbulimin e shpenzimeve publike, shteti i siguron përmes mbledhjes së të hyrave publike, ku në këtë kuadër në shtetet bashkëkohore tatimet konsiderohen burimi kryesor i të hyrave buxhetore. Kosova ka arritur të krijoj një qëndrueshmëri buxhetore dhe tatimet konsiderohen burimi kryesor i të hyrave buxhetore, veçmas që nga paslufta e karakterizon varshmëria e të hyrave buxhetore nga të hyrat kufitare në raport me të hyrat e brendshme. Buxheti qeveritar ka tre qëllime kryesore:[6]

1. Për të deklaruar shkallën dhe alokimin e shpenzimeve qeveritare dhe planet për të financuar aktivitetet e saj,
2. Për të stabilizuar ekonominë,
3. Për të inkurajuar rritjen afatgjate të ekonomisë dhe zhvillimin e balancuar rajonal.

Para luftës së dytë botërore (Parkin Powell Matthews, Economics, Sixth edition), buxheti kishte vetëm qëllimin e parë- për të planifikuar dhe financuar aktivitetin e qeverisë, por gjatë viteve 1940 dhe 1950 filloi të marrë qëllimin e dytë të saj - stabilizimin e ekonomisë, ndërsa më pas, veçmas viteve të fundit ka marr qëllimin e tretë - për të ndihmuar dhe siguruar rritjen ekonomike dhe zhvillim të balancuar rajonal.

Në këtë kuadër, vlen të ceket se Kosova ka arritur të krijojë një qëndrueshmëri buxhetore, mirëpo më tepër është i orientuar ka qëllimi i parë, e shumë më pak ka dy qëllimet tjera.

1. Ecuria e të hyrave fiskale në buxhet

Kosova në periudhën e pasluftës ka ndërtuar një sistem fiskal rishtas, të orientuar kryesisht në drejtim të harmonizimit me standardet Evropiane. Tatimet kanë luajtur dhe mbesin të një rëndësie të veçantë, si nga aspekti i mbledhjes së të hyrave buxhetore, ashtu edhe sa i përket pjesëmarrjes në Bruto Produktin Vendor (BPV-në).

Grafiku 1: Ecuria e të hyrave buxhetore në periudhën 2010-2012

[5] Sherif Bundo & Gentiana Cane, Financë, Tiranë, 2003, f. 215.
[6] Parkin Powell Matthews, Economics, Sixth edition, f. 555.

Nga grafiku shihet se, të hyrat buxhetore kanë pasur një trend rritës nga një periudhë në tjetrën. Në strukturën e të hyrave buxhetore dominojnë të hyrat kufitare në krahasim me ato vendore, d.m.th se të hyrat buxhetore vazhdojnë të varen nga të hyrat të cilat mblidhen në kufi.
Në tabelën në vijim pasqyrohet, pjesëmarrja në përqindje e buxhetit qeveritar në Bruto Produktin Vendor.

Tabela 2: Buxheti Qeveritar, si përqindje në Bruto Produktin Vendor, 2007-2012

Përshkrimi	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Të hyrat	26.0 %	23.6 %	29.3 %	27.2 %	27.4 %	26.7 %
Shpenzimet primare	19.1 %	23.9 %	29.0 %	29.8 %	28.8 %	29.1 %
Nga të cilat: Shpenzimet kapitale	3.9 %	8.9 %	10.2 %	10.6 %	11.1 %	11.1 %
Bilanci rrjedhës	11.4 %	8.5 %	10.9 %	9.8 %	10.3 %	8.9 %
Bilanci primar	6.9 %	-0.3 %	-0.2 %	-2.6 %	-1.4 %	-2.4 %
Bilanci përgjithshëm	6.6 %	-0.4 %	-1.1 %	-2.8 %	-1.6 %	-2.6 %

Burimi: Korniza afatmesme e shpenzimeve 2014-2016, Ministria e Financave, Prishtinë 2013

Grafiku 2: Buxheti Qeveritar, si përqindje në Bruto Produktin Vendor, 2007-2012



Nga tabela dhe grafiku, vështruar Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, deri në vitin 2007 vërehet aplikimi i një politike të kufizuar fiskale që ka rezultuar me bilanc pozitiv primar rreth 6.6 % të BPV-së. Nga viti 2008-2012 filloi të aplikohet një politikë më e hapur fiskale që ka rezultuar me një deficit të lehtë -0.4 % të BPV-së në vitin 2008, ku viti 2010 është përmbyllur me deficit -2.8 % të BPV-së, ndërsa duke u reduktuar në vitin 2011 në -1.6 % si pjesëmarrje në BPV-së, ndërsa gjatë vitit 2012 deficiti arriti në -2.4 %. Megjithatë mund të themi se, Kosova nga një buxhet suficitar nga viti 2008, kalon në një buxhet deficitar, ku duhet bërë kujdes në menaxhimin e deficitit dhe mos tejkalimin e tij mbi 3 % të BPV-së.
Në vijim, pasqyrojmë zhvillimet fiskale në raport me BPV-në, në vendet e rajonit në vitin 2012.

Grafiku 3: Zhvillimet fiskale në raport me BPV-në



Në grafikë, pasqyrohen zhvillimet fiskale në raport me BPV-në në vendet e rajonit, ku vërehen dallime në mes të vendeve të rajonit sa i përket pjesëmarrjes së të hyrave në BPV-në, shpenzimeve në BPV-në dhe borxhit publik në BPV-në. Nga vendet e rajonit Shqipëria, Maqedonia dhe Kosova kanë nivel më të ultë të pjesëmarrjes së të hyrave dhe shpenzimeve publike në raport me BPV-në në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Në këtë kuadër, Kosova për dallim me vendet e rajonit ka nivelin më të ulët të borxhit publik në raport me BPV-në.

1.1.1. Të hyrat e tatimeve kufitare në buxhet

Vend qendrorë në sistemin e të hyrave shtetërore në vendet në zhvillim kanë tatimet, madje tatimet indirekte.[7] Një nga arsyet pse tatimet indirekte, në vendet në zhvillim janë forma kryesore e të hyrave buxhetore mbetet se procedura e caktimit, pagimit dhe e kontrollit të pagimit të këtyre tatimeve është më e thjeshtë.

Vendet transitore me nivel të ulët zhvillimor në strukturën e të hyrave buxhetore kryesisht varen nga të hyrat kufitare. Një situatë e tillë e ka përcjellë edhe Kosovën që nga periudha e pasluftës, ku vërehet pjesëmarrja më e madhe e të hyrave kufitare në mbushjen e buxhetit të shtetit, kundrejt të hyrave të brendshme. Duke pasur parasysh nivelin e ulët zhvillimor në Kosovë, është e pajustifikueshme të vazhdohet të mbahet me tepër orientimi i politikës fiskale në funksion të rritjes së të hyrave buxhetore dhe mos aplikimi i masave lehtësuese fiskale ndaj aktivitetit ekonomik. Kjo vijë e orientimit të politikës fiskale në Kosovë tregon se, vendimmarrësit tashmë kanë gjetur strehën e sigurt të vjeljes së të hyrave buxhetore në kufi, që mund ta definojmë si parimi „streha e sigurt e vjeljes së të hyrave buxhetore në kufi" që në vete përfshinë dy dimensione inverse në mes veti:

E para, më lehtë vjen deri te arkëtimi i të hyrave buxhetore dhe

[7] Bozhidar Jelçiq, Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare, Prishtinë, 1985, f. 66.

E dyta, vështirëson rritjen e aktivitetit ekonomik, në mungesë të masave fiskale lehtësuese.

Më poshtë pasqyrohet ecuria e të hyrave kufitare në buxhet dhe varshmëria e tyre nga niveli i importit.

Grafiku 4: Ecuria e të hyrat kufitare, në milion euro në periudhën 2010-2012



Grafiku 5: Trendi i importeve dhe të hyrave në kufi në përqindje në periudhën 2010-2012



Nga grafiku, vështruar të hyrat nga kufiri, vërehet se këto të hyra kanë pasur një trend rritës ku nga 701 milion sa ishin në vitin 2010 u rritën në 840 milion në vitin 2012, apo shprehur në përqindje gjatë kësaj periudhe në vitin 2011 krahasuar me vitin 2010 u ngritën rreth 18.1 %, ndërsa në vitin 2012 rritja ishte më e ulët duke pasur një rritje për 2.1% krahasuar me vitin paraprak. Të hyrat kufitare mblidhen në kalimet kufitare, duke përfshirë të hyrat nga TVSH-ja në mallrat e importuara, detyrimet doganore dhe akcizën. Të hyrat kufitare varen nga niveli i importit në vend. Nga kjo mund të konstatohet se, një nga arsyet kryesore në vazhdimin e varshmërisë së të hyrave buxhetore nga të hyrat

kufitare, mbetet varshmëria e ekonomisë kosovare nga importi dhe niveli i ulët zhvillimor në vend. Kështu që, ecuria e të hyrave buxhetore të mbledhura në kufi vjen si rezultat, i varshmërisë dhe ecurisë së importit duke u përcjellë edhe me trendin e të hyrave kufitare.
Kontribuues kryesor në të hyrat nga kufiri janë të hyrat nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) me një pjesëmarrje prej mesatarisht 50%, pasuar nga tatimi mbi akcizë 35% në mesatare, përderisa pjesëmarrja e taksave doganore në gjithsejtë të hyrat nga kufiri është 15%

1.1.2. Të hyrat nga tatimet e brendshme në buxhet

Të hyrat e brendshme janë tatimet të cilat mblidhen nga tatimpaguesit brenda territorit të Kosovës. Në strukturën e të hyrave buxhetore pjesëmarrja e mbledhjes së të hyrave të brendshme edhe përkundër trendëve pozitive, akoma është e ulët në krahasim me të hyrat kufitare.
Të hyrat nga tatimet e brendshme përfshijnë të hyrat nga: TVSH-ja e brendshme, tatimi në të ardhurat personale, tatimi në të ardhurat e korporatave.
Shikuar ecurinë e të hyrave të brendshme në buxhet vërehet një trend rritës nga viti në vit, mirëpo ende nuk është e kënaqshme vjelja e tatimeve brenda vendit. Në këtë kuadër, një nga sfidat institucionale mbetet në vazhdimësi në nivel të autoriteteve tatimore rritja e të hyrave brenda vendit dhe mos varshmëria e mbushjes së buxhetit nga të hyrat kufitare. Me fjalë tjera, në nivelin e të hyrave vendore, ngritja në këtë kategori të të hyrave, bazohet përveç nga rritja e aktivitetit afarist në vend, veçmas nga ngritja e efikasitetit brenda Administratës Tatimore të Kosovës (ATK-së), që në kuadër të aktiviteteve të saj institucionale brenda kuadrit ligjor në mënyrë sistematike duhet shtrirë kontrollin tek tatimpaguesit në funksion të rritjes së të hyrave dhe uljes së evazionit fiskal.

Grafiku 6: Të hyrat e brendshme 2010-2012



Grafiku 7: Rritja reale e BPV-së dhe rritja e të hyrave të arkëtuara në vend në përqindje në periudhën 2010-2012



Vështruar grafikun, shihet se të hyrat vendore gjatë periudhës 2010-2012 kanë pasur një trend rritës. Në vitin 2011 TAP (Tatimi në të ardhurat personale) shënoi rritje për 13.6 % krahasuar me vitin paraprak, TAK (Tatimi në të ardhurat e korporatave) shënoi rritje 6.0 %, ndërsa TVSH-ja shënoj rritje për 27.8 %.
Në vitin 2012 të hyrat e inkasuara nga këto tatime shënuan rritje por krahasuar me vitin 2011 në raport me atë 2010 rritja ishte më e lehtë, përkatësisht TAP pati një rritje për 8.6 %, TAK shënoi një rritje për 9.3 %, ndërsa TVSH-ja për 6.7 %.

Përfundimi

Tatimet kanë luajtur dhe mbesin të një rëndësie të veçantë, si nga aspekti i mbledhjes së të hyrave buxhetore, ashtu edhe sa i përket pjesëmarrjes në BPV.
Në kuadër të këtij punimi lidhur me efektet financiare të tatimeve në buxhet paraqesim disa nga konkluzionet dhe rekomandimet që konsiderohen të nevojshme të merren parasysh.

Konkluzione:

1. Varshmëria e të hyrave buxhetore nga të hyrat e inkasuara në kufi në raport me të hyrat e brendshme.
Argumenti: Niveli i ulët zhvillimor në vend, ka orientuar ekonomin kosovare në periudhën e pasluftës në varshmërinë nga importi, e cila është reflektuar edhe në të hyrat buxhetore, përkatësisht në nivelin dominues të të hyrave kufitare (rreth 70%) në raport me të hyrat e brendshme.
2. Vështruar Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, vërehet kalimi nga një buxhet suficitar në deficitin buxhetor.
Argumenti: Vështruar Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, deri në vitin 2007 vërehet aplikimi i një politike të kufizuar fiskale që ka rezultuar me bilanc pozitiv primar rreth 6.6% të BPV-së. Nga viti 2008 filloj të aplikohet një politikë më e hapur fiskale që ka rezultuar me buxhet pothuajse të balancuar gjatë vitit 2008, ku viti 2009 është përmbyllur me deficit prej -1.1% BPV-së, 2010 -2.8% të BPV-së, duke u reduktuar në vitin 2011 në -1.6 % si pjesëmarrje në BPV-së ndërsa në vitin 2012 deficiti buxhetor ishte prej 2.6% të BPV-së.
Disa nga rekomandimet e adresuara janë si vijon:

1. Qeveria e Kosovës duhet bërë kujdes në menaxhimin e deficitit buxhetor dhe mos tejkalimin e tij mbi 3% të BPV-së.
2. Qeveria e vendit dhe Autoritetet tatimore duhet të fokusohen në ndryshimin e strukturës në mbledhjen e mjeteve buxhetore, duke qenë jo të favorshme e bën të domosdoshme përmirësimin e saj dhe orientimin në të hyrat e brendshme.
Gjatë periudhës së hulumtuar, që nga paslufta vërehet se pjesëmarrja e të hyrave në buxhet varet nga tatimet e mbledhura në kufi rreth 70 % dhe ky trend është duke vazhduar ende. Varësia e të hyrave buxhetore nga mjetet e mbledhura në kufi është rezultat i varësisë nga importi dhe nivelit të ulët zhvillimor në vend. Është e nevojshme të kalohet në mbledhjen e të hyrave në brendi të ekonomisë, dhe si rrjedhojë politika fiskale duhet të ketë fokus të njëkohshëm si ruajtjen e balancave makroekonomike ashtu edhe mbështetjen e sektorit privat të ekonomisë kosovare.
3. Në periudhën afatmesme duhet forcuar autoritetet institucionale përgjegjëse (ATK-në dhe Doganat e Kosovës) në drejtim të reduktimit të evazionit fiskal dhe futjes së ekonomisë informale në rrjedha legale, (pasi në këtë sferë dëmtohen të hyrat buxhetore).

Literatura:

Bundo, Dr. Sherif - Gentiana Cane, *Financë*, Tiranë, 2003,

Matthews, Parkin Powel, *Economics,* Sixth edition,

Guitë qytetare për buxhetin, Tiranë 2002.

Jelçiq, Bozhidar, *Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare*, Prishtinë, 1985.

Pierson, Christopher, *Shteti modern*, Tiranë, 2009.

Hilmia, Dr. Sabah, Angjeli, Dr. Anastas, *Financat publike*, Tiranë 1994,

Komoni, Prof. dr. Sabahudin, *Financat publike*, "Leoprint", Prishtinë, 2008.

Korniza afatmesme e shpenzimeve 2014-2016, Republika e Kosovës, Ministria e Financave, Prishtinë 2013.

ANEKS

Tabela 1: Trendi i të hyrave buxhetore në periudhën 2010-2012, në milion euro

Përshkrimi	2010	2011	2012
Të hyrat totale	1,166	1,309	1,322
Të hyrat nga tatimet	894	1,058	1,094
Të hyrat vendore	221	261	284
Të hyrat doganore	701	828	845
Kthimet	-28	-31	-35
Të hyrat jo tatimore dhe vetanake	148	163	145
Dividenta	85	60	45
Mbështetja buxhetore nga donatoret	30	19	37
Komisioni Evropian	30	--	--
Banka Botërore	0	19	37
Grandet e projekteve	0	0	0
Fondi i mirëbesimit	10	9	--

Tabela 2:Zhvillimet fiskale në raport me BPV-në (në përqindje) në periudhën 2012

Shtetet	Të hyrat/BPV	Shpenzimet/BPV	Borxhi publik/BPV
Kosova	27.8	29.2	8.59
Maqedonia	28.7	31.3	30.9
Bosnjë e Hercegovina	47.0	49.8	43.7
Mali i Zi	37.6	42.7	53.9
Serbia	41.7	48.3	63.1
Kroacia	37.0	41.4	54.3
Shqipëria	24.9	28.4	63.8

Burimi:Republika e Kosovës, Ministria e Financave, Buletini vjetor për vitin 2012, Prishtinë 2013

Tabela 3: Të hyrat kufitare, në milion euro dhe në përqindje në periudhën 2010-2012

Përshkrimi	2010	2011	2012
Rritja nominale e importeve	15.6 %	12.0%	-3.2 %
Rritja e të hyrave të arkëtuara në kufi	10.3 %	18.1%	2.1 %
Akciza e arkëtuar në kufi	231	285	303
Ndryshimi vjetor në %	---	23.3 %	6.6 %
TVSH-ja në kufi	360	419.5	418.9
Ndryshimi vjetor në %	---	16.6 %	-0.1 %
Taksat doganore	110.2	121.2	117.7
Ndryshimi vjetor në %	---	10.0 %	-2.9 %
Totali i të hyrave kufitare	701	825	840

Burimi:Korniza afatmesme e shpenzimeve 2014-2016, Ministria e Financave, Prishtinë 2013

Tabela 4: Të hyrat e brendshme në milion euro në periudhën 2010-2012

Përshkrimi	2010	2011	2012
Rritja reale e BPV-së	3.2%	4.5%	2.9%
Rritja e të hyrave të arkëtuara në vend	7.9%	18.1%	8.8%
Tatimi në të ardhurat personale	70	79	86
Ndryshimi në %	---	13.6%	8.6%
Tatimi në të ardhurat e korporatave	57	60	65
Ndryshimi në %	---	6.0%	9.3%
TVSH-ja e brendshme	95	121	130
Ndryshimi në %	---	27.8%	6.7%

Burimi: Korniza afatmesme e shpenzimeve 2014-2016, Ministria e Financave, Prishtinë 2013

PRIORITETET DHE NEVOJAT PËR REFORMIM TË PUSHTETIT VENDOR NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE. MANAXHIMI I BURIMEVE UJORE.

Prof Assoc Dr. Alba Robert DUMI

Prof Assoc Dr, Drejtor i Studimeve të Ciklit të Dytë dhe të Tretë të Studimeve, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, L Pavarësia, Sheshi: Skelë, Vlorë, Albania, alba.besi12@gmail.com

Ma Borana KOÇIU
Fakulteti Ekonomik, Departamenti Manaxhimit, Tiranë Albania

Abstrakt: Manaxhimi i burimeve hidrike ka kaluar nëpër një proces të gjatë zhvillimi derisa ka arritur në statusin që ka fituar sot. Ai është një nga domosdoshmeritë e manaxhimit organizativ dhe një synim që çon në forcimin e shkencës së manaxhimit dhe përmirsimin e eficencës në punë për mirë organizimin e politikave qeveritare monetare fiskale dhe për forcimin e pushteteve në dobi të komunitetit dhe shoqërisë civile.
Ky punim ka ne themel te vet modelet konkrete infrastrukturore siç është infrastruktura hidrike dhe kapacitetet menaxhuese të kësaj infrastrukture si dimension i prekshëm mbi të cilin vepron ndjeshëm një nga aspektet më delikate të shoqërisë shqiptare, aspekti i ofrimit në kohe reale të shërbimeve publike, involvimin e sektorit privat në investime publike, si edhe sugjeron ndërtimin e modeleve të reja menaxheriale në dobi ëe bizneseve dhe komunitetit. Në këtë punim do të prezantoj analizën krahasuese të manaxhimit të burimeve ujore me rolin që aktorët luajnë në decentralizimin e politikave të tij.

Fjale kyçe: manaxhim hidrik, zhvillim demografik,decentralizim pushteti,performancë

JEL Classifications: HO, H1, I O, I 1, I 3, I5

1. Hyrje

Qëllimi i punimit që po prezantoj, është një analizë e përmbledhur dhe pikerisht manaxhimi i kapaciteteve hidrike, lehtesitë qe ai ofron për mire -manaxhimin efektiv të sistemeve hidrike si pjesë e permirësimit të kapaciteteve të menaxhimit infrastrukturor urban dhe ofrimit të shërbimeve publike në qytet dhe zonat rurale.
Sot 40 % e familjeve shiptare kanë mungesë të edukimit bazë për të manaxhuar resourset për ujë, ngrohje dhe shërbimi shëndetësor; pak më tepër se 50 % te banorove te qytetit dhe të zonave rurale kanë akses për ujë të pastër dhe të pijshëm.

Theksojmë se Shqipëria ka resurse të mëdha ujore. rreshjet në të gjithë vendin janë të shumta, burimet nëntokësore janë të shumta dhe shumë cilësore, me kërkesa minimale trajtimi në mos vetëm trajtim me klor. Me përjashtim të Tiranës, ku rreth gjysma e furnizimeve janë nga liqeni, vendi i gjithe mbështetet tek burimet tokësore te furnizimit.
Në dekadën e fundit Shqipëria ka përmirësuar ndjeshëm sistemin e saj të rrënuar të furnizimit me ujë, vaditjen, dhe infrastrukturat e kanalizimeve nëpërmjet një platforme që konsiston në fuqizimin e pushtetit vendor; involvimin e sektorit privat në ofrimin e shërbimeve publike; dhe përdorimin e platformave të iniciuara nga komuniteti për ofrimin e sherbimeve rurale të qëndrueshme. Banka Botërore ka nisur një projekt afatgjatë suporti për sistemin e furnizimit me ujë në shqipëri dhe kjo që prej 1994.

1.1. Reformimi i sistemit ujor

Qëllimi i reformimit të sistemit ujor ishte reformimi i kapaciteteve manxhuese, riparimi, dhe ringritja e sektorit të furnizimit me ujë; për zgjerimin e aksesit në ujin e pijshëm për familjet në nevojë në zonat urbane dhe rurale; dhe krijimin e sistemeve të trajtimit të humbjeve të ujrave si dhe të ujrave të zeza. Rezultatet paraprake na trgojnë një progres të qëndrueshëm.(Studies &Center of Economis, CESS, 2001;2004-2009)

1.1.2 Konceptet moderne të manaxhimit

Henri Fayol (1841-1925) kontribuoi në konceptet moderne të menaxhimit dhe propozoi pesë funksione prioritare në menaxhim: planifikimi, organizimi, udhëheqja, koordinimi dhe kontrolli, të cilat i gjejmë gjerësisht të aplikuara edhe sot. Ndërsa Peter F. Drucker (1909 – 1995) – babai i menaxhimit modern ka thënë: "Qendra e shoqërisë moderne, ekonomisë dhe komunitetit nuk është teknologjia. Nuk është informacioni. Nuk është produktiviteti. Ai është institucioni i menaxhimit si një organ i shoqërisë që të prodhojë rezultate. Dhe menaxhimi është mjeti specifik, që e bën institucionin të aftë të prodhojë rezultate"
Analiza manaxheriale e faktorevë të jashtëm dhe të brendshëm të kapaciteteve hidrike fokusohet mbi menyrën e menaxhimit të një dimensioni real në fushën e shërbimeve publike, rritjen e kapaciteteve menaxhuese nëpërmjet decentralizimit dhe fuqizimit të qeverive vendore, në ofrimin e këtyre shërbimeve, involvimin e sektorit privat në investime publike dhe rolin e organizatave joqeveritare në koordinimin e projekteve të ofruara në sektorin e furnizimit me ujë dhe sistemin e vaditjes me impakt kryesor në zhvillimin bujqësor dhe reduktimin e varferisë.

2. Hipotezat dhe analiza e tyre në kontekstin manaxherial

Por cili është roli i menaxhimit si art dhe shkencë në Shqipëri?

Në analizën tonë do të marrim ndikimin dhe rolin që ai duhet të ketë në funksionin e administratës publike. Por fillimisht le të shpjegojmë dy nocione duke u mbështetur në Fjalorin Politik të Oksfordit (2001): "administrata publike (public administration) ka të bëjë me institucionet e burokracisë shtetërore: strukturat organizative që përbëjnë bazën e marrjes dhe të zbatimit të vendimeve; si dhe rregullat sipas të cilave kryhen shërbimet publike". Ndërsa "Administrimi publik (Public Administration), si degë e shkencave politike,

është studimi i administratës publike nëpërmjet përshkrimit institucional, analizës dhe vlerësimit politik, si dhe i analizës së marrëdhënieve qeveritare.

2.1 Manaxhimi i kapaciteteve hidrike dhe roli i tyre në dimensionimin infrastrukturor

Janë bërë përpjekje për një vlerësim kritik të ecurisë dhe realitetit të manaxhimit infrastrukturor dhe të realizimit të misionit të organizmave rajonale dhe infrastrukturore të manaxhimit dhe një pasqyre të qartë, korrekte aktuale e konkurueshmerise se industrive shqiptare dhe hapave te vegjel rajonale integrues ne prirjen afatgjate te orientimit infrastrukturor te tyre. (Dumi A IJERM, USA 2012, pp1245)

H 1- Shqipëria përballet me një problem të menaxhimit të kapaciteteve hidrike, jo me një problem të mungese së ujit.

H 2-Zhvillimi i turizmit në zonat bregdetare—si një element i rëndësishëm i strategjisë shqiptare për zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e varferisë—kërkon sasi të medha të ujit të pijshëm.

H 3-Fuqizimi i pushtetit lokal është një komponent i rëndësishëm i strategjisë reformuese në sektorin e furnizimit dhe të menaxhimit me efikasitet të infrastrukturës hidrike.

2.2 Zhvillimi i institucioneve dhe nevojat për menaxhim të administratës publike

Këtë formë menaxhimi, organizativ të administratës publike, në fund të viteve '80-të, e gjejmë të ideuar nga David Osborne dhe Ted Gaeblar, të cilët e zhvilluan në teorinë e quajtur "Menaxhimi i Ri Publik", e cila mbronte idenë për përdorimin e metodave të sektorit privat me qëllim efikasitetin e shërbimeve ndaj publikut. Ata argumentuan në librin e tyre "Reinventing Governmen" (1992) (Rikonceptimi i Qeverisjes) se ideja e trajtimit të qeverisë si një sipërmarrje nuk do të thotë ta drejtosh qeverinë si një biznes, por ata shprehin idenë e privatizimit të disa shërbimeve publike, me qëllim që të bëhen sa më efikase dhe të përgjegjëshme.

2.2.1 Përmirësimi i shërbimeve publike, kërkesë e kohës

Njëkohësisht manaxherët ofrojnë idenë për zgjidhjen e problemeve krahas përmirësimit të shërbimit publik". Teoria e tyre u aplikua në administratën amerikanë në kohën e Presidentit Clinton (1993 2001).___Në grafikun e mësipërm janë dhënë tendencat e indikatoreve për vendet përfshirëse në project ku prioritar dhe të rëndësishëm janë forcimi i sistemit të administratrs publike dhe të rinjtë e kualifikuar në tregun e punës.

2.3 Çështë manaxhimi infrastrukturor hidrik?

Manaxhimi i kapaciteteve infrasrukturore hidrike, fenomeni i shumë përfolur sot

Objektivi i këtij komponenti është forcimi i kapaciteteve shqiptare për të manaxhuar burimet bregdetare të detit Adriatik dhe Jon e nëpërmjet zhvillimit

të një politike të përshtatshme operacionale si dhe instrumentave financiare ekonomik për manaxhimin e zonës bregdetare Jugore; forcimit të kapaciteteve të institucioneve për rritjen e efiçencës dhe efektivitetit të funksioneve rregullatore planifikuese dhe manaxheriale për manaxhimin e zonës bregdetare jugore në nivelin qëndror rajonal dhe lokal.; forcimit të rrjetit të monitorimit të cilësisë së ujit në bregdet,e forcimit të manaxhimit të zonave të mbrojtura në parkun kombëtar te Butrintit rritjes së bazës së njohurive dhe rritjes së ndërgjegjësimit publik në lidhje me çështjet e bregdetit në Shqipëri.



Grafiku 1:Treguesit DPAR e analizuar nga Municipal Water Project ,CESS Studies2011, për rajonalizimin e shërbimeve publike

2.3.1 Kapacitetet hidrike si dimension drejt zhvillimit të menaxhimit infrastrukturor urban. Arsyet për një reformë të domosdoshme !

Infrastruktura shqiptare dhe shërbimet e ofruara për furnizimin me ujë kanë filluar degradimin që në vitet 1970. Insitucionet e furnizimit me ujë ishin jo profesionale, me mungesa në manaxhim si rezultat i kombinimit të paaftësisë me vizionin politik të asaj kohe, tarifave të ulta të ujit, shpërdorimit në masë të gjerë prej klientëve, mungesa e mirëmbajtjes së pajisjeve dhe sistemeve, dhe stimulime të varfra për rritjen e performancës[1] .
Këto faktorë u bënë më të ndjeshëm sidomos me izolimin total të Shqipërisë dhe ndërprerjen e asistencës nga Kina në këtë sektor. Në dekadat e mëpasme, shumë nga pajisjet dhe sitemet e furnizimit arritën pikën maksimale të amortizimit, infrastruktura e furnizimit me ujë dhe ajo e kanalizimeve arritën të degradojnë plotësisht, me mundësi minimale për të përballuar kostot e riparimeve.

---

[1] *Commission of the European Communities, "Council directive of 27 June 1985 on the assessment of the affects of certain public and private projects on the environment", in Official Journal of the European Communities, L175, pages11,13,16, 23.*

Në fillimet e viteve 1990, sistemi i shpërndarjes me ujë të vendit në zonat urbane dhe rurale ishte plotësisht i shkatërruar. Menaxhimi i varfër dhe mungesa e planifikimit sollën që sistemi urban i furnizimit me ujë të kishte probleme madhore në fushën e mirëmbajtjes dhe të mos arrinte të ishte në të njëjtin hap zhvillimi me urbanizimin e shpejtë që po ndodhte . Në zonat rurale sistemi i vaditjes ishte shkatëruar si rezultat i mos mirëmbajtjes dhe ishte kthyer në një pengesë për zhvillimin e agrikulturës në vend. Kanalizimet ishin shumë të keqtrajtuara dhe në shumë raste mungonin.
Megjithatë, tranzicioni politik dhe ekonomik në Shqipëri solli rritjen e kërkesës për ujë.
Zonat urbane po zgjeroheshin me shpejtësi, dhe më shumë ujë i pijshëm nevojitej. Edhe pse shumë industri para viteve 1990 që ishin konsumatore të mëdha të ujit nuk funkiononin më, industri dhe biznese të reja po lindnin. Zhvillimi i turizmit në zonat bregdetare si një element i rëndësishëm i strategjisë shqiptare për zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e varfërisë kërkon sasi të mëdha të ujit te pijshëm, por kufizimet dhe mungesa e trajtimit të ujrave të zeza pengon zhvillimin turistik. Në zonat rurale, krijimi i fermave familjare private pas ndarjes nga shteti të fermave kolektive ka krijuar anomali të mëdha në sistemin e vaditjes duke e lënë atë në mëshirë të fatit. *Mungesë menaxhimi, Jo mugesë uji. (Analiza e H1)*

Në një kohë që vendi ynë ka burime hidrike të brendeshme 80% në shkallë pastrtije në raport boteror.

- Shqipëria përballet me një problem të menaxhimit të kapaciteteve hidrike, jo me një problem të prodhimit të ujit. Studimet tregojne se burimet ekzistuese mund të përballojnë mëse mjaftueshëm kërkesën për ujë të vendit. Në shumë qytete, prurjet e ujit në burime janë 500 to 700 litra për frymë në ditë, por humbjet dhe shpërdorimet tregojnë se vetëm një pjesë e ujit konsumohet. (sipas statistikave zyrtare 60 % e sasisë së ujit shpërdorohet.)[2]
- Pothuajse çdo herë problemet e skarcitetit të ujit mund të konsiderohen të lehta nëse arrihet të kalojnë nëpërmjet kontrollit të matësave, detektimi i ndërhyrjeve në rrjet, përmirësimet, prerja e lidhjevete të paligjshme dhe përmirësimi i mënyrave të depozitimit dhe shpërndarjes. Shpërndarja është gjithashtu një problem sezonal:
- Më tepër ujë nevojitet në sezonin e verës, kur rreshjet janë të pakta, në zonat rurale uji i pijshëm keqpërdoret për vaditje .
- Zonat me resurse turistike përdorin shumë ujë . Mesatarisht, uji vjen me orar 3-4 orë ne ditë, me disa zona të vecanta që uji vjen nje herë në tre ditë.[3]

Kanalizimet përbëjnë një problem më të madh se uji i pijshëm. Kanalizimet kanë pothuaj të njejtin mbulim si sistemi i ujit të pijshëm. Zonat urbane në më të shumtën e rasteve kanë kombinuar grumbullimin e ujrave të rreshjeve dhe ujrat e zeza të cilat shkarkohen në rezervuarë hidrovoresh për tu shkarkuar më pas në degë të veçanta.

---

[2] *De Soto, Follet A and Hermine; Egamberdi, Nilufar; Center for Economic and Social Studies (CESS), 2001. Albania: Municipal Water and Sanitation Project – Social Assessment. Washington DC. Government of Albania. 2008. The National Strategy for Socio-Economic Development (NSSED).*

[3] *Albania: Municipal Water and Sanitation Project – Social Assessment. Washington DC.*

- Rreth 40% e popullsisë në zonat urbane kanë lidhje me një pusetë të ujrave të zeza. Në zonat rurale, vetëm një pjesë e vogël e siperfaqes është e plotësuar me kanalizime të ujrave të zeza. Në këto zona familje të tëra sigurojnë nevojat nëpërmjet puseve private,sisteme tubacionesh të thjeshta dhe pa dranazhim. Ringritja e sistemit të kanalizimeve të ujrave të zeza nuk po ecën në të njëjtin hap me zhvillimin e infrastrukturës, materialet, pajisjet dhe teknologjia e përdorur janë jashtë kohe dhe të amortizuara.[4]

Sot, në Shqipëri nuk ka sisteme të manaxhimit të mbetjeve dhe humbjeve.Një pjesë shkarkohen në gropa uji, sidomos në zonat turistike ku kanë një impakt negativ mbi ekosistemet e brishta dhe është një shqetësim i madh ambjental për qeverinë, komunitetin e biznesit dhe publikun.

2.4 Evolimi i sektorit të furnizimit me ujë

Zhvillimi, rënia dhe ripërtëritja e sektorit të furnizimit me ujë në Shqipëri në këto dekadat e fundit mund të ndahet në katër faza organizative dhe një fazë reformuese

Faza e parë daton ne vitin 1930, kur kompanitë italiane ndërtuan akuedotin e parë, i ndjekur nga një linje e kufizuar rrjeti tubacionesh dhe këto në qytetet kryesore . Disa nga këto sisteme vazhdojnë të funksionojnë dhe sot, pavarësisht moshës dhe mirëmbajtjes së tyre inadeguate.

Faza e dytë (1950–78) ishte e karakterizuar nga një ekspansion i shpejtë i shërbimeve, duke predominuar zonat urbane.

Faza e tretë (1978–91) pa deteriorimin gradual të shërbimeve të furnizimit me ujë, kjo si rezultat i problemeve të mungesës së manaxhimit nga ana e qeverisë, si dhe nga mungesa e ndihmave nga jashtë. Uji ishte cilësuar si një e drejtë, dhe tarifat ishin tepër të ulta për të përballuar kostot e furnizimit. Ishte i lirë prandaj shpërdorohej; mirëmbajtja e sistemit injorohej, dhe nuk bëhej as hapi më i vogël për përmirësime në sherbim apo në rrjetin e furnizimit.

Gjate fazës së katërt (1992–2003), pjesa më e madhe e infrastrukturës së kanalizimeve dhe furnizimit me ujë arriti që të bëhej e papërdorshme dhe të mos plotësonte asnjë standart funksional, dhe në disa raste duke tejkaluar pikën e kostos efektive të riparimit .

Faza e pestë reforma të thella me shkallë te lartë decentralizuese

---

[4] *Albania draft report " Public goals and strategy" year 2007page 19*



Grafiku 2 Evolimi i sektorit të furnizimit me ujë dhe indikatorët e shpërndarjes

Duke e mbledhur së bashku këto probleme politike , madhore, teknike, manaxheriale dhe funksionale kërkohej nje program riformues i shërbimeve të furnizimit me ujë i dizenjuar mirë dhe afatgjatë, i adresuar në suportimin e investimeve të rëndesishme në këtë sektor. Kjo ka qënë edhe një nga objektivat kryesore të Bankës Botërore.
Objektivat afatgjata të qeverisë në sektorin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimet janë që të arrijnë një furnizim të qëndrueshëm dhe sipas standarteve të Bashkimit Europian në zonat urbane dhe ato rurale. Për vaditjen, objektivat strategjike janë të mbajnë rrjetin vaditës, të zhvillojnë një sistem të qëndrueshëm shpërndarje me ujë dhe një sistem mirëmbajtjeje profesional, kjo duke stimuluar përdorimin efiçent të ujit. (Lourin,Gredler,International Specific Hidro-Syst.2011)



Tab 1: Analiza në % e prurjeve hidrike në pesë Vendet Adriatiko-Balltike, Burimi: (Lourin,Gredler,International Specific Hidro-Syst.2011)

Uji apo "Ari i kaltër "është një nga pasuritë më të rëndësishme tokësore. Në botë një miliard e 100 milion njerëz, pra 1/7 e popullsisë së botës nuk kanë akses në burimet hidrike dhe mbi dy milion njerëz që jetojnë në vendet në zhvillim dhe vdesin cdo vit nga semudjet që janë shkaktuara nga ndotjet ujore, kurre nuk ia dinë vlerën e paçmueshme kësaj pasurije.

3. Dilemat e zhvillimit te manaxhimit infrastrukturor hidrik

Në kuadrin e Samitit Botëror të Johannesburgut të gushtit të vitit 2005 është vënë si objektive qe brenda vitit 2015 të përgjysmohet numri i personave që vuajnë nga mungesa e ujit". Strategjia që do të mbeshtesi këto objektiva është që të adaptohet programi koordinimit të investimeve të huaja më potencialet ujore dhe burimet e disponueshme të ndërmarjeve të ujësjellesave, si dhe më fondet publike të manaxhuara prej pushtetit lokal. Faktorët kryesorë që sigurojnë suksesin në investimet dhe reformat për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në furnizimin me ujë dhe reduktimin e varfërise janë:

- Rëndësia e krijimit të një klime te favorshme;
- Zhvillimi dhe konkretizimi i një mjedisi të favorshëm ligjor dhe institucional i cili do ti krijojë pushtetit lokal të marrë të gjitha përgjegjësitë e manaxhimit cilësor të kapaciteteve hidrike si dhe krijimin e mekanizmit që do te sigurojë pjesëmarrjen e tyre në pregatitjen dhe implementimin e projekteve;
- Rëndësia e procesit të konsultimit dhe krijimi i mekanizmave institucionale;
- Marrjen e konsensusit të gjërë në nivel lokal përpara se të merren vendime për investime të rëndësishme në nivel qëndror dhe lokal, involvimin e sektorit privat në manaxhimin dhe operimin e shërbimeve të furnizimit me ujë;
- Krijimin e shoqatës së konsumatorëve të ujit e cila do të përfaqësojë konsumatorët në kërkesën për ofrimin e shërbimeve cilësore të furnizimit dhe shpërndarjes si dhe artikulimin e kërkesave të konsumatorëve;
- Rëndësia e planifikimit të burimeve, alokimin dhe manaxhimin e tyre;



Tabela 2 . *Tendenca hidrike per 000/banor, model krahasues , Burimi: Commission of the European Communities report 2008 ,pages 40-48*

3.1 Dimensionet e manaxhimit infrastrukturor hidrik

Brenda vitit 2006 për vendin tonë është përpiluar një plan për menaxhimin e integruar dhe eficent të burimeve të disponueshme hidrike. Edhe pse rëndësia e ujit është e madhe, po të shohim strukturën e burimeve hidrike të tokes (Hidrologjia e Shqipërisë,botim 1984,pg 254) vërejmë se ajo nuk është në favorin e nevojave njerëzore në rastet se shkalla e ndotjeve i kalon limitet e lejuara kur në këto zona vërehen forma morfometrike.(Commission of the European Communities ,pages 40-48)

6 Dimensionet e manaxhimit infrastrukturor hidrik jane si me poshte

a- Diferencat ne zhvillimin ekonomi te vendeve dhe rajoneve
b- Dimensioni i mjedisit dhe vendendodhja gjeografike
c- Problemet konceptuale dhe rrajonale,
d- Dimensionet sociale dhe ato kulturore
e- Politikat vendore,
f- Diagnozat strategjike infrastrukturore ,investimet e trasheguara

3.2 Zhvillimi i turizmit në zonat bregdetare, si një element i rëndësishëm i Strategjisë Shqiptare për Zhvillimin Ekonomik dhe reduktimin e varfërisë

Është aplikuar shpesh klorifikimi ujit në të shumtën e rasteve, përveç kësaj, duke qënë cilësia e klorit, jashtë normave sanitare dhe mjedisore, ajo përbën një rrezik të ndjeshëm për mjedisin dhe shëndetin e popullatës.
Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe institucioneve private apo publike për mbajtjen pastë të qytetit konsiston në bashkëveprim me bashkitë ose prefekturat,marëdhenie deri më sot e munguar.
Model analize manaxherjale , për H2

Të dyja këto objektiva;a) Stimulimi i investimieve dhe b)Ulja e varfërisë janë të lidhura pasi të dyja synojnë krijimin e një mjedisi në të cilin sipërmarrësit vendas dhe të huaj kanë besim për përfitimin e investimeve të tyre dhe shqiptarët kanë gjithashtu besim në mundësinë për karrierë në vendin e tyre.
Në fund të fundit Shqipëria konkurron për investime dhe punë të kualifikuar në vendet e tjera , në të njëjtën mënyrë duhet që të shohim prioritarë burimet tona me të cilat firmatshqiptare do të konkurrojnë për klientë dhe fitime.

4. Metodologja dhe kerkimi

Duke i konsideruar tepër të rëndësishme prirjet e manaxhimit infrastrukturor hidrik garantohen qëllime si më poshtë:

- **a-** Ngritje të nivelit të jetesës në qytet dhe fshat.
- **b-** Rritje të të ardhurave buxhetore direkte dhe jo direkte.
- **c-** Rritje të paqes sociale në komunitet.
- **d-** Rritjes së të mirave publike dhe ndërgjegjësimit të opinionit publik.

Vlersësimi i objektivave infrastrukturore hidrike është pikë kyçe në proçesin e realizimit të platformave infrastrukturore.
Për rrjedhojë kjo mund të karakterizohet nga të mira publike për shoqërinë dhe që ofron oportunitete të mëdha për nxitjen e sipërmarjeve të vogla dhe të mesme, si dhe mundësive për një jetë më të begatë dhe të sukseshme. Në një kontekst më të gjerë ne theksojmë se manaxhimi i burimeve ujore ndikon mbi zhvillimin e politkave publike dhe mirë manaxhimin e resourseve dhe burimeve ujore. Në një kohë kur burimet ujore ndikojnë mbi rritjen e nevojave për konsum të ujit të pijshëm, qeveria po mirë projekton fushën e riinvestimeve në këtë aspekt.

	X	X1	X2	X3	X4
Zgjedhja e pare e indikatorit	7	8	7	9	5
Zgjedhja e dyte e indikatorit	4	7	5	6	4

Kostot e adaptimit dhe kapacitetet e resorseve hidrike.dhe matja e indikatoreve të performancës

Ky model vërteton H3, me mormë të vogël gabimi në analizë.

Kosto e adaptimit

Kapacitete te vogela me kosto te larta	Kapacitete te medha me kosto te larta
Kapacitete te vogela me kosto te ulta	Kapacitete te medha me kosto te ulta

Kapacitetet e resoreseve hidrike

values	4	4	5	6	7	7	7	8	9
Ranks	1	2	3	4	5	6	7	8	9

R_{1o} = 6+7+8+9+9.1

$M_{R=} \frac{n1(n1+n2+1)}{2} = \frac{4(4+5+1)}{2}$ = 40 Llogarisim tendencen duke perdorur Weberlonn kriter *(Weberlonn and Robbins, S.P. 1998)*

$S_{R1} = \sqrt{\frac{n1n2(n1+n2+1)}{12}} = \sqrt{\frac{4.5(4+5+1)}{12}} + R_{1o}$ = 6+7+8+9

$M_{R=} \frac{n1(n1+n2+1)}{2} = \frac{4(4+5+1)}{2}$ = 20

$S_{R2} = \sqrt{\frac{n1n2(n1+n2+1)}{12}} = \sqrt{\frac{4.5(4+5+1)}{12}}$ = 4.8

= 4.8



Grafiku 3 Kostot e adaptimit dhe kapacitetet e resorseve hidrike.dhe matja e indikatoreve të performancës

Burimi: World Bank. 2003. Albania: Management of coastal infrastructure and reduction of poverty. Final Draft

Konkluzion: Vendi ynë ka një problem menaxherial të shpërndarjes dhe jo një problem të mungesës së kapaciteteve dhe resurseve. Manaxhimi infrastrukturor hidrik në nivele të larta mbështet përhapjen e vlerave të demokracisë dhe të lirisë së njerëzve në vendin e punës. Vetë natyra e aktiviteteve ekonomike infrastrukturore në tregetinë e lirë kërkon akses në informacion, përhapje të kompetencave dhe ushtrim në marrjen e vendimeve individualisht , kushtet që pëputhen më shumë me shoqërite e lira dhe mënyrat e qeverisjes demokratike se sa me regjime autoritare.

Së fundi manaxhimi infrastrukturor redukton konfliktet ushtarake midis vendeve duke vepruar si një forcë që bashkon njerëzit për veprimtari infrastrukturore me përfitime të larta financiare dhe stabilizuese. Për shoqërinë shqiptare fakti se ekonomikisht ajo po ribëhet pothuajse nga e para në kushtet e ekonomisë së tregut ose të ekonomisë së përbotshme, përbën njëkohësisht një sfidë manaxheriale. kur treguesit ekonomikë shënojnë një rritje të kënaqëshme dhe një ndihmesë kur politikat infrastrukturore përmbushin nevojat e komunitetit, ky progres përmban edhe reziqe të ndryshme.

Vendi ynë është përfshirë në këtë proces infrastrukturor duke bërë njëkohësisht:

a- Privatizimin e sektorëve me rëndësi të veçantë ekonomike.
b- Ristrukturimi infrastrukturor dhe manaxherjal.
c- Kombinimin e matodave shtetërore për infrastrukturën.
d- Reformat infrastrukturore në sektorin financiar dhe bankar.
e- Ristrukturime infrastrukturore afatshkurtra në ADP
f- Qeverisja dhe planifikimi i burimeve hidrike territoriale, mbrojtja e mjedisit, tutela e peisazhit dhe menaxhimi efiçent i energjisë

nëpërmjet: sistemeve të integruara të monitorimit mjedisor; kërkimeve, sondazheve paraprake,studimeve të fatibilitetit dhe projekteve pilot; shkëmbimeve të kompetencave reaizohet nëpërmjet një përcaktimi paraprak të qartë të proçedurave tekniko-financiare për të garantuar realizueshmerinë dhe qëndrueshmërinë e vetë ndërhyrjeve.. Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm në territorin urban, rural dhe bregdetar; Favorizimi i integrimit të rajoneve ndërkufitare dhe tejkalimi i pengesave dhe i kushteve periferike.

Përforcimi dhe zhvillimi i menaxhimit të burimeve hidrike, organizimeve dhe ritja e vlerës së pasurisë historike, kulturore, arkitektonike dhe gjuhësore të zonave me pasuri të medha natyrore do të mirëmenaxhohen nëpërmjet: shkëmbimeve të eksperiencave dhe të aktiviteteve të marketingut , me një përcaktim paraprak të qartë të proçedurave tekniko- financiare për të garantuar qëndrueshmërinëpasurore dhe natyrore.

Referencat dhe Burimet

UNDP: First Country Cooperation Framework for Albania (1998-2001), DP/CCF/ALB/1 30 January 1998

UNDP: Second Country Cooperation Framework for Albania (2002-2005), DP/CCF/ALB/2 13 November 2001

Mission Report: Support to the development of the Albanian Training Institute of Public Administration, Tirana, 3 – 8 January 2003 Jurgita Siugzdiniene, Public Administration Mission: Development sustainable - training system in Albania – Recommendations. Field Mission to Albania 4 – 13 February 2011

Law on the Civil Service in the Republic of Albania, Law No. 8095, 21/3/1996

Law on the Status of the Civil Servant in the Republic of Albania, Law No. 8549, 11/11/1999

The Newsletter of Public Administration No. 5, sponsored by the European Commission, Tirana, December 2001

Friends of Albania Issue no. 3, December 1998. www.seerecon.org/Albania/

Durata Thanasi, An Overview of Public administration in Albania.

KUJTESA SOCIALE DHE KULTURA E SHKRIMIT PËR LUFTËN E VLORËS, 1920 NË OPTIKËN BASHKËKOHORE

MSc. ALBERT HABAZAJ
Biblioteka Qendrore "Nermin Vlora Falaschi",
Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, ALBANIA
albert_abazi_tr@yahoo.com
bertbiblioteka@gmail.com

Abstrakt

Ndoshta mund të paraqes interes ky trajtim, ku për fokusim të punimit, menduam të qëndrojmë mbi dy këmbët e duhura, që mund ta mbajnë urën e kalimit dhe të komunikimit me një ngjarje historike të Shqipërisë, siç është lufta çlirimtare e Vlorës, e verës së vitit 1920 dhe personazhet që dolën në skenën e kohës. Logjika kombëtare dhe logjika e progresit mund të jenë, për mendimin tonë, dy këmbët e urës që na intereson. Na ka nxitur për këtë artikull dhe një tezë e studiuesit Ernest Gellner, ku shprehet se, shkrimi bën të mundur kodifikimin dhe sistemimin e pohimeve, për pasojë edhe lindjen e doktrinës, që e shtron edhe në librin e tij"*Plough, Sword and Book*"[1]. Duke patur informacion të mjafueshëm nga pleqtë e moçëm, mbledhur gjatë ekspeditave vetiake e kolektive në terren, mendojmë se kemi një element të kulturës tradicionale. Ndërkohë, duke reflektuar se "idetë njerëzore dhe format shoqërore nuk janë as statike, as të dhëna e as të lëna", kemi arritur në përfundimin se, vepra e realizuar me Luftën e Vlorës, 1920, është e shenjtë, sepse fitorja u vulos me gjak në mbrojtje të Vatrës, të Zjarrit të Ndezur, të Tymit, e në se na lejohet të përdorim shprehjen jo thjeshtë metaforike të antropologut Nebi Bardhoshi, "të Gurit të Kufinit", të Ujit Shqiptar të shkelur. Nga ana tjetër, na ngacmon fakti se, është abuzuar me shenjtërimin e fjalës, është folklorizuar pa të drejtë, kur koherenca historike flet pa emocion, por me logjikë shkencore.

Fjalë çelës: kujtesë, shkrim, Lufta e Vlorës (1920), analizë kombëtare, progresi.

Abstract

Perhaps, this could present an interesting treatment, in order to focus the paper, we thought standing right on two feet, so you can keep the crossing bridge and communicative one with just one Albanian historic event, as the war

---

[1]) Gellner, Ernest, *Plugu, shpata dhe libri [Plough, Sword and Book],* botime përpjekja Shtëpia e Librit, Tiranë, 2002, f. 67.

of Vlora, in summer 1920 and the characters who were shown on stage of that time.
National logic and the logic of progress based in our opinion, could be standing on two legs of the bridge we are interested on. The one who encouraged us to this article is the researcher Ernest Gellner's thesis, which states that, “stationery enables encoding and disposition of claims, resulting in the emergence of the doctrine, which was treated in his book “*Plough, Sword and Book*”.
Having sufficiently information from the elders of middle-aged staff, collected during expeditions in the field of personal and collective, we feel that we have an element of traditional culture.
Meanwhile, reflecting that "human ideas and social forms are neither static, nor data, nor left", we have concluded that, with work completed in Vlora War of 1920, is sacred because the victory was sealed with blood in defense of Chamber, of the Fire lit, of the Smoke, if we are allowed to use not merely metaphorical expression of anthropologist, Nabi Bardhoshi " of the Stone of the borders", of Albanian
Water violated. On the other hand, we worry that is being abused with the sanctification of the word, is being folk unjustly when historical coherence speaks without emotion, but with scientific logic.

Key - words: remembrance, writing, Vlora War (1920), national and progressive analyses.

1. Hyrje

Tri periudhat e strukturës së historisë njerëzore, që, edhe sipas filozofit, sociologut dhe antropologut anglez të shekullit XX, E. Gellner (Paris 9. 12. 1925 - Pragë 5. 11. 1995), janë klasifikuar përkatësisht kështu: Etapa e parë: gjuetia, grumbullimi (alias [ndryshe] egërsia); e dyta, shoqëria agrare (barbaria) dhe etapa e tretë, shoqëria industrial (qytetërimi)[2] i ka kaluar, patjetër dhe Shqipëria, krahinë etnografike e së cilës është edhe Labëria, me Vlorën, Tepelenën, Sarandën, Himarën e krahinëzat e tjera, hapërisa e të cilave, për dy - tre muajt e verës së vitit 1920, u shndërrua në teatër luftarak forcash të pabarabarta në numër, mjete, armatim e teknologji tjetër luftarake.
Më i madhi pa të drejtë sulmoi më të voglin, pa e ftuar kush, pa i kërkuar ndihmë kush. I rrëzoi gurin e kufirit, i shkeli vatrën, i nëpërkëmbi nderin, për t’i fikur zjarrin, për të mos dalë më tym nga oxhaku shqiptar, për t’i shuar farën. Këtë bllok informative na sjell kujtesa sociale mbi 90 vjeçare, gati 1 shekullore. Mendojmë, se në atë kohë mund të kemi përjetuar fazën e dytë, sipas Gellnerit. Në atë kohë, Vlora ishte një pellg me moçale e mushkonja, ku problem i malarjes qe shqetësim i kohës, në një Vlorë me pak banorë; vetëm me rreth 4 mijë njerëz në banesa të ulëta te tipit oriental, pa zhvillim, pa arsim të shqueshëm, me pak ushtrim të kushedi çfarë zejeve a mjeshtërishë artizanale, përjashto jetesën e mundimshme me të ardhurat e peshkimit; veçse qe një vend, llomkë me pozita kyçe gjeostrategjike në Adriatik, në Mesdhe e në Rajon. Prandaj dhe lakmohej nga të tjerët, të mëdhenjtë, fuqitë sunduese të kohës.
Këtë informacion e kemi nga Muço Delo (1895 - 1984), Xhebro Gjika (1900 - 1978) dhe Petrit Velaj (dy të parët luftëtarë të Njëzetës, kanë përkatësisht 29 dhe 35 vjet që kanë vdekur), të cilët mund t’i quajmë informantë të drejtpërdrejtë, parësorë, ndërsa i treti, P. Velaj, Mandela i Vlorës, rron, është 96 vjeç, lëviz nëpër qytet dhe është me mendje të freskët dhe mund të quhet

[2]) Po aty, f. 13

informant i ndërmjemë, dytësor, sepse të dhënat për LV, na i sjell, bazuar te kujtesa e babait të tij Ahmet dhe xhaxhait të tij, Beqir Velo, të dy luftëtarë të LV, i dyti edhe komandant i çetës patriotike të Kaninës dhe gjykimtar e burrë krahine. Nga dy të parët, ne, kohë pas kohe, sa qenë gjallë, intuitivisht, për hir të emrit që kishin dhe të respektit që kishim, nga dëshira e pasioni, kemi vjelur visare memorialistike të gjalla e ruajmë, jo vetëm në kujtesën vetiake, edhe me shkrim nga ajo kohë, në trajtën e intervistrimit të lirë, spontan, shumë elemente të traditës lokale, sidomos për LV, edhe të pabotuara, edhe të pathëna, të cilat na kanë shërbyer për mikrotezën: "*Lufta e Vlorës. Historia në Epikën Historike".* Sot kuptojmë, se paskemi aplikuar atë që cilëson antropologu social Olsi Lelaj "*Intervista të strukturuara me informatorë (informantë) kyç*". Jo thjesht,vetëm për statistikë sot, në vitin 2014 Vlora ka rreth 200 mijë banorë dhe tjetër pamje, gati tërësisht europiane, oksidentale (perëndimore).
Sipas psikologut milanez, Rolando Marchesan: "Kujtesa përbën bërthamën thelbësore dhe ndërlidhëse të inteligjencës, madje është kushti i domosdoshëm për veprimtarinë e saj dhe vazhdimësinë". Psikologjia e shkrimit najep këtë perkufizim: "Inteligjenca është vetia, me të cilën psikika kupton, gjykon, dhe, në bashkëpunim me vullnetin, vendos". "Brenda procesit asimilues (përvetësues) dhe inteligjencës ndodhet gjithnjë kujtesa"[3]

2. Punime të mëparshme

Shkurtimisht do të trajtojmë se çfarë kanë thënë studiuesit shqiptarë për këtë çështje, çfarë kanë thënë autorët e huaj si dhe tezat tona, në se mund të jemi përkrahës të x autori, mund të të jemi përforcues të tjetrit, mund të kundërshtojmë y- nin, apo ndoshta, nga arritjet e deritanishme sipas metodave të punës në terren, në ekspedita vetiake apo në grup, nga studimi në biblioteka, me librat e puna krahasimtare e teksteve, mund të jemi dhe krejt autonomë në mendimin tonë.
Duke u futur në kohë, gjykojmë se Lufta e Vlorës ishte e drejtë nga shqiptarët dhe e merituan fitoren, sepse punuan pozitivisht për të drejtën e tyre kombëtare edhe faktorë të brendshëm, edhe faktorë të jashtëm, por nuk do të trajtojmë këto çështje, për të mos dalur nga tema bosht.Kishin nevojë banorët në tokat e tyre të pushtuara poër krahë, për frymëzim, për drejtim, për liri në punë të tyre.
Një nga ata që u bë frymëzuesi i tyre për luftën që shpërtheu në Vlorë qe dhe Halim Xhelo (1894 - 1937), sekretar i Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare të VL. Ai cilësohet si Abdyl Frashëri i Njëzetës për shembullin e tij idealist, për fjalët e tij të zjarrta, për shkrimet e tij patetike, me frymëmarrje të ndezur rilindase, shumë emocionale, si duket për të ngritur njerëzit në këmbë për të mbrojtur trojet e trashëguara nga të parët, që kur s'mbahet mend. H. Xhelo ishte me gramë e, quhej i kënduar, ishte nga më të shkolluarit e kohës, kishte përfunduar studimet e larta në Universitetin e Firences për Drejtësi në Fakultetin e Shkencave Politike, duke u klasifikuar kronologjikisht nga të parët dhe të paktët vlonjatë, aq të arsimuar për kohën.

---

[3]) Marchesan, Rolando: *Psikologjia e shkrimit = Psicologia della scrittura*, Uegen, Tiranë, 2002, f. 57.

Vetë veshja e tij "allafrenga" flet vete e na tregon se ai vinte nga qytetërimi perëndimor, ashtu, sikurse na rrëfen veshja, jo me të leshta shajake e gunë të dhirë, siç visheshin banorët e Labërisë dhe të Çamërisë, të dy prej krahinave etnografike të Toskërisë, që tregojnë kulturën kostumografike të kohës. Po paraqesim portretin e H. Xhelos, si dhe dy pamje me veshje të banorëve të Labërisë, si dhe të krahinës më në jug, asaj të Çamërisë, ku vihen re dallimet dhe përngjasimet, si dhe imazhe të tjera, për të prezantuar dhe interpretuar kujtesën sociale dhe kulturën e shkrimit në kohën e ngjarjes apo direkt pas jehonës së saj, nëpërmjet fotografive, objekteve të ndryshme me efekte pamore, faksimileve të mundshme etj.:



Faksimile të një letre, shkruar në ato vite nga H. Xhelo

Kur në brigjet e Vlorës e të Kaninës binin dëshmorë për liri, dhe në fushat e Koplikut, në Shkodër në malet e Dibrës luftonin vëllezrit tanë të Veriut kundra Sllavit po për këtë qëllim, që të shpëtonin atdheun nga sulmet e tij. Viti 1920 është viti më i shënuar në Përlindjen tonë, se pas Kastriotit është e para herë që shqiptarët të bashkuar nën Dyngjyrashin, luftuan krah për krah kundër të huajve.

Pra në pati Greqia e mooçme një Sparte e një Thermopilë, Shqipëria e Re ka një Labëri dhe Qafën e Koçiut (Kodra rreth qytetit të Vlorës).

Më e ëmbël vdekja, kur i huaji vjen, dhe në mes të «vatrës» bën si i pëlqen.

«Politika»,
Nr. 25, dt. 3.IX.1924.

Nga ky fragment i shkrimit të H. Xhelos në gazetën e kohës "Politika", ndihet fare kollaj fryma romantike, që përshkon këtë artikull luftarak dhe entuziast, me kolorit zbukurativ, hiperbolizues, ndoshta jashtë përmasave të realitetit. Është e vërtetë, që kemi një fakt; por a është e vërtetë, që kemi një të vërtetë? A është ky fakt një e vërtetë? Mendojmë, se dhe gjykimi në kontekstualitet, duke u futur në kohë është i dobishëm, kërkon dhe pranon debat.

3. Lufta e Vlorës dhe historiografia shqiptare

Janë botuar shumë libra të nivelit akademik (historikë dhe etnologjiko - folklorikë) nga autorë shqiptarë dhe studiues të huaj për këtë ngjarje të ndodhur në atë kohë dhe në atë hapësirë konkrete. Ndër autorët shqiptarë mund të përmendim disa prej tyre, si: Aleks Buda, Muin Çami, Arben Puto, R. Zeqiraj, Viron Koka, Kristo Frashëri, Rami Memushaj, Rrok Zojzi, Andromaqi Gjergji, Mark Tirta, Afërdita Onuzi, Agron Xhagolli, Miaser Dibra, Bardhosh Gaçe, etj. Vepra kolektive e nivelit akademik "*Historia e Shqipërisë*" (vëll. I - II, 1959, 1956 përkatësisht) është dëshmia e parë dokumentare historike, që paraqet në mënyrë të përgjithshme historinë e Shqipërisë nëpër rrjedhat e kohës.

Pikërisht në vëll. II të HSH marrim një informacion sintetik edhe për Luftën e Vlorës. Ishte Akademiku Aleks Buda (1910 - 1993), një personalitet i historiografisë dhe i kulturës shqiptare, ai që ideoi dhe konceptoi këtë tekst madhor për kohën, të rëndësishëm si pikë reference për periudhat e pastajme dhe dëshmi historike krahasuese e përfillshme për studiuesit. Një vepër krejt e re për kohën, si nga përmbajtja e gjerësia e trajtimit dhe e vështrimit, ashtu edhe nga kriteret shkencore të ndërtimit e të vështrimit të procesit historik në rrjedhën e ngjarjeve.

Kishin shkruar edhe më parë për LV disa autorë të veçantë. Ndoshta i pari, apo ndër të parët që rrok temën e LV, në botimet e viteve '20 - të të shek.XX, është Sali Hallkokondi, jurist, publicist dhe historian nga Vranishti i Vlorës, ndër intelektualët e njohur të kohës (1877 - 1936). Ai la gjurmë të thella në ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve me librin me kujtime "*Histori e Shqipërisë së re*" (1923), ku përveç pasqyrimit të ngjarjeve të lëvizjes kombëtare e demokratike pas shpalljes së Pavarësisë, duke qenë edhe vetë pjesëmarrës në LV, na paraqet të dhëna interesante, të pasura e të vlefshme për ndërtimin e historisë së kësaj ngjarjeje, aq më tepër që avokati i njohur i ka botuar shkrimet e tij në gazetat "*Mbrojtja Kombëtar*e" e "*Fjala e lirë*", gjatë v. 1921 dhe në "*Politika*" në v. 1923 - '24.

Sejfi Vllamasi (1883 - 1975), duke qenë dhe senator, deputet, si dhe dy herë anëtar kabineti, luajti rol të rëndësishëm në përkrahjen e LV më 1920, apo edhe në përballimin e ndërhyrjes së forcave ushtarake jugosllave në Koplik më 1920. Në dorëshkrimin e tij "*Shënimet dhe kujtimet historike*", një kopje të të cilit ia dorëzoi AIH nga fillimet e vitetve 1960, por që dritën e botimit për herë të parë e pa vetëm më v. 1995, me titullin *"Ballafaqime politike në Shqipëri 1897- 1942"*,

autori i ka kushtuar dhe 10 faqe LV, të cilat, sipas studiuesit Maringlen Verli, janë të vlerësuara për informacionin historik dhe analizat politike[4]. Gjithashtu, ky studiues na sjell informacionin se, "*falë ndershmërisë dhe ekuilibrit që e karakterizonte, S. Vllamasi u konsiderua nga qeveria e Sulejman Delvinës si personi i përshtatshëm për të përballuar misionin delikat të tatimit të pulsit të Beogradit dhe të sigurimit të armëve jashtë vendit për Luftën e Vlorës*"[5].
Tajar Zavalani (1903 - 1966), që ishte sekretar i Komisionit Ndërkombëtar për Caktimin e Kufijve (1923), ka një botim tjetër më vonë "*Histori e Shqypnis*" në dy vëllime: vëll. 1 "*Nga ilirët e deri në kongresin e Berlinit*", Londër, 1957, dhe "*Nga 1878 deri 1965*", Londër, 1966.Në vëll. 2, te "*Lirija e rifitueme*", ka dhe shënimet entuziaste "*Triumfi i Vlonës*", që gjithsesi na pëlqejnë, por problemi është se në tekstin e botuar ka edhe pasaktësira. Po citojmë një paragraf "...*Mesazhin e dorëzoi trimi legjendar Selam Musai, i cili ra i vramë te praku i Vlons, porsa u lanque ofensiva kundër okupatorit*"[6]. E vërteta historike është se bëhet fjalë për ultimatumin që fshatari trim nga Mallkeqi i Vlorës, Mehmet Selim Shahaj, dhe jo kryeheroi i LV dhe legjenda e EHLV, Selam Musa Salaria, i dorëzoi gjeneral Piaçentinit, etj. Edhe historia e shkruan këtë fakt, edhe folkori e këndon bukur e fortë këtë histori trimash. Ne e dimë të vërtetën, por jo të gjithë e njohin në Shqipëri. Aq më tepër që ky libër është botuar dhe jashtë shtetit e pikërisht në Angli, ku mendojmë se nuk ka se si të mos jetë lexuar nga të huajt ky tekst.
Informacioni i pasaktë krijon imazh të shtembëruar dhe qortohemi për mungesë të korrektesës shkencore dhe të seriozitetit në trajtimin historik. Persona të tjerë si Ago Agaj e Gani Abazi, që kanë qenë luftëtarë të lirisë në LV, që e njohin dinamikën në detaj, që e kanë parë me sy luftën, që e kanë ndjerë frymëmarrjen e luftës emocionalisht dhe me logjikë kombëtare, që kanë shkruar libra individualisht dhe jo si bashkautorë në grup pune, janë mbështetur kryesisht në kujtimet e tyre si autorë, aktorë apo faktorë (aqsa) për LV. Gjithsesi janë gjurmë a përshtypje vetiake dhe vetvetiu vërtetësia e fakteve apo argumenteve mund të jetë e diskutueshme, nga që subjetiviteti nuk shmanget dot, kur bëhet fjalë që autor është një person i vetëm dhe jo grup autorësh apo kolektiv hartuesish, si dhe kur autorët nuk përfaqësojnë institucione shkencore shtetërore, organizata apo shoqata të përhershme dijetarësh e njerëzish të kulturës që merren me organizimin e drejtimin e punës shkencore dhe me kërkime e me studime për zhvillimin e shkencës e të diturisë në tërësi dhe të disiplinave të veçanta si historia (e periodizuar, në rastin konkret për LV, 1920) apo etnografia, etnologjia dhe folkoristika (konkretisht mbledhja, seleksionimi, përzgjedhja, studimi, përgatitja dhe botimi i mozaikut të larmishëm të asaj ngjarjeje, të asaj kohe, të asaj hapësire jo vetëm me ciklin EHLV, por edhe me mënyrën e jetesës, doket, kulturën lokale, veshjen, ushqimin, psikologjinë sociale, traditat, virtytet, veset, interpretuar në kontekstualitet).

4. Ç' thonë studiuesit e huaj për Luftën e Vlorës

E quajmë më me vend të ravijëzojmë më tepër optikën e studiueve të huaj për Shqipërinë e kohës në tërësi dhe veçanërisht për Vlorën dhe krahinat e saj, ku ndodhi ngjarja, të cilës iu shkrua historia, iu këndua kënga, iu thur poezia, u bënë filma artistikë, u bënë piktura epike e u përjetësua në monumente nga

---

[4]Shih "*Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, vëll. 3", Tiranë, 2009, f. 2908.

[5]shih VLLAMASI, Sejfi, *"Ballafaqime politike në Shqipëri (1897 - 1942*)". Bot. 2 me il. Përg. për bot. dhe il. Prof. Dr. Maringlen Verli: "*Parathënie"*, f. 6, Neraida, Tiranë, 2000.

[6]shih ZAVALANI, Tajar : "*Histori e Shqipnis"*; PHOENIX, Tiranë, Bot. 2, 1998, f. 261.

skupltorët e piktorët vendas. Pse duam të futemi më thellë në punimet e studiuesve të huaj? Përse synojmë të vjelim nga të huajt sidomos monografitë e panjohura më parë nga komuniteti ynë social e ndoshta, të pakonsumuaraende, edhe nga bashkësia akademikee vendit?
Gjykojmë se mendimi akademik shqiptar për rëndësisnë e padiskutueshme të LV, si një ngjarje e rëndësishme në historinë e vendit, njihet mirë nga të interesuarit dhe komuniteti ynë dhe nuk ka ndonjë gjë të re. Mendimi i huaj nuk është shumë i njohur ndër shqiptarë (përveç elitës shkencore) dhe, gjykojmë, se, duke qenë të pampleksur me interesa të caktuara këtu, e përshkruajnë këtë ngjarje, ndoshta me paanshmëri, sa më afër objektivitetit, sipas lentes së tyre, nga ku ne mund të marim kulturën e shkrimit, që na vlen, se si shkruhet historia. Ajo, po s'i pati të gjitha nuancat reale, të vërtetat, rrezikon ndoshta të shndërrohet në diçka të pabesueshme.
Kujtesa sociale dhe kultura e shkrimit rezonojnë, ose më saktëështë e vlertë të rezonojnë harmonishëm me njëra - tjetrën, e, secila në pozicionin e vetë, për hir të së vërtetës jetësore, për realitetet kulturore e ngjarjesore. Mbajmë mend deri më sot nga librat e lexuar, apo nga kujtimet e botuara, që për Luftën e Vlorës thonë se ka patur vetëm trima, legjendarë, kreshnikë, kapedanë, që me sopata me hanxharë luftuan me një mbret 40 milionë dhe e hodhën në det perandorinë. Standarte. Klishe. Shablone të pa cenueshme. Lindin histrori të rreme, shkruhen ato dhe pranohen si fakte, që me kohë shndërrohen në të vërteta apo serviren si të tilla. Kujtesa sociale firon, humbet. LV s'është ngjarje e largët, por dhe aq e afërt s'është, sepse do të ishin të paktën 110 -115 vjeç luftëtarët më të vegjël, po të rronin, që s'ka fare probalilitet, se e njohim gjendjen. Prandaj na vjen ndërmend ajo fjala latine: "*Fjalët i merr era e shkruara qëndron*".
Shumë nga udhëtarët e huaj që erdhën me misione të ndryshme në Shqipëri gjatë dy dhjetë vjeçarëve të parë kanë lënë përshtypjet e tyre të botuara si shënime udhëtime e libra të veçantë. Dallojmë, nga një lexim i ftohtë dhe i vëmendshëm, se kohezioni e mban të lidhur materialin qëperëndimori, studiuesi i huaj na paraqet me koherencë dhe pa ngjyrat e panevojshme emocionale. Risia e kësaj kumtese është se po promovojmë mendimet e 3- 4 studiuesve bashkëkohorë të "paeksploruar" më parë, si Serge Métais, Nikollas Kosta, Nikola Guy, e Miranda Vickers.

5. Pamje e përgjithshme shqiptare e periudhës së 1920 - ës nga syri i shkrimit europian

Janë mbi 45 studiues që janë marrë instensivisht qysh atëherë, që e vrojtonin dhe e shkruanin Shqipërinë me lentet e tyre kulturore. Mund të përmendim (sipas rendit alfabetik) studiues të tillë si: Baldacci, Bouè, Brailaford, Callan, Chumckv, Cozem - Hardv, Cozzi, Cvijic, Degradd, Dumont, Edlinger, Eliot e deri tek Nvoni, Windish,Wirthi etj, të cilët i japin edhe virtytet, edhe veset e shqiptarëve. Mis Durham thotë se të gjithë shqiptarët në realitet nuk janë muhamedanë, as të krishterë: feja për ta është një formë e jashtëzakonshme, diçka fare formale. Kanë rregull të madh për mbledhjet. Shqiptarët e shkolluar janë tregtarë të shkathët (të zotë) dhe të gjithë kanë individualitet të theksuar. Ndodh, thotë, që pas vrasjes iu vjen keq për plumbin…Njw tjetwr studiues, Woods, bën këtë portret: "*Shqiptari është i egër, luftarak, tolerant në çështje fetare, i pabindur por besnik dhe i ndershëm*".
Etnografi, gjeologu dhe paleontologu hungarez Franc Nopça (Franz Nopcsa: 1877 - 1933) ka ardhur disa herë në Shqipëri gjatë v. 1903 - 1922 dhe për herë të parë përdori metodën krahasuese me vendet e tjera të pellgut të Mesdheut dhe të Azisë së Afërme dhe ndër të parët që në studimet etnografike për Shqipërinë futi për krahasim edhe të dhënat e arkeologjisë. Duke folur për

karakterin e shqiptarëve Baroni Nopça, qysh në fillim të studimit kërkimor shkencor në Shqipëri, thekson se, për të asgjë nuk është më e zorshme se sa të njohë një i huaj thelbin e karakterit të një populli dhe *"asgjë nuk kërkon më tepër qetësi dhe sundim të vetvetes se sa ta përshkruajë atë pastaj në mënyrë objektive dhe siç ndodh realiteti"*[7].

Nga natyra shqiptarët e asaj kohe janë cilësuar si krenarë, luftarakë, gjaknxehtë, sensibël, me moral shoqëror, sidomos në lidhje me femrat qëndron shumë lart, që bëjnë shumë shpenzime për mikpritje dhe festa. Por Jastrebovi thotë sikur mikpritjen shqiptarët e kanë dogmë, sikur kanë prirje për t'i zmadhuar gjërat, sikur janë dinakë, gënjeshtarë dhe hipokritë, sikur janë armiq të këshillave të mira, idololatër të një nderi të gabuar, nuk durojnë cënimin botërisht të gjërave të shenjta. Ippen bën një prerje horizontale ndër shaljanë dhe quan kapadainj, që të dobëtin e përdorin keq, pse nuk merren me grabitje, po kështu banorët e Nikaj - Mërturit. Seksualitetin as që e njohin. Jarav gjen që shqiptarët janë luftëdashës, të prapambetur, kanë inisiativë, janë të guximshëm dhe kundër çdo lloj autoriteti. I quan partikularistë, të cilët fillojnë të dyshojnë sa herë kërcënohen të drejtat e tyre. Studimi i punimeve që ata kanë lënë për vendin tonë është ndoshta një mozaik kompleks për ne, ku shfaqen metaforikishtbanorët e tokës dhe qiellit shqiptar me të gjitha ngyrat e ylberit. Me shumë prej mendimeve të tyre nuk mund të jemi dakort, por ato janë "rekorde" të regjistruara në Kujtesën e Shkrimit të Botës dhe janë, ndërkohë, për studimet tona e të tjerëve, të huaj apo vendas, referenca se si na shikojnë ne të tjerët, ngaqë mungon ajo edhe ajo ndarja e famshme që na ka pëlqyer, që si historinë, si këngën ta reduktojmë në një ndarje kaq binare (bardhë e zi). Shumë nga udhëtarët, studimet e të cilëve kemi lexuar, janë objektivë në shënimet e vlerësimet e tyre, pavarësisht se diku, ku ata na mburrin, ne krenarohemi e na ngrihen veshët dhe diku, siç dhe perifrazuam grimca, ku ata na shajnë (më saktë, jo na shajnë, por na nxijnë portretin, ndoshta ashtu paska qenë) ne mërzitemi, ulim kokën, ulim veshët dhe fillon të pllenohet urrejtja për ta në psikën dhe shpirtin tonë. Për informacionet e të huajve, që sipërpërmendëm, i shikojmë me lente kulturore për të parë më mirë, për çka na shërbejnë në funksion të Njëzetës. Hecquard nënvizon se, në rast lufte, në Shqipërinë e Veriut, çdo shtëpi pajiste një burrë, pavarësisht nga numri i përgjithshëm i pjesëtarëve të shtëpisë.

Ndërkohë historiografia dhe kujtesa sociale e LV njofton se në Beun, më 1920 u mblodhën nga çdo fshat *shtëpi e burrë e burrë e pushkë*. Merr dimensione të reja informacioni historik dhe folklorik që na vjen për atë ngjarje, se në LV ndihmuan, biles morën pjesë edhe gratë. Kur flet për sjellje e zakone të shqiptarëve, kur shkruan për Shqipërinë, sakrifikuar për interesat e Europës, Ismail Qemali thekson: "*Tre objektet kryesore të përkushtimit të shqiptarëve janë: nderi i tij, familja e tij dhe atdheu. Ai preferon vdekjen përpara një çnderimi që nuk është larë".*[8]

Nga të pashkruarat dhe të pathënat për Njëzetën, edhe sot e kësaj dite, në Vlorë, nga më moshatarët që rrojnë akoma dhe që kanë një kujtesë të admirueshme, mund ta shprehim mendimin sipas tyre se "*Njëzeta qe një luftë që çeli e shpërtheu nga rubineti i çesmës morale. E vërteta është se italianët bënë punë e ndërtuan goxha në qytet. Çuan rrugë deri në mal të Çikës. Për interesa të tyre, patjetër, por edhe nevej mirë na bënej. Kishim interesin tonë, se po zhvillonej vëndi. Këtë e dinin dhe e shihnin të gjithë. Këtë e shohni dhe ju sot. Se, ja, fjala vjen, godinën ku është Bashkia e Vlorës dhe Qarku e ka bërë italiani. Po ku qëndron problemi? Këtu ndryshon puna, se ata e shkelën në kallo shqiptarin, vlonjatin,*

---

[7]NOPCSA, Franz , "*Antropologji kulturore"*, Dispencë [Tiranë, maj 2011], f. 4 - 14.

[8] VLORA, Ismail Qemal, *"Kujtime",* Botimet Grand Prind, [Tiranë], [2007], f. 306.

labin. Ulën krenarinë e shqiptarit, e prekën atje ku s'mba më, e cenuan në moral, (mos qesh), i prekën nderin, gjënë më të shenjtë. Të futemi në kohë, more bir, e të flasim. Në atë kohë kishte tradita të mira që ishin ligj i pashkruar për njerëzinë. Ajo psikologji e kulturë zotëronte mënyrën e jetesës, zakonet tona, sjelljet, fejesat, martesat, vdekjet, këngët që keshëm, të gjitha çar' bënim. Kështu duhen parë gjërat e gjykojmë kollaj pastaj. Kur flasim për dje, do gjykojmë me atë mendje; kur flasim për sot, kemi të tjera kondita e raporte, tjetër psikologji dhe edukatë më të avancuar. Sipas vëndit, kuvëndi, e more vesh djalo?! [9].

Logjika e bisedës, nga e cila shkëputëm këtë paragraf, që mendojmë se përfaqëson jo vetëm mendësinë e tyre, por mentalitetin e kohës të komunitetit vlonjat, na dikton të gjykojmë se, jo gjithmonë diversiteti kulturor prodhon gjëra të mira, të bukura dhe të dobishme. Në atë kohë shqiptarët ishin konservatorë, italianët me frymë liberale. Ai sfond psikologjik nxorri në pah, me një reliev dhe efekt të mahnitshëm, ngjarjet e asaj vere të vitit 1920. Fjala e vjetër "*shqiptari për një nder rron*" ndezi sedrën e banorëve, të kryefamiljarëve, të burrave të shtëpisë, të mëhallës, të fisit, të lagjes, të fshatit, të krahinëzës, krahinës, parësisë, burrave të kazasë, se kështu klasifikoheshin në atë kohë burrat, sipas hierarkisë trimërore - morale e atdhetare. Për cenimin në nder, krisi pushka. Vendasit nuk u treguan miqësorë me ata që nuk erdhën si të tillë.

Kjo është logjika e funksionimit të gjërave, që prishi "kavalierllëkun" e atyre që e quanin se s'kishte ndonjë problem të kullosje në kopsht të tjetrit, në "baçe" të botës… Kjo është logjika e funksionimit të gjërave, nga e cila shpërtheu ndjenja e kolektivitetit për t'u bashkuar si një trup i vetëm, deri sa të vihej nderi në vend. Kjo logjikë dhe praktikë e drejtë luftarake bëri që të lindte dhe të forcohej edhe ndjenja e solidaritetit me LV. Ndërsa optikën e ndriçimit të historisë së LV e kemi nga profesori ynë i nderuar Muin Çami, gjykojmë të paraqesim dhe të interpretojmë, për herë të parë, edhe një autor tjetër të huaj, vepra e të cilit (ku përfshihen dhe shënimet e tij për LV) nuk ka qenë e njohur për ne më parë, sepse vonë është botuar në gjuhën shqipe.

---

[9] SIPAS shënimeve që kemi mbajtur në bisedat me z. Petrit A.Velaj, 96 vjeç dhe Fahri Xh. Shaska 78 vjeç gjatë periudhës 29. 05. 2012 - 02. 05. 2013.

Literatura

COSTAS, Nicolas J., "*Shqipëria: enigmë europiane, monografi për Evropën Juglindore = Albania: A European enigma, East European monographs*", OMSCA - 1Tiranë, 2002.

GELLNER, Ernest, *Plugu, shpata dhe libri [Plough, Sword and Book],* botime përpjekja Shtëpia e Librit, Tiranë, 2002.

MARCHESAN, Rolando: *Psikologjia e shkrimit = Psicologia della scrittura*, Uegen, Tiranë, 2002.

FJALORI Enciklopedik Shqiptar, vëll. 3", Tiranë, 2009.

VLLAMASI, Sejfi, *"Ballafaqime politike në Shqipëri (1897 - 1942*)". Bot. 2 me il. Përg. për bot. dhe il. Prof. Dr. Maringlen Verli: "*Parathënie"*, f. 6, Neraida, Tiranë, 2000.

ZAVALANI, Tajar : "*Histori e Shqipnis"*; PHOENIX, Tiranë, Bot. 2, 1998.

NOPCSA, Franz , "*Antropologji kulturore"*, Dispencë [Tiranë, maj 2011].

VLORA, Ismail Qemal, *"Kujtime",* Botimet Grand Prind, [Tiranë], [2007].

REGJISTRIM dhe shënime, mbajtur në bisedat me z. Petrit A.Velaj, 96 vjeç dhe Fahri Xh. Shaska me arsim të mesëm.

MÉTAIS, Serge, "*Historia e Shqiptarëve nga ilirët deri te Pavarësia e Kosovës*", 55, Tiranë, 2006.

GUY, Nicola C., "*Lindja e Shqipërisë = The Birth of Albania*", Pegi, Tiranë, tetor 2012.

VICKERS, Miranda, *Shqiptarët - një histori modern [The Albanains A modern History]*, BOTA SHQIPTARE, Tiranë, 2008.

RENDERING POLITICAL ALLUSIONS FROM ALBANIAN INTO ENGLISH

ARJAN BILO
arjan.bilo@univlora.edu.al
UNIVERSITY OF VLORA
A PAPER PRESENTED AT THE BASEES 2014 CONFERENCE, 05-07 APRIL 2014
FITZWILLIAM COLLEGE AND CHURCHILL COLLEGE,
UNIVERSITY OF CAMBRIDGE, UK

Abstrakti

Ky studim analizon shpeshtimin e aludimeve në editorialet politike dhe në gazetari, si edhe specifikon teknikat e përkthimit që përdoren nga përkthyes profesionistë dhe sasinë e adumbrimeve që konsiderohen në tekstet e përkthyera nga Shqipja në Anglisht. Një fokus i veçantë i është dhënë pyetjes nëse aludimet e përdorura në shkrimet politike janë me një apo me shumë shtresa të nënkuptuara dhe nëse përkthyesit kanë arritur të dallojnë nivelin referencial (adumbrimin) me qëllim dhënien e saktë të tekstit në gjuhën e përkthyer. Korpusi i të dhënave konsiston në më shumë se 100 faqe të formatit A4 të nxjerraa nga artikujt e opinioneve dhe editorialeve të botuara prej gazetave shqiptare që janë më shumë në qarkullim, duke u përqendruar në harkun kohor të viteve 2012-2014. Korpusi i të dhënave përllogaritet të jetë me rreth 50 mijë fjalë të tekstit në shqip, të cilat janë lexuar manualisht për të analizuar shpeshtimin e aludimeve në shkrimet politike dhe më pas 50 artikuj në sasinë e 700-1000 fjalëve janë zgjedhur për analizë të mëtejshme. Nga kërkimi studimor dolën 50 aludime me një shpërndarje 1 aludim për 100 fjalë. Korniza teorike është bazuar në librin e Ritva Leppihalme, "'Culture Bumps: An Empirical Approach to the Translation of Allusions''.

FJALËT KYÇE: Aludime, aludimet me shumë shtresa, adumbrime, papërkthyeshmëri, teknika përkthimi, pengesa kulturore, shkrim politik, aludim i emrin të përveçëm, aludim i frazës kyçe.

ABSTRACT

This study examines the frequency of allusions in political writing and journalism, the translation strategies used by professional translators and the amount in which adumbrations are considered and reflected in texts translated from Albanian into English. Special focus is given to the question whether the allusions used in political writing are single or multiple-layered and whether the translators have been able to recognize the referent level (adumbration) in order to render the proper meaning into the target text. The data corpus consists of more than 100 A4-sized pages of material retrieved from opinion articles and editorials published in a number of high circulation Albanian newspapers during 2012-2014. The data

corpus was decomposed into 50,000 words of Albanian text and manually checked for the frequency of allusions in the political discourse and 50 articles with a length of 700-1000 words were selected for further analysis. The search yielded a total of 50 allusions with a distribution of 1 allusion per 1000 words. The theoretical framework is based on Ritva Leppihalme's book: 'Culture Bumps: An Empirical Approach to the Translation of Allusions''.

KEYWORDS: allusions, multiple-layered allusions, adumbrations, untranslatability, translation strategies, culture bumps, political discourse, proper name allusion, key phrase allusion.

1. INTRODUCTION

An allusion may be denned as the mention of the name of a real person, historical event, or literary character which is not simply a straightforward reference, but which conjures up some extra meaning, embodying some quality or characteristic. For example: *Hercules,* a character derived from Greek methodology, when used today in different situations, carries the meaning of *strong person.* According to the Encyclopedia Britannica, "an allusion is used as a straightforward device *to enhance* the text by providing further meaning, but it can also be used in a more complex sense to make *an ironic comment* to one thing by comparing it something that is dissimilar". Leppihalme agrees on the fact that allusions are culturally rooted and understanding them can prevent the miscommunication into the target text. (Leppihalme 1997:4) and since the culture is greatly involved, the translator is seen as a 'culture mediator' and 'decision-maker' (1997:19). Allusions move only in one directions: if A alludes B, B does not allude A, simply said, the present alludes to the past, and not vice versa, e.g. one sonnet of Shakespeare alludes to a specific part of the Bible, but the reverse is not true.

As culture-bound elements, allusions depend largely on familiarity to convey meaning (Leppihalme 1997:9). Leppihalme argues that allusions are culturally understood, but they can become ambiguous in other cultures unless the readers are biculturalized (1997:4). Lor example: In Albania, many people have enriched their everyday vocabulary by taking different sentences from the movies, especially by comic ones, to display their thoughts about a certain situation. One can say *"Ti po qesh si Kogi i Ollges"* (You are laughing like Ollga's Koci"). This is a literally translation of the phrase which is used in the movie and which is understandable from the Albanian audience, because it recalls the movie situation in their memory making the connection with present speaker. But an international audience does not comprehend the situation at all. Binding the equivalence of the above expression could mean: *"You are laughing like Homer Simpson",* since both characters are similar in their personality. This kind of equivalence strategy, which is called *'transplantation',* is mentioned further in this study as one of possible strategies of translating allusions, especially when it comes to rendering Albanian humor into English.

On the other hand, certain allusions can be familiar to the target language culture. According to Leppihalme (1997:9), certain allusions are widely known in cultures where the Bible or other literature is familiar. Lor example: *The forbidden tree in our garden always was taken care from my father.* The allusion, which is *"the forbidden tree",* can be understood by various cultures, because of

the Bible knowledge, bringing in mind the situation in the Garden of Eden, when God forbade Adam and Eve not to touch the forbidden tree. Shakespeare's literature is well known around the world as well. His famous verse from the Hamlet play, *"to be, or not to be, that is the question"* is well-lcnown in many part of the world and societies. Echoing Shakespeare, Greg Wallace said, To *beef or not to beef? That is the equestrian'* (Greg Wallace, The Independent, Sunday, April 27, 2014). Based on the above examples, allusions are built on famous phrases of world literature, known by most parts of the world to communicate a truth or an idea and to persuade the audience.

1.1. Statement of the Problem

Allusions have their effect when readers understand their meaning. Usually this understanding happens when the author and the audience are from the same culture.According to Leppihalme (1997:4), as it is mentioned earlier, TT readers need to biculturalized, otherwise they cannot pass this culture barrier and 'culture bump' happens. The term 'culture bump' is suggested for the first time by Carol M. Archer (1986:170-1), which defined the term as follows: *'A culture bump occurs when an individual finds himself or herself in a different, strange, or uncomfortable situation when interacting with persons of a different culture'.* When there are multiple-layered allusions, the translator apart from knowing the adumbration of the expression, should know the proper strategy to render it for the audience. Very sensitive areas are those of humor and political discussion; because the gap tends to be wider between cultures, since the speakers or writers mention multiple-layered allusions. Thus, many scholars have come up with solutions, techniques and strategies to cover this problem.

1.1.1. Research Question

a. How often are allusions used in political writings?
b. What source have the authors of political writings used to draw allusions from?
c. How are allusions treated by translators and interpreters in political discourse?
d. What are some of the specific methods they have used to render them into English?

2. Literature Review

2.1. Defining allusions

An allusion may be defined as the mention of the name of a real person, historical event, or literary character which is not simply a straightforward reference, but which conjures up some extra meaning, embodying some quality or characteristic. For example: *Hercules,* a character derived from Greek methodology, when used today in different situations, carries the meaning of *strong person.* According to the Encyclopedia Britannica, “an allusion is used as a straightforward device *to enhance* the text by providing further meaning, but it can also be used in a more complex sense to make *an ironic comment* to one thing by comparing it something that is dissimilar”. Leppihalme agrees on the fact that allusions are culturally rooted and understanding them can prevent

the miscommunication into the target text. (Leppihalme 1997:4) and since the culture is greatly involved, the translator is seen as a 'culture mediator' and 'decision-maker' (1997:19). Allusions move only in one directions: if A alludes B, B does not allude A, simply said, the present alludes to the past, and not vice versa, e.g. one sonnet of Shakespeare alludes to a specific part of the Bible, but the reverse is not true.

As culture-bound elements, allusions depend largely on familiarity to convey meaning (Leppihalme 1997:9). Leppihalme argues that allusions are culturally understood, but they can become ambiguous in other cultures unless the readers are biculturalized (1997:4). For example: In Albania, many people have enriched their everyday vocabulary by taking different sentences from the movies, especially by comic ones, to display their thoughts about a certain situation. One can say *"Ti po qesh si Koçi i Ollgës"* (You are laughing like Ollga's Koci"). This is a literally translation of the phrase which is used in the movie and which is understandable from the Albanian audience, because it recalls the movie situation in their memory making the connection with present speaker. But an international audience does not comprehend the situation at all. Finding the equivalence of the above expression could mean: *"You are laughing like Homer Simpson*", since both characters are similar in their personality. This kind of equivalence strategy, which is called '*transplantation',* is mentioned further in this study as one of possible strategies of translating allusions, especially when it comes to rendering Albanian humor into English.

On the other hand, certain allusions can be familiar to the target language culture. According to Leppihalme (1997:9), certain allusions are widely known in cultures where the Bible or other literature is familiar. For example: *The forbidden tree in our garden always was taken care from my father.* The allusion, which is *"the forbidden tree",* can be understood by various cultures, because of the Bible knowledge, bringing in mind the situation in the Garden of Eden, when God forbade Adam and Eve not to touch the forbidden tree. Shakespeare's literature is well known around the world as well. His famous verse from the Hamlet play, *"to be, or not to be, that is the question"* is well-known in many part of the world and societies. Echoing Shakespeare, Greg Wallace said, *'To beef or not to beef? That is the equestrian'* (Greg Wallace, The Independent, Sunday, April 27, 2014). Based on the above examples, allusions are built on famous phrases of world literature, known by most parts of the world to communicate a truth or an idea and to persuade the audience.

Leppihalme (1997:6) gives the following definitions, which share the idea of *'reflecting something'* or are *'a reference to something'*. Allusion comes from the Latin word '*alludere'*, *'to play with, to jest, to refer to'*, and it implies a reference to characters and situations in mythology, legends, history (Scott, Current Literary Terms, 1965). Allusion is an implicit reference to another literary work, to another art, to history, or contemporary implicit reference to another literary work, to another art, to history, to modern figures. (Preminger, Encyclopedia of Poetry and Poetics, 1965).Shaw (1976) when referring to allusions explains them as a reference, usually brief, often casual, and occasionally indirect, to a person, event, or condition presumably familiar but sometimes obscure or unknown to the reader. According to Abrams (1984) allusions are references, explicit or indirect, to a person, place, or event, or to another literary work or passage.

2.2. Forms of allusions

Forms that allusions reveal themselves in the source text and how they change their form in the target text is not the focus of this thesis, however they are mentioned further in this papers. Referring to Leppihalme (1997:10), allusions are classified and divided into two groups according to their forms:

2.2.1. Proper Name (PN) allusions

Proper name allusions contain a proper name, as in the following example:

'...you are more than a star; you're a *Rambo, an Oprah,* a minister without a portfolio...' (Tema Daily, May 9, 2012).

2.2.2. Key-Phrase (KP) allusions

Key-phrase allusions containkey phrases that bear a specific meaning in the source language culture, as in the following example:

'Albania - *home of the wise fool!*' (Sot Daily, March 9, 2014)

(I) Both of these classes are further divided into:

> (a) Regular allusions = an unmarked category of 'prototypical' allusions
>
> *Someone's got to stand up and say that the emperor has no clothes.*
>
> (b) Modified allusions = allusions with a 'twist', that is, the preformed material is altered or modified
>
> *You decide what to do nowadays, to beef or not to beef!*

(II) Stereotyped allusions = the allusions used frequently and they have no freshness and do not necessarily evoke their sources; also clichés and proverbs. *We were ships that pass in the night.*

(III) (A) Semi-allusive comparisons = superficial comparisons or looser associations

Like in a Big Brother show, our parliament has become a house of Nasreddin.

(B) Eponymous adjectives (adjectives derived from names)= in such types no fixed collocations are formed with their current headwords.

I saw that girl dressed in Victorian style and gave her a flower.

2.4. The function of allusions

Leppihalme (1997) divides allusions in three main groups according to their functions: allusions that create humor, allusions that describe characters, allusions that carry themes.

Humor, apart from the other two functions, serves more on a local level (Leppihalme, 1997:10), and it needs some understanding from the part of the audience (readers) in order for the humor to function properly and leave its effect. The phrase from the comedy *"Pallati 176"* (Building 176-my translation)

"Shoqe me pantallona, hë?" even when translated as *"Girlfriend in trousers?"* is unclear and does not cause any humor for the English-speaking readers or audience, because that phrase primarily has a culture meaning. In time of communism, at least for some years, girls were not allowed to dress trousers because it was seen as a "foreign" and a "capitalist" way of dressing. Then in "Pallati 176", this phrase got satirical connotation and based on this play, people in Albania were using it to create humor among them depending from the context. **In describing characters**, allusions refer to well-known, successful, and famous characters in the past to compare another character or event in the present. In the Greek legend, there is a character known as 'Odyssey', who was described by the author as very clever man, went to Troy war with his soldiers and in the way back home, he went through many perils and difficulties. Only after a long period time he managed to come home and meet his family. Having this story in mind, phrases like, "*The democracy in Albania is having its Odyssey through many waves and storms of instability*" explain a present situation, or *"My father was the Odyssey of our family'* implying that the father was very clever to find solutions for his family. **Allusions can carry themes** as well. The characters of *'Adam and Eve'* can convey different themes as allusions, such as sexuality, innocence, happiness, sin, disobedience, abundance and generation of life (The Oxford Dictionary of Allusions) or the phrase *'Garden of Eden'* can mean beauty, paradise, perfection and rest. This complexity that is found in allusions makes the work of an translator or the interpreter difficult where in cases like this the context in which such allusions are used, the translator gives his best in concentrating.

3. Methodology

3.1. Qualitative analysis

Content analysis was used as a qualitative method to study the translation of allusions from Albanian into English in political discourse. Samples were taken and analyzed from various newspapers and political writings. Their meaning and source were made clear from the context before they were sent to the translators. In this project, professional Albanian translators as well as translators who werenative speakers of Englishgave their possible rendition of the samples. Later, those translations were further analyzed to identify the strategy applied by the translators in rendering allusions into the target text. The potential strategies offered by Leppihalme (1997) served as the basis for this analysis. Then, the next step was to find out what were the most dominant strategies used by the translators for the translation of Key-Phrase allusions and Proper Name Allusions. Further observationswere made to explore the main sources used by speakers and writers in political discourse.
The sources used to collect the corpus data were some of the major daily Albanian newspapers, listed as follows.

Tema Daily
Gazeta Shqiptare Daily
Panorama Daily
Mapo Daily
Shqip Daily

Sot News Daily
Shekulli Daily
BalkanWeb
YouTube

Editorials and articles from the selected newspapers were read in search of allusions. About 50,000 words were read before 50 allusions were found for further study and were put in a table for analysis. This table of analysis contained a translation work from professional translators whose native language is English, whoaccepted to collaborate in this research project. The corpus table contains the meaning of the allusions, the source they were coming from and the method chosen by the translators to render these allusions into English, which was mainly the purpose of this study. Based on the table of analysis, charts were built to display the most common method applied from the translators in the rendering of the allusions, as well as the most common source from where allusions in the political discourse were coming from.

3.1.1. Quantitative analysis

As it is mentioned earlier 50 thousand words are read from different newspapers, from which 50 random allusions are drawn and analyzed. There is 1 allusion in 1000 words, which shows that allusions in political discourse are used to underline a certain topic, and when there are used more than once in one essay they are used from the author to emphasize the topic or the problem. In the 50 allusions taken for the study in this paper, 45 of them are single-layered allusion, which means there is one known event in the past that is reflected in the present and that event is the adumbration - the origin of the allusion, while 5 out of 50 are multiple-layered allusions.

3.1.2. The most predominant methods used by the translators

Based on Leppihalme's list of potential strategies for key-phrase allusions and proper name allusions, referring to Tab.5, translators and interpreters have used a lot of standard translation for the key-phrase allusions and have rendered literally the proper name allusion from source text to the target text. This way of rendering allusions may help the target language readers and audience to enrich their knowledge about the source culture, but on the other side it is confusing if there is no explanation with footnotes or brackets from the author or the translator in order for the target audience to understand, e.g. *'Holy Trinity'* (number 44 in the sample list) is translated literally into the target text. This does not cause any confusion since English speaking audience understand the bible and the Christian theology, but in the example of *'kunati i shokut Xhemal'* (number 49 in the sample list), which is also rendered literally into the target text, it is hardly understood by the English-speaking audience, because this expression is deeply rooted in the Albanian culture and humour and if translator does not find any equivalent in the target text using the method of transplantation (Fig.1 and Fig.2), at least some footnotes or

explanation in brackets would be appreciated in order for the audience to comprehend the expression.

Some translators have replaced the allusion from the source text using a preformed TL item, e.g. '*U duket vetja Zeusi i mendimit'* is translated 'They think themselves to be the *God of thought'* (number 48 in the sample list). The translator has found the equivalent meaning and this translation help the target audience understand the author, but on the other hand, the richness of the source allusion is lost in the target text. Of course, in the above-mentioned examples, apart from the loss of vocabulary richness in translation, also the gain in translation from the target audience is worth-mentioning, since the audience gain understanding of meaning from the source text. This loss and gain concept is decided by the translator or interpreter and if a translation work should have a loss or gaining character, but as it is mentioned earlier the translator could maintain 'balance' between these 'two' forces' through the use of the literal translation of the allusions and in the same time using footnotes for the audience, thus the vocabulary richness and the meaning from the source text are maintained. Referring to the sample list, the translators and interpreters have used the *Omission* method or rendering allusions.

An example of this method is found in number 47 in the sample list: '*ai foli, midis të tjerash, për eliminimin e departamenteve, por dhe njëfarë "Bing Bang"-u kolektiv…'* is rendered as '*he spoke, among other things, about eliminating departments and about some kind of big restructuring of the administrative regions…'* thus omitting the phrase 'Big-Bang'. In this case the translator decided to render the exact meaning of the source text by omitting the entire allusion phrase.

Even though the omission strategy is not popular, sometime the translator uses it when there is no other chance of translating the phrase, which apparently it is not the reason in the above-mentioned example, and in cases where the translator decides to do it differently, especially (and this could be our case) when the allusion from source text is well-known by the target audience and it does not bring any 'richness of vocabulary' to them. *Footnotes* and *brackets* seem to be a great way when translating allusions, since they 'cover' both, the richness of vocabulary and the meaning from the source text, e.g. '*...mos kërko ta bësh atë "Lei Feng" të sjelljes arrogante e as target të "fletë rrufeve" të "kolektivit punonjës'* (number 21 in the sample list) is rendered as '*...do not ask them to obediently engage in arrogant politics or make them the target of the workers' collective fletërrufe [critical opinions expressed in anonymous public signs during communism].*

Also in the translation of the proper name allusions, footnotes and brackets are appreciated, e.g. *'Harrojnë ata se si sillen Kapot, me homologet e saj, Silvia Kontet?'* is rendered as *'Have they forgotten how Capos behave with her homologues, like Mafia with Silvia Konti? [the prosecutor against Italian Mafia at La Piovra movie series].'* On the other hand, footnotes and brackets, as it is earlier said, could offend the intelligence of the audience if they are improperly used. The translator has to know the audience before using footnotes and brackets.

4. Findings

4.1. Humor in the Albanian vocabulary

From the three main functions mentioned above I have chosen allusions that create humor to study a little bit deeper, since it is a sensitive area of translation to be considered. Humor in Albanian society alludes to the Albanian movies and plays. Since Albania has been under communism for 50 years, movies and plays were the most ethically educative tools for the society that not only entertained the masses but enriched their soul as well. In case of humor, movies and plays did just that. Phrases like: *"Ti do të më vdesësh mua"* (Dy herë mat), *"Gërmo Tare, Gërmo"* (Përballimi), *"Shitën gomerët, dhe blenë biçikleta"* (Zonja nga qyteti), *"Hë, më të keqen xhaxhi… shoqe me pantallona hë?"* (Pallati 176), are some of hundreds of phrases that have entered the Albanian vocabulary of humor and they are used by our society and culture, to create humor, to explain a situation, and to reveal a truth about something. Let us take one of the above expressions to use it as an illustration. *"Ti do të më vdesësh mua"* (You will get the hell out of me), which explains the situation when *Cuk* (known for his servility towards the mayor of the city) make the *Mayor* (Comrade Kopi) very tired with his behaviour, and Kopi says: *"Ti do të me vdesësh mua".* In similar situations this expression is used in real life to mean the same thing toward a person who embarrases others, but it can be used for humor as well, when an individual is acting like Cuk. People say the same expression, but meaning different things. Context determines the use of such expressions. Usually, phrases taken from comedies have satiric intentions and not to be taken literally.

4.2. The difficulty of rendering satiric allusions

In the above-mentioned example, the phrase "*Gërmo Tare Gërrmo*"(Fig.1) it is taken from the the movie *'Përballimi'* (The Clash- my translation), which speaks about the rise of first communist government after the second world war, members of which were searching for deposits of grains in the houses of their enemies in order to distribute it to the people. The phrase it is used as an ironic expression by one of this rich people to one to the main characters - *Tare* - who searches for the deposit under the stack. When used today it means *"someone who searches something in vain".*That phrase in the movie means: *'You might search in vain, but you will not find anything"* - What makes it hard is the translation of it. The literal translation is out of option (*dig, Tare, dig)*, since humor is locally understood and it does not mean anything in the target English-speaking culture when translated literally. An alternative might be translating this phrase thought for thought like, *'Yeah, Tare, come on, chase the wind!'* (Ecclesiastes, Bible), which explains the idea of vainness. Even though the "right" translations may be acceptable and understandable for the English-speaking audience when it comes to rendering Albanian humor, still the satirical part of it is lost, which means that even correct translation do not complete the job.



Fig.1. - The loss of humor in the "right" translation

Knowing that the satire in this phrase is not the phrase itself (since the phrase is just an ordinary one), but the character who spoke it, than we can "dig" more to find the equivalent. The phrase conveys the idea of searching, vainness, impossibility, and irony behind it (Fig.2). These three columns are glimpses that can help the translator render the exact humorous meaning to the target audience. Apart from these glimpses, method of transplantation suggested by Hervey and Higgins (1986:29) seems to fit well when we deal with the Albanian humor. It is the procedure in which SL names are replaced by indigenous TL names that are not literal equivalents, but have similar connotations. Then let us 'transplant' the phrase *'gërrmo Tare, gërrmo"* in English:'*Finding the needle in the haystack? Yeah, genius Thraso, surely you will find it"*.



Fig.2 – The method of transplantation in rendering the Albanian humor

Finding the needle in the haystack - is a well-known expression which denotes impossibility to find something, so we need that to describe 'the searching' in Albanian expression.*Thraso*, is the equivalent for the name *Tare*, who was a boastful soldier in the Roman writer Terence's comedy *Eunuchus*. His name, and the related adjective *'Thrasonical'*, can be used to denote someone who is

vain and boastful. Thraso denote vainness. Therefore, what we needed was the idea of searching, impossibility, vainness, irony and a name. Name change is added to the list, since the name *"Tare"* does not convey any satire in English, thus using the method of transplantation all the ideas are "transplanted" correctly into English. Leppihalme agrees that a culture barrier can prevent the understanding of an allusion, unless the receivers are sufficiently biculturalized (1997:4) and humor is an area when authors should consider the audience and make sure they comprehend allusions, so culturally rendering the humor is the convenient way.

5. Adumbrations – The Multiple-Layered Allusions

Adumbration is an extra linguistic aspect, which, if left untranslated when transferring the meaning of multiple-layered allusions into a target language, may obscure the meaning or cause ambiguities. The term *'multiple-layered allusion'* is used to define an allusion that evokes another allusion, which, in its turn, calls to mind an object, person, event, place, myth, literary work or work of art without mentioning it explicitly (Fig. 3), e.g. the word *"exodus"* might refer to three known events: the Kosovar exodus in 1997, the Albanian exodus in 1991 and the Israel exodus in 1576 BC. These three events form a multiple-layered allusion since they evoke each other.

5.1. Three layers of allusions

In this study three layers of allusions are distinguished:
1. *Literal layer* – which is a combination of the semantic, direct content of each word that forms the allusion
2. *Pragmatic layer* – which is the meaning drawn by the way in which the allusion was used in a previous context in the past
3. *Referential layer or adumbration* – which is the very origin of the meaning of the phrase, the way in which the word/phrase was used for the first time if traceable.

If we refer to the above example with the *"exodus"* word, the literal layer is the *"closest"* meaning known and the referential layer is the *"remote"* meaning traceable and known. Thus, we have as literal layer – the Kosovar exodus, as pragmatic layer – the Albanian exodus (since it refers to the past exodus of Kosovars) and as referential layer – the Israel exodus, which is the adumbration in the same time, since it is the most remote event we know and the origin of the word *"exodus".*The term *'adumbration'* refers to the direct connection of the first allusion to its referent denoting the object, person or event that prompted the allusion. Adumbration is the original proper noun or phrase, which with the passing of years is used by authors as an allusion. Once we fail to understand the *adumbration* that takes place in the phrase, i.e. *the connection between the initial phrase as used by the source language text and its true referent*—which is not the phrase that has been mentioned in the book, but instead it is the event that happens outside of that book—ambiguity ensues.

The reason that is called adumbration is because it is a phenomenon that has not a lot of coverage as far a research work it is done in this study, and it did not have an exact term for adumbration, which comes from the word *'ombra'*

(shadow), thus explaining the meaning of the word, which means *"things after allusions".*



Fig.3. The allusion of an allusion

6. CONCLUSION

The objective of this study was to find out what was the most predominant strategy used by professional translators in rendering allusions from Albanian into English. This study started with a preview in the definitions of allusions, their forms and functions, their main sources and it continued with the difficult phenomenon of rendering Albanian humor into the English language and based on the research in Fig. 1 and 2, it came out that the method of transplantation could be a proper method in preserving humor. Other methods could have been used in translating humor, but they were not sufficient enough, despite their correct translation, to transfer humor into the English culture. In this study also multiple-allusions are mentioned as an important phenomenon to be considered by the translators and interpreters knowing that an allusion has its 'roots' in the past events and failing to consider this fact when rendering them into another culture creates anomalies in translation, misconceptions and even incidents as we have seen earlier in this study. Since this study is based on Leppihalme's book "*Culture Bumps: An Empirical Approach to the Translation of Allusions",* strategies offered in this book served as a foundation in the further study of allusions in the political writing, which was also the main objective of this thesis. Strategies adapted to the translation of Key-Phrase allusions and Proper Name Allusions, as it is shown in the statistics (Tab.5 and 6), the most dominant strategy used by the translators is that of Standard translation, which means the translators have rendered it word for word into the target text with no further explanation of the phrase.

The method of Replacement by a preformed TL item and that of Reduction to sense must also be taken into consideration, since these methods are considered quite frequently by the translators, which means translators have found the equivalent phrase into the target text or have paraphrased the source text allusion for the target audience. Omission, Footnotes, Minimum change and Re-creation methods are rarely used, since the translators have preferred the first three dominant strategies to render allusions into the target text. Allusions

in political Discourse derive mainly from Cinematography and Folklore, basically from the movies during the Communist era. Then, the source from specific situations in the past comes next, which reminds the public about that situation and the repetition of it in the present. As the third source chosen by the writers are Biblical Allusions. These kinds of allusions are used mainly to convince the audience morally, leaving them with no choice to think otherwise. The other sources are mentioned less, but these do not make them less important. These sources are historical, literary and mythological. The chronological order, the way sources are listed, displays the frequency they are used in political writings, as well as the writer's tendency to make their message understandable for their audience and to use those sources as their best strategy to convince the audience.

6.1. Relevance of this study

Apart from the frequency of the allusions and multiple-layered allusions in Albanian political discourse, the most significant contribution of this study is identifying the methods of rendering Albanian allusions for the English audience. As it wasmentionedearlier, allusions are culturally comprehended and it not enough to literally translate them into English, but as some of the translations show in the Tab.1, the best method to be considered is the method that does not translate just the words and the meaning, but the familiarity as well into the target culture (English). Based on Leppihalme's work, the audience must be biculturized in order to grasp allusions of another culture, or the translator should make it familiar to them. In addition, this study shows that the most popular methods in achieving this familiarity for the English-speaking audience are the methods of replacing allusions by a preformed target language term, and using footnotes or brackets for adding some clarification for the readers.

According to the study, the translator or the interpreter is free to choose what is best in a certain situation, but the above-mentioned methods should be considered first, then the translator may choose what is working in different contexts. The reason why the standard translation is not primarily preferred (even though it on the top of the most used methods in this thesis) when rendering allusions is because it does not bring the correct understanding and familiarity in the English audience, and it needs footnotes or brackets when it is used in rendering allusions.

As a whole, the issue of the proper methods and familiarity deserves more attention in future studies.

6.1.1. Limitations to the study and indications for further research

As it is mentioned earlier in this thesis, due to the limited number of newspapers text, the results cannot be considered to be specific, but general; as an indication and as a 'trampoline' for further studies in allusions. On the other hand, the political text is sufficient to experiment with possible methods of translations regarding allusions.

Another limitation to this study is the limited translation given by one translator only regarding a certain text. In further studies, another experiment

could be implemented with many translators giving their variant of translation regarding to a specific sentence where allusions are involved.

Some further research work must be made regarding the issue of familiarity, even though it is slightly mentioned in this study. Probably, if the familiarity of the English audience regarding the Albanian allusions by the translators could have been considered more in detail, there would have been better results regarding the methods displayed in the table of the analysis. Distinguishing what is 'probably' and 'possibly' familiar to the audience is the key to deciding what method would work in a particular context. Probably, a good idea would have been to ask the English audience about the translated allusions in political writing to get a percentage of their understanding in this issue.

Translators in the time when they translated allusions presented in this thesis, were not told about the methods mentioned in this thesis, in order for them to decide which they seem best for a proper translation and this might have shrinked the results that were expected from this study, but on the other hand, leaving them free in their own choice of the method might trigger the thought about further studies regarding the freedom of the translator.

Lastly, a limitation to this study is that methods mentioned in this thesis could have been deeper explored and probably more examples could have been given to each of them to get further understanding, but in the same time this limitation is an indication for further studies in the subject of methods related to allusion

7. References

Andrew Delahunty and Sheila Dignen. *The Oxford Dictionary of Allusions*. Oxford: Oxford University Press, 2001.

Alex Preminger.*Encyclopedia of Poetry and Poetics. Princeton*, NJ: Princeton University Press, 1965

Anthony L. Johnson.*Allusion in Poetry*. *A review of Gian Biagio Conte* (1974), Memoria dei poeti e sistema letterario: Catullo, Virgilio, Ovidio, Lucano, Turin: Einaudi. PTL: *A Journalfor Descriptive Poetics and Theory of Literature* 1,579-87.], 1976

Balz Engler. *Textualisation.* In R.D. Sell (ed.) *Literary Pragmatics* (pp. 179-89). London: Routledge, 1991

Basil Hatim and Jeremy Munday. *Translation: An Advanced Resource Book*. London&New York: Routledge, 2004.

Basil Hatim and Ian Mason. *Discourse and the Translator*. Harlow: Longman, 1990.

Carol.M. Archer,. *Culture bump and beyond*. In J.M.Valdes (ed.) *Culture Bound. Bridging the Cultural Gap in Language Teaching*(pp. 170-8). Cambridge: Cambridge University Press, 1986

Charleston Daily Mail Newspaper Archive:http://newspaperarchive.com/us/west-virginia/charleston/charleston-daily-mail/1959/08-08/page-11, page 11, August 08, 1959

Encyclopedia Britannica inc.*The New Encyclopedia Britannica*. 15th ed ed. 32 vols Chicago, London: Encyclopaedia Britannica, 1993

Fitgerald Scott.*Current Literary Terms: A Concise Dictionary of Their Origin and Use*. New York: Macmillan, 1965

Ghanooni, A. *Allusions in Hafez's poetry in two English and one French, 2008*

Harry Shaw. *Dictionary of Literary Terms*. New York: McGraw-Hill, 1976

Henry Bradley. *The Making of English*. London: Macmillan, 1957, 1904

Holmes Hönig, *Review of S. Hervey and I. Higgins (1992) Thinking Translation*. A Course in Translation Method, London: Routledge. Target 5:1, 119-123, 1993

Independent Daily. http://www.independent.co.uk/news/media/tv-radio/to-beef-or-not-to-beef-that-is-the-equestrian-masterchefs-greg-wallace-admits-he-would-like-to-try-horsemeat-8497350.html, Sunday, April 27, 2014.

John. P. Riquelme. *Stephen Hero and A Portrait of the Artist as a Young Man: transforming the nightmare of history*. In D, Attridge. 2nd ed, *The Cambridge Companion to James Joyce*. Cambridge: Cambridge University Press. pp. 103-120, 2006.

Mohammed *Albakry***.** *Linguistic and cultural issues in literary translation*. Retrieved November 17, 2006 fromhttp://accurapid.com/journal/29liter.htm, 2004

Meyer (Mike) Howard Abrams. *A glossary of literary terms*. 4th ed ed. New York ; London: Holt, Rinehart and Winston. 1981,1984.
Martin Montgomery.*Ways of Reading: Advanced Reading Skills for Students of English literature*.London:Routledge,2007
Paul Lennon. *The Functions of Allusion : Allusion in the Press*. Retreived June 22, 2009, 2004.
Peter Newmark. *A Textbook of Translation*. New York: Prentice Hall, 1988
Refik Kadija.*William Shakespeare in Albania,* Article 4 in LCPJ, 2009

Ritva Leppihalme.*Culture Bumps: An Empirical Approach to the Translation of Allusions.* Vol. 10: Multilingual matters, 1997

Richard Sieburth.*Sylvie*. Hardmonsworth, Penguin.1995

Umberto Eco.*Experiences in translation*. Toronto, ON: University of Toronto Press, 1999.

William Hazlitt. *Lectures on the English Poets and the Spirit of the Age*. London: Dent, 1990.
Wilss, W. 1989. *Translation strategies, translation method and translation technique: towards a clarification of three translational concepts*. Revue de Phonétique Appliquée 66-67-68,143-52.

NDËRMJETËSIMI NË ÇËSHTJET PENALE

Artur Malaj
Gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Apelit

1. Hyrje

Në dy dekadat e fundit, është vënë re një zhvendosje e vëmendjes së drejtësisë penale në drejtim të një koncepti të ri, atij të Drejtësisë Restauruese. Drejtësia Restauruese ofron një alternativë të re në zgjidhjen e çështjeve penale, e cila në ndryshim nga sistemi ndëshkues, tenton drejt një zgjidhje me karakter social, në themel të sëcilës vendoset restaurimi i marrëdhënies midis autorit të veprës penale dhe të dëmtuarit prej saj, si dhe komunitetit.
Zhvillimi i këtij sistemi erdhi si rezultat i nevojës për evoluim të politikave penale për parandalimin e kriminalitetit, duke shmangur formalitetin në zgjidhjen e çështjeve penale dhe duke përdorur metoda, të cilat synojnë një rehabilitim të dyfishtë, si për të dëmtuarin nga vepra penale, ashtu edhe për autorin e saj. Në pikëpamje praktike, aplikimi i Drejtësisë Restauruese realizohet nëpërmjet metodave të ndryshme, ndër të cilat do të theksonim Ndërmjetësimin.
Në vendin tonë, ndërmjetësimi në çështjet penale ka gjetur pasqyrim në një ligj të posaçëm, në ligjin nr. 10 385, datë 24.02.2011 "Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve". Kuptimi i ndërmjetësimit si metodë e Drejtësisë Restauruese, procedura dhe efektet e zbatimit të tij në praktikë, në këndvështrim të ligjit të sipërpërmendur dhe akteve ndërkombëtare, do të përbëjnë objektin e këtij trajtimi.

2. Kuptimi dhe qëllimi i ndërmjetësimit në çështjet penale

Ndërmjetësimi në kuadër të Drejtësisë Restauruese, përfaqëson një metodë të projektuar për të zhvilluar ndjeshmërinë e autorit të veprës penale (e cila mund të ndihmojë parandalimin e sjelljes së ardhshme penale) dhe përcaktimin e nevojave emocionale dhe informative të të dëmtuarit. Rrjedhimisht, qëllimi i tij nuk qëndron në përcaktimin e fajësisë, por në nevojën që autorët e veprës penale të pranojnë përgjegjësinë dhe të riparojnë dëmin e shkaktuar prej tyre.
Ai mbështetet në zhvillimin e një takimi dhe dialogu ndërmjet të dëmtuarit nga vepra penale dhe autorit të saj, nëpërmjet një ndërmjetësi, duke synuar në këtë mënyrë përfshirjen aktive, si të autorit të veprës penale, ashtu edhe të të dëmtuarit prej saj. Kështu, ndërmjetësimi siguron një mundësi për të dy palët, për të diskutuar shkaqet që çuan në kryerjen e veprës penale, si dhe ndikimin që ajo sjell në jetën e tyre, me qëllim riparimin të dëmit emocional dhe material të shkaktuar nga vepra penale.
Kuptimi i ndërmjetësimit, si metodë e drejtësisë restauruese, përcaktohet edhe në ligjin nr. 10 385, datë 24.02.2011, "Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve", i cili në nenin 1 të tij parashikon: " *Ndërmjetësimi është veprimtari jashtëgjyqësore, në të cilën palët kërkojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje me anë të një personi të tretë asnjanës (ndërmjetësit), për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes dhe që nuk bie në*

kundërshtim me ligjin".
Pra, ndërmjetësimi përfaqëson një veprimtari me karakter jashtëgjyqësor, nëpërmjet së cilës i dëmtuari nga vepra penale dhe autori i saj, synojnë të zgjidhin mosmarrëveshjen midis tyre, nëpërmjet ndihmës së një personi të tretë, asnjëanës. Nisur nga ky përkufizim si dhe nga parashikimet vijuese të ligjit[1], mund të nxjerrim disa karakteristika të ndërmjetësimit:
Së pari, ndërmjetësimi përfaqëson një veprimtari jashtgjyqësore, pavarësisht organit referues dhe momentit të referimit të tij. Ai, gjithashtu konsiston në një veprimtari të pavarur nga struktura shtetërore të drejtësisë apo administratës publike. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë që ai nuk ka nevojë për mbështetjen e tyre.
Së dyti, ndërmjetësimi ka karakter vullnetar. Kjo do të thotë se palët me vullnetin e tyre të lirë dhe reciprok duhet të vendosin për aplikimin e ndërmjetësimit. Ato nuk mund të detyrohen që të zgjidhin mosmarrëveshjen me ndërmjetësim.
Së treti, ndërmjetësimi synon zgjidhjen e mosmarrëveshjes nëpërmjet një personi të tretë, i cili është ndërmjetësi, por që njëkohësisht duhet të përfaqësojë një subjekt asnjëanës. Kjo do të thotë që ai nuk duhet të ketë as lidhje dhe as interes për çështjen në fjalë.
Së katërti, zgjidhja e arritur nëpërmjet ndërmjetësimit duhet të jetë në përputhje me vullnetin e të dy palëve. Megjithatë, ajo nuk duhet të jetë zgjidhje jo ligjore, edhe pse mbështetet në konsensusin e palëve.
Së pesti, aplikimi i ndërmjetësimit duhet të respektojë një kategori parimesh si p.sh.: parimi i barazisë së palëve, konfidencialitetit, fleksibilitetit, transparencës së procedurave dhe vullnetit të palëve. Ai gjithashtu, duhet të zhvillohet konform procedurës së parashikuar në ligj.
Nga sa u tha më sipër, rezulton se qëllimi primar i aplikimit të ndërmjetësimit është të përfshijë dhe rehabilitojë jo vetëm autorin e veprës penale, por edhe të dëmtuarin prej saj. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet zhvillimit të takimit ndërmjet të dy palëve, me qëllim që të diskutojnë vullnetarisht për veprën penale, një mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm.
Ndërmjetësimi gjithashtu, synon të ndërgjegjësojë autorin e veprës penale në lidhje me dëmin e shkaktuar ndaj palës së dëmtuar nga kryerja e veprës penale, si dhe në lidhje me përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për sjelljen e tij. Së fundi, ndërmjetësimi synon të ofrojë mundësinë që të dy palët të hartojnë një marrëveshje të përbashkët, konsensuale, për riparimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale në shkallën e mundshme.
Suksesi i këtij programi, rrjedh nga fakti se ai i krijon palës së dëmtuar mundësinë për të shprehur dëmin e pësuar dhe emocionet në lidhje me kryerjen e veprës penale. Në këtë mënyrë, ndërmjetësimi rezulton në një proces të ballafaqimit social nëpërmjet të cilit qartësohen arsyet që çuan në marrëdhënien konfliktuale. Kështu, lehtësohet gjetja e një zgjidhje të përshtatshme për të dy palët, mundësi e cila nuk do të mund të realizohej nëpërmjet procesit penal. Nga ana tjetër, duke u larguar nga strikticizmi i normave penale, palët nuk do të jenë më nën efektin e presionit ligjor dhe për rrjedhojë, do të ketë mundësi potenciale për konsensus midis tyre.

3. Aplikimi i ndërmjetësimit në fushën penale

[1] Neni 1 pg. 2 i ligjit parashikon: "*Ndërmjetësimi për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve është veprimtari e pavarur, që ushtrohet në përputhje me këtë ligj dhe nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë.*" Shih gjithashtu edhe nenin 3 të ligjit.

Pavarësisht suksesit të tij, ndërmjetësimi nuk mund të zbatohet në çdo çështje penale. Vetë ligji ka vendosur kufizime, duke parashikuar rastet e aplikimit të tij. Kështu në nenin 2 pg. 3 të ligjit, përcaktohet se ndërmjetësimi në fushën penale mund të zbatohet për mosmarrëveshjet që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e të dëmtuarit akuzues ose me ankim të të dëmtuarit, respektivisht sipas neneve 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale (në vijim K.Pr.P), apo në çdo rast tjetër kur ligji i posaçëm e lejon.[2]
Nga ana tjetër, përveç kufizimit të vendosur në lidhje me kategorinë e veprave penale në të cilat mund të aplikohet ndërmjetësimi, është thelbësore të theksojmë se zbatimi i tij kërkon vullnetin reciprok të të dy palëve.[3] Kjo do të thotë se edhe nëse vepra penale, bën pjesë në kategorinë e përcaktuar nga ligji, në rast se mungon vullneti i njërës prej palëve, ndërmjetësimi nuk mund të gjejë zbatim.
Për sa më sipër, aplkimit të ndërmjetësimit në çështjet penale i vendosen dy kufizime:

- Në rradhë të parë, kufizimi i referohet vullnetit të palëve. Duke qënë se ndërmjetësimi është një alternativë vullnetare dhe jo detyruese, duhet që palët të bien dakort për aplikimin e tij. Ato nuk mund të detyrohen që të zgjidhin një çështje penale me ndërmjetësim.
- Në rradhë të dytë, vetëm vullneti i palëve nuk është i mjaftueshëm. Duhet gjithashtu të bëhet fjalë për një nga rastet e lejuara nga ligji, pasi jo të gjitha rastet mund të zgjidhen me ndërmjetësim. Sikurse u përmend më sipër, rastet e parashikuara nga ligji konsistojnë në mosmarrëveshjet që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e të dëmtuarit akuzues ose me ankim të të dëmtuarit, sipas neneve 59 dhe 284 të K.Pr.P., si dhe rasteve kur ligji i veçantë e lejon atë. Pra, ligji referon në K.Pr.P. për të përcaktuar fushën e veprimit të ndërmjetësimit.

Duke iu referuar K.Pr.P., kategoria e veprave penale për të cilat mund të aplikohet ndërmjetësimi nëse palët shprehin vullnetin e tyre reciprok, janë:

1. Bazuar në nenin 59 të K.Pr.P.,[4] veprat penale që shqyrtohen nga gjykata me kërkesë të të dëmtuarit akuzues: dëmtime të tjera me dashje (neni

---

[2] Neni 2, pg. 3 i ligjit: "*Ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet për mosmarrëveshjet që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e të dëmtuarit akuzues, ose me ankim të të dëmtuarit, sipas neneve 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në çdo rast kur ligji i veçantë e lejon atë.*" Ndërsa neni 2, pg. 6 i ligjit parashikon: "*Mosmarrëveshjet për të cilat është e detyrueshme zgjidhja në rrugë gjyqësore nuk mund të zgjidhen me ndërmjetësim.*"

[3] Neni 2, pg. 1 i ligjit: "*Ndërmjetësimi, sipas këtij ligji, zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të parashikuara*
nga pikat 2 dhe 3 të këtij neni, në çdo kohë që palët në konflikt, me vullnetin e tyre të lirë, kërkojnë dhe pranojnë ndërmjetësimin si alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, pavarësisht nëse mosmarrëveshja është paraqitur përpara organit të përcaktuar nga ligji për zgjidhjen e saj. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe në ato raste kur gjykata, apo organi përkatës shtetëror, pas vënies në lëvizje për zgjidhjen mosmarrëveshjes, orientojnë palët drejt ndërmjetësimit, sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni."

[4] Në lidhje me këtë nen, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 27, datë 9 Maj 2012 është shprehur se: "*Edhe pse ndjekja penale është funksion i prokurorisë, ekzistojnë*

90), plagosje e rëndë nga pakujdesia (neni 91), plagoje e lehtë nga pakujdesia (neni 92), dhunimi i banesës, paragrafi i parë (neni 112/1), fyerja (neni 119), fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik (neni 119/b), shpifja (neni 120), ndërhyrje të padrejta në jetën private (neni 121), përhapja e sekreteve vetjake (neni 122), mosdhënia e mjeteve për jetesë (neni 125), marrja e padrejtës e fëmijës (neni 127), botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet (neni 148), riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit (neni 149), shkelja e paprekshmërisë së banesës (neni 254).

2. Bazuar në nenin 284 të K.Pr.P., veprat penale që shqyrtohen nga gjykata mbi ankimin e të dëmtuarit: plagosja e lehtë me dashje (neni 89), marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura, paragrafi i parë (neni 102/1), marrëdhënie seksuale ose homseksuale duke shpërdoruar detyrën (neni 105), marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari (neni 106), shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë (neni 130), goditjet ndaj pjestarëve të familjes së personit që kryen një detyrë shtetërore (neni 243), detyrimi për të marrë pjesë ose jo në grevë (neni 264), përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike (neni 275), fyerja e gjyqtarit (neni 318).[5]

---

disa raste, specifikisht të përcaktuara, në të cilat ndjekja penale i nënshtrohet ekzistencës së një ose disa kushteve për të proceduar. Në këtë kuptim, në rastin e veprave penale për të cilat parashikohet shprehimisht ndërhyrja e të dëmtuarit akuzues, është vetëm ky person që mund të ngrejë akuzë private ndaj autorit të veprës penale. Kusht i domosdoshëm për të ngritur këtë akuzë është që i dëmtuari të jetë viktimë e njërës prej atyre veprave të parashikuara për këtë qëllim nga ligji procedural penal. Vepra të tilla konsiderohen me rrezikshmëri jo të madhe shoqërore dhe që nuk cenojnë rendin publik... Në hartimin e kësaj dispozite, ligjvënësi është përpjekur të vendosë një balancë sa më të drejtë midis interesave publikë, nga njëra anë, të përfaqësuara dhe të mbrojtura nga prokuroria dhe interesave privatë nga ana tjetër, që lidhen ngushtë me individin dhe që për këtë arsye mund të mbrohen drejtpërdrejt prej tij...Akuza private është akti me të cilin personi i dëmtuar manifeston vullnetin për të iniciuar procedimin penal dhe për të venë para përgjegjësisë autorin e një vepre penale nga e cila personit të dëmtuar, sipas vlerësimit të tij, i kanë ardhur pasoja negative. I dëmtuari akuzues mund të përcaktohet si titullar i interesit juridik të mbrojtur nga norma që pretendohet se është cenuar nga vepra penale dhe KPP-ja i njeh atij cilësinë e "subjektit të procesit". Në këtë rast ngritja e akuzës nga i dëmtuari akuzues nuk varet nga vendimmarrja e prokurorisë, ai ka të drejtën t'i drejtohet direkt gjykatës me akuzën e tij dhe merr pjesë aktivisht në proces për ta bindur gjykatën, me anë të provave dhe fakteve, që të marrë një vendim në favor të tij, duke iu ngarkuar, njëkohësisht, edhe barra e provës për të vërtetuar para gjykatës fajësinë e personit të akuzuar. I dëmtuari akuzues ka të drejtë të shfrytëzojë të gjitha mjetet juridike të njohura nga legjislacioni procedural, përfshirë këtu edhe të drejtën e ankimit apo rekursin."

[5] Në këtë nen përfshiheshin edhe: fyerja për shkak të detyrës (neni 239), shpifja për shkak të detyrës (neni 240) dhe shpifja ndaj Presidentit të Republikës (neni 241). Por këto vepra penale u shfuqizuan me ligjin nr. 23/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 'Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar".

Sikurse mund të vihet re, në parashikimet e nenit 59 të K.Pr.P., shkalla e rrezikshmërisë shoqërore e veprave penale është më e ulët se në kategorinë e veprave penale të parashikuara në nenin 284. Gjithsesi, është e qartë se aplikimi i ndërmjetësimit në çështjet penale është mjaft i kufizuar. Shkaku i kufizimeve gjendet në vetë natyrën e konfliktit penal dhe rrezikshmërisë që ai paraqet, jo vetëm në nivel individual, por në një rrafsh më të gjerë, atë shoqëror.

4. Parimet e ndërmjetësimit

Ligji parashikon se ndërmjetësimi penal karakterizohet nga respektimi i disa parimeve si: parimi i vullnetarizimit të palëve, i barazisë së tyre, i konfidencialitetit të të dhënave, i respektimit të fleksibilitetit dhe transparencës së procedurave[6]. Këto parime demonstrojnë veçantinë e shërbimit të ndërmjetësimit, natyrën dhe elementët më thelbësorë që duhet të respektohen.[7] Parimi i vullnetarizmit të palëve është parimi thelbësor në të cilin bazohet aplikimi i ndërmjetësimit. Ai shfaqet në tre aspekte:

1. Së pari, në vullnetin për aplikimin e ndërmjetësimit për zgjidhjen e çështjes penale, pasi sikurse u përmend më sipër, vetëm palët mund të vendosin nëse do ta zgjidhin mosmarrëveshjen me ndërmjetësim apo jo.
2. Së dyti, në përcaktimin e kushteve, procedurës dhe afateve të ndërmjetësimit për aq sa ato janë të lejueshme.
3. Së treti, për arritjen e një marrëveshje përfundimtare apo për heqjen dorë në çdo kohë nga zgjidhja e çështjes me ndërmjetësim.

Parmi i konfidencialitetit[8] konsiston në faktin se tërësia e të dhënave dhe rrethanave për procedurat e ndërmjetësimit duhet të mbeten të rezervuara,

---

[6] Neni 3 i ligjit: "1. *Ndërmjetësimi bazohet në parimin e barazisë së palëve, konfidencialitetit të të dhënave, si dhe në respektimin e fleksibilitetit e të transparencës së procedurave dhe të vullnetit të palëve në proces. 2. Ndërmjetësi, në ushtrimin e funksionit të tij, siguron zgjidhjen e çështjes me efikasitet, drejtësi dhe paanshmëri, si dhe në mënyrë profesionale e pa paragjykime ndaj palëve apo çështjes, objekt ndërmjetësimi. 3. Ndërmjetësimi është vullnetar dhe palët në mosmarrëveshje janë të lira:*
a) të zgjedhin ndërmjetësimin, si mundësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të përcaktuara në
këtë ligj;
b) të përcaktojnë kushtet, procedurën, si dhe afatet për aq sa ato janë të lejueshme;
c) të heqin dorë, në çdo kohë, nga zgjidhja e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim.
4. Ndërmjetësi nuk ka përgjegjësi nëse ndërmjet palëve për zgjidhjen e konfliktit me ndërmjetësim nuk arrihet marrëveshje, ose nëse marrëveshja është arritur, por nuk zbatohet nga palët. 5. Në rastin kur palët arrijnë një marrëveshje për zgjidhjen e konfliktit ndërmjet tyre, ndërmjetësi nuk ka përgjegjësi për moszbatimin e kësaj marrëveshjeje."

[7] Grup autorësh, "Komentar i Ligjit Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve", Tiranë 2012, fq. 32.

[8] Neni 19 i ligjit: "*1. Përveçse kur palët kanë rënë dakord ndryshe, tërësia e të dhënave dhe e rrethanave për procedurat e ndërmjetësimit duhet të mbeten konfidenciale. 2. Pavarësisht nga rregulli i ruajtjes së konfidencialitetit, bëhen publike të dhënat dhe përmbajtja e marrëveshjes së arritur në rastet kur:*
a) është e nevojshme për shkaqe të cenimit të interesave themelorë të shtetit dhe/apo interesit publik;

duke u mbrojtur nga personat e tretë jashtë ndërmjetësimit. Konfidencialiteti përfaqëson një detyrim ligjor si për ndërmjetësin, ashtu edhe për vetë palët. Megjithatë, respektimi i tij, varet nga konteksti në të cilin ngrihet natyra e informacionit apo dokumentit në fjalë, i cili shihet rast pas rasti[9]. Vetë ligji ka parashikuar situatat në të cilat të dhënat dhe përmbajtja e marrëveshjes bëhet publike, të cilat konsistojnë në rastet kur:

1. është e nevojshme për shkaqe të cënimit të interesave themelorë të shtetit dhe/apo interesit publik;
2. është e nevojshme për parandalimin apo ndalimin e dhunës fizike apo psikologjike ndaj çdo personi, veçanërisht ndaj fëmijëve apo personave me aftësi të kufizuara;
3. është e nevojshme për parandalimin apo ndalimin e keqtrajtimit, të dhunës fizike apo psikike të personave me aftësi të kufizuara;
4. nëpërmjet bërjes publike të të dhënave dhe/apo marrëveshjes së ndërmjetësimit sigurohet zbatimi i kësaj marrëveshjeje."

Nga ana tjetër, parimit të konfidencialitetit i bashkangjitet ai i mospërdorimi të të dhënave nga pala pjesëmarrëse ose një person i tretë pjesëmarrës në ndërmjetësim, përveç kur palët kanë rënë dakort ndryshe[10].

Parimi i barazisë në trajtimin e palëve shfaqet në kuptimin që të dy palët duhet të ndjejnë që drejtësia po vepron në emër të secilës prej tyre. Gjatë procedurës së ndërmjetësimit, ndërmjetësi duket të kujdeset për të siguruar trajtimin e njëjtë të palëve.[11] Ato duhet të kenë të drejta dhe detyra të barabarta, duke mos u favorizuar asnjëra prej tyre në mënyrë që palët të sigurohen se interesat e tyre do të trajtohen në mënyrë të drejtë. Marrëveshja përfundimtare duhet të jetë e balancuar dhe pozitive në mënyrë që të zgjidhë konfliktin në mënyrë të kënaqshme për të dyja palët.[12]

Parimi i fleksibilitetit të procedurës konsiston në natyrën e veçantë të ndërmjetësimit për sa i përket formës dhe kohës së realizimit, kontributit të palëve, ndërmjetësit dhe mbështetësve të tjerë.[13] Në themel të ndërmjetësimit qëndron shmangia e procedurave formale dhe të ngurta, pavarësisht se edhe procedura e tij është e parashikuar nga ligji.

Së fundi, parimi i transparencës së procedurës, i cili shfaqet në kuptimin e së drejtës së palëve për t'u informuar dhe kontrolluar të gjithë elementët e ndërmjetësimit në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Transparenca e ndërmjetësimit qëndron edhe në të drejtën e palëve për t'u përfshirë në një proces ndërmjetësimi, si dhe për të ofruar dhe pranuar me vullnet të lirë, pa imponime nga jashtë ose nga ndërmjetësi të mënyrës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes ku janë përfshirë.[14]

---

b) është e nevojshme për parandalimin apo ndalimin e dhunës fizike apo psikologjike ndaj çdo personi, veçanërisht ndaj fëmijëve apo personave me aftësi të kufizuara;

c) është e nevojshme për parandalimin apo ndalimin e keqtrajtimit, të dhunës fizike apo psikike të personave me aftësi të kufizuara;

ç) nëpërmjet bërjes publike të të dhënave dhe/apo marrëveshjes së ndërmjetësimit sigurohet zbatimi i kësaj marrëveshjeje."

[9] Grup autorësh, 'Komentar i Ligjit Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve", Tiranë 2012, fq. 69.

[10] Neni 20 i ligjit.

[11] Neni 17, pg. 4 i ligjit.

[12] Grup autorësh, 'Komentar i Ligjit Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve", Tiranë 2012, fq. 71.

[13] *Ibid,* fq. 33.

[14] *Ibid.*

5. Procedura e ndërmjetësimit

Ndërmjetësimi midis autorit të veprës penale dhe të dëmtuarit, zakonisht konsiston në zhvillimin e një takimi midis dy palëve, në një mjedis të sigurt dhe të strukturuar, në praninë e një ndërmjetësi të trajnuar. Ai përfaqëson një proces që i siguron të dëmtuarve të interesuar mundësinë për të diskutuar me autorët e veprave penale të kryera ndaj tyre. Aplikimi i tij kërkon ndihmën e një ndërmjetësi të trajnuar, i cili lehtëson komunikimin midis dy palëve, duke mundësuar që i dëmtuari nga vepra penale t'i tregojë autorit të saj ndikimin e veprës penale në aspektet fizike, emocionale dhe financiare. Nga ana tjetër, autori i veprës penale, ka mundësinë të përgjigjet për pyetjet që i drejtohen, duke shpjeguar edhe keqkuptimet që mund të jenë krijuar.
Procesi i ndërmjetësimit në drejtësinë restauruese, është i ndryshëm nga ndërmjetësimi i praktikuar në konfliktet civile ose tregtare, pasi ai vendos në themel të tij realizimin e dialogut, pa u përqendruar në arritjen e një zgjidhjeje konkrete. Pikërisht për këtë arsye, shpesh herë, në praktikë e quajnë "procesi i takimit" apo "procesi i dialogut" të autorit të veprës penale me të dëmtuarin prej saj. Gjithsesi, seanca, në përfundim, duhet të rezultojë në një marrëveshje të nënshkruar nga të dy palët për zgjidhjen më të përshtatshme.
Nga ana tjetër, dialogu paraqet një mundësi për të dy palët, që të zhvillojnë në mënyrë konsensuale planin për restaurimin e dëmit të shkaktuar nga krimi. Në këtë mënyrë, ato duhet të jenë aktive në përcaktimin e nevojave dhe detyrimeve, sipas këndvështrimit të secilës. Megjithatë, më tepër se sa marrëveshja e kompensimit, rëndësi paraqet mundësia e rivendosjes së dialogut dhe ndërgjegjësimit të autorit të veprës penale për dëmin e shkaktuar ndaj palës së dëmtuar.
Procedura për aplikimin e ndërmjetësimit është parashikuar nga ligji nr. 10 385, datë 24.02.2011 "Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjve".[15] Bazuar në këtë procedurë, ka dy mënyra se si çështja mund të referohet për ndërmjetësim:

- Së pari, nëpërmjet paraqitjes së ftesës për ndërmjetësim nga të paktën njëra palë, kuptohet për veprat penale të lejuara nga ligji.
- Së dyti, nëpërmjet referimit nga gjykata (ose organe të tjera si p.sh. prokuroria, policia), për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim, duke iu përcaktuar palëve një afat në përputhje me natyrën e mosmarrëveshjes.

Në rastin e dytë, është gjykata ajo që e dërgon çështjen për ndërmjetësim. Ky në fakt përfaqëson një detyrim për gjykatën, në kuptimin që nëse çështja rezulton të jetë në kategorinë e veprave penale që mund të zgjidhen me ndërmjetësim, gjykata ka detyrim që t'u bëjë të ditur palëve dhe t'i ftojë ato në një procedurë ndërmjetësimi[16]. Por, nga ana tjetër, palët nuk janë të detyruara për t'iu nënshtruar ndërmjetësimit, pasi ndërmjetësimi është një veprimtari që bazohet në vullnetin e tyre. Në këtë mënyrë, nëse palët nuk janë dakord, ato kanë të drejtën të kërkojnë në çdo kohë rifillimin e gjykimit.
Pra, procesi i ndërmjetësimit fillon nëse të dy palët subjekte të veprës penale kanë shprehur vullnetin për të. Ato duhet të zgjedhin në mënyrë të lirë dhe pa u nxitur në asnjë lloj mënyrë të pandershme për të pranuar ndërmjetësimin. Gjithsesi, edhe pse ligji nuk e parashikon shprehimisht, në të dy situatat, vendimi për kalimin e çështjes penale në ndërmjetësim, si dhe vlerësimi i

[15] Kreu III i ligjit.
[16] Neni 2, pg.6 i ligjit.

rezultateve të procedurës së ndërmjetësimit, duhet t'u rezervohet autoriteteve të drejtësisë penale.[17] Një përcaktim i tillë është i nevojshëm nisur nga natyra e konfliktit penal. Vetë palët nuk janë në gjëndje të përcaktojnë nëse ndodhen përballë situatës që vepra penale sipas parashikimit të K.Pr.P. mund të zgjidhet me ndërmjetësim, apo ligji i veçantë e lejon atë.

Pasi është rënë dakort për aplikimin e ndërmjetësimit, duhet të zgjidhet një ndërmjetës, bazuar në konsensusin e palëve[18]. Roli i ndërmjetësit, është thelbësor, duke qënë se është ai që do të drejtojë zhvillimin e procedurës së ndërmjetësimit dhe do të ndihmojë palët në arritjen e një marrëveshjeje konsensuale. Prania e tij synon kapërcimin e konfliktit që mund të lindi nga takimi ndërmjet autorit të veprës penale dhe të dëmtuarit. Për këtë arsye, ai duhet të jetë një person asnjëanës, jo i lidhur me një nga palët dhe pa interesa vetjake në zgjidhjen e çështjes[19].

Ndërmjetësi, gjithashtu duhet të jetë trajnuar dhe specializuar paraprakisht për realizimin e kësaj detyre. [20] Është e nevojshme që ai të kujdeset që të trajtojë palët në mënyrë të barabartë, të ruajë konfidencialitetin dhe transparencën gjatë zhvillimit të procedurës[21]. Ai nuk duhet të ofrojë këshillim ligjor.[22] Roli i tij

---

[17] Rekomandim nr . R (99) 19 i Komitetit të Ministrave, drejtuar shteteve anëtare në lidhje me ndërmjetësimin në çështjet penale, pika IV/9.

[18] Neni 15 dhe 16 i ligjit.

[19] Neni 11 i ligjit: "*1. Ndërmjetësi siguron që ndërmjet tij dhe palëve në një procedurë ndërmjetësimi nuk ekziston*
asnjë konflikt interesash. Kur ka dyshime për pavarësinë dhe paanshmërinë e tij, ndërmjetësi heq dorë nga procedurat e ndërmjetësimit.
2. Konsiderohet se ka konflikt interesash kur:
a) ndërmjetësi ka një interes personal, të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me të apo të afërmit e tij, në çështjen për të cilën kërkohet ndërmjetësimi;
b) ndërmjetësi është kujdestar apo përfaqësues i njërës prej palëve;
c) ndërmjetësi vetë, bashkëshortja ose të afërmit e tij, deri në shkallën e dytë, janë në konflikt gjyqësor, në marrëdhënie kredie ose huaje me njërën prej palëve;
ç) ekziston një arsye serioze dhe e mjaftueshme që tregon një situatë konflikti interesi.
3. Kur një personi i ofrohet mundësia për t'u zgjedhur si ndërmjetës, ai duhet të deklarojë, si dhe të vërë në dijeni palët për çdo rrethanë që mund të dëmtojë ose të shkaktojë dyshime për paanshmërinë dhe pavarësinë e tij në lidhje me rastin që ndërmjetësohet.
4. Ndërmjetësi, duke filluar nga koha e caktimit në këtë detyrë dhe gjatë kohës së procedurës së ndërmjetësimit, duhet t'u deklarojë pa vonesë palëve çdo rrethanë që mund të përbëjë cenim ose dyshim në paanshmërinë dhe pavarësinë e tij. "

[20] Rekomandim nr. R (99) 19 i Komitetit të Ministrave, drejtuar shteteve anëtare në lidhje me ndërmjetësimin në çështjet penale, pika V.2 si she neni 9 pg. 2 i ligjit.

[21] Neni 10, pg. 1, 3, 4 të ligjit: "*1. Ndërmjetësi e ushtron profesionin e vet në mënyrë të paanshme, me ndershmëri dhe profesionalizëm, respekton rregullat e etikës profesionale dhe përdor të gjitha mjetet e ligjshme për zgjidhjen e drejtë të mosmarrëveshjeve. 3. Ndërmjetësi ruan konfidencialitetin për të dhënat, për të cilat ka dijeni për shkak të një procedure ndërmjetësimi, në raport me secilën prej palëve apo me persona të tjerë jashtë procedurave të ndërmjetësimit, me përjashtim të rastit kur pala, të dhënat e së cilës bëhen publike ose përpunohen sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, ka dhënë miratimin e saj me shkrim. 4. Ndërmjetësi ruan sekretin profesional dhe nuk mund të detyrohet të dëshmojë për fakte dhe rrethana, për të cilat vihet në dijeni gjatë ushtrimit të veprimtarisë së*

ezaurohet në njohjen reciproke të palëve pa u investuar në riparim, pasi logjika e ndërmjetësimit nënkupton se " marrëveshja e riparimit" është rezultat i vullnetit të lirë të palëve. Megjithatë, nëse palët nuk vendosin ndryshe, ai ka të drejtë të propozojë zgjidhje.[23]
Në vijim, në ditën e caktuar për zhvillimin e ndërmjetësimit, para fillimit të procedurës, ndërmjetësi informon palët në lidhje me qëllimet dhe parimet e përgjithshme, rolin e ndërmjetësit dhe të palëve në proces, shpenzimet dhe efektet e marrëveshjes së ndërmjetësimit[24]. Pasi nënshkruhet marrëveshja për realizimin e ndërmjetësimit, palët diskutojnë për zgjidhjen e nevojshme dhe të pranueshme prej të dyjave[25]. Por, ndërmjetësi, mund të takojë ose komunikojë me palët edhe veçmas, nëse ato nuk kanë vendosur ndryshe[26].
Në një proces ndërmjetësimi, është veçanërisht e domosdoshme të ruhet ndjeshmëria ndaj nevojave të të dëmtuarve:

1. Ndërmjetësi duhet të marrë çdo masë të nevojshme që të sigurojë se i dëmtuari nuk do të dëmtohet në asnjë mënyrë.
2. Pjesëmarrja e të dëmtuarit duhet të jetë totalisht vullnetare, ashtu sikurse edhe e autorit të veprës penale.
3. I dëmtuari duhet të ketë të drejtën e zgjedhjes në lidhje me vendimet që do të merren si p.sh. kur dhe ku duhet të zbatohet ndërmjetësimi, kush do të jetë i pranishëm etj.
4. Ndërmjetësi, jo vetëm duhet të drejtojë fazën para ndërmjetësimit, por gjithashtu duhet të ndjekë vazhdueshmërinë e ruajtjes së marrëdhënieve, duke përfshirë arritjen e një marrëveshje.

Së fundi, vlen të theksohet se edhe gjatë aplikimit të ndërmjetësimit, duhet të zbatohen masa mbrojtëse proceduriale, nisur nga fakti që kemi të bëjmë me një çështje penale. Po kështu, palët kanë të drejtë për të patur asistencë ligjore nëse e kërkojnë. Ndërsa minorenët, duhet të kenë mbështetjen dhe të drejtën për asistencë prindërore[27].

6. Përfundimi i procedurës së ndërmjetësimit

Qëllimi final i procedurës së ndërmjetësimit është zgjidhja e çështjes me konsensus nga të dyja palët. Pra, suksesi i ndërmjetësimit konsiston në arritjen

---

ndërmjetësimit, përveç rasteve kur ka detyrimin me ligj që faktet t'i referojë tek autoritetet proceduese shtetërore."

[22] Neni 10, pg. 2 i ligjit: "*Ndërmjetësi nuk ofron këshillim ligjor*".

[23] Neni 17, pg. 5 i ligjit: "*Kur nuk vendoset ndryshe nga palët, ndërmjetësi ka të drejtë që, në çdo fazë të zbatimit të procedurave të ndërmjetësimit, të propozojë një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes*."

[24] Neni 17, pg. 1 i ligjit.

[25] Edhe ndërmjetësi ka të drejtë të propozojë një zgjidhje të pranueshme, gjithnjë nëse palët nuk kanë vendosur ndryshe. Shih nenin 17, pg. 5 i ligjit.

[26] Neni 18 i ligjit: "*1. Përveçse kur vendoset ndryshe nga palët, ndërmjetësi mund të takojë ose të komunikojë me palët, së bashku ose veçmas me secilën prej tyre. 2. Ndërmjetësi, pasi njihet me rrethanat dhe të dhënat e ofruara nga njëra palë në mosmarrëveshje, mund t'i parashtrojë palës tjetër çështjet thelbësore që rezultojnë nga këto rrethana*. "

[27] Rekomandim nr . R (99) 19 i Komitetit të Ministrave, drejtuar shteteve anëtare në lidhje me ndërmjetësimin në çështjet penale, pika III/8.

e një marrëveshje vullnetare midis dy palëve, në lidhje me zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale. Si rregull, marrëveshja duhet të bëhet me shkrim, megjithatë ka edhe raste kur për shkak të natyrës së saj apo kur palët e vlerësojnë dhe ligji nuk e ndalon, mund të bëhet edhe me gojë. Në përmbajtje të saj, duhet që ndër të tjera[28] të përcaktohen qartë detyrimet dhe kushtet që palët i vendosin njëra-tjetrës, të cilat duhet të jenë të arsyeshme dhe proporcionale dhe të mos vijnë në kundërshtim me ligjin, edhe nëse do të ekzistonte vullneti i palëve.

Nënshkrimi i akt marrëveshjes, i jep kësaj të fundit, vlerë detyruese për palët. Si e tillë, ajo merr vlerën e një vendimi gjyqësor, e për rrjedhojë nuk duhet të lejohet ndjekja penale për të njëjtin person dhe për të njëjtat fakte[29]. Pra, ajo duhet të ketë të njëjtin status me vendimet gjyqësore, duke iu nënshtruar ndalimit të parimit *ne bis in idem*[30]. Në këtë këndvështrim, në rast se çështja është referuar për ndërmjetësim nga gjykata, pasi aktet e procedurës së ndërmjetësimit i dërgohen asaj, ajo vendos pushimin e çështjes penale në rast se gjykimi kishte filluar. Nëse çështja është referuar nga prokurori, ai vendos mosfillimin e procedimit penal.

Megjithatë mund të ndodhë që palët të mos arrijnë në një konsensus për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, apo të kundërshtojnë më pas zgjidhjen e arritur[31]. Në një situatë të tillë do të rifillojë procedimi penal. Do të jetë gjykata ajo që do të zgjidhë mosmarrëveshjen, pa u lidhur me procedurën e ndërmjetësimit, megjithëse, nëse diskutohet rasti i kundërshtimit të marrëveshjes së arritur midis palëve, mbetet në vlerësimin e saj, nëse do ta marrë parasysh apo jo atë.

7. Avantazhet e Ndërmjetësimit

Nga sa është trajtuar në këtë punim, mund të konkludojmë se rezultati pozitiv i procesit të ndërmjetësimit konsiston në:

1. Zgjidhjen e konfliktit.
2. Rehabilitimin dhe pajtimin e të dy palëve.
3. Pjesëmarrjen e të dëmtuarit.
4. Kosto e ulët, mjedis joformal dhe i çliruar nga tensioni.
5. Kompensim i dëmit apo zvogëlim të tij.
6. Ruajtjen e konfidencialitetit.

Zgjidhja e konfliktit. Ndërmjetësimi finalizohet me nënshkrimin e një marrëveshjeje konsensuale ndërmjet të dëmtuarit dhe autorit të veprës penale. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeve nënkupton se autori i veprës penale është ndërgjegjësuar për veprën penale të kryer dhe merr përsipër riparimin e efekteve të saj, qoftë edhe në mënyrë simbolike (p.sh. duke kërkuar falje). Në këtë mënyrë konflikti ndërmjet tyre konsiderohet i zgjidhur, duke u rivendosur një marrëdhënie normale.

Rehabilitimi dhe pajtimi i të dy palëve. Si i dëmtuari, ashtu edhe autori i veprës penale, duke përmbushur detyrimet e përcaktuara në marrëveshje,

---

[28] Neni 22 i ligjit.

[29] Rekomandim nr. R (99) 19 i Komitetit të Ministrave, drejtuar shteteve anëtare në lidhje me ndërmjetësimin në çështjet penale, pika IV/17.

[30] *Ibid*, pika IV/18. Shih gjithashtu edhe: Grup autorësh, "Drejtësia Restauruese dhe Ndërmjetësimi në Zgjidhjen e Konflikteve Penale. Manual për Gjyqtarë dhe Prokurorë." Tiranë, 2007, fq.16.

[31] Neni 21, 23/4 i ligjit.

superojnë situatën e tensionuar ndërmjet tyre, për t'u rivendosur dhe rintegruar në jetën sociale.

Pjesëmarrja e të dëmtuarit. Një nga elementët më thelbësore të procesit të ndërmjetësimit, është pjesëmarrja aktive e të dëmtuarit, në dallim nga sistemi i drejtësisë ndëshkuese, ku interesat e tij konsiderohet se mbrohen nëpërmjet prokurorisë, për shkak të rëndësisë publike të interesit. Ndërmjetësimi nxit pjesëmarrjen e të dëmtuarit nga vepra penale, i cili gjatë procesit dëgjohet dhe argumenton dëmet e shkaktuara, me qëllim mbrojtjen personalisht të interesave të tij.

Kosto e ulët, mjedis joformal dhe i çliruar nga tensioni. Në raport me zgjidhjen gjyqësore, ndërmjetësimi ka kosto më të ulët. Gjithashtu, zhvillimi i tij në një mjedis më pak formal se salla e gjyqit, nxit zhvillimin e komunikimit, pa trysninë ligjore, duke iu mundësuar palëve të qartësojnë situatën dhe të diskutojnë lirisht në lidhje me interesat individuale.

Kompensim i dëmit apo zvogëlim të tij. Sikurse është trajtuar, ndërmjetësimi përfundon me nënshkrimin e një marrëveshjeje ndërmjet dy palëve, në të cilën autori i veprës penale merr përsipër të kompensojë dëmin apo ta zvogëlojë atë. Mënyra e kompensimit dhe modalitetet e tjera përcaktohen sipas vullnetit reciprok të palëve. E rëndësishme është që i dëmtuari të ndiejë se drejtësia është rivendosur.

Ruajtja e konfidencialitetit. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj si dhe kur palët kanë rënë dakord ndryshe, tërësia e të dhënave dhe e rrethanave për procedurat e ndërmjetësimit mbeten konfidenciale. Si palët, ashtu edhe ndërmjetësi janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e të dhënave.

Konkuzione dhe Rekomandime

- Ndërmjetësimi në çështjet penale përfaqëson një metodë nëpërmjet së cilës aplikohet Drejtësia Restauruese. Ai konsiston në një veprimtari me karakter jashtëgjyqësor, me anë të së cilës i dëmtuari nga vepra penale dhe autori i saj, synojnë të zgjidhin mosmarrëveshjen midis tyre, nëpërmjet ndihmës së një personi të tretë, asnjëanës.
- Ndërmjetësimi është një veprimtari e pavarur nga struktura shtetërore të drejtësisë apo administratës publike dhe ka karakter vullnetar. Ai realizohet me ndihmën e një ndërmjetësi, i cili duhet të përfaqësojë një subjekt neutral, që nuk duhet të ketë as lidhje dhe as interes për çështjen në fjalë.
- Qëllimi parësor i aplikimit të ndërmjetësimit është të përfshijë dhe rehabilitojë jo vetëm autorin e veprës penale, por edhe të dëmtuarin prej saj. Përveç kësaj, ndërmjetësimi gjithashtu, synon të ndërgjegjësojë autorin e veprës penale në lidhje me dëmin e shkaktuar ndaj palës së dëmtuar nga kryerja e veprës penale, si dhe të ofrojë mundësinë që të dy palët të hartojnë një marrëveshje të përbashkët, konsensuale, për riparimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale në shkallën e mundshme.
- Aplkimi i ndërmjetësimit kufizohet në rradhë të parë, nga vullneti i palëve, duke qënë se ndërmjetësimi është një alternativë vullnetare dhe jo detyruese, e për rrjedhojë palët duhet të bien dakort për aplikimin e tij. Në rradhë të dytë, vet ligji parashikon se ndërmjetësimi mund të aplikohet vetëm në rastet e parashikuara në të dhe konkretisht në

rastin e mosmarrëveshjeve që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e të dëmtuarit akuzues ose me ankim të të dëmtuarit, sipas neneve 59 dhe 284 të K.Pr.P., si dhe në rast se ligji i veçantë e lejon atë.

- Ligji parashikon se ndërmjetësimi në mosmarrëveshjet penale karakterizohet nga respektimi i disa parimeve si: parimi i vullnetarizimit të palëve, i barazisë së tyre, i konfidencialitetit të të dhënave, i respektimit të fleksibilitetit dhe transparencës së procedurave.
- Procedura për aplikimin e ndërmjetësimit përcakton se çështja mund të referohet për ndërmjetësim ose nëpërmjet paraqitjes së ftesës për ndërmjetësim nga të paktën njëra palë, ose nëpërmjet referimit nga gjykata (ose organe të tjera si p.sh. prokuroria, policia), për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim, duke iu përcaktuar palëve një afat në përputhje me natyrën e mosmarrëveshjes.
- Zgjidhja e çështjes me ndërmjetësim përfaqëson një mundësi alternative për palët, të cilat nuk janë të detyruara me aplikimin e saj, ndërkohë që gjykata, (apo prokuroria), në rast se çështja mund të zgjidhet me ndërmjetësim, është e detyruar t'ua referojë palëve këtë mundësi, me qëllim që ato të vendosin nëse do e aplikojnë ose jo atë.
- Pasi është rënë dakort për aplikimin e ndërmjetësimit, duhet të përcaktohet ndërmjetësi, bazuar në konsensusin e palëve. Roli i ndërmjetësit, është thelbësor, duke qënë se është ai që do të drejtojë zhvillimin e procedurës së ndërmjetësimit dhe do të ndihmojë palët në arritjen e një marrëveshjeje konsensuale. Për këtë arsye, në ligj është treguar kujdes në lidhje me përcaktimin e kritereve për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësit, si dhe për të drejtat dhe detyrimet e tij.
- Pasi nënshkruhet marrëveshja për realizimin e ndërmjetësimit, palët diskutojnë për zgjidhjen e nevojshme dhe të pranueshme prej të dyjave. Por, ndërmjetësi, mund të takojë ose komunikojë me palët edhe veçmas, nëse ato nuk kanë vendosur ndryshe.
- Ndërmjetësimi përfundon në mënyrë të suksesshme nëse palët arrijnë në një marrëveshje konsensuale, në lidhje me zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale. Kjo marrëveshje duhet të përcaktojë qartë detyrimet dhe kushtet që palët i vendosin njëra-tjetrës, të cilat duhet të jenë të arsyeshme dhe proporcionale dhe të mos vijnë në kundërshtim me ligjin, edhe nëse do të ekzistonte vullneti i palëve.
- Nënshkrimi i akt marrëveshjes, i jep asaj vlerë detyruese për palët. Në këtë kuptim, ajo merr vlerën e një vendimi gjyqësor, e për rrjedhojë nuk duhet të lejohet ndjekja penale për të njëjtin person dhe për të njëjtat fakte (*ne bis in idem)*.
- Megjithatë mund të ndodhë që palët të mos arrijnë në një konsensus për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, apo të kundërshtojnë më pas zgjidhjen e arritur. Në një situatë të tillë do të rifillojë procedimi penal. Do të jetë gjykata ajo që do të zgjidhë mosmarrëveshjen, pa u lidhur me procedurën e ndërmjetësimit, megjithëse, nëse diskutohet rasti i kundërshtimit të marrëveshjes së arritur midis palëve, mbetet në vlerësimin e saj, nëse do ta marrë parasysh apo jo atë.
- Rezultati pozitiv i procesit të ndërmjetësimit konsiston në: zgjidhjen e konfliktit; rehabilitimin dhe pajtimin e të dy palëve; pjesëmarrjen e të dëmtuarit; kosto e ulët, mjedis joformal dhe i çliruar nga tensioni; kompensimin e dëmit apo zvogëlimin e tij; ruajtjen e konfidencialitetit.
- Pavarësisht se ndërmjetësimi është aplikuar në mënyrë të suksesshme, ka ende nevojë për përmirësim të infrastrukturës ligjore. Në këtë kuadër, është e nevojshme që të harmonizohet ligji "Për

ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" me Kodin e Procedurës Penale.

- Rëndësi e veçantë i duhet kushtuar përmirësimit të bashkëpunimit të strukturave shtetërore dhe atyre jo shtetërore për mbështetjen e drejtësisë restauruese si dhe ndërgjegjësimit të vazhdueshëm të shoqërisë.

Bibliografia

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë.

Ligj nr. 10385, datë 24.02.2011, "Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve".

Ligj nr. 23/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 'Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë' i ndryshuar".

Rekomandim nr . R (99) 19 i Komitetit të Ministrave, drejtuar shteteve anëtare në lidhje me ndërmjetësimin në çështjet penale.

Grup autorësh, "Komentar i Ligjit për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve", Tiranë 2012.

Grup autorësh, "Drejtësia Restauruese dhe Ndërmjetësimi në Zgjidhjen e Konflikteve Penale. Manual për Gjyqtarë dhe Prokurorë." Tiranë, 2007.

Buletin nr. 5, maj 2013 "Zbatimi i Drejtësisë Restauruese dhe Ndërmjetësimit Viktimë-Kundërvajtës në Shërbimin e Provës" - financuar nga Delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri.

Vendim nr. 27, datë 9 Maj 2012 i Gjykatës Kushtetuese.

http://en.wikipedia.org/wiki/Restorative_justice.

http://www.johnhoward.ab.ca/pub/C26.htm.

http://www.unodc.org/pdf/criminal_justice/06-56290_Ebook.pdf.

http://www.nij.gov/nij/topics/courts/restorative-justice/marketing-media/welcome.html.

http://www.altrodiritto.unifi.it/ricerche/mediaz/maglione/cap3.htm.

E Drejta e Autorit në BE

MSc: Belinda HALILAJ
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Vlorë/Shqipëri
belinda2012halilaj@gmail.com
MSc: Oljana HOXHAJ
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Vlorë/Shqipëri
oljana.hoxhaj@gmail.com

Abstrakt

Në ditët e sotme termi Pronesi Intelektuale është një prej termave që hasim më shpeshë. Titullarët e këtyre të drejtave mund t'i ndalojnë të tjerët që t'i përdorin krijimet e tyre pa autorizim paraprak, ose mund të lejojnë shfrytëzimin dhe përdorimin e tyre në shkëmbim të kompensimit material për përpjekjet dhe investimet e tyre gjatë gjithë krijimtarisë. Të drejtat e Pronësisë Intelektuale ende janë të mbrojtura kryesisht nga legjislacionet kombëtare dhe jo nga ligjet e BE-së [1]. Mbrojtja e tyre në çdo vend të BE-së është e vështirë dhe e kushtueshme, kështu që është i nevojshëm një harmonizim i mëtejshëm. Një nga degët e pronësisë intelektuale është dhe e drejta e autorit. Në ditët e sotme kjo e drejtë shpeshë herë cënohet në forma të ndryshme. Për mbrojtjen e kësaj të drejte deri tani janë nxjerrë shtatë Direktiva, të cilat shpeshë herë janë ndryshuar duke ju përshtatur ndryshimeve soial-ekonomike.

Fjalët kyçe: E Drejta e autorit, liçensim, Direktivë etj…

Abstract

Nowadays intellectual property term is one of most terms that we encounter often. Holders of these rights may forbid others to use their works without prior authorization, or may allow the exploitation and use them in exchange for financial compensation for their efforts and investments of all creativity. Intellectual Property rights are still largely protected by national legislation and not by the laws of the EU. Their protection in each EU country is difficult and costly, so it needed a further harmonization. One of the branches of intellectual property is copyright. Nowadays it right often affected in different ways. To

[1] http://eubusinessrelay.al/sq/faqe/pron%C3%ABsia-intelektuale

protect this right so far issued seven directives, which are often changed by adapting soial-economic changes.

Keywords: copyright, licensing, Directive ect

1. Hyrje

E drejta e autorit si një koncept ligjor ka lindur ne Britani ne fillim te shekullit te XVIII. Ne vitin 1710, Statusi britanik i Annes[2] percaktonte disa pika mbi të drejtat që gëzonte një artist. Konventa e Bernës e vitit 1886 garantonte njohjen e të drejtave të autorit midis kombeve sovrane, e jo thjesht në mënyrë bilaterale. Sipas Konventës së Bernës, të drejtat e autorit për veprat krijuese nuk duhet që të pohohet apo deklarohet, pasi ato janë automatikisht në fuqi me krijimin e tyre, një autor nuk ka nevojë të "regjistrohet" ose "të aplikoj për të drejtën e autorit në vendet e respektimi të Konventës së Bernës[3]. Rregullat e Konventës së Bernës janë të përfshira në marrëveshjen e Organizatës Botërore të Tregtisë TRIPS ne 1995, duke i dhënë Konventës së Bernës zbatimin në mënyrë globale[4]. Natyrshëm shtrohet pyetja, kujt i takon e drejta e autorësisë mbi punën e kryer, kur kemi nje "punë me qira" ? Mbajtësi origjinal i autorit mund të jetë punëdhënësi e autorit dhe jo vetë autori, në qoftë se puna është një "punë me qira". Për shembull, në ligjin angleze e drejta e autorit, Disanjit dhe Patentes, ne Aktin e vitit 1988 parashikon se nëse një punë "mbi te drejten e autorit" është bërë nga një i punësuar gjatë këtij punësimit, e drejta e autorit është pronë automatikisht nga punëdhënësi që do të ishte një "puna për qira."

Para vitit 1989, u përdor dhe simboli për të drejtën e autorit, (©, shkronja C brenda një rrethi), shkurtesa e fjalës "COPR.", ose fjala "Copyright", e ndjekur nga viti i botimit të parë të punës dhe emri i mbajtësit të së drejtës së autorit. Nje dallim mbi te drejtën e autorit, është midis sistemit civil law dhe common law. Sistemi common law përqëndrohet në të drejtat ekonomike, si dhe stimujt për të prodhuar vepra të reja. Ne sistemin civil law *droit d'auteur*[5], të drejtës së autorit I është dhënë prioritet për të drejtat që gëzon autori si dhe të drejtat që vijnë nga puna e tij.

E drejta e autorit është një e drejtë që i jep të drejtën autorit për një " vepër origjinale, "të tilla si libra, artikuj, filma, dhe programeve kompjuterike. Si

---

[2] Arthur. R. Muller, Michael H. Davis, „Intelectual Property", 1991,West Publishing Company,P.O.BOX 64526, faqe 280.

[3] "Berne Convention for the Protection of Literary and Artistic Works, Article 5". World Intellectual Property Organization. http://www.wipo.int/treaties/en/text.jsp?file_id=283698ëP109_16834

[4] MacQueen, Hector L; Charlotte Waelde and Graeme T Laurie (2007). *Contemporary Intellectual Property: Law and Policy*. Oxford University Press. p. 39. ISBN 978-0-19-926339-4.

[5] Seville C., *EU Intellectual Property Law and Policy*, MPG Books Ltd, Bodmin, Cornwall, 2009, pg.7, ISBN 978 1 84720 123 2

rrjedhoj kjo e drejtë i jep të drejtën ekskluzive autorit për të riprodhuar, të përgatisë vepra të rrjedhura nga një e mepareshme etj.. E drejta e autorit mbron vetëm formën ose shprehje e ideve, por jo idetë themelore. E drejta e autorit është një nga format e pronësisë intelektuale.

Materiali dhe metodat

E Drejta e autorit në BE sot përbën një temë të rëndësishme. Për realizimin e këtij punimi kam përdorur literature të autorëve të huaj si dhe të autorëve shqiptarë. Një vend të rëndësishëm ka edhe përdorimi i direktivave të nxjerra nga BE-ja. Për zhvillimin e këtij punimi kam patur parasysh disa metoda kërkimi, si përshkruese, krahasuese dhe shpjeguese.

2. Fusha e verptimit të drejtës së autorit.

2.1 Objekti i të drejtës së autorit.

Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike në neni 2 përcakton se: "Shprehja e "veprave letrare dhe artistike" do të përfshijë çdo prodhimin letrar, shkencore dhe fushë artistike, çdo gjë që mund të jetë mënyra apo forma e shprehjes së saj . Konventa përcakton një listë me shembuj me punime të tilla si[6] :

- libra, pamflete dhe shkrimet e tjera;
- leksione, adresa, predikime;
- vepra dramatike ose dramatiko-muzikore;
- veprat koreografike dhe show argetimi;
- kompozimet muzikore me ose pa fjalë;
- krijimet kinematografike dhe krijimet e tjera vizuale;
- veprat e vizatimit, pikturë, arkitekturë, skulpturë, gdhendje dhe litografi;
- veprat fotografike;
- veprat e artit të aplikuar,vizatimet, planet, skicat, krijimet tridimensionale, hartat dhevizatimet në fushën e topografisë, gjeografisë, krijimet arkitekturore dhe shkencës në përgjithësi;
- "Përkthimet, përshtatjet, rregullimet muzikore dhe ndryshimet e tjera të një pune letrare ose artistike, të cilat janë të mbrojtura si vepra origjinale pa paragjykim për të drejtën e autorit në veprën origjinale" ;
- "Koleksionet e veprave letrare dhe artistike të tilla si enciklopedi dhe antologji të cilat për shkak të zgjedhjes dhe rregullimit të

[6]http://www.wipo.int/export/sites/www/freepublications/en/intproperty/909/wipo_pub_909.pdf

përmbajtjes së tyre përbëjnë krijime intelektuale, mbrohen si të tilla, pa paragjykuar të drejtën e autorit në secilën prej veprave që janë pjesë e koleksioneve të tilla".

2.2 Permbajtja e të drejtës së autorit.

Rregulli i përgjithshëm është se pronari mund ta përdori pronën e tij si dëshiron dhe se askush tjetër në mënyrë të ligjshme nuk mund ta përdorin atë pa autorizimin e tij. Të drejtat e autorit klasifikohen në dy kategori:

1. Të drejtat ekonomike të cilat i japin mundsin pronarit të nxjerri shpërblim financiar nga përdorimi i veprave të tij nga të tjerët.
2. Të drejtat morale që lejojnë autorin të marrë veprime të caktuara për të ruajtur lidhjen personale ndërmjet vetes dhe punës së tij.

2.3 Pronësia, ushtrimi dhe kalimi i të drejtave pasurore të autorit.

Pronari i të drejtave të autorit në një punë është në përgjithësi personi që e krijoi punën, dmth autori i punës, por kjo nuk është gjithmonë në çdo rast. Disa ligje të caktuara kombëtare përcaktojnë se kur një vepër është krijuar nga një autor i cili është i punësuar për qëllim krijimin e asaj pune, atëherë punëdhënësi e jo autori është pronar i punës së kryer. Në rastin e të drejtave morale e drejta gjithmonë i takon autorit të punës, kushdo që mund të jetë pronar i të drejtave ekonomike. Ligjet e shumë vendeve të BE-së sigurojnë që pronari i të drejtave ekonomike të një punë mund transferojë të gjitha të drejtat ekonomike te një pale e tretë, në rastin e të drejtave morale, duke qenë se kanë karakter personal, nuk mund të transferohen. Autori ka të drejtë të shesë punën e tij një individi ose kompanie, kundrejt pagesës.Transferimi i të drejtave të autorit mund të kryhet ne dy forma: detyre dhe license. Sipas një **detyre**, pronari që transferon të drejtën mund të lejojë apo ndalojë akte të caktuara që mbulohen nga një, disa ose të gjitha të drejtat e përcaktuara nga e drejta e autorit. **Liçensim** do të thotë se autori ruan pronësinë, por ai autorizon një palë të tretë për të kryer veprime të caktuara që mbulohen nga të drejtat ekonomike në përgjithësi për një periudhë të caktuar kohe dhe për një qëllim specifik.

3. Direktivat ekzistuese për të drejtën e autorit

Këto direktiva ndjekin një përshkrim të shkurtër të secilës prej shtatë Direktivave të cilat janë miratuar deri tani. Megjithëse disa nga direktivat janë ribotuar në një formë të konsoliduar, duke marrë parasysh ndryshimet e mëvonshëm. Ligji për të drejtën e autorit në Bashkimin Evropian ka lindur si një përpjekje për të harmonizuar ligjet e ndryshme mbi të drejtën e autorit të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian. Ai përbëhet nga direktivat e BE-së, rregullore të ndryshme apo drejtime që Shtetet Anëtare janë të nevojshme për të transpozuar në ligjet e tyre kombëtare, dhe vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme të Bashkimit Evropian.

3.1 *Direktiva 2009/24 / EC mbi mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike (fillimisht botuar si 91/250 / EEC).*

Direktiva e parë e BE-së për mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike ishte Direktiva e Këshillit 91/250 / EEC e datës 14 maj 1991. Dallime të caktuara në mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike të ofruara nga ligjet e shteteve anëtare kanë efektet direkte dhe negative në funksionimin e Tregu i brendshëm sa i përket programeve kompjuterike. Personi që ka një të drejtën për të përdorur një program kompjuterik nuk duhet të parandalohet nga aktet që testojë funksionimin e programi, me kusht që këto akte nuk cënojnë drejtën e autorit në program. Riprodhimi i paautorizuar, përkthimi, përshtatja ose transformimi i formës së kodit në të cilat një kopje e një programi kompjuterik është bërë në dispozicion përbën shkelje të të drejtave ekskluzive të autori. Një program kompjuterik mbrohet nëse ajo është origjinale në thelb dhe se ajo është vetë krijimi orgjinal intelektual i autorit. Mbrojtja duhet të jepet për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të huaj sipas legjislacionit kombëtar për të drejtën e autorit, njësoj si aplikohet për veprat letrare. Programet kompjuterike mbrohen si veprat letrare brenda kuptimit të nenit 2 të Konventës së Bernës[7].

3.2 *Direktiva 2006/115 / EC mbi të drejtën e qirasë dhe të drejtën e kreditimit dhe për të drejtat e caktuara lidhur me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale (botuar fillimisht si Direktiva 92/100 / EEC): Qiraja dhe Direktiva mbi të Drejtën e Kreditimit.*

Në preambulën vëren rëndësinë e këtyre të drejtave: për të parandaluar piraterinë, por edhe për të siguruar të ardhura të mjaftueshme për ata që janë përfshirë në punë kreative dhe artistike, për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe kulturor të komunitetit. Data e zbatimit të direktivës ishte 1 korrik 1994.
Në nenin 2 përcaktohet se kjo dirktivë gjenë zbatim për fushat si më poshtë:

1. "me qira" nënkupton vënien në dispozicion për përdorim, për një periudhë të kufizuar e kohës për shkak të natyrës ekonomike apo avantazheve tregtare;
2. 'kreditimit "nënkupton vënien në dispozicion për përdorim, për një periudhë të kufizuar të kohës dhe jo për shkak të natyrës ekonomike apo avantazheve komerciale, kur ajo është bërë me anë të institucioneve të të cilat janë të hapura për publikun;
3. 'film' do të thotë një vepër kinematografike apo audiovizuale ose imazhe lëvizse, nëse janë apo jo të shoqëruar nga tinguj.

---

[7] Report from the Commission to the Council, the European Parliament and the Economic and Social Committee: on the implementation and effects of Directive 91/250/EEC on the legal protection of computer programs.
http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52000DC0199&from=EN

Në nenin 3 të kësaj direktive, e drejta ekskluzive për të autorizuar ose për të ndaluar dhënien me qira dhe përdorimin do ti takojnë si më poshtë:

1. autorit në lidhje me origjinalin dhe kopjet e punës së tij;
2. interpretues në lidhje paraqitjen e performancës së tij;
3. prodhuesit të fonogrameve në lidhje fonogramet e të tij;
4. prodhuesi i fiksimit të parë të një film në lidhje me origjinalitetin dhe kopjet e filmit të tij.

3.3 *Direktiva 93/83 / EEC mbi koordinimin e rregullave të caktuara në lidhje me të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të drejtën e autorit të aplikueshme për transmetimin satelitor dhe ritransmetimin kabllor.*

Në vitin 1984 Komisioni publikoi një Raport Paraprak mbi krijimin e një tregu të përbashkët në fushën e transmetimit[8]. Ajo mbulonte një numër të çështjeve, të tilla si rregullimi i reklamave, trajtonte aspektin e autorsisë të transmetimit ndërkufitar, me qëllim të promovimit të një tregu të përbashkët. Kapitulli II i Direktivës merret me transmetimin satelitor. Ajo tenton të parandaloj fragmentimzimin e tregut evropian, duke krijuar një të drejtë unitare të komunikimit satelitore të cilat mund të ushtrohen vetëm në vendin e origjinës[9]. Kapitulli III i Direktivës merret me ritransmetimet kabllore. Ajo përcakton një sistem menaxhimit të detyrueshëm kolektiv të të drejtave të ritransmetim kabllor. Shtetet anëtare kanë detyrim kur programet nga shtetet anëtare janë ritransmetuar me kabëll në territorin e tyre të zbatojn të drejtën e autorit[10].

3.4 *Direktiva 2006/116 / EC në afatin e mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe sigurimi i të drejtave të lidhura (të publikuara fillimisht në Direktivën 93/98 / EEC): Direktiva e afatit dhe Direktiva 2011/77 / BE që ndryshon Direktivën 2006/116 / EC në afatin e Mbrojtjes të të drejtës së autorit dhe të drejtave të caktuara të lidhura me të.*

Në nenin 1 të *Direktivës 2006/116 / EC,* të drejtat e një autori të një vepre letrare ose artistike brenda kuptimi i nenit 2 të Konventës së Bernës do të mbrohen gjatë gjithë jetës së autorit dhe 70 vjet pas vdekjes së tij, pavarësisht nga data kur vepra është bërë e ligjshme në dispozicion të publikut. Të drejtat e interpretuesve skadojn 50 vjet pas datës së performancës. Megjithatë, në qoftë se një fiksim i performancës është botuar në mënyrë të ligjshme ose komunikohen publikut brenda kësaj periudhe, të drejtat do të përfundojnë 50 vjet nga data e botimit të

---

[8] Television Without Frontiers. Green Paper on the Establishment of the Common Market for Broadcasting, Especially by Satellite and Cable. COM (84) 300, 14 June 1984

[9] Direktiva per stelitet, Neni 1(2).

[10] Direktiva per stelitet, Neni 8(1).

parë ose komunikimit të parë për publikun[11]. Afati për të mbrojtur vepra të papublikuara më parë do të jetë 25 vjet nga koha kur puna u botua së pari në mënyrë të ligjshme apo në mënyrë të ligjshme i është komunikuar publikut. Shtetet Anëtare mund të mbrojë botime kritike dhe shkencore, afati i mbrojtjes së të drejtave të tilla do të jetë 30 vjet nga koha kur botim u botua për herë të parë në mënyrë të ligjshme. Direktiva e afatit fillloj të zbatohet nga çështja *EMI kundër Patricia*[12], një rast i cili theksoi vështirësitë me të cilat haste një regjim i paharmonizuar. EMI kishte të drejta të shiste regjistrimet zanore nga Cliff Richard në Gjermani. Ajo kundërshtoi shitjen në Gjermani të regjistrimeve zanore të tregtuara në mënyrë të ligjshme në Danimarkë, me pretendimin se kishte mbaruar afati për të drejtat e regjistrimit.
Direktiva 2011/77 / BE zgjat afatet e mbrojtjes të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të si dhe kushtet e për të drejtën e regjistrimit të autorit nga 50 vjet në 70 vjet.

3.5 *Direktiva 96/6 /EC për mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave: Direktiva Baza e të dhënave.*

Direktiva Baza e të dhënave ka hyr në fuqi që nga 1 janari i vitit 1998. Kjo Direktivë ka të bëjë me mbrojtjen ligjore bazë të të dhënave në çdo formë. Për qëllimet e kësaj Direktive, "database" do të thotë grumbullimi i punës së pavarur, të dhënave apo materialeve të tjera e rregulluar në mënyrë sistematike ose metodike dhe individualisht të arritshme me mjete elektronike apo të tjera. Mbrojtja nga kjo Direktivë nuk zbatohet për Programet kompjuterike të përdorura në bërjen ose funksionimin bazë të të dhënave të arritshme me mjete elektronike[13]. Mbrojtjen e autorit është zgjeruar për "bazën e të dhënave të cilat, për shkak të përzgjedhjes ose rregullimit të përmbajtjes së tyre, përbëjnë vepër intelektuale të autorit, krijimet do të mbrohen si të tilla nga "e drejta e autorit"[14]. Autori i një baze të dhënash ka të drejtën ekskluzive për të riprodhuar atë (tërësisht ose pjesërisht); për ta shpërndarë ; për ta përkthyer, përshtatur, rregulluar ose ta ndryshojë atë; dhe për ta komunikuar atë në publik[15]. Direktiva miraton një strategji të dyfishtë: së pari, ajo përpiqet të harmonizojë kushtet e mbrojtjes së të drejtës së autorit për bazat e të dhënave. Së dyti, për ato baza të dhënash të cilat dështojnë për të arritur në pragun e origjinalitetit të nevojshme për të drejtën e autorit, ajo krijon një të drejtë *sui generis* që zgjat për 15 vjet nga përfundimi apo publikimi.

---

[11] Neni 3, *Direktiva 2006/116 / EC.*
[12] *EMI Electrola GmbH v Patricia Imund Export,* Case C-341/87 [1989]ECR 79
[13] Neni 1(3), *Direktiva 96/6 / KE.*
[14] Neni 3(1), *Direktiva 96/6 / KE.*
[15] Neni 5, *Direktiva 96/6 / KE.*

3.6 *Direktiva 2001/29 / EC mbi harmonizimin e disa aspekteve të të drejtave të autorit dhe të drejta në shoqërinë e informacionit.*

Direktiva mbi harmonizimin e disa aspekteve të të drejtave të autorit dhe të drejta në shoqërinë e informacionit reflektohet shpejtë dhe në zhvillimet e thella teknologjike të viteve të fundit. Shtetet Anëtare do të sigurojnë të drejtën ekskluzive për të autorizuar ose të ndalojnë riprodhimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të përkohshëm ose të përhershëm me çdo mjet dhe në çdo formë, në tërësi ose në pjesë[16]:

a) për autorët, për veprat e tyre;
b) për interpretuesit, ose fiksimin e shfaqjeve të tyre;
c) për prodhuesit e fonogrameve, dhe fonogramet e veta;
d) për prodhuesit e regjistruesit e parë të filmave, në lidhje me origjinalitetin e filmave të tyre;
e) për transmetimin e organizatave, regjistrimin e transmetimeve të tyre, nëse këto transmetime transmetohen me përcjellsa ose me anë të ajrit, duke përfshirë me kabëll apo satelit.

Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë për autorët, në lidhje me origjinalitetin i e veprave të tyre apo të kopjeve të tyre, të drejtën ekskluzive të lejojë ose ndalojë çdo formë të shpërndarjes për publikun nga shitja ose në mënyra të ndryshme[17]. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë përjashtime ose kufizime për të drejtën e riprodhimit e parashikuar në nenin 2 në këto raste[18]:

a) në lidhje me riprodhimet në letër ose ndonjë mënyrë të ngjashme, të realizuara nga përdorimi i çdo lloj fotografike teknikë ose me ndonjë proces tjetër që ka efekte të ngjashme, me përjashtim të fletëve muzikore, me kusht që shfrytëzueit të të drejtave të marrin kompensim të drejtë;
b) në lidhje me riprodhimet me çdo mjet të bërë nga një personi fizik për përdorim privat dhe për qëllime që nuk janë direkt ose indirekt me karakter tregtar, me kusht që shfrytëzuesit e të drejtave të marrin kompensim të drejtë, e cila merr parasysh e aplikimit ose jo zbatimin e teknologjis.
c) në lidhje me akte të veçanta të riprodhimit të bëra nga bibliotekat publike, institucionet arsimore apo muzetë, ose nga arkivat, të cilat nuk kanë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë avantazh ekonomik apo tregtare;
d) në lidhje me regjistrimet kalimtar të veprave të bëra nga organizatat e transmetimit.

---

[16] Neni 2, *Direktiva 2001/29 / EC.*
[17] Neni 4, *Direktiva 2001/29 / EC.*
[18] Neni 5, *Direktiva 2001/29 / EC.*

e) në lidhje me riprodhimet e transmetimeve bërë nga Institucionet sociale që ndjekin qëllime jo-komerciale, të tilla si spitalet apo burgjet, me kusht që nga shfrytëzimi i të drejtave të marrin kompensim të drejtë.

3.7 *Direktiva 2001/84 / EC mbi të drejtën e rishitjes së përfitimeve të autorit nga një punë origjinale arti.*

E drejta e rishitjes ishte njohur në me shumë se gjsmën e vendeve te BE-se, vëndet e tjera antare e kundërshtonin një të drejtë të tillë. Kjo Direktivë pati kundërshtime nga Britania e Madhe dhe nga Hollanada. Shumë pikëpyetje ngriheshim me miratimin e një Direktive të tillë, me pasojat që do të kishte si dhe si do të ishte ndikimi i saj në tegun e artit kombëtar. Gjithashtu, duhet të theksohet se [19]: Direktiva nuk ka harmonizuar çdo aspekt për të drejtën e rishitjes. Harmonizimi është i kufizuar për të. . .fusha e të drejtës së rishitjes, kategoritë e veprat e artit që i nënshtrohet të drejtës, personat që kanë të drejtë të marrin honorare, normat e aplikuar, transaksionet që i nënshtrohen pagesës së familjes mbretërore. Megjithatë, Shtetet Anëtare mbeten të lira për të siguruar rregulla të brendshme në lidhje me ushtrimin e të drejtës së rishitjes, veçanërisht në lidhje me mënyrën se si ajo është menaxhuar, mbledhur dhe si janë shpërndar honoraret[20].
Në nenin 2 përcaktohen veprat e artit për të cilat lind e drejta e rishitjes:

- Për qëllimet e kësaj Direktive, 'punë origjinale arti' do të thotë vepra arti grafik ose plastik të tilla si fotot, collages,piktura, vizatime, gravurat, printimet, litografi, skulptura, tapestries, qeramika, qelqe dhe fotografi, me kusht që të jenë bërë nga artisti vetë ose janë kopje që konsiderohen se janë vepra origjinale arti.
- Kopjet e veprave të artit të mbuluar nga kjo Direktivë, të cilat janë bërë në numër të kufizuar nga vetë artisti ose nën autoritetin e tij, do të konsiderohet të jenë vepra origjinale të arti për qëllimet e kësaj Direktive.

Konkluzione

Deri më sot në Bashkimin Europian janë nxjerrë disa direktiva mbi të drejtën e autorit, ajo që vazhdon të vihet re është mungesa e harrmonizimit të legjislacionit europian në këtë fushë për shkak të kostos së lartë që ka një proçes i tillë. Të drejtat e autorit janë të drejta që u njihen personave të caktuar për krijimtaritë e tyre në fushën e letërsisë, shkencës dhe artit ku përfshijnë në mes tjerash: romanet, poezitë, kompozimet muzikore, skulpturat, pikturat, vizatimet, krijimet kinematografike, arkitekturën, koreografinë, fotografinë dhe krijimet tjera të

---

[19] Dreier TH., Kur A., *European Intellectual Property Law,* Edward Elgar Cheltenham, UK• Northampton, MA, USA, 2013, pg. 274 .
[20] Po aty, fq. 274.

ngjashme. Kjo degë e Pronësisë Intelektuale përfshinë edhe të ashtuquajturat të drejta të tjera të përafërta me të drejtën e autorit; e drejta e artistëve interpretues (këngëtarët, muzikantët tjerë, valltarët, aktorët dhe të tjerët të cilët interpretojnë vepra); producentët e fonogrameve, producentët e filmave dhe organizatat transmetuese.

Bibliografia

Arthur. R. Muller, Michael H. Davis, „Intelectual Property“, 1991,West Publishing Company,P.O.BOX 64526.

MacQueen, Hector L; Charlotte Waelde and Graeme T Laurie (2007). *Contemporary Intellectual Property: Law and Policy*. Oxford University Press. ISBN 978-0-19-926339-4.

"Berne Convention for the Protection of Literary and Artistic Works, Article 5". World Intellectual Property Organization.

Seville C., *EU Intellectual Property Law and Policy*, MPG Books Ltd, Bodmin, Cornwall, 2009, ISBN 978 1 84720 123 2

Television Without Frontiers. Green Paper on the Establishment of the Common Market for Broadcasting, Especially by Satellite and Cable. COM (84) 300, 14 June 1984

Dreier TH., Kur A., *European Intellectual Property Law,* Edward Elgar Cheltenham, UK• Northampton, MA, USA, 2013

http://eubusinessrelay.al/sq/faqe/pron%C3%ABsia-intelektuale

http://www.wipo.int/export/sites/www/freepublications/en/intproperty/909/wipo_pub_909.pdf

http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52000DC0199&from=EN

http://www.aepo-artis.org/pages/59_1.html

RAPORTET FINANCIARË SI PËRCAKTUES TË MIRË TË KTHIMIT

MSc.Blerina Dervishaj
Departamenti i Financës, Universiteti i Vlorës"Ismail Qemali"
Sheshi "Pavarësia", Vlorë,Shqipëri
Email:blerina.dervishaj@univlora.edu.al

Abstrakt:

Kthimi nga një investim është arsyeja e çdo iniciative investuese. Investitorët janë të interesuar të njohin kthimin e pritur për investimet që bëjnë. Llogaritja e tij bazohet në të dhënat historike dhe na shërben për të përcaktuar nëse investimi i kryer gjeneron një rezultat mesatar neto pozitiv apo negativ. Njohja me faktorët të cilët janë të rëndësishëm në shpjegimin e ndryshimit të kthimit na ndihmon të bëjmë përllogaritje më të sakta për kthimin që presim, ndihmon investitorët të jenë më të sigurt në vendimet investuese që ndërmarrin, por edhe kreditorët për të vlerësuar aftësitë shlyese të debitorëve të tyre. Metodologjia: Ky studim me natyrë empirike ndjek disa objektiva praktike. Punimi kërkon grumbullimin dhe analizimin e të dhënave të firmave që marrin pjesë në studim. Ndërtimi i modeleve ekonometrikë me qëllim gjetjen e faktorëve përcaktues të fitimit përbën bazën e këtij studimi. Popullimi dhe kampioni i studimit: Informacioni i grumbulluar nga shoqëritë e marra në studim i përket një periudhe kohore pesëvjeçare dhe konkretisht viteve 2008-2012. Popullimi përbëhet nga 17 biznese të mëdha të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorin industrial në qytetin e Vlorës.

Fjalë kyç: fitim mesatar, faktorë përcaktues, raporte financiare, variabla të pavarur, variabël i varur.

Abstract:

Return from investment is the reason for every investing iniciative. Investors are interested in knowing the expected return for their investments. We base on historical data when calculate it and we use it to determine whether the investment made, has a positive or negative average net outcome. Having a sufficient knowledge of the determininig factors of return, helps us make more exact calculations of the return we expect, helps investors being less risky in their investing decisions and also creditors in assessing their debitors' paying-off capacity. Methodology: This study, with an empirical nature research, follows some practical objectives. The study requires the data collection and data analysis of the firms taking part in research. Population and sample of the study: The data collected from companies in research belongs to a 5-year time

period, precisely during the years 2008 - 2012. The population of the study includes firms classified as large enetreprises which submit their activity in the Industrial Sector in Vlora town.

Key Words: Average return, determining variables, financial ratios, independent variable, dependent variable.

1. Hyrje

Një ndër kriteret kryesorë për kryerjen e një investimi është fitimi që pritet të merret prej tij. Investitorëve u duhet të identifikojnë faktorët kryesorë që përcaktojnë kthimin e një investimi. Njohja me këta faktorë dhe krijimi i një modeli të përshtatshëm mund ta përmirësojë një vendim investimi. Ky model mund t'u shërbejë edhe kreditorëve për të vlerësuar aftësinë shlyese të debitorëve të tyre. Investitorët kanë nevojë për një model që të mund të vlerësojnë performancën e shoqërisë së tyre si dhe të përcaktojnë fitimin. Nga ana tjetër identifikimi i faktorëve përcaktues të fitimit nëpërmjet krijimit të një modeli të përshtatshëm, ndihmon në një shpërndarje më të mirë të burimeve të shoqërisë.

Studimi ka si qëllim që të përcaktojë faktorët me ndikim të rëndësishëm në shpjegimin e fitimit.

Raportet financiare tregojnë lidhjen midis aspekteve të ndryshëm të pozicionit ekonomik të një shoqërie si dhe bëjnë të mundur krahasimin e informacionit financiar midis firmave të ndryshme. A mund të shërbejnë ata si faktorë determinantë të kthimit?

Punimi është organizuar si më poshtë:

Së pari, do të paraqiten faktorët përcaktues të kthimit të rezultuar të rëndësishëm prej studimeve të mëparshme.

Më pas do të shpjegohet sfondi i kërkimit, hipotezat dhe metodologjia e kërkimit. Në vijim, do të paraqiten rezultatet e përftuara nga ngritja` e hipotezave.

Në fund do të nxirren përfundimet e punimit.

Bashkangjitur janë shtojcat të cilat pasqyrojnë rezultatet e interpretimeve të kryera..

2. Rishikimi i literaturës

Në vijim po paraqesim disa nga variablat lidhja e të cilëve me kthimin gjendet në literaturë. Fama dhe French (1992) përmblodhën gjetjet nga studimet e mëparshme empirike dhe konkluduan se variablat "Madhësia e firmës" dhe raporti "Vlerë libri/Çmim tregu", mund të shpjegojnë më mirë ndryshimet në fitimin mesatar. Studimi i Clubb and Naffi (2007) përfshiu periudhën 1980 - 2000. Variablat më të rëndësishëm në studim ishin "Kthimi mbi Kapitalin e vet" (ROE), dhe raporti "Vlerë libri/Çmim tregu". Ata gjetën se këto variabla shpjegojnë një pjesë të madhe të kthimit të aksioneve në firmat angleze. Lam (2009) verifikoi ndikimin e variablave si "Beta", "Madhësia e firmës", raporti "Vlerë libri/Çmim tregu" si dhe raporti "Të ardhura/Çmim", në kthimin e aksioneve në bursën e Hong Kongut. Ai arriti në përfundimin se 3 variablat e

fundit kanë një lidhje të rëndësishme me variablin e varur "fitim". Mehrani dhe Mehrani (2003) studioi lidhjen "raport përfitueshmërie"-"kthim aksioni" në bursën e Teheranit. Rezultatet e studimit të tyre treguan se "fitimi marzhinal neto", "kthimi mbi kapitalin e vet", "fitimi para tatimit", janë kriteret më të mirë në parashikimin e fitimit. Në studimin e tij, Bagherzadeh (2003, 2005) verifikoi faktorët që ndikojnë kthimin e aksioneve në Bursën e Teheranit gjatë viteve 1997-2004. Ndër variablat e shumtë që studioi, variablat "Madhësia e firmës", "Vlerë libri/Çmim tregu" dhe "Të ardhura/Çmim", dolën të rëndësishëm në përcaktimin e fitimit.

3. Analiza e rezultateve

Në këtë seksion do të testohen Hipoteza duke përdorur regresionin e shumëfishtë për të përcaktuar sesi variablat e pavarur lidhen me variablin e varur "fitimi".
Kam marrë në studim 17 Biznese të Mëdha në Qytetin e Vlorës të cilat e zhvillojnë aktivitetin e tyre në sektorin industrial dhe specifikisht në atë të ndërtimit. Kohëzgjatja e kërkimit ishte periudha Janar-Mars 2014. Për të 17 firmat nga të mësipërmet kam patur akses në pasqyrat financiare për një periudhë kohore 5 vjeçare. Me këtë database të dhënash, kam bërë një përllogaritje dhe analizë të raporteve financiarë të firmave në veçanti dhe të mesatares së këtyre treguesve për te gjitha firmat së bashku për periudhën kohore 2008-2012. Raportet u përdorën për të ndërtuar modele statistikorë dhe për të ngritur Hipoteza, me qëllim arritjen në përfundimin se këto raporte janë të rëndësishëm në përcaktimin e fitimit të shoqërisë. Pasi të dhënat i hodha në Softin Statistikor SPSS, disa nga raportet u evidentuan të rëndësishëm në lidhje me fitimin, duke qenë kështu modele të mirë statistikorë. Pra kam ndërtuar 3 modele duke ngritur hipotezat përkatëse dhe duke i testuar ato për intervalin e besimit α=95%. Programi përpunon automatikisht të dhënat dhe më jep informacion për vlerën e koeficentëve, të devijimeve standarde, për statistikat e modelit, për korrelacionin, normalitetin, për praninë ose jo të autokorrelacionit, të heterovariancës, multikolinearitetit etj. në mënyrë që të gjykojmë nëse hipotezat e ngritura janë të vlefshme apo jo dhe si rrjedhim nëse modeli është i mirë ose jo. Nga testet e bëra, modelet që kam paraqitur më poshtë rezultuan të rëndësishëm:

Modeli I

H1: Fitimi mesatar i lidhur me përfitueshmërinë dhe aftësinë paguese të shoqërisë.

Variabli i parë i pavarur i përfshirë në model është ROA, një tregues përfitueshmërie**,** tregues i rëndësishëm i fuqisë financiare afatgjatë të shoqërisë. ROA reflekton kthimin e shoqërisë mbi të gjitha aktivet / financimet e besuara asaj. Ky matës nuk bën dallime sipas burimeve të ndryshme të financimit, nëse është financim i jashtëm apo i brendshëm; borxh apo kapital.
ROA= EBIT / Aktive Totale

Raporti *Detyrime totale / Kapital* është variabli i dytë i pavarur. Ky raport mund të shprehet ndryshe edhe si financimi me kredi, pra sa financohet me kredi çdo lek i financuar me kapitalin e vet.

Fitimi = 16457813 + 49810183*x_1 - 483094*x_2 **R^2=0.997**
Stat.t 10.541 16.829 -2.531
Ku:
x_1 = ROA (kthimi mbi aktivet)
x_2 = Detyrime totale / Kapital i vet
Studimi i modelit:

Rëndësinë e lidhjes së këtyre variablave e tregon statistika *t* e studentit e cila është më e madhe sesa dy për të dy variablat, pra lidhjet individuale janë të rëndësishme, | t_1 |=16.829 dhe | t_2 |=2.531.

i. Shenja pozitive e statistikës *t* për variablin e parë *Kthimi mbi aktivet,* tregon se fitimi rritet me rritjen e ROA-së.
ii. Shenja negative e statistikës *t* për variablin e dytë *Detyrime totale / Kapital,* tregon se sa më i madh është ky raport, pra financimi më i madh me kredi për çdo lek kapitali të vet, aq më tepër e redukton fitimin.

Koefiçenti i përcaktueshmërisë R^2 = 0.997 do të thotë se 99.7% e vlerave të variablit të varur shpjegohen vetëm nga dy variablat e mësipërm së bashku. Një vlerë e tillë tregon se dy variablat e pavarur janë përcaktues shumë të mirë për vlerat e variablit të varur. Modeli shpjegon 99.7% te ndryshimit te vlerave te fitimit.

Rëndësinë e modelit e tregon statistika F,e cila është më e madhe sesa tre, pra modeli rezulton i rëndësishëm.

Statistika Durbin-Watson teston praninë ose jo të autokorrelacionit. Statistika Durbin-Watson teston Hipotezën bazë se mbetjet nga regresioni OLS nuk janë të autokorreluara apo Hipotezën alternative që mbetjet ndjekin një proces autokorrelacioni. Vlera e statistikës Durbin -Watson varion në vlerë nga 0 në 4. Një vlerë afër 2 tregon jo-autokorrelacion; një vlerë drejt 0 tregon autokorrelacion pozitiv; një vlerë drejt 4 tregon autokorrelacion negativ.

Koefiçienti ynë *d* i testit Durbin-Watson, i cili është afër vlerës 2, tregon se modeli nuk vuan nga prania e autokorrelacionit (d=2.026 $\approx$2), pra kemi mungese autokorrelacioni.
Vlera e testit të **multikolinearitetit** VIF_i = 1.172 < 3, tregon se nuk kemi multikolinearitet.

Korrelacioni mes variablave : Korrelacioni Pearson

- Sa shpjegohet fitimi mesatar i pesë viteve te fundit nga kthimi mbi aktivet? $r_{fitim\text{-}ROA} = 0.986$ Kemi një lidhje pozitive midis 2 variablave, si dhe vlera 0.986 tregon se lidhja është e fortë.
- Sa shpjegohet fitimi mesatar i pesë viteve te fundit nga raporti i aftësisë paguese? $R_{fitim\text{-}aftesi\ paguese} = 0.244$. Vlera e koeficentit tregon se lidhja midis dy variablave përfshihet tek lidhjet e dobëta, çka do të thotë se pjesën më të madhe të shpjegueshmërisë së vlerave të fitimit mesatar e jep kthimi mbi aktivet.

H1 qëndron: pra fitimi varet nga raporti i përfitueshmërisë (ROA) **si dhe nga raporti i aftësisë paguese** (Detyrime totale / Kapital i vet)**.**

Modeli II

H2:Fitimi mesatar i lidhur me përfitueshmërinë, aftësinë paguese të shoqërisë dhe me politikën e fitimit të firmës.

Variabli i parë i përfshirë në model është ROA. (i sqaruar më sipër).

Variabli i dytë *Totali i Detyrimeve / Totalin e Aktiveve*, është një prej raporteve të borxhit, por shpjegon edhe strukturën e kapitalit që ka zgjedhur njësia ekonomike, pra sa është kjo njësi e varur nga të tjerët. Ky quhet edhe raporti i borxhit total dhe shpreh peshën specifike të detyrimeve ndaj aktiveve totale. Ky raport na mundëson të studiojmë shkallën e varësisë së njësisë nga të tretët.

Të 17 firmave të cilave u kam analizuar treguesit financiarë, u drejtova një pyetje në lidhje me politikën e fitimit të cilën ata ndjekin:

Politika/Strategjia e firmës suaj është e orientuar drejt fitimit afatshkurtër apo drejt atij afatgjatë?

1)Fitim afatshkurtër 2)Fitim Afatgjatë

Përgjigjet që u dhanë paraqiten më poshtë grafikisht:

Figura 15: Politika e firmave në studim në lidhje me fitimin

Rezultatin e përgjigjeve e përfshiva në model si variablin e tretë. Pra, firmat që zgjedhin alternativën 1) pranojnë se janë të orientuara drejt realizimit të fitimit afatshkurtër, ndërsa të tjerat synojnë maksimizimin e vlerës së shoqërisë së tyre duke ndjekur politika të orientuara drejt fitimit afatgjatë.

Fitimi = 11989422.2 – 11323732.9 x_1 + 10376906.7 x_2 – 44618731 x_3
R^2=0.711

Stat t. 2.621 -3.497 3.285 -2.306

Ku:

x_1 = raporti i borxhit total (D / A)

x_2 = ROA (kthimi mbi aktivet)

x_3 = politikë e orientuar drejt fitimit afatshkurtër apo afatgjatë

Studimi i modelit:

Rëndësinë e lidhjes së këtyre variablave e tregon statistika *t* e studentit e cila është më e madhe sesa dy për të tre variablat, $|t_i| > 2$, pra lidhjet individuale janë të rëndësishme, $|t_1|=3.497$; $|t_2|=3.285$ dhe $|t_3|=2.306$.

i. Shenja negative e statistikës *t* për variablin *raporti i borxhit total* tregon se sa më shumë një shoqëri është e varur nga të tretët, sa më të larta nivelet e borxhit,aq më i lartë risku i paaftësisë paguese dhe ai i falimentimit e si pasojë edhe risku i rënies së fitimit.
ii. Shenja pozitive e statistikës *t* për variablin *kthimi mbi aktivet* tregon se fitimi rritet me rritjen e ROA-së.
iii. Shenja negative e statistikës *t* për variablin *politikë e orientuar drejt fitimit ash apo agj*, tregon se fitimi mesatar zvogëlohet kur kalohet nga politika e fitimit afatshkurtër drejt strategjisë së fitimit afatgjatë.

Koefiçenti i përcaktueshmërisë R^2=0.771 do të thotë se 77.1% e vlerave të variablit të varur shpjegohen vetëm nga tre variablat e mësipërm së bashku. Një vlerë e tillë tregon se tre variablat e pavarur janë përcaktues shumë të mirë për vlerat e variablit të varur. Modeli shpjegon 77.1% te ndryshimit te vlerave te fitimit.

Rëndësinë e modelit e tregon statistika F,e cila është më e madhe sesa tre. F = 4.424, pra modeli rezulton i rëndësishëm.

- **Statistika Durbin-Watson** teston praninë ose jo të autokorrelacionit. Vlera d=1.601 ≈ 2 tregon se modeli nuk vuan nga prania e autokorrelacionit, pra kemi mungese autokorrelacioni.
- Vlera e testit të multikolinearitetit VIF_i < 5, tregon se nuk kemi prani të fortë multikolineariteti.

Korrelacioni mes variablave : Korrelacioni Pearson

- Sa shpjegohet fitimi mesatar i pesë viteve te fundit nga kthimi mbi aktivet? $r_{fitim\text{-}ROA}$= I0.91I. Vlera 0.91 tregon se lidhja midis 2 variablave është e forte, pra raporti i përfitueshmërisë, *Kthim mbi Aktivet* (ROA), e shpjegon pothuajse plotësisht fitimin.

- Sa shpjegohet fitimi mesatar i pesë viteve te fundit nga politika e orientuar drejt fitimit ash apo agj? $r_{\text{fitim-politikë e orientuar drejt fitimit ash apo agj}}$ = 0.199. Vlera e koeficentit e klasifikon lidhjen si të dobët.

- Sa shpjegohet fitimi mesatar i pesë viteve te fundit nga raporti i borxhit total? $r_{\text{fitim-borxh total}}$ = -0.307. Vlera e koeficentit tregon se lidhja midis dy variablave përfshihet tek lidhjet relativisht të forta.

Pra, pjesën më të madhe të shpjegueshmërisë së vlerave të fitimit mesatar e jep kthimi mbi aktivet.

H2 qëndron: pra fitimi varet nga raporti i përfitueshmërisë ROA, nga raporti i aftësisë paguese (borxhi total) dhe nga politika e fitimit të firmës.

Modeli III

***H3: Fitimi mesatar i lidhur me raportin* Borxh/Kapital i vet *dhe* Fitimi i pashperndare/Aktive totale.**

Variabli i parë është raporti *Detyrime Totale / Kapital i vet*. Me këtë variabël u njohëm në hipotezën e parë.

Variabli i dytë është Raporti i përfitueshmërisë *Fitim i pashperndare / Aktive Totale.* Ky raport tregon përfitueshmërinë e akumuluar të firmës me kalimin e kohës.

Fitimi = 56584150 -2852287*x_1 - 215553787*x_2 R^2=0.999
Stat.t 47.482 -23.501 38.493
Ku:
x_1 = Detyrime totale / Kapital i vet
x_2 = Fitim i pashpërndarë / Aktive Totale
Studimi i modelit:
Rëndësinë e lidhjes së këtyre variablave e tregon statistika *t* e studentit e cila është më e madhe sesa dy për të dy variablat, pra lidhjet individuale janë të rëndësishme, $| t_i | > 2$

i. Shenja negative e statistikës *t* për variablin e parë *Detyrime totale / Kapital* tregon se sa më i madh ky raport, pra financimi më i madh me kredi për çdo lek kapitali të vet, redukton fitimin.
ii. Shenja pozitive e statistikës *t* për variablin e dytë *Fitim i pashperndare / Aktive Totale,* tregon se një rritje e përfitueshmërisë së

akumuluar, ndikon në rritjen e fitimit. Raporti i fitimit të pashpërndarë mat mbrojtjen e fondeve që shoqëria ka qenë në gjendje të fitojë përgjatë kohës, të cilat mund të përdoren në kohë krize për të balancuar humbjet. Sa më e lartë mbrojtja, aq më i ulët është risku i paaftësisë paguese, aq më i lartë fitimi.

Koefiçenti i përcaktueshmërisë R^2 = 0.999 do të thotë se 99.9% e vlerave të variablit të varur shpjegohen vetëm nga dy variablat e mësipërm së bashku. Një vlerë e tillë tregon se dy variablat e pavarur janë përcaktues shumë të mirë për vlerat e variablit të varur. Modeli shpjegon 99.9% te ndryshimit te vlerave te fitimit.

Rëndësinë e modelit e tregon statistika F, e cila e tejkalon vlerën kritike, pra modeli rezulton i rëndësishëm.

Statistika Durbin-Watson teston praninë ose jo të autokorrelacionit. Koefiçienti ynë *d* i testit Durbin-Watson, d=3.025 $\approx$ 3 i cili është afër vlerës 4, tregon se modeli vuan paksa nga prania e autokorrelacionit, që do të thotë se raportet financiare të shoqërive të marra në studim, tentojnë të kenë prirje të njëjtë. Ky autokorrelacion është i justifikueshëm pasi shoqëritë veprojnë nën ndikimin e kushteve të njëjta të ambientit të jashtëm ekonomik, por edhe nga fakti që shoqëritë janë pjesë e të njëjit sektor, atij industrial.

Vlera e testit të multikolineariteti VIF_i = 2.462 < 3, tregon se nuk kemi multikolinearitet.

Korrelacioni mes variablave : Korrelacioni Pearson

- Sa shpjegohet fitimi mesatar i pesë viteve te fundit nga raporti Detyrime totale / Kapital i vet? $r_{fitim-\ Det.tot./Kap.vet}$ =0.243 Vlera 0.243 tregon se lidhja është e dobët.
- Sa shpjegohet fitimi mesatar i pesë viteve te fundit nga raporti Fitim i pashpërndarë / Aktive Totale? $R_{fitim-\ Fitim\ i\ pashperndare\ /\ Aktive\ Totale}$ = - 0.805. Vlera e koeficentit tregon se lidhja midis dy variablave përfshihet tek lidhjet e forta, çka do të thotë se pjesën më të madhe të shpjegueshmërisë së vlerave të fitimit mesatar e jep raporti Fitim i pashperndare / Aktive Totale.

H3 qëndron: pra fitimi varet nga raporti Fitim i pashpërndarë / Aktive Totale si dhe nga raporti Detyrime Totale / Kapital i vet.

4. Diskutime dhe përfundime

Hipotezat e këtij studimi u testuan për intervalin e besimit α = 95%.
Testi i regresionit të shumëfishtë për hipotezën e parë, tregoi se ka një lidhje të rëndësishme midis ROA, raportit *Detyrime totale / Kapital i vet,* dhe fitimit mesatar. ROA rezulton i lidhur pozitivisht me fitimin ndërsa raporti i dytë i

lidhur negativisht me të. Rezultati tregon se vetëm këta dy variabla së bashku shpjegojnë 99.7% të ndryshimit të vlerave të fitimit.
Testimi i hipotezës së dytë tregoi se *raporti i borxhit total (D / A), ROA (kthimi mbi aktivet)* dhe *Politika e orientuar drejt fitimit afatshkurtër apo afatgjatë*, rezultuan të rëndësishëm dhe një model i tillë shpjegon 77.1% të ndryshimit të vlerave të fitimit.
Nga testimi i hipotezës së tretë doli se raporti *Fitim i pashpërndarë / Aktive Totale* dhe raporti *Detyrime Totale / Kapital i vet,* janë faktorë përcaktues për fitimin dhe së bashku shpjegojnë 99.9% të ndryshimit të vlerave të tij. Shoqëria duhet të synojë të realizojë një raport të lartë *Fitim i pashperndare / Aktive Totale,* pasi një rritje e përfitueshmërisë së akumuluar, ndikon në rritjen e fitimit. Një raport i lartë i fitimit të pashpërndarë tregon se fondet që shoqëria ka qenë në gjendje të fitojë përgjatë kohës, të cilat mund të përdoren në kohë krize për të balancuar humbjet, janë më të "mbrojtura".
Pra, këta variabla rezultojnë faktorë përcaktues të fitimit. Prandaj investitorët duhet t'i marrin parasysh këta faktorë si edhe lidhjet pozitive apo negative që ata kanë me fitimin (të cilat kuptohen nga statistikat e llogaritura në model), kur duan të bëjnë parashikimet e tyre në lidhje me kthimin që presin nga investimi i kryer.
Sidoqoftë në këtë punim kam paraqitur vetëm modelet që me kanë rezultuar të rëndësishëm. Gjatë provave në Programin SPSS, modelet e ndërtuar me raportet e likuiditetit (*kapitali punues /Aktive totale* apo *raporti korrent*) nuk rezultuan të rëndësishëm. Pra, nuk u gjet ndonjë lidhje mes këtyre variablave dhe fitimit.Rezultatet e studimit treguan se për të shpjeguar fitimin është e rëndësishme t'i studiojmë raportet financiarë. Prandaj investitorët, kreditorët, manaxherët, duhet t'u kushtojnë rëndësi variablave të tillë.

Referenca

Përmbledhje leksionesh në Ekonometri – Albert Qarri

Fama, E.F. and K.R. French, 1992. The cross-section of expected stock returns. J. Financ., 47: 427-465.

Fama, E.F. and K.R. French, 1995. Size and book-to-market factors in earnings and returns. J. Financ., 50: 131-155.

Bagherzadeh, S., 2005. Factors influencing stock returns in Tehran stock exchange. Financ. Res., 19: 25-64.

Fama, E.F. and K.R. French, 1998. Value versus growth: The international evidence. J. Financ., 53: 1975-1999.Lam, K.S.K., 2009. The relationship between size,book-to-market equity ratio: Earnnigs - price ratio and return for the Hong Kong stock market. Glob. Financ. J., 13: 163-179.

Mehrani, S. and K. Mehrani,2003. The relationship between profitability ratios and stock returns in Tehran stock exchange. Account. Audit. Rev., 33(Fall). Penman,H.,

S. Scott and A. Richardson, 2005. The Book – to - Price Effect in Stock Returns

Clubb,N. and M. Naffi, 2007. The usefulness of book-to-market and ROE expectations for explaining UK stock returns. J. Bus. Financ. Account.,34(1): 1-32.

Saghafi , A. and M.J. Salimi, 2005. Fundamental variables of accounting and stock returns. Soc. Sci. Hum.Mag. Shiraz Univ., 22(2)

Shtojca

Llogaritjet e programit SPSS 20 per 3 Hipotezat e ngritura.

Modeli I

Hipoteza1:Fitimi I lidhur me aftesine paguese te firmes dhe perfitueshmerine

Variables Entered/Removed[a]

Model	Variables Entered	Variables Removed	Method
1	R2, R3[b]	.	Enter

a. Dependent Variable: Fitimi
b. All requested variables entered.

Model Summary[b]

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Durbin-Watson
1	.997[a]	.993	.987	1762185.855	2.026

a. Predictors: (Constant), R2, R3
b. Dependent Variable: Fitimi

ANOVA[a]

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	935341843521826.800	2	467670921760913.400	150.604	.007[b]
	Residual	6210597974679.962	2	3105298987339.981		
	Total	941552441496506.800	4			

a. Dependent Variable: Fitimi
b. Predictors: (Constant), R2, R3

Coefficients[a]

Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	T	Sig.	Correlations			Collinearity Statistics	
		B	Std. Error	Beta			Zero-order	Partial	Part	Tolerance	VIF
1	(Constant)	16457813.984	1561258.576		10.541	.009					
	R3	49810183.390	2959735.941	1.046	16.829	.004	.986	.996	.966	.853	1.172
	R2	-483094.871	190866.199	-.157	-2.531	.127	.244	-.873	-.145	.853	1.172

a. Dependent Variable: Fitimi

Modeli II

Hipoteza2:Fitimi i lidhur me aftësinë paguese,kthimin mbi aktivet dhe politikën e firmës drejt fitimit ash apo agj.

Variables Entered/Removed[a]

Model	Variables Entered	Variables Removed	Method
1	Kultura., ROA, det/akt.totale[b]	.	Enter

a. Dependent Variable: Fitimi

b. All requested variables entered.

Model Summary[b]

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Durbin-Watson
1	.711[a]	.505	.391	20534642.03	1.601

a. Predictors: (Constant), Kultura, ROA, det/akt.totale

b. Dependent Variable: Fitimi

ANOVA[a]

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	5.624E+15	3	1.875E+15	4.424	.024[b]
	Residual	5.508E+15	13	4.237E+14		
	Total	1.113E+16	16			

a. Dependent Variable: Fitimi

b. Predictors: (Constant), Kultura, ROA, det/akt.totale

Coefficients[a]

Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.	Correlations			Collinearity Statistics	
		B	Std. Error	Beta			Zero-order	Partial	Part	Tolerance	VIF
1	(Constant)	113894222.3	45738963.33		2.521	.02[illegible]					
	det/tot/totale	-113237329.7	32383932.33	-2.498	-3.497	.004	-.307	-.696	-.682	.075	3.437
	ROA	133769067.2	31585149.33	2.069	3.235	.006	-.091	.674	.641	.096	4.417
	Kultura	-44518731.42	18923562.32	-.368	-2.306	.2[illegible]4	.199	-.341	-.255	.479	2.333

a. Dependent Variable: Firm

Modeli III

Hipoteza 3: Fitimi mesatar i lidhur me raportin Borxh/Kapital i vet dhe Fitimi i pashperndare/Aktive totale.

Variables Entered/Removed[a]

Model	Variables Entered	Variables Removed	Method
1	Fitim i pashperndare/Aktive Totale, Det.tot./Kap.vet[b]	.	Enter

a. Dependent Variable: Fitimi

b. All requested variables entered.

Model Summary[b]

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Change Statistics					Durbin-Watson
					R Square Change	F Change	df1	df2	Sig. F Change	
1	.999[a]	.999	.997	772.666	.999	787.558	2	2	.001	3.025

a. Predictors: (Constant), Fitim I pashperndare/Aktive Totale, Det.tot./Kap.vet

b. Dependent Variable: Fitimi

ANOVA[a]

Model		Sum of Squares	Df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	940365863.944	2	470182931.972	787.558	.001[b]
	Residual	1194026.856	2	597013.428		
	Total	941559890.800	4			

a. Dependent Variable: Fitimi

b. Predictors: (Constant), Fitim I pashperndare/Aktive Totale, Det.tot./Kap.vet

Coefficients[a]

Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	T	Sig.	95.0% Confidence Interval for B		Correlations			Collinearity Statistics	
		B	Std. Error	Beta			Lower Bound	Upper Bound	Zero-order	Partial	Part	Tolerance	VIF
1	(Constant)	56584.150	1191.707		47.482	.000	51456.649	61711.650					
	Det.tot./Kap.vet	-2852.287	121.370	-.928	-23.501	.002	-3374.498	-2330.076	.243	-.998	-.592	.406	2.462
	Fitimi pashper/Akt.Tot	-215553.787	5599.829	-1.521	38.493	.001	-239647.905	-191459.670	-.805	-.999	-.969	.406	2.462

a. Dependent Variable: Fitimi

KUSHTET JO TË MIRA TË PUNËS DHE STRESI NDIKOJNË NË RRITJEN E PAKËNAQËSISË NË PUNË

B. Subashi[1], R. Luçi[1], D. Selfo[1], R. Lalo[1], G. Sinanaj[1], Ll. Subashi[2].

[1] Faculty of Public Health, University of Vlora

[2] Vlora Regional Hospital

brunasubashi@gmail.com

Abstrakti

Hyrje: Shkalla e kënaqësisë së personelit infermieror në shërbimin e pediatrisë, është një faktor themelor dhe i domosdoshëm për të ruajtur ekuilibrin në aktivitetin e tyre profesional.

Qëllimi: Evidentimi i kënaqësisë në punë dhe i faktorëve që ndikojnë në kënaqësinë e personelit infermieror të shërbimit të pediatrisë dhe reanimacionit të pediatrisë.

Objektivat: Evidentimi i faktorëve që ndikojnë në kënaqësinë në punë dhe i faktorëve që shkaktojnë pakënaqësi në punë.

Materialet dhe metodat: Ky është një studim rast-kontroll, retrospektiv, analitik, i realizuar në personelin infermieror të shërbimit të pediatrisë dhe reanimacionit të pediatrisë, gjatë periudhës 15 nëntor-15 shkurt duke aplikuar si instrument për mbledhjen e të dhënave një pyetësor të përbërë nga 8 pyetje.

Rezultate dhe konkluzione: Në personelin infermieror shumë të kënaqur shikojmë se perceptimet janë të ndryshme: 31% janë shumë të kënaqur në lidhje me orarin e punës, 27% në lidhje me marredhëniet me përgjegjësin dhe kolegët, 19% në lidhje me pavarësinë në punë, 11% në lidhje me mbështetjen nga përgjegjësi dhe kolegët, 4% në lidhje me kushtet e punës (reanimacioni), komunikimin dhe paraqitjen e mirë në punë.
Në personelin infermieror shumë të pakënaqur dallojmë: 86% e personelit infermieror janë shumë të pakënaqur në lidhje me kushtet e punës, 14% në lidhje me stresin, tensionin dhe acarimin në punë.

Rekomandime: Të përmirësohen kushtet e punës dhe të trajnohet personeli infermieror në lidhje me menaxhimin e stresit në situata të ndryshme me të cilat ai përballet çdo ditë në punën e tij.

Fjalët kyçe: kënaqësia në punë, infermierë, pediatri.

1. Hyrje

Është vënë re në rritje fakti që punonjësit e fushës së shëndetit, sidomos infermierët, provojnë dhe eksperimentojnë çdo ditë situata mjaft të rënda në punë që shkaktojnë vuajtje.
Si rrjedhojë, përjetimi i vuajtjes së personelit infermieror në punë nga inferimierët e pediatrisë duhet të jenë më të shumta si pasojë e ekspozimit të vazhdueshëm të punonjësve në situata shumë të shëmtuara dhe tejet tmerruese

që janë karakteristikë e dinamikës së këtij profesioni, si perjetimet individuale ose të të tjerëve që e kanë origjinën në situatat e konfliktit midis deshirës/nevojës së punojësit dhe organizimit të punës [1].
Ata janë në një kontakt të shpeshtë me dhimbjen, ankthin, vuajtjen dhe kërcënimin e vdekjes.
Shkalla e kënaqësisë së personelit të infermierisë pediatrike është faktor themelor për të ruajtur ekuilibrin në aktivitetin e tyre, një kusht nëpërmjet të cilit veprimet, sjelljet dhe detyrimet mund të zhvillohen pa tensione që paaftësojnë ose ndërhyjnë në kujdesin specifik të specialitetit [2].
Sipas një sondazhi të fundit të kryer prej Agjencisë së Kujdesit Shëndetësor të stafit Infermieror del se infermierët mund të jenë më të kënaqur profesionalisht krahasuar me mjekët e përgjithshëm [3].
Pakënaqësia në punën e infermierëve ka qenë përcaktuesi kryesor i qëllimit për t'u larguar nga puna, megjithatë edhe pse shumë përcaktues të kënaqësisë në punë janë identifikuar, shumë pak dihet për ndikimin e qëndrimeve të ndryshueshme të infermierëve mbi kënaqësinë në punë, të tilla si fuqizimi psikologjik dhe trimëria [4].
Ekzistojnë aspekte si: interesi për punën, mirënjohja, shkalla e përgjegjësisë, zhvillimi profesional, politika e promovimit, që përbëjnë *aspekte motivuese të brendshme* dhe nëse nuk trajtohen me kujdes sjellin si pasojë një punë të keqe në profesion.
Aspektet e motivimit të jashtëm janë të lidhura me ambientin e punës, politkën organizative, mbikëqyrjet e shpeshta, relacionet ndërpersonale, kushtet e punës dhe mbështetjen e kolegëve dhe shefave.
Është themelore të konsiderohet që burimet duhet të orientohen drejt nevojave të këtyre profesionistëve dhe motivacionit të tyre, si bashkimi i kushteve ekonomike, ambientale, të punës, të zhvillimit dhe formimit profesional.
Kënaqësia në punë është diçka që lidhet me kushtet e punës, motivet e brendshme dhe të jashtme të aktivitetit profesional dhe të përballjes, njohëse dhe drejtuese, me streset dhe modalitetet e perceptimit dhe manifestimit emocional të këtyre kushteve të punës dhe të këtyre streseve është diçka që nuk lë dyshime.
Kënaqësia në punë është konsideruar pasojë e sjelljes nga stresi në punë, është një nga treguesit më klasikë i cili përdoret më shpesh kur duhet të njihemi me sjelljen e përgjithshme të njerëzve në jetën në punë.
Për të vlerësuar kënaqësinë në punë është e nevojshme të mbahen parasysh disa përmasa, disa prej të cilave janë të njohura në mënyrë relativisht të qëndrueshme dhe në përputhje.
Ndërmjet tyre duhet të theksojmë kënaqësine e lidhur me motivacionet e jashtme, me mbikëqyrjen ose mënyren e drejtimit, me organizimin institucional dhe drejtimin, me mundësitë e ndërhyrjes, me bashkëpuntorët, kushtet e punës (fizike dhe psikike), të ardhurat materiale, rekomandimet e mirënjohjen, si dhe stimulimin moral (feedbeck, mirënjohje verbale për punën e bërë) [2].
Nivelet e larta të stresit dhe sfidat e përmbushjes së nevojave komplekse për fëmijët e sëmurë rëndë dhe familjet e tyre mund të kërcënojë kënaqësinë e punës dhe të shkaktojë levizje të infermierëve [5].
Gjatë dekadave të fundit, stresit i është kushtuar vëmendje nga studiues në shumë fusha të ndryshme. Një arsye kryesore pse studiuesit janë duke studiuar stresin, qëndron në njohjen prej menaxhuesve se problemet e lidhura me stresin kanë reduktuar produktivitetin dhe moralin [6].
Pra, infermieria është një profesion që pjesën më të madhe të aktivitetit e realizon nën stres dhe është thelbësisht e rëndësishme që gjithë puna që përfshin të realizohet me kenaqësi dhe gëzim.
Në rastin që infermierja është e kënaqur me punën e saj, pacientët do të shërbehen më mirë dhe do të priten më mirë [2].

Është i mundur zbulimi i një forme të re të zhvillmit të punës që të jetë më e kënaqshme për punonjësin dhe më cilësore për pacientin [1].

2. Qëllimi

Evidentimi i kënaqësisë në punë dhe i faktorëve që ndikojnë në kënaqësinë e personelit infermieror të shërbimit të pediatrisë dhe reanimacionit të pediatrisë.

3. Objektivat

1. Evidentimi i faktorëve që ndikojnë në kënaqësinë në punë
2. Evidentimi i faktorëve që shkaktojnë pakënaqësi në punë.

4. Materialet dhe metodat

Ky është një studim rast-kontroll, retrospektiv, analitik, i realizuar në personelin infermieror të shërbimit të pediatrisë dhe reanimacionit të pediatrisë, gjatë periudhës 15 nëntor-15 shkurt duke aplikuar si instrument për mbledhjen e të dhënave një pyetësor i përbërë nga 8 pyetje.

5. Rezultate dhe konkluzione

Kënaqësia në punë sipas kategorive

	Shumë të kënaqur	**Të kënaqur**	**Disi të kënaqur**	**Pak të kënaqur**	**Të pakënaqur**	**Shumë të pakënaqur**	**Pa përgjigje**
Pavarësia	**5**	**5**	**14**	**2**	**3**	**0**	**2**
Kushtet e punës	**1**	**0**	**9**	**2**	**6**	**12**	**2**
Komunikimi	**1**	**19**	**7**	**1**	**1**	**0**	**0**
Paraqitja e mirë në punë	**1**	**25**	**3**	**1**	**0**	**0**	**0**
Marrëdhëniet (përgjegjës/kolegë)	**7**	**11**	**11**	**1**	**0**	**0**	**0**
Stresi/tensioni dhe acarimi në punë	**0**	**2**	**6**	**12**	**8**	**2**	**0**
Mbështetja (përgjegjes/kolegë)	**3**	**14**	**8**	**3**	**0**	**0**	**0**
Orari i punës	**8**	**14**	**6**	**1**	**1**	**0**	**0**



Personeli infermieror i shërbimit të pediatrisë dhe reanimacionit të saj në lidhje me:

- Pavarësinë është disi i kënaqur, që ndiqet nga personeli i kënaqur dhe shumë i kënaqur.
- Kushtet e punës është shumë i pakënaqur, që ndiqet nga personeli disi i kënaqur.
- Komunikimin është i kënaqur, që ndiqet nga personeli disi i kënaqur.
- Paraqitjen e mirë në punë është i kënaqur, që ndiqet nga personeli disi i kënaqur.
- Marrëdhëniet përgjegjës/kolegë është i kënaqur, që ndiqet nga personeli disi i kënaqur dhe shumë i kënaqur.
- Stresin/tensionin dhe acarimin në punë është pak i kënaqur, që ndiqet nga personeli i pakënaqur.
- Mbështetjen psikologjike përgjegjës/kolegë është i kënaqur, që ndiqet nga personeli disi i kënaqur.
- Orarin e punës është i kënaqur, që ndiqet nga personeli shumë i kënaqur.

Objektivi 1. Evidentimi i faktorëve që ndikojnë në kënaqësinë në punë

Kategoria e personelit infermieror shumë të kënaqur në lidhje me kategoritë e mëposhtëme



Në personelin infermieror shumë të kënaqur shikojmë se perceptimet janë të ndryshme:

- 31% e personelit infermieror janë shumë të kënaqur në lidhje me orarin e punës
- 27% e personelit infermieror janë shumë të kënaqur në lidhje me marrëdhëniet me përgjegjësin dhe kolegët
- 19% e personelit infermieror janë shumë të kënaqur në lidhje me pavarësinë në punë
- 11% e personelit infermieror janë shumë të kënaqur në lidhje me mbështetjen nga përgjegjësi dhe kolegët
- 4% e personelit infermieror janë shumë të kënaqur në lidhje me kushtet e punës (reanimacioni), komunikimin dhe paraqitjen e mirë në punë.

Objektivi 2. Evidentimi i faktorëve që shkaktojnë pakënaqësi në punë

Kategoria e personelit infermieror shumë të pakënaqur në lidhje me kategoritë e mëposhtëme



Në personelin infermieror shumë të pakënaqur dallojmë:

- 86% e personelit infermieror janë shumë të pakënaqur në lidhje me kushtet e punës
- 14% e personelit infermieror janë shumë të pakënaqur me stresin, tensionin dhe acarimin në punë.

6. Rekomandime

Të përmirësohen kushtet e punës dhe të trajnohet personeli infermieror në lidhje me menaxhimin e stresit në situata të ndryshme me të cilat ai përballet çdo ditë në punën e tij.

7. Bibliografia

Placer y sufrimiento en trabajadores de enfermería de una Unidad de Terapia Intensiva, Helena Eri Shimizu, 2011, http://www.scielo.br/pdf/rlae/v19n3/es_16.pdf

Satisfacción del personal de enfermería en servicios de oncología, Infante idalmis Ochoa, 2007, http://bvs.sld.cu/revistas/spu/vol33_3_07/spu11307.htm

Alison Ritchie, OCT 07, 2013, Nurse practitioners may have higher job satisfaction than physicians, survey says, http://medicaleconomics.modernmedicine.com/medical-economics/news/nurse-practitioners-may-have-higher-job-satisfaction-physicians-survey-says?page=full

Larrabee, June H. PhD et al, Predicting Registered Nurse Job Satisfaction and Intent to Leave, http://journals.lww.com/jonajournal/Abstract/2003/05000/Predicting_Registered_Nurse_Job_Satisfaction_and.3.aspx

Bratt MM[1] et al, Influence of stress and nursing leadership on job satisfaction of pediatric intensive care unit nurses, http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed/10976354

U. Syed Aktharsha, Job Stress and Job Satisfaction: an investigation of nursing personnel, http://www.jmijitm.com/papers/130245501118-32.pdf

Condiciones de trabajo. Definición, http://www.insht.es/InshtWeb/Contenidos/Documentacion/TextosOnline/GuiasMonitor/CondicionesTrabajo/I/Ficheros/ctsi24.pdf

Condiciones de trabajo, http://www.ugt.es/campanas/condicionesdetrabajo.pdf

Conceptos de condiciones Y medio ambiente de trabajo. Ing. Rodolfo Arias Díaz, http://www.stps.gob.mx/DGIFT_STPS/PDF/Concepto%20de%20condiciones%20y%20medio%20ambiente%20de%20trabajo.pdf

New Report: High Job Satisfaction Among Public Health Nurses, But Many State Health Departments Struggle to Fill Vacancies, June 27, 2013, http://www.rwjf.org/en/about-rwjf/newsroom/newsroom-content/2013/06/new-report--high-job-satisfaction-among-public-health-nurses--bu.html

GLOBALIZMI DUKURI QË LIDHET ME ZGJERIMIN E HAPËSIRAVE TË KOMUNIKIMIT

Msc.Bukuroshe ISUFAJ
Universiteti "Ismail Qemali"Vlorë

Abstrakt

Vështrimi i sotëm sociolinguistik ka lënë pas pikënisje e teza të gjuhësisë tradicionale. Hapësira e re ka vërtetuar se variabilitetet dhe sjellja gjuhësore janë të lidhura me tregues etnikë, fetarë, moshorë,krahinorë, arsimorë etj. Konteksti global dhe proçeset integruese po mishërohen në sistemin e shqipes, po orientojnë modelet e komunikimit të shqiptarëve, prandaj edhe pasojat e tyre në gjuhën shqipe janë të dukshme. Ndryshime vihen re në ligjërimin publik (si në formë, edhe në përmbajtje), në zhanret dhe stilet e përdorura, ku ndihet bindshëm ndikimi i gjuhëve të huaja, kryesisht i anglishtes. Mjaft të përdorshme në këtë lloj kontesti janë huazime leksikore e strukturore si: *implementim projekti, ndërtim i kapaciteteve, resurse humane / natyrore; partnership; investime publike, workshop*-e etj.
Studimi ynë synon të jetë hulumtues, rreth gjuhës së shkruar dhe ligjërimeve të folura të shqipes në hapësirat shqiptare ballkanike dhe në diasporë, duke kundruar si është përdorur ajo në kontekste të ndryshme, sa më të larmishme dhe me mundësi për të parë në rrafshe të ndryshme, se si shkallëzohet pragmatikisht gjuha e shkruar dhe e folur nën gjykimin e bindjes, duke u pykëzuar në fusha të komunikimit, duke pasur si objekt dhe synim kryesor të studimit: "Gjuha e zemrës" dhe "gjuha e bukës" sipas studimeve të reja të sociolinguistikës bashkëkohore .
Studimi ynë vjen si thellim e mbështetje e fushës "Qytetërime në simbiozë e gjuhë në kontakt" dhe, në vijim të shtjellimeve që janë bërë në boshtin "përplasja e qytetërimeve" të formuluar prej Hantingtonit, si dhe të sociologëve të tjerë në fundshekullin XX, dhe dekadat e fundit ,të cilat kërkojnë edhe hetime konkrete në aspektin sociolinguistik të proçeseve të lidhura me emigrimin dhe imigrimin.

Fjalët çelës :Globalizmi,globalizim,proçes,gjuhë ,studim.

Globalizmi është term, kuptimi i të cilit nuk është i qartë aq sa duhet, prandaj edhe ekzistojnë dallime të mëdha mes autorëve reth përkufizimit të tij. Disa e shohin si një proçes, i cili çon drejt bashkimit të njerëzve, shteteve dhe kulturave të ndryshme, si një proçes, i cili synon ta shndërrojë botën në një "fshat global ", fshat të vogël, ku të gjithë do të jetonin në marrëdhënie shumë të mira ndërshtetërore. Nëqoftëse do të kishte ekzistuar një kuptim i vetëm për globalizimin, atëherë ai do të ishte "integrim në nivel botëror".[1]Ideja e globalizmit është e lidhur me zgjerimin e hapësirave të komunikimit midis

[1] Shih: Etem Aziri, "Sociologjia", f. 425

njerëzve, duke shpërfillur e tejkaluar ndarjet e moçme gjeopolitike, etnike dhe kulturore.
Autorëtë tjerë, e shohin si proçes që mundëson lidhjen e njerëzve nga mbarë bota dhe krijimin e përfitimeve për të gjithë, ndërsa disa të tjerë që janë më tepër kundër globalizimit, e shohin si proces që individëve dhe shteteve të pasura ju mundëson të pasurohen edhe më tepër në kurizin e të varfërve. Në një farë mënyre, globalizimi i kulturës do të thotë universalizim dhe, së këndejmi,edhe sinkretizime madje unifikim ose uniformizim.[2] Kjo është arsyeja që, në shumë vende të botës,ka pasur e vijon të ketë dy rrjedha; njëra, që e dëshiron, e përkrah dhe e mbështet fuqishëm globalizmin në shkallë botërore(sikundër na e thotë edhe vetë termi që përmban rrënjën "glob'(rruzull, univers), duke vlerësuar të mirat që sjell një jetë ekonomiko-shoqërore dhe kulturore e përfshirë ngakahet e reja dhe modernizimi i sotëm; kurse tjetra, që e kundërshton me forcë globalizmin, duke parë tek ai një armik të etnive dhe të kulturave të popujve të vegjël.
Së fundi, por jo nga rëndësia, duhet të themi se një ide e globalizmit ka qenë shprehur qysh në kohët e lashta në maksimën" *Ubi bene,ubi patria*"(Aty ku është mirë,aty është atdheu),porse ajo ka pasur edhe shumë kundërshtime nga pikëpamja e atdhetarizimit. E kundërt me tëka qenë fjala e urtë: "*Guri i rëndë në vend të vet*".Globalizimi prek,në radhë të parë, fushat që janë më të afërta me politikën, si: ekonominë, marrëdhëniet publike dhe marrëdhëniet me jashtë, krejt sistemin e komunikimeve me shkrim e me gojë dhe, në këtë kuadër të gjerë,më shumë ndikon edhe nëprocesin e marrëdhënieve ndërgjuhësore, të cilat, në qoftë se deri vonë ndiqnin kryesisht sistemin e kalimeve binare (ose të ndikimeve të ndërsjella nga një kulturë në tjetrën, përkatësisht nga një gjuhë në tjetrën), tani, krahas kësaj udhe që mbetet edhe mëtej, priren të ndjekin edhe udhën e ndërkëmbimeve të shumëfishta.
Duke përmbledhur që të shkojmë drejt çështjes që na intereson, njerëzit e përcaktojnë veten nga pikëpamja e paraardhësve, besimit, gjuhës, historisë,dokeve, vlerave, zakoneve dhe institucioneve. Në mendësinë e tyre çojnë peshë grupet ose bashkësitë etnokulturore, si: fiset, grupet etnike, bashkësitë fetare, kombet dhe në nivelin më të gjerë qytetërimet. [3]Në këtë botë të re, ku shihet qartë se shoqëritë joperëndimore gjithnjë e më tepër ngulitin vlerat e tyre kulturore dhe hedhin poshtë ato të imponuara nga Perëndimi, vihet re një risi që politologët e përkufizojnë duke u nisur nga dy polet e politikës së sotme botërore, politika vendore (lokale) dhe rruzullimore (globale), ose lokalizmi dhe globalizmi. Le ta themi këtë me fjalët e një politilogu të famshëm: "*...në këtë botë të re, politika lokale është politikë e etnicitetit, politika globale është politikë e qytetërimeve. Rivaliteti ndërmjet superfuqive është zëvendësuar nga përplasja e qytetërimeve*".[4]
Sot për këtë shërben kryesisht anglishtja, pra, në një farë mënyre, jemi në atë raport që ishte *latinishtja* në periudhën klasike dhe mesjetare, *frëngjishtja* për disa shekuj në Perëndim, *swahili* në shumë pjesë të Afrikës. Këtë rol të një *lingua franca* e ka marrë anglishtja në gjysmën e dytë të shek XX dhe, siç po duket, do të vijojë me hapa e ritme më të shpejta në mijëvjeçarin që sapo ka filluar.Më poshtë do të shtjellojmë se si konteksti global dhe proceset integruese po mishërohen në sistemin e shqipes, cilat janë flukset a shtysat më aktive në

---

[2] Shih: Etem Aziri, "Sociologjia", f. 425
[3]Shih: S.P Huntington, *Përplasja e qytetërimeve*, Përkthyer nga anglishtja, Logos-A 2004, f. 21.
[4]S.P Huntington, *Përplasja e qytetërimeve*, Përkthyer nga anglishtja, Logos-A 2004, f, 22

ditët tona që po orientojnë modelet e komunikimit të shqiptarëve dhe cilat janë pasojat e tyre në gjuhën shqipe.
Shoqëria shqiptare, gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, është gjetur para ndryshimesh të shumta politike, shoqërore, kulturore, demografike etj. Në qendrat më të mëdha qytetare (urbane) vërehet shtim dhe përqëndrim mjaft i madh i popullsisë. Përkatësia e origjinës së tyre gjeografike nuk përputhet më plotësisht me karakterizimin gjuhësor të para 20 viteve. Shndërrimet e mëdha shoqërore dhe ekonomike, si edhe marrëdhëniet e afërta me kulturat dhe gjuhët e popujve të tjerë kanë sjellë ndryshime të dukshme edhe në sjelljen gjuhësore të shqiptarëve në mbarë hapësirat e Republikës, po edhe më gjerë, sidomos në hapësirat kombëtare shqiptare, në trojet kompakte ballkanike, madje, deri në diasporat e hershme hsitorike ende shqipfolëse (përkat.arvanite /arbërore, arbëreshe,arbneshe, arnaute etj.).
Hapja e Shqipërisë dhe e hapësirave të tjera etnike shqiptare ndaj botës dhe, sidomos, ndaj Evropës, shtimi i pakufizuar tashmë i shtegtimit fizik dhe virtual të njerëzve dhe të informacioneve e botimeve, kuptuar kjo: e fjalës së shkruar dhe të folur, e gjuhëve dhe e kulturave të ndryshme në shkallë evropiane e, me kohë, edhe ndërplanetare, edhe pse i shumëpritur e i mirëseardhur jo vetëm politikisht, po edhe kulturalisht, nuk mund të mos sillte me vete, krejt natyrshëm, edhe trysninë e sistemeve të ndryshme nga ai i shqipes, mbi shqipen e shkruar, po edhe mbi formën e saj të folur.
Edhe në Shqipëri po ndihet ndikimi i globalizimit dhe kjo në radhë të parë shprehet me animin e fortë nga anglishtja, anim që të kujton pemët e larta që epohen e shkojnë andej nga fryn era; por procesi i globalizimit duhet kuptuar jo vetëm si arë e mbjellë që e zë breshri dhe bën kërdinë mbi të, por edhe si përpjekje për ta ruajtur gjuhën nga asimilimi dhe për ta rreshtuar shqipen me dinjitet krahas gjuhëve të tjera evropiane.
Ne, si popull, sikundër është theksuar edhe nga korifejtë e albanologjisë, si A. Buda, E. Çabej,Sh.Demiraj etj. jemi pjesë e familjes evropiane, por të jesh pjesë e kësaj familjeje të madhe nuk do të thotë harrim i vetvetes, nënshtrim ndaj ndonjë gjuhë tjetër, qoftë ajo edhe anglishtja, që shumëkush e quan sot "gjuha e botës".Në këtë bashkësi qytetërimesh ne duhet të futemi , në radhë të parë,me identitetin tonë kulturor e kombëtar. Gjuha është pjesë themelore dhe shprehësja më e dukshme e këtij identiteti, tipari dallues më kryesor i mbijetesës sonë si komb.
Antiglobalizimi është qëndrim politik, për të perceptuar aspektet negative të globalizimit. Kofi Anan ka thënë se "*të kundërshtosh Globalizimin është sikurse të kundërshtosh kundër ligjit të gravitacionit*". Lëvizja përkatëse është e njohur gjerësisht si lëvizje e antiglobalizimit dhe është kryesisht një përpjekje bazë , me mbështetje nga disa elita intelektuale.
Padyshim,bota po shndërrohet në një "global village". Përveç komuniteteve tradicionale si familja apo fqinjësia, po dalin në skenë komunitete të reja komunikimi (chat, e-mail, facebook), por ato nuk i zëvendësojnë dot këto hapësira tradicionale komunikimi.
Nëse do kalonim pastaj në dimensionin kulturor të globalizimit, ata thonë se si rezultat i afrimit të kulturave të ndryshme, vjen deri te shkatërimi dhe zhdukja e disa kulturave. Këtu vlen të përmendet zhdukja e kulturave Indiane, si dhe ajo e Majëve dhe Actekëve, kultura këto të cilat edhe pse ishin të mëdha, nën ndikimin e kulturës Amerikane dhe Meksikane, pothuajse janë zhdukur plotësisht.

Gjuha e globalizmit është anglishtja[5]. Kjo bën që edhe në Shqipëri, po t'u referohemi disa zhvillime kulturore , duhet të pranojmë se anglishtja po bëhet një gjuhë e dytë, në mos për të gjithë njerëzit, së paku për brezin e ri të qyteteve të mëdha e sidomos të qendrave me përqendrim të madh të institucioneve dhe marrëdhënieve me jashtë, siç janë sot, jo vetëm Tirana e Prishtina, si dy kryeqendrat me kah nga zmadhimi e metropolitanizimi, po edhe të tjera, si Shkupi e Tetova, pjesërisht edhe Durrësi, Shkodra, Vlora etj. [6]

Po përmendim, ndër të tjera, rrethanën që në një qendër shqiptare si Tetova, sot ka edhe një universitet ku mësimet zhvillohen në gjuhën angleze dhe programat mësimore janë të njëjta me ato të Amerikës. Edhe në Tiranë ka disa vjet që është çelur Universiteti i Nju-Jorkut, ku, gjithashtu mësimet zhvillohen në anglisht dhe planet e programet e lëndëve janë të njëjta me ato të Amerikës. Ndërkaq, të dhënat tregojnë se ndikimi dhe anësimi nga anglishtja është edhe më i shtrirë:

1.Anglishtja sot mësohet që në moshën parashkollore, dmth. qysh në kopshtet e fëmijëve.

2. Në jetën politike e shtetërore shumë *"drafte*" e ligje hartohen duke u bazuar tek modele të huaja, të cilat janë të formuluara në anglisht.Vetë fjala "*draft*" (në vend të projekt), *"implementoj*" në vend të zbatoj, vë në jetë, "*rurale*" në vend të malore, "*aplikoj*" në vend të plotësoj, mbush një formular etj. na flasin pikërisht për "*erën*" anglo-amerikane të të shkruarit.

3. Shumë organizata të huaja që veprojnë në vendin tonë dhe në Kosovë operojnë në gjuhën angleze.p.sh. OSBE, NATO, PNUD, KFORetj.

4. Literatura që përdoret sot për çështje të ndryshme ndërkombëtare, po edhe të gati e të gjitha marrëdhënieve ndërshtetërore është në gjuhën angleze.

5. Anglishtja është gjuhë e dytë zyrtare në Kosovë.

6. Takimet e konferencat ndërkombëtare zhvillohen kryesisht në anglisht.

7. Eshtë bërë si diçka e zakonshme që emrat e shumë shoqërive prodhuese e kompani biznesi të emërtohem në anglisht.p.sh.:

AMC (Albanian Mobile Communication)
NBG (National Bank of Greece)
Alb Telecom etj.

8. Në anglisht i kanë emrat shumë hotele, bare, klube. P.sh.:*Grand Hotel, Pradise Hotel, Tirana Internacional Hotel, Choco Bar, Flower Bar, London Club* etj.

9. Disa radio e televizione shqiptare i kanë emrat anglisht. Madje, edhe shqiptimi i fjalëve "radio" e "television" bëhet si në anglisht., p.sh.:*Top Channel, Vlora Channel, Agon Channel, Pop Channel, 24 News, ABC News, Vizion +, Top Radio*etj.

10. Mjaft tituj gazetash e revistash janë në anglisht, p. sh.:Gazeta *"Tirana Observer", "Albania", "Standard",* gazeta kosovare " *Express*", *Channel 1, Ilva tare Tunicht* etj.

11. Grupe këngëtarësh e muzikantësh i kanë emrat në anglisht. Madje, shpesh, edhe këngët janë në anglisht. P.sh. *West Side Family, Big Mamma, Hana Band, The dreams* etj.

12. Reklama, postera e njoftime në gazeta dhe revista i gjejmë në anglisht.p.sh.*" Tirana Airport Partners SHPKis seeking for Traffic Manager, on Duty who will report to Airport Service Director…","Wester Union. Unë ju dërgoj ndihmë"*

---

[5] Shih: Gabriela del Lungo Camiciotti, *L'inglese nell'ambito della Comunita Europea*, vep.cit., f. 29-46.

[6]Shih: Gj.Shkurtaj, *vep.cit*.

13. Gjuha e kompjuterave, e elektronikës është në anglisht.

14. Në gjuhën e politikës e të shtypit përdoren mjaft fjalë anglisht.

15. Shumë fjalë anglisht kanë hyrë në gjuhën e përditshme p.sh.: DJ, VIP (<Ver important person), TASK FORCE, Hitet e javës, Muzikë House, Film horror, luk,-u (*ndryshoj lukun, kujdesem për lukun, me një luk të ri*), kurrikulla (<cv), shou(*top–shou, shoumen*)etj.

16.Emërtime të ideuara sipas anglishtes ndeshim tashmë edhe në emrat e qendrave të mëdha tregtare, si TEG =*Tirana East Gate* etj.

Siç shihet edhe në gjuhën shqipe kemi vërshimin e shumë fjalëve anglisht, duke përfshirë këtu edhe emrat e përveçëm. Këto hyjnë kryesisht nga gjuha e shkrimit, si: përkthimet politike, letrare, ekonomike, nga gazetat, nga gjuha e folur e televizioneve, radiove, intervistave e konferencave të shtypit etj.

Si pasojë vihen re shmangie e shkelje gjuhësore në të gjitha rrafshet, p.sh. në rrafshin e leksikut, të morfologjisë, të sintaksës e kryesisht të drejtshkrimit, ku drejtshkrimi (dhe drejtshqiptimi) i emrave të përveçëm të huaj duhet parë si një çështje më vete, që ka jo pak probleme e mëdyshje për t'u zgjidhur.

Ruajtja e grafisë sëgjuhës së huaj po karakterizon vitet e fundit shkrimin e emrave të përveçëm të huaj të njerëzve e të vendeve, veçanarisht ata të përdorur rishtas, por edhe të tjerë me traditë përdorimi më të hershme në shqipen.Po vihet re një praktikë "e re", e cila është në kundërvënie të plotë me parimin fonetik të të shkruarit. Disa e përpiqen ta përligjin (justifikojnë) këtë praktikë me faktin se numri i këtyre emrave të huaj që po hyjnë në gjuhën shqipe është aq i madh, saqë është e vështirë që të mësosh shqiptimin e tyre dhe pastaj t'i shkruash ato duke zbatuar grafinë e gjuhës shqipe. Aq më tepër duhet bërë kujdes, sot kur përballemi me epokën e superzhvillimit të teknologjisë së informacionit, të kontakteve pa fund të gjuhëve e të kulturave, jo vetëm përmes shkrimit e botimeve,po edhe nëpërmjet postës elektronike, botimeve në faqet e internetit, si edhe përmes takimeve të drejtpërdrejta, si rezultat i lëvizjes së lirë të njerëzve, të ekspansionit të anglishtes dhe të shndërrimit të saj në "gjuhë globale".

Historikisht në gjuhën tonë, për shkak të nevojës që kishte, janë futur fjalë të reja nga gjuhë të ndryshme, si nga latinishtja, greqishtja, turqishtja etj. Në kohën më të re edhe nga anglishtja e nga ndonjë gjuhë tjetër. Veçmas, në periudhën e pasluftës, depërtimi i fjalëve të huaja në fjalorin e përditshmërisë në Kosovë ka qenë mjaft i theksuar, dhe shumë fjalë shqipe janë zëvendësuar me ato të huaja, kryesisht angleze. Tashmë fjalët: *bord, departament, shoping, trust, okej* e shumë fjalë të tjera kanë zënë vend pothuajse në fjalorin e zakonshëm. Interesant është edhe fakti se në shumë reklama, udhëzime, madje edhe në mbishkrimet e shumë lokaleve afariste është i vendosur vetëm një emër në gjuhën e huaj, kryesisht anglez.

Një depërtim i fjalëve të huaja, sipas gjuhtarëve, është shumë herë i panevojshëm. Sipas tyre, ka edhe disa anë pozitive, por ka edhe pasoja. Gjatë huazimeve të fjalëve të huaja në gjuhën shqipe duhet pasur kujdes për ato terma, të cilët nuk janëtë nevojshëm dhe duhen ruajtur e përdorur ato të shqipes. Megjithëkëtë, përdorimi i fjalëve të gjuhëve të huaja në gjuhën shqipe si në të shkruar, edhe në të folur në njëzet vitet e fundit është mjaft i dendur dhe ndikimet e anglishtes në gjuhën shqipe janë bërë të përditshme.

Në ditët tona gjuha shqipe është e hapur përballë gjuhëve të huaja, sidomos përballë anglishtes e veçanërisht ndër emigrantët përballë italishtes e greqishtes, prej të cilave ka marrë e do të marrë fjalë që nuk i ka vetë. Shumë emërtime të fushës së informatikës, të financave, të ekonomisë së tregut, të biznesit, të arteve moderne etj., që sot kanë marrë zhvillim të veçantë, vijnë në shqipe bashkë me konceptet që shprehin dhe mbushin zbrazëtitë e leksikut. Ky

huazim ka vlerën e vet pasuruese, por, nëse bëhet pa kurrfarë kontrolli e pengese, kthehet në një dukuri të dëmshme për gjuhën tonë, sidomos kur mbushet me fjalë të huaja ligjërimi i folur ose shtresa leksikore e përdorimit të përgjithshëm. Prandaj *duhet të bëhen përpjekje për të penguar huazimin e fjalëve nga gjuhë të tjera ose për të hedhur jashtë përdorimit fjalët e huaja, kur për ato kemi fjalë shqipe, plotësisht me të njëjtin kuptim, më të njohura, të përpikëta e të qarta për folësit e shqipes.* Veprimtaria e gjerë e shkrimtarëve, e gazetarëve, e veprimtarëve politikë e shoqërorë, e njerëzve të kulturës e të artit etj. për pastrimin e pasurimin e gjuhës standarde, konkretizohet edhe me zëvendësimin e fjalëve të huaja me fjalë shqipe, një pjesë e të cilave janë botuar në librin "Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj" (1998).

Çështja e pastërtisë së leksikut lidhet drejtpërdrejt me ruajtjen e gjuhës amtare, si tipar themelor i kombësisë, nga çdo përzierje e huaj, si edhe me kristalizimin e normave të gjuhës standarde në leksik. Në këtë sistem norma letrare, siç e kemi thënë më parë, është më e çlirët, sesa në fonetikë e në gramatikë. Kjo do të thotë që, përveç disa varianteve leksikore (siç janë sinonimet), gjuha standarde pranon edhe fjalë të huaja, të domosdoshme për përmbajtjen e tyre dhe për kërkesat e disa fushave, si terminologjia, ligjërimi shkencor etj. Por është krejt i papërligjur vërshimi pa kufizim i fjalëve të huaja të panevojshme, siç ndodhi në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XX e siç po vijon edhe sot, sidomos në publicistikë e në ligjërimin politiko-shoqëror.

Në një prononcim për "Kosova Sot", me një dozë kritike, duke folur për këtë fenomen, prof.dr. Agim Vinca është shprehur se prej themelimit të saj në vitin 1960, pra mbi gjysmë shekulli, Dega e Gjuhës Shqipe e Fakultetit Filozofik/ Filologjik të Universitetit të Prishtinës është quajtur "degë", pra shqip. Tani, ka thënë ai, quhet "departament" (nga angl. department - degë, seksion), kështu që edhe Dega e Letërsisë Shqipe dhe të gjitha degët e tjera të Fakultetit të Filologjisë kanë marrë emërtimin e ri. "*S'ke pse shkon më tutje. Ky është proces prapakthyes ose retrograd, siç do t'u pëlqente atyre që i kanë qejf fjalët e huaja, sepse u tingëllojnë më mirë ose kujtojnë se bëhen më të mençur kur i përdorin" (një prononcim për "Kosova Sot").*

Naim Berisha, hulumtues në Institutin Albanologjik të Prishtinës, është shprehur, se duke pasur parasysh se gjuha shqipe në vazhdimësi po i nënshtrohet trysnisë së gjuhëve të huaja, të cilat janë në një shkallë shumë më të lartë të zhvillimit, kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet pengimit të depërtimit të fjalëve të panevojshme, për të cilat ekziston fjala shqipe. Gjithsesi, ka thënë ai, duhet të veprohet me maturi ndaj huazimeve, nuk duhet të lejohet me çdo kusht nxjerrja e fjalëve të huaja nga përdorimi edhe kur ato janë të nevojshme. "*Në kuadër të kësaj, duhet të dallohen ndërkombëtarizmat, fjalët të cilat kanë hyrë së bashku me objektin, termat e fushave të ndryshme, si dhe nocione të cilat gjuha shqipe nuk i ka, prandaj fjalët e këtyre kategorive domosdo duhet të lejohen që të përdoren, sepse shqipja nuk ka fjalë gjegjëse për zëvendësimin e tyre",* por duhet shtuar, se huazimet gjuhësore janë një proces normal për të gjitha gjuhët e botës.

Por, sipas tij, marrja dhe përdorimi i fjalëve të huaja për të cilat ekzistojnë fjalë shqipe, përdorimi i të cilave nuk është përshtatur me natyrën e gjuhës shqipe, është proces shumë i dëmshëm dhe mund të ndihmojë në krijimin e një komunikimi jo të natyrshëm. "*Është detyrë e institucioneve shkencore dhe arsimore që në mënyrë institucionale të botohen lista për zëvendësimin e fjalëve të huaja të panevojshme me fjalë shqipe*". Edhe pse është konstatuar përdorimi pa vend i fjalëve të huaja, deri më tani nuk është bërë ndonjë studim i hollësishëm rreth huazimeve të viteve të fundit. Por, gjatë takimeve të ndryshme shkencore, gjuhëtarët kanë thënë se sidomos përdorimi i fjalëve nga anglishtja në njëzet

vitet e fundit edhe në Kosovë, ashtu si në Shqipëri ka qenë shumë i dendur. Në sajë të statusit dhe tëpranisëadministrative ndërkombëtare, prania dhe ndikimet e anglishtes në gjuhën shqipe janë bërë të shpeshëta.
Marrja vend e pa vend e fjalëve nga gjuhë te huaja është një e keqe. Por ka edhe më keq, kur ato përdoren plotësisht gabimisht. Ta marrin vetëm fjalën anglishte *Nation.* Në anglishte ajo do tëthotë komb dhe shtet. Përkthyesit dhe të tjerët, në vend që ta përkthejnë shtet ose komb, e përdorin vetëm atë nacionale. Në vend të*vetëdije kombëtare*, e *institucion shtetëror*, për të dy rastet përdoren ajo *nacionale*. E sa për emrat e ndërmarrjeve e të këngëve etj., as mos të flasësh. Duke ecur nëpër Tiranë e Prishtinë, kur i shikon firmat në të dy anët e rrugës, të shkon mendja se je në Londër, apo në Birmingen. Kjo ka të bëjë me një marrosje të një kombi të tërë, e jo me përjashtime.
Në ditët tona përpos specialistëve të gjuhës, për një ide të tillë zotohet edhe akademik Rexhep Qosja i cili thekson: "*Mund të thuhet se përdorimi i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe, si dhe në gjuhët e popujve të tjerë, është i domosdoshëm. Purizmi, që bazohet në parimin e përjashtimit prej gjuhës kombëtare të të gjitha fjalëve të huaja, është i dëmshëm, po ashtu është siç është i dëmshëm edhe përdorimi i tyre, natyrisht në rastet kur nuk janë, vërtet, të domosdoshme.Gjuha, më në fund, i përvetëson fare lehtë dhe fare natyrshëm dhe i hedh ato që nuk i përgjigjen dhe që nuk i duhen* ". (Rexhep Qosja "Nocione të reja albanologjike")
Në këtë kuadër, është tashmë një domosdoshmëri studimi i gjuhës shqipe në të gjitha arealet gjuhësore. Për këtë duhet bërë punë e kujdeshme dhe e vëmendshme, në mënyrë që të realizohet përshkrimi sa më i plotë dhe i saktë i varieteve sociolinguistike, të krijuara për shkak të përkatësisë gjeografike, gjinore, moshore, arsimore e, në disa raste, edhe fetare.
Së pari, ndryshime vihen re në ligjërimin publik (si në formë, edhe në përmbajtje), në gjinitë dhe stilet e përdorura ku ndihet bindshëm ndikimi i gjuhëve të huaja, kryesisht i anglishtes. Ky ndikim pasqyrohet në fjalor, në struktura gjuhësore të huazuara, në modelet e ndjekura për hartimin e raporteve të shkruara, kërkesave, projekteve, kjo për arsye të bashkëpunimit me organizata, institucione dhe partnerë të huaj. Madje, jo të rralla janë rastet kur edhe vetë komunikimi/dialogimi kryhet tërësisht në anglisht, edhe pse veprimtaritë a mbledhjet zhvillohen në Shqipëri e në mjediset tona shqiptare.
Mund të sjellim këtu përvojat e njohura gjatë punës me organizata të huaja, ku shqiptarët marrin pjesë në hartimin (në anglisht/ frëngjisht ose italisht) dhe zbatimin e projekteve, duke u angazhuar në tryeza të rrumbullakëta ku punohet në gjuhën angleze, prej nga mund të nxjerrim disa konkluzione në lidhje me faktin se shqiptarë të punësuar në OJF (organizata jofitimprurese) me kohë kanë fituar disa shprehi sociale - kulturore dhe gjuhësore të huaja (të kulturës perëndimore) gjatë punës dhe qëndrimit me të huaj në raport me të tjerë shqiptarë, që kanë pasur pak ose aspak kontakte me kultura të huaja.
Mjaft të përdorshme në këtë lloj kontesti janë huazime leksikore e strukturore si: *implementim projekti, ndërtim i kapaciteteve, resurse humane / resurse natyrore; partnership; investime publike, workshop*-e etj. solucion në vend të zgjidhje, gjeneron për lind, shkakton, *bilaterale* për dypalëshe, *multilaterale* në vend të shumëpalëshe, *bodigard / bodiguard* në vend të truprojeë, roje personale, *implementoj* në vend të zbatoj, kryej, realizoj, *kostitucionale* në vend të kushtetuese, *draft* në vend të projekt a skicë, *staf* në vend të grup drejtues, shtab; *inicioj* në vend të filloj, zë fill, nis; *konsensus* në vend të marrëveshje, të marrë vesh; *lider*, në vend të kreu, udhëheqësi, *lidership* kryesia a udhëheqësia; *spacio* në vend të hapësirë, vend; *kredibilitet* në vend të besueshmëri, *parlament* në vend të kuvend, *atakoj* në vend të sulmoj, godas, prek, ngacmoj; *difensiv* në vend të mbrojtës; *imprenditor* në vend të sipërmarrës; *menaxhoj* e në vend të;

menaxhim në vend të qeverisje, drejtim, *koordinoj* e *koordinim* në vend të bashkërendoj e bashkërendim; *violencë* në vend të dhunë, *violent-e* në vend të i dhunshëm, e dhunshme; *starton* në vend të fillon, nis, zë fill; *konciz* në vend të i përmbledhët, i shkurtër; *interferoj* në vend të ndërhyj,ndërndikoj; *interferim* në vend të ndërhyrje, ndërndikim; *ekuivalent*-e në vend të i barazvlershëm; *stagnacion* në vend të amulli, pezullim; *rurale* në vend të fshatare, e fshatit; agravoj në vend të keqësoj, rëndoj, përkeqësoj; *axhendë* në vend të rend dite, ditar veprimesh, ditar pune; *impas* në vend të rrugë e verbër, udhë pa krye, gjendje pa rrugëdalje e të tjera.

Madje, siç ka vënë në dukje edhe shkrimtari Ismail Kadare, disa politikanë dhe shtetarë, jo vetëm nuk ndreqen, nuk duan t' ia dinë aspak për dëmin që po i sjellin shqipes, po edhe vazhdojnë të "kërkojnë" për të prurë sa më shumë fjalë të huaja, të reja. Këtij ndikimi, mendojmë se është e pamundur t'i shpëtohet plotësisht, pasi prirja është e qartë, ajo lidhet me aspiratat e shqiptarëve për integrim në Evropë, por çështja është që huazimet të përdoren me kriter, siç është rasti kur shqipja mund të paraqesë mungesë fjale për një koncept të ri (p.sh. *kompjuter, biznes, manager*), ose kur fjala e huaj mbart një ngjyrim kuptimor e stilistikor që nuk e ka në shqip, p.sh. themi "*fansat* e Maikell Xhekson-it" dhe jo "*tifozat* e Maikell Xhekson-it" ; do të shoh një film me"*serial killer*" dhe jo "me *vrasës në seri"*, sepse mendohet se ka tjetër ngarkesë emocionale në anglisht.

Gjuha shqipe është përballur me modele të huaja gjuhësore e kulturore gjerësisht këta dy dhjetëvjeçarët e fundit, sidomos nga shtypi i shkruar dhe media televizive. Këto modele e kanë tejkaluar sensin e masës, aq sa gjuha e sotme e shtypit i ngjan një antimodeli të shqipes. Fjalë dhe shprehje (kryesisht nga anglishtja dhe italishtja), si: *lidership, fizibilitet, bipartizan, kompromis, konstitucional, katarsis (greq), implementim, tur elektoral, bestseller, trendi, evakuim, i paprecedent* etj. janë kthyer në një dukuri normale në faqet e gazetave, duke e lodhur e munduar lexuesin e thjeshtë dhe duke revoltuar intelektualin që kërkon të lexojë shqip. E si për të mos mjaftuar me kaq, këtyre u shtohen edhe një mori strukturash të komplikuara e aspak të njohura për shqipen me fjali të gjata, me një varg të gjatë përcaktorësh, me shumë abstragime, aq sa as vetë ata që i shkruajnë dhe i shqiptojnë nëpër artikuj e debate televizive nuk i kuptojnë.

Si shprehje të këtyre shmangieve në komunikim, interpretohen shumë nga mosmarrëveshjet, keqkuptimet, grindjet, situatat e mbarsura me një trysni a peshë të theksuar nervore, që shpesh shpërthejnë në konflikte të hapura dhe në skandale, në revolta, në prishjen e marrëdhënieve të prindërve me fëmijët etj. Përmes komunikimit dhe në situata të ndryshme kumtuese shprehen qartë psikika, vetëdija, nënvetëdija dhe personaliteti ynë, mendimet, ndjenjat, sjelljet dhe veprimet tona, shkalla e zhvillimit dhe e formimit të çdo qënieje njerëzore, ndikimet mbi ne dhe ndikimi ynë mbi të tjerët.

Komunikimet tona janë vetë jeta jonë. Ne jemi të përfshirë në qerthullin e tyre qysh kur ngjizemi në barkun e nënës dhe në të gjitha periudhat e jetës. Kudo dhe kurdoherë jemi në komunikim. Komunikojmë me veten, me të tjerët dhe me botën. Komunikojmë me të njohur dhe të panjohur, me grupe dhe organizata të ndryshme, me shtetin dhe institucionet e tij dhe me publikun e gjerë. Pra, komunikojmë parreshtur, ne me të tjerët dhe të tjerët me ne. Padyshim që në këtë komunikim të ndërsjelltë jo çdo gjë mund të ecë mirë. Ka dhe do të ketë edhe probleme, ndërlikime apo situata të ndërlikuara, të cilat e vështirësojnë aktin e komunikimit.

Një person, i pajisur me një kompetencë thjesht gjuhësore, ''do të shihej si një lloj përbindëshi kulturor''. Ky individ do të njihte mirë rregullat gramatikore të

gjuhës, por nuk do të ishte në gjendje të komunikonte, të përcaktonte variantet sociolinguistike më të përshtatshme për një situatë të caktuar (Gigglioli,1987).
Të folurit merr karakter publik në komunikimin në masmedia, përmes mjeteve të kulturës dhe të propagandës, përmes radios,televizionit, shtypit, me veçoritë e ndikimit dhe të efektit të këtyre mjeteve në masën e njerëzve. Fjala ka qenë gjithmonë nxitëse e madhe për të gjitha veprimet e jashtëzakonshme. Të gjithë udhëheqësit e mëdhenj kanë pasur nevojë për fjalën. Për të treguar rëndësinë e madhe të fjalës, do të mjaftonte t'i hidhnim një sy listës së shpikjeve të kohëve të fundit, e do të bindeshim se pothuaj të gjitha i janë kushtuar fjalës, ruajtjes dhe përhapjes së saj. Kush do të mund të mendonte, vetëm tridhjetë vjet më parë, se një fjalë do të mund t'i rrotullohej globit për disa sekonda e të shkonte në të gjithë veshët e botës?
Por fjala nuk është e njëjtë për të gjithë. Prifti nuk duhet të flasë siç flet avokati. Edhe kandidati politik, duhet t'a ndryshojë mënyrën e tij të të folurit, kur bëhet deputet dhe akoma më shumë kur zgjidhet ministër. Nëse nuk ndodh kështu, atëherë do të kemi një shmangie nga normat e komunikimit, që përcaktohen nga rolet që ndërmarrin njerëzit. Çdo kategori shoqërore ka tipin e vet karakteristik të elokuencës, për faktin e thjeshtë se çdo kategori shoqërore i drejtohet një grupi të ndryshëm dëgjuesish.
Duket se e tërë ekzistenca jonë rrëshqet mbi rrotat monotone të temave të detyrueshme (moti, politika, situata ndërkombëtare, mbarëvajtja e punëve, thashetheme të zakonshme). Sekreti për të ditur të bisedosh dhe t'u përmbahesh normave të komunikimit qëndron në atë që të mos dukesh as ''kokë e madhe'', as tepër banal apo mendjelehtë. Besoj se një politikë mbrojtëse ndaj gjuhës shqipe dhe një vëmendje më e madhe ndaj saj në përgjithësi do ta zbuste këtë dukuri dhe do të çonte në një rivlerësim të merituar të gjuhës sonë.

BIBLIOGRAFIA

Alpan, Nexhip: *Ndikime e gjuhës dhe të letërsisë turke në gjuhën dhe letërsinë shqipe*. – në: "Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike me rastin e 5ëë-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit–Skënderbeut". Tiranë, 12–18 janar 1968. III. Materiale të seksionit të shkencave filologjike. Tiranë, 1970, f. 81–88.

Ajeti, I. *Mjetet e informimit për ngritjen e kulturës gjuhësore*, në "Çështje të kulturës së gjuhës", Prishtinë, 1980, f.15.

Altimari, F. *Comportamento linguistico e condizionamenti socioculturali nella situazione plurilingue di uni area albanofona della Calabria*, në "Atti del IX Congresso Internazionale di Studi Albanezi, Palermo 1981, p. 57.

Altimari, F. (1983) *Comportamento linguistico e condizionamenti socioculturali nella situazione plurilingua di un' area albanofona della Calabria*, in "Studi linguistici arbëreshe", "Quaderni di Zjarri", 1988, pp.5-29.

Altimari, F. (1985) *Lingua ed emigrazione nella comunità albanese di Calabria,* in "Minoranze etniche e linguistiche", Palermo-Piana degli Albanesi, pp. 121-142.

Ballhysa a.-Lala M., *Shqiptarët dhe plurilinguizmi në Europën plurikulturore*, në "Studime Albanologjike", II, Tiranë, 2011,f.382-393.

Çabej, E. *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, në "Gjuha jonë", 1,1981, f.36-47.

Çeliku M., *Për pastërtinë e shqipes nga fjalët e huaja në përdorim*, në "Akte të Konferencës Shkenore me temë "Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar", Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë, 2004, f.9-25..Shkurtaj Gj., *Ligjërimet arbëreshe,* Tiranë, 2006, f.94-116.

Demiraj, Shaban: *Rreth huazimeve prej burimit turk, arab dhe persian në gjuhën shqipe*. – *Univers* 2001, 1, 15–30.

Demiraj, Shaban: *Rreth huazimeve të shqipes prej burimi persian*. – *Perla* 11/2006, 1, 29–36.

Demiraj, Sh., *Eqrem Çabej- një jetë kushtuar shkencës*, Tiranë,1982.

Gjinari J.- Shkurtaj, Gj.*Dialektologjia,* SHBLU, Tiranë, 2003 e ribotime.

Hashorva O., *Gjuha shqipe në shkolat arbëreshe të Kalabrisë dhe Sicilisë*, në "Studime Albanologjike", II, Tiranë, 2011, f.345-350.

Isa Avdullai ,"Antiglobalizimi", Shkup, 2009.

Islamaj Shefkije, *Anglishtja dhe latinizimi i ri i shqipes*, në "Akte të Konferencës Shkencore, 16 dhjetor 2004, Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar, Tiranë, 2004, f.56-62.

Journal of Sociolinguistics, Volume 7, Issue 3, pages 392–397, August 2003 Eckert 2003.

Shkurtaj Gj., *Ligjërimet arbëreshe,* Tiranë, 2006.

L' APPRENDIMENTO SPONTANEO DI UNA SECONDA LINGUA / a cura di Anna Gacalone Ramat. - Bologna : il Mulino, c1986.

S.P Huntington, *Përplasja e qytetërimeve*, Logos-A 2004.

L' ITALIANO TRA LE ALTRE LINGUE : strategie di acquisizione / A cura di Anna Giacalone Ramat. - Bologna : il Mulino, 1988.

SISTEMET E INFORMACIONIT NË MESIMIN UNIVERSITAR

MSc.Dorina Mino
Departamenti i Shkencave Kompjuterike
Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.

Abstrakt

Me këtë shkrim kërkojë të hedh dritë mbi kuptimin,vendin dhe rolin e sistemeve të informacionit në proçesin e edukimit universitar. Shikohen sistemet e informacionit si një instrument menaxhimi, metodologji zhvillimi, si dhe paraqiten pjesët dhe e ardhmja e sistemeve të informacionit.
Në të njëjtën kohë do të përcaktohen objektivat dhe qëllimet e subjektit Sistemet e Informacionit në Ekonomi. Do të nënvizohen konpetencat që studenti fiton nga studimi i këtij subjekti. Një vëmendje e vecantë i kushtohet kurikulave të studimit për këtë subjekt dhe një sërë aplikacioneve që mund të jenë motiv i praktikës në laborator si dhe disertacionit të studentëve.

Fjalë kyce: Sisteme Informacioni, Parteriteti Akademik, Kurikula, Kompetenca të përgjithshme, Kompetenca specifike, Tendencat e IS.

Sistemet e Informacionit si instrument modern menaxhimi

Për ekonomin dhe organizatat sociale që të jenë efiçente duhet që të menaxhohen në një menyrë shkencore të bazuar në:

a) një tërësi njohurish për ligjet ekonomike,
b) në njohuri ekzakte operative,
c) në njohuri të mira rreth mekanizmave të çmimeve,
d) në karakteristikat teknologjike
e) në menyrat më të mira të shfrytëzimit të burimeve ekzistente.

Që të arrihet një efiçencë e tillë kërkohet përdorimi i disa metodave moderne, teknikave dhe kuptimeve për aksesimin e informacioneve për analizat dhe vendimet që do merren. Nën këto kuptime moderne një rol të rëndësishëm kanë metodat matematikore për matjen e efiçencës si dhe sistemet e informacionit.
Eshtë e një rëndësie të madhe përmirësimi i sistemeve të menaxhimit përkrah përmirësimit të sistemeve të informacionit duke aplikuar principet moderne, metodat e menaxhimit, shkencën kompjuterike, kërkimin operacional. Në njërën anë shikohet ekonomia me elementët e saj dhe në anën tjetër informatikë me metodat efiçente të koleksionimit, verifikimit, trasmetimit dhe proçesimit të të dhënave.
Duke ditur faktin se modelet matematikore përbëjne komponentin shkencor te sistemeve te informacionit dhe duke kujtuar falcitetet që ofron përdorimi i kompjuterit theksojmë se janë një instrument efiçent në menaxhimin e aktiviteteve të ekonomisë, thënë këtë vërejmë disa motive teorike dhe praktike në favor të kësaj ideje:

a) Sistemet e Informacionit ofrojnë mundësi për të simuluar me lehtësi proçeset ekonomike dhe fenomenet e niveleve mikro dhe makroekonomik.

b) Ato sigurojnë lidhjen e duhur midis objektivave dhe burimeve.
c) Përdorimi i modeleve matematikore dhe sistemeve të informacionit siguron mundësin e zgjedhjes së opsionit më të mirë për shumë fusha të aktiviteteve.
d) Sistemet e informacionit evitojnë anakronizmat në aktivitetet e organizatës të manifestuara nga fakti se një sasi e madhe kohore përdoret për aktivitete rutinë, proçesim të dhënash dhe raportim duke lënë shumë pak kohë për gjetjen e informacioneve teknike, për konsultim të materialeve apo për analizë të proçeseve ekonomike.
e) Sistemet e informacionit ofrojnë një potencial të lartë si sasior dhe cilësor për informacionin e përdorur për marrjen e vendimeve. Eshtë e nevojshme të dizenjohen dhe implementohen sisteme informacioni që përdorin teknika organizimi të dhënash të rafinuara si dhe modele matematikore të përzgjedhura me kujdes.Në fund të gjitha këto do të çojnë në rritjen e performancës së sistemeve të informacionit dhe të aktiviteteve bazë që ata do të menaxhojnë.

Dizenjimi i sistemeve të informacioni të përdorur në nivelet mikro dhe makroekonomi, të cilët përdorin teknikat e databazave dhe përfshijnë modele matematikore duke suportuar tipare si: informimi dhe raportimi që kanë rolin të sjellin në vëmëndje devijimin nga gjëndja normale, përbën një formë superiore të organizimit të të dhënave dhe proçesimit.
Ky koncept sjell një ndryshim thelbësor në rolin e sistemit të informacionit duke trasformuar atë nga një instrument pasivë sinjalizimi dhe analizimi për të kompletuar aktivitetet ekonomike, në një instrument aktiv parashikimi, komandash dhe kontrolli.
Në këtë mënyrë qarkullimi i informacionit ndryshoi aspektin e tij nga një njësi e komplikuar dhe e tepërt në një njësi të thjeshtë nga burimi ku rridhte e deri tek databaza si një burim i vetëm.

Patneriteti akademik

Integrimi në Bashkimin Europian nënkupton integrimin e edukimit universitar në Edukimin e Bashkimit Europian në përputhje me sistemet e reja të edukimit, sikurse është sistemi i Bolonjës.
Ky kontekst e bën domosdoshmërisht të nevojshme përmirësimin e proçesit edukativ, modernizimin e tij dhe të njohurive, adaptimin e tij me kërkesat e punës duke harmonizuar aspektin teorik me atë praktik të derivuara nga kërkesat, të gjitha këto të integruara përfshihen në konceptin e përgjithshëm të zhvillimit. Stabilizimi i një partneriteti akademik midis universiteteve, instituteve të kërkimit dhe njësive të prodhimit është një nga kuptimet që ndihmojnë në rritjen e kualitetit të studimit.
Duke pranuar partneritetin akademik me kompanitë kryesore në fushat e shkencës kompjuterike do të sillte krijimin e mundësive të mëdha për bashkëpunim në linjat e kërkimit dhe prodhimit me avantazhe për të gjithë anëtarët e perfshirë. Disa avantazhe janë:

- Mundësia për të tërhequr specialistë dhe organizata profesionale në fusha të caktuara në mënyrë që të ndërtojnë kurikula të reja për universitetet duke patur në konsideratë kërkesat e tregut të punës dhe profesionalizmin ekzistues.
- Mundësia për të ndërfutur edukimin europian në menyrë aktive dhe të vazhdueshme në fusha të shkencës kompjuterike duke mbajtur të azhornuar kërkesat dhe nevojat qe ka vendi ynë dhe vende të tjera.

- Mundësia për të ri-konfiguruar syllabuset duke implementuar elemente shkencore, teknike, ekonomike në pajtim me komponentët që do ti jepen studentit.
- Mundësia për të vendosur për çdo universitet etalon specializues për të realizuar forma dhe aktivitete praktike duke krijuar një urë lidhëse midis studentëve dhe kompanive që kerkojnë për të punësuar staf.
- Mundësia për të angazhuar studentët dhe stafin mësimdhënës në zgjidhjen e disa problemeve ose aktivizimin në sipërmarjet komerciale.
- Thellimi i një partneriteti dhe kontakti midis universiteteve, koorporatave, instituteve të kërkimit dhe njësive lokale e qëndrore të administrimit e bën transferimin teknologjik dhe njohës të mundur, gjithashtu stimulon një zhvillim ekonomiko-social.
- Për më tepër është e mundur të përmirësohen kurikulat, syllabuset dhe metodologjitë e mësimdhënies duke mbajtur një lidhje të vazhdueshme midis universiteteve jashtë vendit duke siguruar në këtë menyrë integrimin e standarteve të edukimit të Bashkimit Europian.

Vendi i disiplinës së Sistemeve Informative në mësimdhënien e universiteteve

Në mënyrë që të përcaktohet vendi i "Sistemeve të Informacionit" në kurikulat e mësimdhënies në universitete dhe në menyrë që të përcaktohet se sa vjet të tjera studim kërkon kjo disiplinë është e nevojshme të konsiderohen disa aspekte të specifikimit dhe objektivave të tyre. Njihet më së miri se zhvillimi i një sistemi informacioni është një aktivitet i gjatë dhe kompleks i cili përfshin një numër të madh njerëzish, një volum të madh materialesh, burimesh financiare dhe kohë. Në të njëjtën kohë disiplina e "sistemeve të informacionit" është një disiplinë e cila implikon një sërë njohurish të mara nga kurse të tjera sikurse janë sistemet operative, databazat, gjuhët e programimit, kërkimi operacional, financa, menaxhimi e shumë të tjera.Në një kontekst të tille kjo disiplinë në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike kërkon strukturimin e subjekteve të kursit në tre module të cilët së bashku do të funksionojnë për të ndërtuar sistemin e informacionit por që do të kenë një emërtim të ndryshëm.

Plani mësimor

Materiali i kursit të Sistemeve të Infromacionit është shumë kompleks dhe duhet të ketë një strukturë të specifikuar si më poshtë:

A. Konceptet bazë dhe aspektet e Sistemeve të Informacionit si instrument menaxhimi dhe organizimi duhet të perfshijnë elementët e mëposhtëm:

- Sistemet e Informacionit si një komponent menaxhimi
- Përkufizimi dhe komponentët e një sistemi informacioni
- Sistemet e menaxhimit të informacionit dhe objektivat
- Klasifikimi i sistemeve të informacionit
- Stadet e zhvillimit të një sistemi informacioni dhe tendencat
- Sistemet e suportit të marrjes së vendimeve

B. Metodologji të zhvillimit të sistemeve të informacionit dhe mjetet ndihmëse të sistemeve inxhinierike.
Ky seksion duhet të prezantojë aspekte të përgjithshme të metodologjive dhe mjeteve të përdorura për zhvillimin e sistemeve të

informacionit. Dy nga metodat kryesore të zhvillimit janë prezantuar në detaje: Metoda e analizës dhe dizenjimit të sistemeve të strukturuar e cila e marrë nga metodologjia e strukturuar dhe metoda e dytë është Proçesi i unifikuar racional i marrë nga metodologjia e orientuar nga objekti.
Ky seksion përfshin elementët:

i. Metodologjitë e zhvillimit të sistemeve të informacionit
ii. Mjetet ndihmëse të kompjuterizuara
iii. Metodologjinë e bazuar në strukturimin e analizës dhe dizajnit
iv. Analizën dhe dizajnin e drejtuar nga objekti

C. Komponentët e dizajnit të sistemeve të informacionit
Ky seksion do të prezantojë aspekte të përgjithshme të gjithë metodologjive të disa komponentëve të sistemeve të informacionit.
D. Implementimin e sistemeve të informacionit
E. Mirmbajtjen e sistemeve të informacionit
F. Efiçencën e sistemeve të informacionit
G. Sistemet e informacionit të integruara i cili është një seksion shtesë që duhet të flasë për konceptin e integrimit, tippet e integrimit të aplikacioneve të sistemeve, SOA(Arkitektura e orientuar nga sherbimet) si një teknologji e re integrimi.

Kurikula duhet të perfshijë:

- Modelin e orientuar nga shërbimet—konceptet
- Arkitekturën e orientuar nga shërbimet
- Linjën e ndërmarrjeve të shërbimeve
- Web shërbimet

Një sistem informacioni I integruar kohët e fundit ka zëvendësuar aspektin funksional të modelit me nje model të orientuar nga procesi I biznesit, për këtë propozohet të studjohet Proçesi I menaxhimit të biznesit(BPM) dhe marrdhëniet e tij me SOA. Kurikula duhet të perfshijë:

- Prezantimin e BPM
- Terminologji të BPM
- BPM dhe SOA
- Modelimi I proçesit të biznesit

Objektivat dhe grupet që mësojnë Sistemet e Informacionit në Universitete

Suksesi i një organizate varet nga aftësia e arkitekturës së teknologjisë së informacionit për të suportuar kërkesat për ndryshimet e informacionit në proçeset e biznesit.Informacioni është një burim bazë për një organizatë, ai konsiderohet si çelsi i suksesit duke qënë se një njeri që ka informacionin e duhur në kohën e duhur ka mundësin të bëj shumë për organizatën.
Shpesh duke pasur më shumë informacion mund të sigurosh një zhvillim radikal të proçeseve ekonomike. Kjo konsiderohet dhe si një faktor çelës për proçeset e vendimit.Në të njëjtën kohë informacioni konsiderohet si një matës dhe monitorues për efiçencën e proçeseve ekonomike, për integrimin e proçeseve, për planifikimet dhe optimizimin e proçeseve.
Në kontekstin e përmendur më lart, objektivat e të mësuarit sisteme informacioni janë studimi i metodologjive, metodave dhe teknologjive për koleksionimin, verifikimin, trasmetimin, ruajtjen dhe proçesimin automatik të të dhënave me një këndvështrim për të plotësuar kërkesat për informacion të menaxherëve në mënyrë që të arrihen vendime të drejta.

Kompetenca të pergjithshme dhe specifike

Duke studjuar disiplinën e sistemeve të informacionit studentët e diplomuar duhet të kenë disa kompetenca të përgjitheshme dhe disa specifike.Kompetencat e përgjitheshme perfshijnë:

- Kapacitetin për të investiguar gjendjen komerciale të një kompanie të konsideruar si një sistem.
- Kapacitetin për të vlerësuar një bazë formale të përshtatëshme të një sistemi informacioni me dimensione të mëdha me disa njësi rajonale, nacionale dhe komerciale.
- Kapacitetin për të vlerësuar dhe diagnostifikuar njësite sociale dhe ekonomike të konsideruara si një sistem.
- Kompetencën për të dizenjuar zgjidhje informative për nivle makro dhe mikroekonomike.
- Kompetencën për të zgjedhur dhe përdorur teknikat dhe mjetet më me shumë avantazh për dizenjimin dhe implementimin e zgjidhjeve informative për probleme komplekse në fushat ekonomike dhe teknologjike.
- Kompetencën për të zhvilluar dhe përmirësuar funksionimin e zgjidhjeve ekzistuese në përputhje me ndryshimet që ndodhin në fushat ekonomike dhe sociale.
- Aftësinë për të mirëmbajtur sistemin e informacionit.
- Aftësinë për të menaxhuar dhe dizenjuar projekte komplekse informacioni.

Ndër kompetencat specifike mund të numërojmë:

- Njohja dhe përdorimi I disa metodologjive, teknikave, dhe metodave studimi, analizimi dhe dezinjimi për të realizuar sisteme informacioni në ekonomi.
- Njohja e disa teknologjive për të ndërtuar sisteme të integruar.
- Kapaciteti për të modeluar proçese të orientuar për aktivitetet e biznesit.
- Zhvillimi i disa njohurive dhe ekspertizave për proçeset e vendimit dhe sistemet e mbështetjes së vendimeve.
- Përfitimi i njohurive për të përdorur dhe operuar me mjedisin e databazave.
- Kapaciteti për të dizenjuar komponente të sistemeve të informacionit sikurse janë: inputet, outputet, dizenjimi logjik i databazave.
- Përcaktimi i arkitekturave për sistemet e informacionit lokal dhe të shpërndarë.

Gjëndja aktuale dhe tendencat e sistemeve të informacionit

Kompjuterizimi i aktiviteteve sociale dhe ekonomike kërkon realizimin e ndryshimeve. Më poshtë jepen disa nga ndryshimet dhe tendencat në zhvillimin e sistemeve të informacionit.

A. Tendenca për të ndarë shpenzimet e software_ve të sistemeve të informacionit.

Prerja e kostos së sistemeve të informacionit është për shkak të prerjes së kostove të hardware në njërën anë dhe prerjes së kostove të software në anën tjetër. Mënyra më e zakonshme për të implementuar

një sistem informacioni është të programosh një nga një softet që duhen. Kjo mënyrë e të bërit gjërat është shumë e shtrenjtë pasi nuk ka prerje kostoje për përdorimin e sistemit në shkallë të lartë. Kostua për dizenjimin, arkivimin, mirëmbajtjen dhe cilësinë e çdo komponenti duhet të suportohet nga një përdorues në sistem. Sot ka një tendencë të qartë për zhvillimin e sistemeve e cila bazohet në software të niveleve të larta. Një platformë software_ike korespondon me platforma aplikacionesh dhe përmban funksionet software_ik bazë të funksioneve të një kompanie.
Funksionet bazë përcaktojnë dhe zgjidhin probleme të përgjithshme dhe aplikacionet specifike përcaktojnë mënyrën e të sjellurit suplementare të kompanisë. Një përcaktim i tillë jep mundësinë të përgjithësohet dhe implementohet i njëjti sistem informativ në disa organizata duke sjellë shkurtim dhe ndarje të kostos.

B. Ka një tendencë për sistemet informativ të bazuar në rrjet.

Kompleksiteti dhe diversiteti i rritur i aplikacioneve ashtu sikurse dhe emergjenca e produkteve software_ik me një çmim dhe performancë më të mirë kërkon që kompjuterat të lidhen në rrjet duke siguruar suportin në largësi.
Nje impakt i shquar për zhvillimin e kompjuterave në rrjet është Interneti, i cili ofron akses të palimituar për kohë të ndryshme informacioni ashtu sikurse dhe kanale të ndrsyhme që lidhin njerëzit në mbarë botën.Tendencat në fushën e rrjeteve kompjuterike përfshijnë aspekte të ndryshme sikurse janë: zhvillimi i protokolleve dhe ambjenteve të komunikimit të cilët lejojnë transportimin me shpejtësi të madhe; zhvillimin e komunikimit wireless; zhvillimin e rrjeteve satelitore; akses në distancë për të realizuar tregtinë elektronike ose transaksionet online.

C. Në fushën e organizimit të të dhënave ka një tendencë për databazat e orientuara nga objekti, databazat multimediale dhe databazat speciale.

Struktura klasike e databazave të bazuara në vlera numerike dhe tekst provon se ka insufiçencë. Aplikacionet e shoqëruara me disiplina teknologjike si: komjuterat ndihmës për dizajn; sistemet e informacionit gjeografik dhe sistemet e bazuara në njohuri kërkojne ruajtjen e sasive të mëdha të të dhënave. Këto aplikacione kanë nevojë për suport për tipe të ndryshme të dhënash të cilat nuk mund të prezantohen dot në formen klasike.
Disa aplikacione kerkojnë monitorim per dizenjimin e disa elementeve kompleks të cilët duhet të kombinohen , ndahen, mbivendosen dhe modifikon në mënyrë të tillë që të lejojnë punën e projekteve në të njëjtën kohe orientimi multimedial ka sjellë elemente të rinj në botën e shkencave kompjuterike. Grafet, imazhet fotografike, imazhet vidio, muzika nuk mund të trajtohen njësojë sikurse një tabelë emrash e thejshtë.
Databazat tradicionale ofrojnë shumë pak suport teorik dhe praktik për tipe të komplikuara të dhënash. Databazat e orientuara nga objekti lejojnë krijimin e objekteve kompleks , ku gjithsecili prej tyre ka atributet e veta dhe janë në gjëndje të ofrojnë zgjidhje të problemeve dhe të aplikacioneve të përmenduara më sipër.

Konkluzione

Roli që luajnë sistemet e informacionit ne Ekonominë e re dixhitale është shumë I rëndësishëm. Për këtë arsye studimi i Sistemeve të Informacionit në fakultete duhet të trajtohet me kujdesin maksimal. Disiplina duhet të sudiohet në bashkëpunim me subjekte të tjera ekonomike dhe teknike.
Misioni i kësaj disipline duhet të jetë sigurimi i specialistëve me kualifikim të lartë që e gjejnë veten në organizata të niveleve të ndryshme në treg. Më e rëndësishmja është të tejkalohet distanca midis teorisë dhe praktikës, midis kërkimit akademik dhe tregut aktual, duke siguruar një integrim të mundshëm të të diplomuarve në organizatat e biznesit.

Referenca

J. Valacich, J. George and J. Hoffer, Essentials of System Analysis and Design, 4th Edition, Prentice Hall, 2009 R. Kelly Rainer Jr., Efraim Turban, Introduction to Information Systems: Supporting and Transforming Business,Wiley, 2008.

R. Stair and G. Reynolds, Fundamentals of Information Systems.

S. R. Magal and J. Word, *Essentials of Business Processes and Information Systems*, Wiley, 2009.

N. Ashrafi and H. Ashrafi, *Object Oriented Systems Analysis and Design*, Prentice Hall, 2009.

A. R. Lupu, R. Bologa, G. Sabău and M.Muntean, "Management Information Systems in Romanian Universities," in The proceedings of the International Conference on e-business (ICE-B is part of ICETE - The International Joint Conference on e-Business and Telecommunications), 26-29 July 2008, Porto, pp. 425-428, ISBN 978-989-8111-58-6.

A. R. Lupu, R. Bologa, G. Sabău and M. Muntean, "Integrated Information Systems in Higher Education," *Wseas Transactions on Computers*, Vol. 7, Issue 5, May 2008, ISSN 1109-2750, pp.473-482.

T. Connolly and C. Begg, Database Systems A Practical Approach toDesign, Implementation, and Management, Addison Wesley, 2005.

VSM (Espejo R, Harnden R, 1996), Living Systems (Miller JG, 1978), SSM (Checkland P, Scholes J, 1997), ITIL (IT Library, 2007)

Baldwing, LP; Irani, Z. and Love, P. (2001) "Outsourcing Information Systems: Drawing Lessons from a Banking Case Study", European Journal of Information Systems, Vol. 10 No. 1, pp. 15-24.

Systems Management, Vol. 9 No. 3, pp. 44-50. Guterl, F. (1996) “How to Manage your Outsourcer?”, Datamation, Vol. 42 No. 5, pp. 79-83. McLellan, K.; Marcolin, B. and Beamish, P. (1995) “Financial and Strategic Motivations behind IS Outsourcing”, Journal of Information Technology, Vol. 10 No. 4, pp. 299-321.

METODA MONTE CARLO NË VENDIMET FINANCIARE

MSc. Elena Bardhaj
Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali", Fakulteti i Ekonomisë
elena.bardhaj@yahoo.com

MSc.Arsjola Dodoveci
Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali", Fakulteti i Ekonomisë
arsi.dodoveci@yahoo.com

Abstrakt

Nga eksperienca kërkojmë të dimë "sa shumë apo nga çfarë" për të gjetur një komoditet të duhur. Në këtë pjesë përqendrohet simulimi tek analiza e modelit financiar të tregut, në mënyrë të veçantë, asetet siç janë aksionet dhe bonot. Me globalizimin e ekonomisë, industritë janë subjekte të shumë forcave ekonomike që në të shumën e rasteve janë të paafta të kontrollojnë gjithë të dhënat. Avantazhi në teorinë e financës, me ndihmën e matematikës, po shkon drejt një evolucioni në kompjuter dhe një simulim fuqiplot me simbole matematike. Çmimi i ekuilibrit në një treg efiçent paraqitet si variabël rasti që ka një komponent të rastit që i bën ato të paparashikueshme. Detyra jonë është që të njohim çdo ndryshim në çmimin e stokut, duhet gjetur cili faktor në kompani ose ekonomi ndikon në ndryshim. Ne do të jemi në gjendje të vlerësojmë me saktësi probabilitetin e ngjarjeve të pa sigurta. Për shembull, sa është probabiliteti që flukset e mjeteve monetare të një produkti të ri të kenë vlerë neto aktuale positive (NPV), sa është risku mesatar i produkteve të reja, apo llojet e ndryshme të riskut (sië janë ndryshimet e normave të interest dhe luhatjet e kursit të këmbimit). Simulimi Monte Carlo mundëson situata të modeluara që paraqesin pasiguri.

Fjalët kyçe: Simulim, Monte Carlo, Proçes Stokastik, modeli matematik.

Simulimi:- është imitimi i proçesit të sistemit në botën reale

Metodologjia dhe Objektivat

Metodologjia e përdorur në këtë punim është një formë teorike e mbështetur mbi të dhënat empirike të cilat pastaj gjatë simulimeve Monte Carlo japin mundësi për një analizë dhe interpretim tjetër nga ana e studiuesit,në varësi të asaj c'ka ne kërkojmë të mësojmë nga ky simulim. Në financë për modelet bazë të evoluimit të cmimit të stokut, % e interesit etj. , e kemi të nevojshme të përkufizojmë shmangien e riskut. Përse të zgjedhim simulimet? Sepse transferojnë punën në CPU. Modelet mund të mbahen në kompjuter duke pasur kompleksitet të madh(nr. i veprimeve që mund të bëhen me formula). Kjo metodë kompjuterike është më e shpejtë se baza e analizave matematike. Simulimi mund të përdoret gjithashtu për të verifikuar një rezultat të marrë nga zgjidhja analitike, sepse disa modele të përdorura në financë për të zgjedhur portofolin ose cmimet janë disi të gabuara. Simulimi gjithashtu përdoret për t'i dhënë përgjigje pyetjes "Cfarë ndodh n.q.s……" . Duke përkufizuar se cfarë do të ndodhë në këto rrethana, simulimi është një mjët i vecantë,përderisa skenat që kemi ndërtuar rreth tyre janë skenat që kemi vëzhguar nga eksperienca jonë. Synimi është që kjo të jetë një metodë e përdorshme në vendin tonë nga bizneset në vendimet që ata marrin,vendime këto të cilat mbartin një nivel të konsiderueshëm pasigurie. Kjo metodë do të rriste nivelin e saktësisë së vendimeve të mundshme. Metoda mund të përdoret nga të githa format e bizneseve pr jo vetem. Perdorimi i saj mund të bëhet edhe nga individë për situate të ndryshme pasigurie si dhe si lendë studimore në universitet tona (duke marrë parasysh që një pjesë e tyre e studiojnë këtë metodë).
Në Shqipëri janë bërë disa studime në lidhje me metodën Monte Carlo për saktësimin e gabimeve në modelet e përdorura (kryesisht në Bankën e Shqipërisë"Hulumtimi empirik i pasigurisë së parashikimit me simulimin Monte Carlo".

Hyrje

Metodat Monte Carlo janë përdorur në sektorin e financës dhe të matematikës-financiare për të simuluar burime të ndryshme të pasigurisë që ndikojnë në vlerën e një instrumenti financiar, një portofoli ose një investimi, dhe pastaj për të llogaritur një vlerë përfaqësuese duke dhënë një input themelor të mundshme. Kjo bëhet me ndihmën e modeleve stokastike. Metoda Monte Carlo përfshin çdo teknikë mostrimi statistikor për të arritur tek zgjidhjet e përafërta të problemeve sasiore. Në thelb, metoda Monte Carlo zgjidh një problem duke simulon drejtpërsëdrejti procesin themelor (fizike) dhe pastaj llogarit (mesataren) rezultatin e proçesit . Modelet mund të mbahen në kompiuter duke pasur kompleksitete të mëdha (numri i veprimeve që bëhet me formula). Kjo metodë kompjuterike është më e shpejtë se analiza e bazave matematike. Në

vitn1946 Stanislaw Ulam i lindën ide për metodën Monte Carlo. Mendimet e para dhe përpjekje që bëri për të praktikuar Metodën Monte Carlo erdhën nga pyetja "sa janë shanset që një diamant Canfield i paraqitur me 52 karta do të dalë me sukses?" Pasi kaloi shumë kohë duke u përpjekur për të vlerësuar ato nga kombinator të ndryshëm. Së bashku me John von Neumann arritën në parashikimin e duhur, por kjo ishte rrugë shumë e gjatë ndaj një prgram kompjuterik do e lehtësonte punën së tepërmi. Duke qenë sekrete, puna e tyre kërkonte një emër të koduar. Von Neumann zgjodhi emrin Monte Carlo. Emri i referohet Kazinosë Monte Karlo në Monako ku Ulam-së do të marrë hua para për të rezikuar. Më pas simulimet kompjuterike janë kryer për të vlerësuar probabilitetin e zinxhirit të nevojshëm të bombës atomike i cili doli me sukses. Shumë kompani të mëdha e përdorin Simulimin Monte Carlo si një mjet të rëndësishëm për marrjen e vendimeve. Përmëndim General Motors, Procter Gamble, dhe Eli Lilly, të cilat përdorin Simulimin për të vlerësuar riskun mesatar të produkteve të reja, pra simulimi përdoret për të vlerësuar "opsionet reale" të tilla si vlera e një opsioni për të zgjeruar aktivitetin, ose shtyrjen e një projekti, i cili përfshinë një shpenzim fillestar dhe të ardhura të pritshme. Nëse këto fitime të ardhme mund të vlerësohen me saktësi, atëherë firma mund të përcaktojë nëse këto fitime do të jenë më të mëdha se shpenzimet dhe pastaj mund të vendosë nëse do të vazhdojë me projektin apo jo. Faktorët që ndikojnë në fitimet e ardhshme mund të përbëhen nga shumë variabla, duke përfshirë edhe luhatjet e normave të interesit, në ndryshimin e kursit të këmbimit, faktorët makro-ekonomik, shpenzimet e punës, çështjet e mjedisit apo avancimet në teknologji. Secili prej këtyre faktorëve mund të jetë shumë-dimensional dhe nuk mund të ketë një sasi shumë të madhe të parametrave që duhet të vlerësohen, secili ka shpërndarjen e vet. Simulimi mund të përdoret për të gjeneruar rrugë të mundshme të çmimeve për të vlerësuar vlerën e ardhshme të një opsioni. Kjo pastaj na tregon një çmim të caktuar për opsionin në pikën aktuale të kohës. GM përdor simulimin për të parashikuar të ardhurat neto për korporatën, për të përcaktuar koston, dhe për të përcaktuar ndjeshmërinë e saj për të përcaktuar llojet e ndryshme të riskut (siç janë ndryshimet e normave të interest dhe luhatjet e kursit të këmbimit). Një kompani shpesh ka nevojë për të vlerësuar një projekt. Metoda Monte Carlo mund të përdoret për të simuluar sjelljen e lidhur të komponentëve të portofolit me kalimin e kohës për të vlerësuar se si portofoli është prekur nga disa ndryshime të nivelit të çmimeve për të vlerësuar vlerën e portofolit. Metodat Monte Carlo sigurojnë fleksibilitet dhe mund të trajtojë burime të shumta të pasigurisë megjithatë teknikat nuk janë gjithmonë të përshtatshme. Avantazhi i metodës Monte Carlo është se rrit dimesionet e problemit. Simulimi mund të përdoret gjithashtu për të verifikuar një rezultat të marrë nga zgjedhja analitike. Modeli në vetvete është një përgjithsim real dhe i ngurtë i ralitetit, ndaj dhe mbart pasiguri. Vlerësimet pikësore e fshehin këtë pasiguri, për aq kohë sa ato nuk paraqiten në formën e shpërndarjes probabilitare.

Pyetjet më të shpeshta nga vendimmarrësit janë:
Sa besim duhet të kemi në këto rezultate?
Sa është probabiliteti i pasigurisë?
Që ti japim përgjigje këtyre pyetjeve na nevojiten metodat matematike dhe simulimi i problemit në kompjuter.

1. Hapat që ndiqen në metodën Monte Carlo

1. Formulohet problemi me dorë (pse duhet simulimi?)

2. Shohim cilat ndryshore janë më të rëndësishme në proçes.

3. Shohim modelet e ngjashme me të, vendosim cilat ekzistojnë në botën reale, Cilat janë më të përshtatshme për tu koduar në kompjuter.

4. Verifikohet modeli. Duhet të jemi të sigurt që gjenerohen të dhëna reale .

5. Run simulation-> mblidhen dhe analizohen të dhënat.

6. Shikohet përfundimi, a ka surpriza? Nqs jo përfitojmë zgjidhjen. Zgjidhja mund të jetë grafike ose numerike

Matematikisht

Teorema themelore e arbitrazhit pa çmim thekson se vlera e një derivativi është e barabartë me vlerën e pritshme të zbritur të fitim të prejardhur, ku pritja është marrë nën masën e rrezikut-neutral. Një pritje është një integral në lidhje me masën. Metodat Monte Carlo janë të përshtatshme në mënyrë ideale për të vlerësuar integralet e vështira. Kështu në qoftë se ne supozojmë se rrezikuneutral në hapësirën tonë probabilitare është {P} dhe se ne kemi një derivat H që varet nga një sërë instrumentesh nga S_1, ..., S_n. Pastaj jepet një mostër omega nga hapësira probabilitare, vlera e derivativit është H (S_1(ω), S_2 (ω), ..., S_n(ω)= H (ω). Vlera e sotme e derivativit është gjetur duke marrë pritjet mbi të gjitha mostrat e mundshme dhe skontimin me normën pa risk. Domethënë derivati ka vlerën:

$$H(0)=\{DF\}_T\int H(\omega)dP(\omega)$$

ku {DF} T është faktori zbritës i cili i korrespondon normës pa risk për vitet e fundit me maturim T.

Tani supozojmë se integrali është i vështirë për tu llogaritur. Ne mund të përafrojmë integralin duke gjeneruar shtigjet mostër dhe pastaj duke marrë një mesatare. Supozojmë se ne gjenerojmë N mostra, kemi që

$$H_0 \approx DF_T \frac{1}{N} \sum_{\omega} H(\omega)$$

E cila është më e lehtë për tu llogaritur.

Shtigjet mostër për modele standarde

Në sektorin e financës, ndryshoret e ndërlidhura të rastit (të tilla si çmimi themelor i aksioneve) supozohet zakonisht për të ndjekur një rrugë që është një funksion i një lëvizje Broënian. Për shembull në modelin standard Black-Scholes, çmimi i aksioneve evulon si

DS=μSdt+σSdËt

rruga e mëposhtme me shpërndarje nga koha 0 në T, ne pres intervali kohor në njësitë M, gjatësi δt, dhe përafrimin e lëvizjes Broëniane mbi intervalin e dt nga një variabël me shpërndarje normale 0 dhe variancë δt . Kjo çon në një rrugë mostër

$$S(k\delta t) = S(0) \exp\left(\sum_{i=1}^{k}\left[\left(\mu - \frac{\sigma^2}{2}\right)\delta t + \sigma\varepsilon_i\sqrt{\delta t}\right]\right)$$

për çdo k midis 1 dhe M. Secili ε_i është barazim nga një shpërndarje normale standarde.
Le të supozojmë se një derivat H paguan vlerën mesatare të S midis 0 dhe T pastaj një rrugë mostër ω bën pjes { ε_1.... ε_M } dhe

$$H(\omega) = \frac{1}{M}\sum_{k=1}^{M} S(k\delta t).$$

Në të marrim vlerën Monte-Carlo të këtij derivativi duke gjeneruar N shumë e variablave normale M, duke krijuar shtigje mostër N dhe kështu vlerat N e H, dhe pastaj duke marrë mesataren. Zakonisht derivati do të varet nga dy apo më shumë (korrelime) themelore. Metoda këtu mund të zgjatet për të gjeneruar shtigjet mostër të disa variablave, ku variablat normale në ndërtimin e shtigjeve mostër janë në korrelacion në mënyrë të përshtatshme.
Ajo vijon nga teorema qendrore e limitit që katërfishon numrin e rrugëve të mostrës, përafërsisht gjysmave gabimin në çmim stimulues (dmth gabim ka qëllim $\varepsilon = \varphi(N^{-1/2})$konvergjon në kuptimin e devijimit standard të zgjidhjes). Në praktikë metodat Monte Carlo janë përdorur për derivate e stilit

europian që përfshijnë të paktën tri variablat (më shumë metoda direkte përfshijnë integrimin numerike zakonisht mund të përdoret për ato probleme me vetëm një ose dy underlyings.

Shembull i thjeshtë i një simulimi

Jemi duke marrë parasysh blerjen e një aksioni të një kompanie
Çmimi i të cilës aktualisht është s = 11.50$. Nqs blerjet e kompanisë shkojnë mirë, mendohet që ky të shkojë S_1= 14.00$. Kompania ka dëshirë të përdori 3 alternativa oferta cash: 12.00$, 13.00$, 14.00$ për cdo njësi të shitjes. Nga ana e kompanisë duam që risku të jetë minimal. Në kosto përfshihen humbjet dhe pagesat që bëhen për kompaninë.(Në fund të secilës strategji do të jetë një Pay off.)
Do të ndërtojmë një tabelë ku të dhënat i kemi të gatshme nga eksperienca e kompanisë.

Strategjia	1	2	3
12	3	2	-2
13	1	-4	4
14	0	-5	5

Strategjia e pay off e konkurentit është:

Strategjia	1	2	3
12	-1	-2	3
13	0	4	-6
14	0	5	-5

1.	Do you think Albanians should unite?	Yes	67
		No	33
		No opinion	0
2.	Would you be willing to start a war against the countries that disagree with the creation of the Greater Albania?	Yes	4
		No	88
		No opinion	8
3.	Do you think Greater Albania should have one army?	Yes	55
		No	41
		No opinion	4
4.	Do you think Greater Albania should have one government?	Yes	48
		No	47
		No opinion	4
5.	Do you think Greater Albania should have a single currency?	Yes	70
		No	28
		No opinion	2
6.	If yes, which currency?	ALL	37
		EUR	42
		USD	4
		No opinion	16
7.	Will the European Union support a Greater Albania?	Yes	29
		No	56
		No opinion	15
8.	Will NATO support a Greater Albania?	Yes	30
		No	49
		No opinion	21
9.	Will the United States support a Greater Albania?	Yes	47
		No	45
		No opinion	18
10.	Will the neighbouring countries (Greece, Italy, Macedonia) support a Greater Albania?	Yes	2
		No	89
		No opinion	9
11.	Do you see the integration of ethnic Albanians from Kosovo into your community as beneficial?	Yes	70
		No	24
		No opinion	6
12.	Do you see the integration of ethnic Albanians from Macedonia into your community as beneficial?	Yes	60
		No	30
		No opinion	10
13.	Do you see the integration of ethnic Albanians from Montenegro into your community as beneficial?	Yes	60
		No	27
		No opinion	13
14.	Would you look favourably upon the idea of ethnic Albanians (including Albanians from	Yes	58
		No	37

Kosovo, Montenegro, Macedonia, Chameria) having equal voting rights in Albania?	No opinion	5
15. Would you look favourably upon the idea of ethnic Albanians having equal voting rights in Kosovo?	Yes No No opinion	63 33 4
16. Would you look favourably upon the idea of ethnic Albanians having equal voting rights in Macedonia?	Yes No No opinion	56 38 6
17. Would you be willing to serve as a guard at a potential military base along the new expanded border?	Yes No No opinion	24 59 18

In fact, the interview responses and the open-ended questions on the questionnaire asking to elaborate the reasons why they think Albanians should unite, a vast majority of the participants responded:

- "Because we are one blood" (Skanderbeg's motto)
- "Because we speak one language"
- "Because we pledge to one flag" (ethnicity)
- "Because we have family members living on the other side of the border." (Only residents of villages next to the borders.)

Many respondents would repeat Skanderbeg's motto like a refrain "Because we are one blood, one language, one nation, of course" as if that was an obvious reason that needed no further explanation. On the other hand, people who disagreed with the unification offered the following reasons:

- No hope for EU integration;
- No admission to the Western bloc would lock the country into another isolation, probably worse than the communist seal-off;
- A war would start with the neighboring countries and there is no willingness to start a war
- A number of respondents said 'no' to unification while mentioning counter-reaction against politicians' populist nationalism as their reason.

Conclusions

Recent events highlight the timeliness of this study, which provides an empirical check of the differences in nature between the people's patriotism and the elite nationalism in Albania. The revival of platonic patriotism became tangible through the prompt and personal response of the Albanian population to the Kosovo families exiled to Albania fleeing the war in 1999. When the data gathering process was launched, the phenomenon under investigation was still the kind of platonic sense of national identity that made Albanians think of themselves as part of a cohesive whole. The brotherly allegiance between Kosovo and Albania was uplifting for Albanian nationals and welcomed by the internationals, because it was a unifying force between two countries that were

cheering each other on along the way to European integration, and therefore it was acting as a stabilizer in the region. All of that changed when the Albanian prime minister surprised both Albanians and internationals with his nationalistic remarks which raised a serious threat for a major diplomatic crisis in the region.

The study showed that the distinction between the degree of interest shown by two of the principal agents in the quest for ethnic unification—on the one hand, the Albanian political parties and, on the other hand, the Albanian citizens—is a sharp one. Even though political parties claim to represent their respective portions of the Albanian population, the evidence from this survey and other surveys conducted recently by reputable international bodies shows that a majority of Albanians prefer to live at peace with their neighbors and are unwilling to follow their political leaders in a war to create a Greater Albania. Therefore, Albanian people's patriotic feelings can be categorized as a platonic type of patriotism, in contrast to the dangerous, unstable nationalistic type. The survey shows that this attitude stems from the four core values of the Albanian society, namely dedication to the fatherland, loyalty to one's family, repudiation of invasion, and the duty of hospitality. It is, therefore, safe to conclude that such feelings do not lead to starting a war in order to invade territories that belong to the neighboring states, as some may suggest. As history testifies, from the beginning of its journey as a nation, the Albanians have suffered many invasions, but they never initiated any wars with the purpose of invading another country.

In addition, it must be stated that this platonic type of patriotism the Albanian people demonstrates is very far from the aggressive nationalism of some Albanian politicians, who have tried to capitalize on this feeling for political gain. The fact that, among all participants surveyed in a European context, the Albanians are the only nation that would highly prefer to move permanently to another country if given the opportunity (Gallup Balkan Monitor 2010) shows that there is no feeling of ethnic superiority to other nations. Such a conclusion is additionally supported by the amount of trust Albanians put on supranational institutions (European Social Survey 2013), again featuring a considerably high index and the highest index among other countries in Europe. Secondly, Albanians have no inclination to fanaticism of any kind. While many ethnic wars are founded on and fueled by religious extremism, Albania has one of the highest indexes of religious tolerance, which has often attracted public acclaim. For instance, as Stephen Schwartz states in an article with title "How Albania's Religious Mix Offers an Example for the Rest of the World" published on Huffington Post: "For their example of cooperation between believers in different faiths, and people of no religious affiliation, they deserve the congratulations of the world in the 100th year of their independence" (The Huffington Post, 2012). Thirdly, the survey conducted for this study showed that 88% of Albanians say 'no' to the war for ethnic unification, 4% say 'yes' and 8% have no opinion. Included in the majority of those who would not start a war against the neighbors are people living on the border, who have already lost family members during the Kosovo war. Lastly, Ahtisaari's Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement, which has been incorporated into Kosovo's constitution, will not allow the newborn state to join another country or part of another country, which means, constitutionally, it is impossible for Kosovo to merge its territories with Albania.

References

Batt, J. et al. (2008) Is there an Albanian question? Institute for Security Studies, European Union

Bostock, W.W. & Smith, G.W. (2001) Towards measuring national identity. SSPP. net, 4, EJ.

ESS (2013) European Social Survey (2012) Gjetjet Paraprake të Hulumtimit Social Evropian: realizuar në Shqipëri në dhjetor 2012 – shkurt 2013.

Heisenberg, W. (1949) The physical principles of the quantum theory. Courier Dover Publications

Institute, H. (2008) Quote Junkie: Greek and Roman Edition. books.google.com,

Judah, T. (2008) Kosovo: what everyone needs to know. Oxford University Press, USA

Khanam, R. (2005) Encyclopaedic Ethnography of Middle-East and Central Asia: AI. Global vision pub.

Koefoed, L. & Simonsen, K. (2007) The price of goodness: everyday nationalist narratives in Denmark. Antipode, 39, 310-330.

Lawton, M.P. et al. (1992) Dimensions of affective experience in three age groups. Psychology and aging, 7, 171.

Kraja, M. (2011) Identiteti Kosovar. PEN Qendra e Kosovës, Pristina.

Melady, T.P. (2013) Albania: a nation of unique inter-religious tolerance and steadfast aspirations for EU integration. Academicus International Scientific Journal, 12-17.

Miller, C. (2002) Guns, Germs, and Steel. The Fate of Human Societies. Economic Botany,

Vickers, M. (2004) Albania: Pan Albanianism: Myth or Threat to Balkan Stability? [online] Available: http://www.crisisgroup.org/home/index.cfm?id=2608&l=1. Accessed March 2013. International Crisis Group

Monitor, G.B. (2008) Insights and Perceptions: Voices of the Balkans, 2008 Analytical Report.

Moore, M. (2001) The ethics of nationalism. Oxford University Press Oxford

Murati, V. (2005) Identiteti kosovar nuk eshte identitet kombetar. Revistë Mikste Debatike për Çështje Shoqërore

NDI (2013) National Democratic Institute, Pre-Election Assessment Mission to Albania.

Miscevic, N. Nationalism. In The Stanford Encyclopedia of Philosophy (Summer 2010 Edition), (Ed, Zalta, E.N.)

Nicholson, B. (1999) The Beginning of the End of a Rebellion: Southern Albania, May-June 1997. East European Politics and Societies, 13, 543-565.

Okey, R. (1992) Central Europe/Eastern Europe: Behind the Definitions. Past and Present, 102-133.

Rama, S. (2012) Përrallat e tranzicionit shqiptar. Botimet Princi

Shraga, D. & Zacklin, R. (1994) International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia, The. Eur. J. Int'l L., 5, 360.

Schwartz, S. (2012) How Albania's Religious Mix Offers an Example for the Rest of the World. The Huffington Post, Nov 28

Sugar, P.F. (1988) The Problems of Nationalism in Eastern Europe: Past and Present. East European Program, European Institute, The Wilson Center

Tarifa, F. (2008) Of time, honor, and memory: Oral Law in Albania. Oral Tradition, 23

Waller, M., Drezov, K. & Gökay, B. (2001) Kosovo: the politics of delusion. Routledge,

Waterbury, M.A. (2009) From Irredentism to Diaspora Politics: States and Transborder Ethnic Groups in Eastern Europe. Global Migration and Transnational Politics

Wheeler, R. (1998) Past and present land tenure systems in Albania: Patrilineal, patriarchal, family-centered. Land Tenure Center, University of Wisconsin-Madison

Willard, C.A. (1996) Liberalism and the Problem of Knowledge: a New Rhetoric for Modern Democracy. University of Chicago Press, Chicago.

Perea, W.A. (1999) Rapid Needs Assessment Among Kosovar Refugees Hosted by Albanian Families and Assessment of Human Rights Violations Committed in Kosovo. Doctors Without Borders/Médecins Sans Frontières (MSF), International Activity Report 1999

Winter, M. (1919) The Aesop for children. Rand, McNally & Co.

Zolo, D. (2002) Invoking Humanity: war, law and global order. Continuum

COMPARATIVE FEATURES BETWEEN PROVERBS IN ALBANIAN, ENGLISH AND GREEK

Evis CELO (Ph.D)
Lorenc Danaj (Ph.D)
University of Vlora "Ismail Qemali"
Faculty of Humanities
Department of foreign Languages
evis.celo8@gmail.com
eviscelo@yahoo.com

Abstract

In connection with reality and the general perception the Ethno-linguistic phenomena between proverbs in English, Albanian and Greek, give comprehensive conclusions and findingsarised after an analysis of the synthesis and verification of long life living. As such they have many values and aim to prepare man to lead at work, in conversation, in his efforts as a citizen of a particular society. That kind of correspondence of proverbs with life, with the problems of the time, with the environment and its specific conditions, with the conscience and real psychology of the country, shows up for the emphasized realistic sense of folk culture in different countrie[1]s.
Besides the definitions in world folk, especially recently, efforts have been made to the definition of proverbs as a special kind of epic and lyrical creations, which are distinguished by a rich content, which in itself expresses a certain opinion, a trial clearly, a high rating, a generalization or conclusion drawn by a deep observation of life and socio-historical experience of the Albanian people and other indigenous neighbors.

Key words: *tradition of people; living experience; proverb approach; socio-linguistic purposes*

HYRJE

Në aspektin kronologjik historik termi *gnoma* i Greqisë Antike, për shembull, shumë shpejt doli nga përdorimi, sepse u zëvendësua me termin latin *proverba* ose *sententia*, si ka vepruar në *Fjalorin* e tij, Frang Bardhi, botuesi i parë i fjalëve të urta shqiptare, i cili të dy termat i përdori njërin pranë tjetrit, pra në mënyrë paralele. Këta dy terma, paralelisht përdoren përgjatë Mesjetës e më vonë deri

[1]Panajoti-Xhagolli, *Funksioni komunikativ i fjalëve të urta*, Tiranë 1983: 162.

edhe sot, por me një dallim se nën ndikimin e letërsisë kishtare, termi *proverb* mbisundoi mbi termin *sentencia*. Kështu termi *proverb*, i cili në fillim shenjonte format letrare të letërsisë gojore, kurse *sentencat* ato të traditës së shkruar, pas Mesjetës, më vonë, në shekujt XVIII – XX, brenda vetes nisi t'i përfshijë edhe aforizmat e thëniet (*sentencat*), si është rasti me *proverbat biblikë të Solomonit*. Për proverbat në Greqinë Antike ka qenë i përhapur termi *gnoma*, kurse përmbledhjet e proverbave, quheshin *gnomologji.* Të dy termat sot janë jashtë përdorimit. Në terminologjinë latine proverbat janë quajtur *proverbium, difteria, adagium, adagia* dhe *sentencium*[2].

Arsyet pse ndodhi kështu janë të thjeshta: në njërën anë ndihet ndikimi i letërsisë kishtare dhe në anën tjetër i studimeve në fushën e gjuhësisë. Për këtë të fundit, p.sh. *fjalët e urta*, në aspektin semiotik, nuk paraqesin ndonjë dallim të rrënjësishëm nga *aforizmat* a *thëniet*, sepse konsiderohen fjali kuptimisht të plota; ndërkaq për letërsinë gojore dallimi është i madh, sepse *fjalët e urta*, si u tha më sipërprapa vetes fshehin kontekstin, d.m.th. ndonjë përrallë, legjendë, fabulë, anekdotë apo këngë (lirike ose epike), në kontekst të së cilës përdoret dhe si përfundim i së cilës realizohet. Shumë proverba kanë origjinën e tyre te besimet popullore, te fetë, përrallat. Proverbi *Miun s'e nxinte vërra, hiqte dhe kunguj pas* i përket fabulës popullore; kurse proverbi *S'a' ngushtë nieri deri n'ditë të vorrit* e gjejmë në një këngë kreshnikësh[3].

Kjo ngjet edhe për faktin e njohur se letërsia kishtare, përgjatë Mesjetës, duke u përpjekur ta afirmojë besimin e ri, bëri zhvlerësimin e parimit të dallimit të stileve. Midis masave që ndërmori, hapi i parë qe kompromisi midis dy kanaleve të komunikimit artistik të fjalës: *dëgjueshmërisë* dhe *lexueshmërisë*[4]. Kjo u reflektua edhe në rrafshin e krijimit të saj: *gojore* dhe *të shkruar*. Kështu letërsia fetare, duke u krijuar sipas modeleve të letërsisë së shkruar, përgjatë Mesjetës dhe më vonë, si edhe sot, duke shenjtëruar shkrimin (*Krishti shkroi me gisht në shkretëtirë*)[5] afirmoi dëgjueshmërinë, sepse përhapet me anë të gojës, sipas ligjësive të përhapjes e të funksionimit të formave të letërsisë gojore.

FUNKSIONE TE DREJTPERDREJTA NE PROVERBA

Proverbat kanë kuptim e përdorim të drejtpërdrejtë e të tërthortë. Në rastin e parë, në funksion të drejtpërdrejtshmërisë përdoren për ta vërtetuar thënien paraprake, kurse në rastin e dytë, kur janë në funksion të tërthortë artistik, përdoren për t'i tërhequr vëmendjen bashkëbiseduesit t'i përmirësojë veprimet e veta. Në këtë mënyrë, ato plotësojnë funksionin e tyre estetik edukativ e mësimor.

Pra, proverbat përveç kuptimit praktik utilitar njohës e sinkretik, kanë edhe kuptimin figurativ, me të cilin përgjithësojnë dhe tipizojnë dukuri të lloj-llojshme jetësore. Për to është karakteristike shprehja e plotë, e përgjithësuar e mendimit, e ndjenjës dhe vendosja e porosisë, e cila bëhet e kuptueshme vetëm

---

[2] Kekez, Josip, *Poslovice i njima srodni oblici*, Zagreb 1984: 13; Kekez, Josip, *Svaki je kamen da se kuca gradi*, Samobor1986: 10-11.

[3]Sako, Zihni, Proverbat: *Historia e Letërsisë Shqipe I*, Tiranë 1959: 49.

[4]Neziri, Zeqirja, *Meshari i Buzukut*, Logos – 5, Shkup 2006: 106 - 108.

[5]Curtius, Ernest Robert, *Evropska knjizevnost i latinsko srednjovjekovlje*, Zagreb 1972: 326.

nga konteksti, në të cilin është përdorur. Kjo edhe është njëra nga prirjet e tyre kryesore për shprehjen e mendimit në mënyrë figurative. Ky parim i lejon proverbit jo vetëm të bëjë përgjithësime të gjera, por në të njëjtën kohë, i jep karakter polisemik dhe sa më i gjerë, sa më i përgjithësuar të jetë mendimi, aq më i bukur është kuptimi i figurshëm. Prandaj, proverbat më të bukur janë ata që kanë mundësi të ofrojnë më shumë se dy e tri mënyra interpretimi.
Në pikëpamje të stilit shpesh afrohet me etimologjinë popullore, e cila jo gjithmonë është në lidhje të ngushtë me interpretimin joprofesional, parashkencor të fjalëve në bazë të përputhjes etimologjike me fjalën tjetër, si ka vepruar Thimi Mitko, i cili emrin e Amerikës e shpjegonte përmes fjalëve të shqipes *"a mer ik"(ha, merr, ik)*. Është shpjegim jo profesional i kuptimit të fjalëve në bazë të afrisë së rastit. Do të ishte e palogjikshme të pranohet shpjegimi i Mitkos se *Amerika* vërtetë ka marrë emrin ashtu si e shpjegonte ai. Teksti është ndërtuar mbi përdorimin krijues të përputhshmërisë së leksemës e të ndarjes së saj në rrokje dhe të veprimit të fenomeneve fonetike (në të folmen e Korçës): *elizionit* (rënies së tingujve), *hiatusit* e *përngjitjes*. Ky shpjegim i Thimi Mitkos[6], nuk është i besueshëm, sepse përputhja gjuhësore është e rastit[7]. Po kështu është i pabesueshëm besimi se "*Kush kalon ylberin, ndërron gjininë*" (është e qartë se kjo është e pamundshme).

METODA KOMPARATIVE SI VLERE NDERKULTURORE MIDIS POPUJVE

Metoda komparative me metodën gjeografike - historike shpjegonte migrimin e të arketipe. Sipas mësimeve të këtilla format parake (paraformat / arketipet) kanë lindur në një pikë të caktuar të rruzullit tokësor dhe prej aty kanë migruar gjatë historisë nëpër vende të ndryshme. Pra, historikisht dhe gjeografikisht janë bartur nga njëri popull në popullin tjetër, ndaj edhe hasen shumë pikëtakime. Kur këtë pikëpamje e ballafaqojmë me metodën poligjenetike fitojmë njohuri të kundërta.
Proverbat poetikisht segmentojnë dukuri të ndryshme jetësore nga aspekte të ndryshme, por gjithmonë ato dukuri që përsëriten. Proverbi është *fiksion preciz figurativ*, vëren, abstragon dhe tipizon dukuri të ndryshme jetësore. Meqë dukuri të këtilla janë konstanta jetësore dhe tipike, duke iu nënshtruar *procesit të abstragimit* shmangin hollësitë lokale dhe kështu krijojnë arsye të mendohet për realizimin, funksionimin dhe tiparet e tyre ndërkombëtare.
Proverbi absolutizon edhe hapësirën edhe kohën, ndaj edhe paraqiten përputhje në shumë kultura të botës. Këto përputhje janë të shumta, bile edhe më të shumta se sa metoda komparative i ka vërejtur. Kjo metodë, p.sh. nuk ka parë se edhe shembujt të cilët historikisht kanë lidhshmëri me ngjarjet tona, ose me rrethanat tona sociologjike, gjeografike, kulturore, jo rrallë, me formën dhe semantikën e tyre janë paralele me proverbat e popujve të tjerë[8].
Metoda komparative ka analizuar atë material, i cili nëpërmjet historisë grafike ka qenë më i eksploatuari dhe i cili ka qenë më i afërt me kulturat e huaja, për ndryshim nga materiali tjetër që ka mbetur konservativ në mjediset e mbyllura agrafike fshatare. Në të vërtetë, komparativizmi ka lënë jashtë komunikimit të

---

[6] Sako, Zihni (etj. red.), *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar II*, Tiranë 1962:
[7]Neziri, Zeqirja, *Epikagojoreshqiptare*, Shkup 2010: 266 - 267.
[8] Kekez, Josip, *Svaki je kamen da se kuca gradi*, Samobor1986: 46.

gjithë ata shembuj të cilët nuk janë derdhur në burimin e përbashkët, sikurse që interpretimi utilitar ka afirmuar vetëm njësitë edukative krahasimore paremiologjike dhe jashtë këtij këndvrojtimi ka mbetur opusi më i suksesshëm poetik[9]. Është tepër kategorik opinioni i folkloristëve romantikë të shekullit XIX, sipas të cilëve proverbat, si fenomen ndërkombëtar, janë bartur nga një popull në popullin tjetër. Edhe në këtë gjini të folklorit ndihet prania e ndërsjellë e proceseve letrare, sepse popujt në jetën e tyre të gjatë historike, midis tyre, kanë marrë dhe kanë dhënë shumë nga përvoja e tyre e gjatë jetësore. Prandaj dhe është e vështirë të dallosh origjinën e një proverbi të huazuar nga proverbi origjinal, autokton, sidomos kur ai pëson ndryshimet e veta.
Kontaktet ndërkulturore, në këtë drejtim edhe dhënie marrjet midis popujve, sipas studimeve më të reja të *teorisë së ndërkulturorësisë*, mandej të *teorisë së intertekstit* e të *teorisë* së moçme *historike gjeografike*, të njohur në shekullin e XVIII, si *teori e monogjenezës* shpjegohen në mënyra të ndryshme. Ndër to më kryesorët janë tre faktorë:
(a) dyndja e popujve; **(b)** jetesa në fqinjësi; dhe **(c)** përkthimi.

ELEMENTE TE PERIUDHAVE TE NDRYSHME QYSH NGA LASHTESIA

Në studimet paramiologjike rreth lashtësisë dhe origjinës së proverbave janë zhvilluar pikëpamje të ndryshme. Qasja tradicionale, në vija të trasha, mund të përshkruhet si historike krahasimtare. Paremiologët me ndihmën e formularëve të caktuar gjuhësorë, përpiqen ta përcaktojnë gjenealogjinë e proverbave, thënieve e frazemave mbiburimore dhe formave më të vjetra, madje t'u përcaktojnë prejardhjen gjeografike dhe udhët e migrimit nga njëri popull në tjetrin[10].
Në trajtën e tyre të sotme, disa herë edhe në brendi hasim gjurmë të periudhës helene, romake e bizantine, mandej të periudhës osmane. Tri sundimet e para nuk janë më të reja se shekulli XV, por më të hershme se vendosja e këtij sundimi, koha kur në jetën e popullit shqiptar nisin të depërtojnë elemente të sundimit osman, i cili ndër shqiptarë vendoset pas këtij shekulli. Të kësaj natyre janë proverbat që rrokin tema të besimeve, si të besimit të krishterë, ashtu edhe ato ku ka lënë gjurmë feja islame. Nga një krahasim i kujdesshëm që do të bënim midis proverbave shqiptare dhe atyre arbëreshe të Italisë e të arvanitasve të Greqisë, do të gjenim gjëra të përbashkëta dhe mund të nxjerrim përfundimin se vjetërsia e disa proverbave tona arrin para shekujve XIV-XV. Rrënjët e lindjes së proverbave, në disa raste, përkojnë me ato të lindjes së fabulave, legjendave, përrallave e anekdotave e të llojeve të tjera të letërsisë gojore dhe është e vështirë të përcaktosh fillesën e krijimit të tyre[11].
Proverbat dhe origjina e tyre kanë qenë të njohura përmes Lindjes së Mesme me Librin e madh të Proverbave. Kjo ka shkaktuar kundërshtime midis besuesve të Biblës dhe Paganëve. Besuesit këmbëngulin në unicitetin hyjnor,

---

[9] Kekez, Josip, *Svaki je kamen da se kuca gradi*, Samobor1986: 47.
[10] Permjakov, *Proverbs in mind-theories of proverbs cognitions,* Lawrence Erlbaum Associate, New York 1997: 122-124.
[11] Berisha, Ibrahim, *Origjina e rinjohjes (The origin of recognition),* Prishtinë 1997: 261.

por kjo nuk do të thotë se gjithçka e vërtetë është unike, sepse ideja e relativitetit situacional është e panjohur. Edhe pse Libri i Proverbave biblike, ngjan të jetë një përmbledhje, ekzistojnë pikëpamje se ato janë thënie pa asnjë lidhje të veçantë me librat e tjerë biblikë. Si rrjedhojë kanë lindur një mori deklaratash që i konsiderojnë si krijime hibride, sepse ato nuk janë ndonjë ligjërim mitik i përrallave apo mbretërve të epokave të ndryshme[12]. Dukshëm, Solomoni, grumbulloi shumë prej tyre nga burime të tjera. Ai konsiderohet redaktor dhe autor i disave prej tyre. Atij i përshkruhet merita se është i pari që u mor me mbledhjen dhe kodifikimin e proverbave. Studiues, si dr Thirtle e ndonjë tjetër vunë në dyshim autorësinë e Solomonit, duke konsideruar se proverbat ishin mësuar prej mësuesit të tij. Sipas dr Thirtle, në libër ka një ndryshim të përemrit nga veta e dytë për te veta e tretë. Për rrjedhojë proverbat në vetën e tretë ishin të hartuara nga Solomoni.

- "Γιάτο καρφί έχασε το πέταλο."
- *"For (because of) the nail he lost the horseshoe."*
- If you don't take care of small problems, they eventually get bigger.

Shumë studiues përqafojnë mendimin se Orienti dhe Lindja e Largët janë shtëpia e proverbave. Kjo sipas teorisë së monogjenezës, e cila kundërshtohet nga teoria e poligjenezës, sipas së cilës secili popull në kushte dhe rrethana të caktuara historike ka nevojë për krijimin e formave të pavarura e autonome shprehëse, semantikisht artistike ose jo, me të cilat ta shprehë qëndrimin e tij ndaj realitetit jetësor, pavarësisht se mund të hasen afëri me popuj të tjerë .

Qëllimi i shprehshmërisë tradicionale të proverbit, mbështetur në përcjelljen e shkallëzuar, në burimet e lashta, është përpjekur t'i përcaktojë prejardhjen dhe kuptimin e fundit të ndonjë forme gjuhësore. Kështu, p.sh. Taylori, në kreun e parë të librit të tij *The Proverb*, ku merret me origjinën e proverbave, edhe pse është i vetëdijshëm se është e pamundshme të përcaktohet me përpikmëri dhe në mënyrë precize origjina dhe mënyra e lindjes së ndonjë proverbi, përpiqet t'i vërtetojë burimet e ndonjërit prej tyre. P.sh., proverbin *When in Rome, do as the Romans*:: *Sipas vendit dhe kuvendi* (në një përkthim të fjalë për fjalshëm kemi = *Në Romë, sillu si romak*) ai e lidh me anekdotën hipotetike të bisedës midis

Shën Ambrozit dhe Shën Augustinit, i cili, ky i fundit, kishte vërejtur se romakët nuk agjërojnë në ditën kur ai e kishte zakon të agjëronte në Milano. Për këtë e pyeti Shën Ambrozin. Ky I përgjigjet: "*When i am here*, *I do not fast on the Sabbath*; *when i am at Rome*, *I fast on the Sabbath*. *To whatever church you come, observe its practice, if you do not wish to suffer or to create a scandal*"::*Kur jam këtu, nuk agjëroj te Sabati, kur jam në Romë agjëroj. Cilës do kishe që t'i përkasësh, bindju zakoneve të saj, nëse nuk dëshiron të keshë vuajtje ose të nxitësh skandale*.

Brenda kësaj tradites tudimore të shprehshmërisë formulative shpesh theksohet se një numër shumë imadh i modeleve të shprehjeve formulative që I hasim ndër popuj të ndryshëm evropianë ruhet prejardhja e vetme antike ose mesjetare.Në të vërtetë, përkrah ekzistimit të proverbave autonome e autoktone, nuk mund të mohohet se një numër i madh proverbash janë huazime nga burime të ndryshme, të cilat me anë të përkthimit janë përhapur në gjuhë të ndryshme evropiane.Për shembull: *T'I shtihet vaj zjarrit*::*Cil ins Feuergiessen*;

---

[12]Ecclesiates,*Predikuesit 12*: 09; Shalom media, Tiranë 2009.

Dora dorën lanë:: *Eine Hand wascht die andere*. Homeri, Platoni, Sofokliu, Aristofani, Eskili, Euripidi dhe shumë shkrimtarë e mendimtarë të tjerë të antikitetit helen, në veprat e tyre kanë përfshire proverba. Kështu kanë vepruar edhe shkrimtarë tromakë Plauti, Terenci, Ciceroni,Horaci[13].
Disa nga proverbat që përshkruajnë **njeriun**,sjelljen e gjetuninë e tij ndërtimin kompozicional shpesh e kanënë kundërshtim me njëra-tjetrën, sepse shqiptojnë kuptime semantike kundërvënëse. P.sh.:

a. *Look before you leap* **vs** *He who hesitates is lost*:
Hapi sytë para se tëbiesh **kundër** *Ai që heziton është I humbur*;
Όποιος βιάζεται σκοντάφτει. **vs** Αυτός πουδισταζει χανει.

b. *A man gets no more than he pays for* **vs** *The best thing in life are free*:
Njeriu merr atë që paguan **kundër** *Gjerat më të mira në jetë janë falas*;
Ότιδίνεις παίρνεις **vs** Τα καλύτερα στηζωήείναι δωρεαν.

Një proverb si *Harro mushkë Valarenë, se Ali Pashën' e prenë* vendoset mire historikisht dhe nuk mund të jetë më ivjetër se viti 1822, kur u vra Ali PashëTepelena[14]. Për të përcaktuar vjetërsinë e proverbave, mund të na shërbejë dhe letërsia e shkruar që u dha jetën disave prej tyre, ose dokumentat e librat e shekujve të kaluar. Kështu, proverbat e botuar nga Frang Bardhi janë të paktën më të vjetra se viti 1635, sepse atëherë duhet të kishte kohë që ishte krijuar proverbi *Ku shkel turku, nuk mbin bar*; ose *Anëmiku plaks'të bahet kurrë mik*, *edhe ndët'u baftë s'bahet i dëreitë*[15].

BOTA E PROVERBAVE NE PORET E JETES SE NJERIUT

Proverbat *gjenetikisht* dhe *praktikisht* gjithmonë janë të lidhura me kontekstin e përvojës proverbiale, pra me përjetimin e përsëritur narrativ dhe, që është tipike për të është se kuptimi që bartet përmes porosisë së tyre poetike gjithmonë është parabolik, figurativ. Stilistikisht shqiptohen në metonimi, aliteracion, sinekdokë, onomatope dhe në mjete të tjera shprehëse. Ato, si u tha edhe më sipër, aq sa janë formë e pavarur dhe autonome, *mundësi e raste* miniaturale, po aq janë edhe pjesë përbërëse e një tërësie më të madhe poetike që shprehin pasqyrime të përjetuara dhe me *parabolikën* e tyre, thënë në terminologjinë e sotme janë *metaforë globale*[16].

Mbi të gjitha figurat e shprehjes artistike me të madhe përdoret metafora. Disa shembuj të metaforës: *Diell me dhëmb*; *Bebja e syrit*. Proverbi në formën e vargëzuar njeh ritmin, rimën dhe strukturën e vargut, pra, të gjitha karakteristikat e formave të kënduara të letërsisë gojore, qofshin lirike, qofshin epike. Rima mund të jetë e jashtme ose e brendshme. Veç gjuhës figurative e cila përdoret edhe në jetën tonë sociale, karakteristikë për proverbat është edhe

---

[13]Rohrich, Mieder: *Proverbs speak louder than words,* Lang publishing, New York 2008: 121-123.
[14]Sako, Zihni, Proverbat: *Historia e Letërsisë Shqipe I*, Tiranë 1959: 50.
[15]Bardhi, Frang, *Fjalori latinisht-shqip*,ribotuar në Prishtinë 1883: 209.
[16] Hamburger, Käthe*, Die Logik der Dichtung*, Klett, Stuttgart 1957: 13.

konciziteti i theksuar dhe vështirë i ndryshueshëm. Ai arrin deri në atë shkallë saqë proverbi nuk ka zhvillim subjekti a veprimi. Përgjithësimet e situatave në jetën e përgjithshme dhe nëpërmjet figurës artistike në proverba janë po aq evidente sa tipike. Përshembull: *Së keqe shapi derën*: *If anything can go wrong, it will; Peshku i madh e ha të voglin*: *Big fish eat little fish; Mos I bjer fatit me shkelm (Mos I bjer bukës me këmbë)*[17]: *Don't burn one's boot; Mos I shiko gunën, po punën*: *You can't tell a book by it's cover; Frika ruan vreshtin*: *Care killed the cat.*

Një lloj tjetër ndërtohen në formë të dialogut. Të tillat përmbajtjen e tyre e kanë në formë të pyetjes dhe përgjigjes. Në to, dialogu është mjet kompozicional dhe stilor. Fiksojnë momente të ndryshme jetësore me anë të dialogut si formë më shembullore, si në rastet:

– *Palokë, të fali pasha!*
– *Prej shokësh mos u ndasha!*[18]

Mund të jetë një varg i thjeshtë i ndarënë dy hemistekë të rimuar. P.sh.: *Buk'e hi e ndë shtëpi*; *Gjen shesh, bën përshesh*; *Ferra e nisi, ferra e grisi*.

Por mund të organizohen edhe në dy vargje:

Bukuria s'është për fis ;

Po kush di e kullandris!;

Edhe tristikët nuk janë të rrallë:

Ku hanë e s'apin,
Ku flet e s'të dëgjojnë,
O zot ynë mos të shtiftë![19]

Në të gjitha këto raste, vargjet dhe sidomos rimat, janë mjete mnemoteknike që shërbejnë për kujtesën, për t'i mbajtur mend. Sidoqoftë, është me vend të themi këtu që zakonisht me anë të kësaj forme ato bartin idenë e proverbit. Shembujt e mësipërm e tregojnë këtë. Ja edhe një shembull me një rimë të brendshme të qartë: "*Nëma e solli, gjëma e mori*".

Aliteracioni mund të zërë vendin e rimës, jo vetëm në proverbat me formën e vargut, por edhe në ato që kanë formën e një fraze në prozë. P.sh.: *Çdo mizë nuk bën mjaltë*; *Ngordhi macja, u ngjall miu*; *Ka të keqen e kalorësit, se i varen këmbët*. Shpesh hasen proverba në formë antiteze, kontrasti. P.sh.: *Keq me burrë, e keq pa burrë*; *Bëri të pjellë e dështoi*; *Vdis pa të dua.*

Herë-herë proverbi ka formën e një morali fabule. P.sh.: *Në mos gjeça konop gjetiu, / Po vi pashë e virem te ti*; *Miun s'e nxinte vëra, hiqte dhe kungullin pas*; *Shumë herë edhe dhelpra q'është aqë dinake, zihet për katër këmbësh*; *Shpinin ulkun ta pagëzonjën e ay thosh: "Ja dhentë tek an turbullojnë ujët"*[20].

---

[17]Panajoti-Xhagolli, *Funksioni komunikativ i fjalëve të urta*, Tiranë 1983: 307.

[18] Panajoti, Jorgo dhe Xhagolli, Agron (përgatitur), Hyrje: *Fjalët e urta shqipe*, Rilindja, Prishtinë 1987: 74.

[19]Gazulli, N., *Fjalorthi i fjalëve të përdoruna në veri të Shqipnis*, Tiranë 2005: 49-52.

[20]Zeneli, P., *Fjalor me shprehje të rralla,* Tiranë 2000: 241- 243.

Shpesh herë shfaqet dhe ka formën e një rregulli apo të një neni të kanunit të maleve. P.sh.: *Gusht e gunë*; *Prilli këndon bilbili*; *Marsi mbledh lëkurët, shkurti shkurton urët*; *Gjaku ujë s'bëhet.*
Si proverba shpeshherë funksionojnë thëniet, të cilat nga letërsia e shkruar kalojnë lehtë e bëhen popullore. Shumë vargje të Naim Frashërit kanë formë të proverbit: *Punë, punë natë e ditë që të shohim pakëz dritë*. Gjithashtu te Th. Mitkoja thënia "*Duaj të të duan*" duket qartë që vjen nga Shën Agostini *Latinisht (Si vis amari, ama)*.

Απο μακρυά και αγαπημένοι , παρά απο κοντά και μαλωμένοι."

- *"From far away and beloved rather than close by and arguing."*
- Better to live apart and get along than to live together and argue.

Në të tilla raste kemi maksima të cilat kthehen e bëhen proverba popullore.Fuksionaliteti i proverbave në jetën sociale është i gjithanshëm, por proverbi duke pasur një formë të përgjithshme konkrete, gëzon kështu të drejtën e përdorimit në drejtime të ndryshme. Është kjo veçori e përgjithësimit në proverba, që mundëson përdorimin e të njëjtit proverb në kuptime të ndryshme. Në këtë mënyrë, mendimi figurativ i proverbit zgjeron sferën e përdorimit të tij në disa kuptime.

KONKLUZIONET

Nga krahasimet e melartme themi se proverbat ne te tria gjuhet anglisht ,shqip dhe greqisht shfaqen si një lloj letrar me të cilin shqiptohen gjykime e vlerësime të mirëfillta situatash e shfaqjesh, të cilat lindin prej jetës materiale e shpirtërore, prej përvojës shumëshekullore, prej praktikës dhe veprimtarisë popullore. Ato paraqesin urtësinë e filosofinë e popullit, mendimin e psikologjinë, ndërgjegjen e tij artistike dhe estetike. Në lidhje me realitetin dhe perceptimin gjithëpërfshirës ato japin përfundime e konstatime, që rrjedhin pas një analize e sinteze dhe verifikimi të gjatë jetësor. Si të tilla kanë vlera të shumta dhe synojnë ta përgatisin njeriun, ta udhëheqin në punë, në sjellje, në përpjekjet e tij si qytetar i një shoqërie të caktuar. Një lidhje e tillë e proverbit me jetën, me problemet e kohës, me mjedisin dhe kushtet konkrete, me ndërgjegjen dhe me psikologjinë reale të vendit, dëshmon për sensin e theksuar realist të folklorit në kultura të vendeve të ndryshme[21].
Është e rëndësishme të vihet re se interesi për proverbat është shumë i lashtë, sepse ato duke shërbyer si burime për transmetimin e ideve sjellin informacione për të gjithë ata që duan të kenë mbështetje (akses) në traditën dhe njohjen e tërësisë së proverbave më të përdorura në vendin autokton, në rastin tonë Shqipërinë,Greqine e lashte, mandej Anglinë, Amerikën dhe vendet e tjera anglishtfolëse. Për këtë arsye dhe për shumë të tjera proverbat janë shumë të vlefshme për studime me qëllime sociolinguistike. Për qëllimet tona, është e rëndësishme të themi se, proverbat përgjithësisht konsiderohen bashkime speciale frazeologjike. Në këtë kontekst, është thelbësore të nxjerrim në pah që

[21] Panajoti-Xhagolli, *Funksioni komunikativ i fjalëve të urta*, Tiranë 1983: 162.

kërkimet mbi studimin e proverbave nuk kanë dalë vetëm prej frazeologjisë, por edhe prej disiplinave të tjera shkencore, sidomos prej shkencës së letërsisë e veçanërisht prej letërsisë gojore e të folkloristikës.
Krahas këtyre përcaktimeve në folkloristikën botërore, veçanërisht kohëve të fundit, janë bërë përpjekje për përkufizimin e proverbave si një lloj i veçantë i krijimeve epike apo lirike, që dallohen me një përmbajtje të pasur, e cila në vetvete shpreh një mendim të caktuar, një gjykim të qartë, një vlerësim të lartë, një përgjithësim apo një përfundim të nxjerrë nga vëzhgimi i thellë i jetës dhe i përvojës historike-shoqërore të popujve.

KORRELIMI TREGTAR I EKONOMISË SHQIPTARE ME EKONOMI TË TJERA

Fjona Zeneli
Student Doktorature, FEUT, Tiranë
Lektor në FE, Universiteti „Ismail Qemali" Vlorë
fjona_zeneli@yahoo.com

Abstrakt

Tematika e shkallës së hapjes së një ekonomie përmes marrëdhënieve tregtare dhe impaktit të këtij faktori në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të saj është fushë e hulumtuar në shumë literatura. Lidhja teorike mes tregtisë mes vendeve dhe rritjes ekonomike është një çështje gjerësisht e debatuar në literaturat ekonomike. Studime teorike tregojnë për një lidhje komplekse mes dy variablave (Romer,1990; Matsuyama, 1992). Ky punim është ndërtuar për të vërtetuar lidhjet statistikore mes rritjes ekonomike të një vendi dhe tregtisë së hapur të tij, me evidencat e Shqipërisë. Punimi është ndërtuar mbi dy hipoteza-bosht që përmes programit statistikor të përpunimit të të dhënave SPSS, do vërtetohet rëndësia e tyre.

Abstract

The theme of the degree of openness of an economy through trade relations and the impact of this factor in the growth and development is a explored topic in different literature. Theoretical link between trade and economic growth among countries is an issue widely debated in economic literature. Theoretical studies indicate a complex relation between two variables (Romer, 1990; Matsuyama, 1992). This paper is built to prove statistical links between a country's economic growth and its open trade, with evidence of Albania. The paper is built on two-main hypothesis , through statistical program SPSS data processing will be proved their importance.

Fjalë kyçe: korrelim tregtar, bilanc tregtar, ekonomi në tranzicion, rritje ekonomike
Keywords: trade correlation, trade balance, transition economies, growth

1 Hyrje

Shqipëria ishte i fundit vend komunist në rajon që pas viteve ´90 hyri në ekonomi të hapur tregu, me marrëdhënie tregtare me shumë vende, ndryshe nga vitet e komunizmit, ku vendet me të cilat lidheshin marrëdhënie tregtare ishin të diktuara nga politika dhe filozofia e „vllazërisë“ mes vendeve komuniste. Si pjesë e Ballkanit, marrëdhëniet tregtare të Shqipërisë, gjatë periudhës së gjatë të tranzicionit, reflektojnë zhvillimin ekonomik të saj dhe shkallën e suksesit të përshtatjes me mjedisin e ri ekonomik pas viteve ´90. Shkalla e gjerë e marrëdhënieve tregtare janë rrjedhojë e politikave të ndjekura të tregut të lirë por normalisht reflektojnë edhe shkallën e konkurueshmërisë apo avantazhet krahasuese të Shqipërisë krahasuar me vendet e tjera të rajonit.

Në këtë punim fillimisht do shihet në kohë ecuria e eksporteve, importeve, bilancit tregtar të Shqipërisë për të kuptuar mënyrën se si ekonomia shqiptare është hapur drejt tregut rajonal e atij global. Vëmendje do i kushtohet edhe organizimit sipas sektorëve të marrëdhënieve tregtare për të kuptuar intensitetin dhe drejtimin e ndryshimeve strukturore në sektorët më produktivë të ekonomisë. Përmes një analize përshkruese dhe empirike (regresive), do përcaktohet shkalla e reagueshmërisë së ekonomisë shqiptare nga zhvillimi ekonomik i vendeve kryesore, partnerë tregtar të saj, përcjellë përmes zinxhirit tregtar.Ka shumë çështje të rëndësishme teorike lidhur me efektet e marrëdhënieve tregtare në zhvillimin dhe rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të rajonit, gjatë dekadave të fundit. Këto çështje lidhen me (mos)suksesin në manaxhimin e tronditjes së ekonomisë nga ndryshimi strukturor i saj (nga ekonomi e centralizuar komuniste në ekonomi tregu), me hapësirën që lejojnë ose jo marrëdhëniet tregtare një ekonomie, për të ruajtur strukturën e prodhimit dhe tregtisë, etj.

2 Marrëdhëniet tregtare: rishikim i përqasjeve teorike

Teori të njohura ekonomike e kanë trajtuar zhvillimin e marrëdhënieve tregtare mes vendeve- pra shkallën e liberalizimit të tregtisë ndërkombëtare- si një proçes i nevojshëm dhe i pashmangshëm që nën disa supozime dhe kushte rezulton me përfitime të rëndësishme ekonomike (dhe jo vetëm) për vendet (Krugman, 1987). Këto përfitime vijnë nga disa arsye:

Së pari, është specializimi i vendeve në degë për të cilat ato kanë një avantazh relativ konkurrues apo diferenca në disponueshmërinë, produktivitetin apo kostot e faktorëve të prodhimit. Normalisht çdo vend specializohet në produktet, për të cilat ka kosto të ulta prodhimi dhe importon ato produkte për të cilat kostot e prodhimit në vend janë të larta. Në këtë mënyrë, rritet efiçienca e ekonomisë, duke transferuar burimet produktive të prodhimit në industrinë e eksportit. Së dyti, ka faktorë të lidhur më tepër me konsumin se sa me prodhimin. Një rritje në standartin e jetesës rrit kërkesën e individëve për mallra të lira importi apo për shumëllojshmëri në konsum (produkte të diferencuara importi). Së treti ka faktorë të lidhur me qëndrueshmërinë dhe sigurinë në nivel rajonal apo ndërkombëtar. Vendet që kanë vendosur marrëdhënie tregtare me të tjera, rrallë e përfshijnë veten në konflikte, meqë ka

interesa reciproke në zgjidhjen më paqësore të çdo konflikti. Normalisht sa më intensive të jetë marrëdhënia tregtare mes dy vendeve, aq më e madhe ndërvarësia mes tyre, aq më i paktë është probabiliteti i zgjidhjeve jo-paqësore të konflikteve.

Të dyja teoritë, ajo klasike e tregtisë (Teoria Rikardiane) e cila bazohet në avantazhet relative konkurruese, ashtu dhe ajo moderne neo-klasike (Hecksher-Ohlin), e cila është e bazuar mbi kostot oportune, e konsiderojnë tregtinë mes vendeve me përfitime dhe promovuese të zhvillimit. Mbi këtë bazë teorike janë mbështetur të gjitha përpjekjet për të reduktuar tarifat dhe kufizimet doganore mes vendeve nga Organizata Botërore e Tregtisë (WTO). Gjithashtu dhe përpjekjet e krijimit të unioneve ekonomikë si EFTA (zona europiane e tregtisë së lirë) apo NAFTA (zona e Amerikës së Veriut e tregtisë së lirë), apo disa të ngjashme në Afrikë, Azi janë bazuar në këto teori të njohura nga literatura ekonomike e tregtisë mes vendeve.Megjithatë, perceptimi i përgjithshëm se tregtia e lirë mes vendeve sjell përfitime për të gjitha vendet pa përjashtim, është kritikuar gjerësisht. Në nivel empirik, modelet e tregtisë ndërkombëtare janë kritikuar sepse nuk marrin në konsideratë papërsosmëritë e tregut, efektet kumulative të ekonomive të shkallës në prodhim, apo roli i kostove të transportit apo pozicionit gjeografik në lidhjet tregtare (Krugman, 1995). Egzistenca e sistemeve të prodhimit që derivojnë nga forma e konkurrencës së plotë (monopolet, oligopolet) dhe zhvillimi i ekonomive të brendshme (të jashtme) të shkallës në proçeset e prodhimit, mund të çojë në marrëdhënie tregtare mes vendeve që nuk sjellin zhvillim të balancuar, por mund të derivojë në një proçes që të jetë ekonomikisht vetëm në favor të njërit vend.

Praktika ka treguar se mes vendeve me diferenca në zhvillimin ekonomik, vendet më pak të zhvilluara specializohen në produkte që kërkojnë forcë punëtore apo materiale të rralla, ndërkohë që vendet më të zhvilluara kanë avantazhe në produkte me përdorim intensiv të teknologjisë, kapitalit dhe njohurive. Kështu që liberalizimi i tregtisë mes dy vendeve që kanë nivele të ndryshme zhvillimi do i imponojë vendit më pak të zhvilluar ato forma të specializimit që në terma afatgjatë do kufizonin mundësitë e vendit për të zhvilluar ato degë të prodhimit që karakterizojnë vendet e zhvilluara (Petrakos, 2000). Si përmbledhje rezulton se edhe teoria dhe praktika mbështesin së pari se tregtia ndërkombëtare mund të jetë e dëmshme për vendet në zhvillim. Është e qartë se asnjë vend nuk mund të jetë vet-sufiçient. Rasti i Shqipërisë e izoluar për katër dekada rradhë, e cila gjeneroi një nivel mungese mes popullsisë, rast ky i padokumentuar në asnje vend tjetër komunist të Europës e dëshmon më së miri. Izolimi pati kostot e veta.

3 Rishikimi i literaturës

Lidhja teorike mes tregtisë mes vendeve dhe rritjes ekonomike është një çështje gjerësisht e debatuar në literaturat ekonomike. Studime teorike tregojnë për një lidhje komplekse mes dy variablave (Romer,1990; Matsuyama, 1992). Nqs vendet partnerë tregtarë janë vende asimetrike (jo me të njëjtin zhvillim),

tregtia mes tyre mund të mos sjellë të njëjtat efekte ekonomike për ta (Grossman, 1991; Young 1991). Gjithashtu literatura ka evidentuar edhe ndryshime në efektet që sjellin barrierat tregtare dhe volumi tregtar në rritjen ekonomike (variabla këto të korreluara mes tyre). Kjo sepse ka dhe faktorë të tjerë ndikues në këtë lidhje si : faktorët gjeografikë, madhësia e ekonomisë, të ardhurat e individëve. Tabela mëposhtë është një përmbledhje e punimeve referuese:

Tabela 3.1: Autorë që kanë studiuar tematikën

Studiuesit	Tematika	Përfundimet
Anderson dhe Neary, 1992	Matja e „hapjes së një ekonomie“	Indeksi i kufizimit të tregtisë u krijua duke mbledhur efektet e barrierave tarifore dhe jo tarifore. Jo i vlefshëm për zgjedhje të madhe.
Sachs dhe Wamer, 1995	Matja e „hapjes së një ekonomie“	Indeksi= (Importe+ Exporte)/GDP
Harrison, 1996	Lidhja mes pjesës së tregtisë mbi GDP-në dhe rritjes ekonomike	U gjet një lidhje positive e fortë mes variablave.
Rodriguez dhe Rodrik, 2001	Lidhja mes tregtisë dhe të ardhurave	U gjet lidhje e rëndësishme statistikore, në regresion u përfshinë edhe variabla institucionalë dhe politikë.
Edwards, 1993	Eksportet përballë importeve	Dy variablat duhet të shihen si komplementare, jo si alternativa të ndara.
Sachs dhe Wamer,1997	Dendësia e popullsisë dhe tregtia e lirë.	Vendet me dendësi të lartë tëpopullsisë tentojnë të jenë ekonomi më tëhapura se të tjerat.
Lee, 1993; Harrison,1996;	Tarifat doganore dhe rritja ekonomike	U gjet një lidhje e rëndësishme negative mes variblave.

Burimi: Rishikim kritik i literaturës nga autori

3 Ekonomia shqiptare dhe marrëdhëniet tregtare

Shqipëria u bë vendi anëtar i 138- të me të drejta të drejta të plota në Organizatën Botërore të Tregtisë (WTO) që prej vitit 2000. Sipas statistikave, rreth 70% e totalit të exporteve të vendit janë të destinuara për vendet e Bashkimit Europian. Ky përqëndrim i tregut e bën vendin shumë të ndjeshëm nga ndryshimet ekonomike të partnerëve të tij tregtarë. Eksportet janë të përqëndruara në një numër të vogël sektorësh. Industria fasone zë 1/3 e totalit

të eksporteve, dhe 1/3 tjetër e zë mineralet, gazi, hekuri, çeliku.[1] Prej vitesh vendi vuan nga një defiçit i gjerë tregtar, me vlerë të importeve sa afërsisht tre herë vlerën e exporteve[2]. Në figurën më poshtë jepet një paraqitje grafikore e ecurisë së eksporteve, importeve dhe bilancit tregtar të Shqipërisë nga viti 1998-2012. Vihet re një bilanc tregtar negativ gjatë gjithë periudhës, ritmi i rritjes së importeve (piku është arritur në vitet 2008, 2011), ka qenë disa herë më i madh se ritmi i rritjes së eksporteve (vlerat më të larta janë arritur në vitet 2011-2012).



Figura 3.1: Eksport-Importet e Shqipërisë, në bln $, 1998-2012
Burimi : UN Comtrade

Bilanci tregtar rregjistroi një defiçit prej 2.9 bln$ në vitin 2012. Tregtia në këtë vit qe në defiçit me të gjitha vendet (shih figurën 3.2).



Figura 3.2: Bilanci tregtar mes vendeve, në bln $,2012
Burimi : UN Comtrade

[1] www.intracen.org/country/albania-full

[2] United Nations Development Assistance Framework for Albania Report ,2006-2010

[2] Hasimja, E. (2008). Teoritë e demokracisë. Shënime.

[3] The Universal Declaration of Human Rights. Art 21.

[4] OSCE/ODIHR, Venice Commission. (2011). Guidelines on Political Party Regulation. Poland: POLIGRAFUS. Fq, 20.

[5] Ligj Nr. 8580, datë 17.2.2000. "Për Partitë Politike" Republika e Shqipërisë. Neni 1.

në një program të caktuar, në synime, ideale, interesa të ndryshme nga konkurrentet e saj, në individë të cilët kanë të njëjtin mendim se si duhet të qeveriset shteti, çdo anëtar i cili e gjen veten në përputhje me idealet, interesat, aderon në radhët e saj.

Në çdo sistem politik, kur flasim për demokraci moderne do të flasim edhe për pluralizëm partiak, pluralizmi partiak është baza e shtetit shqiptar. Këtë vlerë madhore për ndërtimin e një shteti demokratik, kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e shpreh në nenin 3 të saj, "*Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues,* ***pluralizmi,*** *identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë".*[6] Karakteri demokratik i sistemit politik shqiptar, liria e veprimit dhe organizimit të tyre është shprehur gjithashtu edhe në nenin 3 të ligjit për partitë politike. *Partitë politike shqiptare janë pjesë e një sistemi të lirë e demokratik qeverisës në vend. Krijimi dhe veprimtaria e tyre është e lirë dhe e garantuar nga Kushtetuta.*[7]

Elementi bazë që mundëson përfaqësimin e popullit janë mekanizmat strukturorë, të njohura ndryshe si partitë politike, grupet e interesit, shoqatat, masmedia etj, të cilat shërbejnë si kanalet e komunikimit ndërmjet dy skajeve, elitës dhe shoqërisë. Në krye të piramidës do të qëndrojnë partitë politike, si arsenali më i plotë i përfaqësimit të vullnetit politik të popullit. Partitë politike si gate keepers krijojnë një lidhjen të fortë jetike ndërmjet shtetit dhe shoqërisë civile, qytetarëve dhe organeve kushtetuese midis institucioneve shtetërore dhe grupeve të interesit që veprojnë në shoqëri. Ekzistenca e tyre bën të mundur formësimin e vullnetit politik, pasi populli mund ta ushtrojë pushtetin e tij si Sovran, vetëm në mënyrë të organizuar dhe të strukturuar. *Partitë politike marrin pjesë në formimin e vullnetit politik të popullit në të gjitha fushat e jetës publike dhe kryesisht nëpërmjet: a) ndikimit në krijimin e opinionit publik dhe të edukatës politike; b) nxitjes së pjesëmarrjes aktive të shtetasve në jetën politike dhe evidencimin e aftësimit të shtetasve për të marrë përsipër përgjegjësi publike.*[8] Partitë politike ofrojnë kuadrin e nevojshëm që qytetarët të kategorizohen në përputhje me interesat dhe pritshmëritë e tyre, nëpërmjet programeve, përkatësisë dhe idealeve që mbron një parti politike e caktuar. Për të kuptuar më qartë pozicionimin e partive politike si ndërmjetës dhe bacgroundin në të cilën ato ndodhen shohim figurën e mëposhtme.

[6] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998. Neni 3.

[7] Ligj Nr. 8580, datë 17.2.2000. "Për Partitë Politike" Republika e Shqipërisë. Neni 3.

[8] Ligj Nr. 8580, datë 17.2.2000. "Për Partitë Politike" Republika e Shqipërisë. Neni 2.

Figura 1.



Partitë politike nuk janë aktorët e vetëm ndërmjetësues midis shtetit edhe shoqërisë, por ndryshe nga grupet e interesit, iniciativat qytetare, media etj partitë politike luajnë një rol të dyfishtë. Roli i tyre i legjitimuar nga zgjedhjet për afrimin e interesave të qytetarëve pranë institucioneve shtetërore dhe roli i formimit të vullnetit të përgjithshëm në organet shtetërore. Partitë politike si gatekeepers mbajnë në funksion qarkullimin e vazhdueshëm të komunikimit politik, si forcë shtytëse për transmetimin e kërkesave. Ato luajnë rol të rëndësishëm në formimin e vullnetit të popullit dhe formimin e vullnetit shtetëror duke qëndruar ndërmjet dy sferave. Kur diskutojmë dhe pohojmë lidhjen e ngushtë që ekziston ndërmjet partive politike dhe formimit të vullnetit të popullit duhet patjetër të sqarojmë që partitë politike nuk janë elementët e vetëm dhe sundues të këtij proçesi ata nuk e kanë monopolizuar situatën. Në formimin e vullnetit politik ndikojnë edhe shoqatat apo grupet e interesit, por diferenca është se ato nuk mund ta legjitimojnë pushtetin e tyre në mënyrë të ngjashme me partitë politike.

Për një funksionim dhe ushtrim të veprimtarisë së tyre është e rëndësishme edhe mënyra e organizimit të partive politike. Në lidhje me organizmin e partive politike neni 9 i kushtetuës së Republikës së shqipërisë shpreh se: *Partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike. Partitë politike dhe organizatat e tjera, programet dhe veprimtaria e të cilave mbështeten në metoda totalitariste, që nxitin e përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdorin dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore, si edhe ato me karakter të fshehtë janë*

të ndaluara sipas ligjit. Burimet financiare të partive, si dhe shpenzimet e tyre bëhen kurdoherë publike.[9]

Rëndësia e organizmit sipas parimeve demokratike shoqërohet edhe me financime të ligjshme të tyre, pasi një element i rëndësishëm që kërcënon legjitimitetin e qeverisjes dhe që nxit rënien e besimit publik është financimi i paligjshëm i partive politike. Një fenomen ky shumë i përhapur dhe prezent në demokracitë europiane. Përcaktimi i ligjshmërisë, apo se çfarë konsiderohet e ligjshme është e përcaktuar në legjislacionet kombëtare dhe e ndryshme në vënde të ndryshme. Të ardhurat janë të paligjshme kur ato mund të vijnë nga organizata, qeveri apo kompani të huaja me qëllime tendencioze, nga krimi i organizuar, nga të ardhura të parregjistruara dhe të paligjshme. Partitë politike si person juridik disponojnë pasuritë për ushtrimin e aktivitetit të tyre dhe burimet financiare të tyre përbëhen nga:

1. Kuotat e anëtarësisë;
2. Çdo pasuri e fituar në mënyrë të ligjshme;
3. Të ardhurat nga veprimtaria ekonomike e socialkulturore;
4. Ndihma financiare në masën e caktuar në buxhetin e shtetit, të miratuar me ligj nga Kuvendi Popullor.[10]

Partitë politike janë të llojeve të ndryshme, ato ndryshojnë nga njëra-tjetra për nga mënyra e organizimit, tipologjia, ideologjia së cilës ato i përkasin etj. Po t'i referohemi partive politike në shqipëri ajo që do të dilte në pah do të ishte se për një vënd të vogël si shqipëria numri i partive politike do të ishte shumë i madh. Po të bëjnë një analizë të partive politike si subjekteve në proçeset zgjedhore do të shohim se në zgjedhjet e fundit në 2013 do të merrnin pjesë 68 parti duke përfshirë edhe 1 parti e kthyer me vendim të kolegjit, PESh. Parti të cilat ndoshta të ndryshme nga programet e tyre politike por jo shumë të ndryshme nga pikpamja ideologjike dhe mbrojtjes së idealeve, dhe kjo përfshin edhe dallimet e spektrit politik të majta dhe të djathta. Ku përherë e më tepër dallimet ideologjike homogjenizohen, dallimet e identitetit të partive politike përafrohen, duke shmangur përfaqësimi i një shtrese të caktuar të popullsisë, element bazë i teorive politike dhe duke u futur në kategorinë e quajtur "*catch all parties"* (parti gjithpërfshirëse) të prirura drejt koalicioneve duke kërkuar edhe mbështetjen e të gjithë shoqërisë dhe jo ndonjë klase apo grupi të veçantë shoqëror.

Në mënyrë që partitë politike t'i shërbejnë dhe funksionojnë në një sistem demokratik dhe në mënyrë që ato të rezultojnë të suksesshme në qëllimet e tyre duhet të mbështeten dhe përbëhen nga funksione dhe parime. Funksionet e partive politik janë përcaktuar ndryshe nga autorë dhe kërkime të ndryshme, një studim i Fondacionit Konrad Adenauer Stiftung[11] ka përcaktuar gjashtë funksione kryesore të partive politike. Le të njihemi me këto koncepte duke parë tabelat e mëposhtme.

---

[9] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998. Neni 9.

[10] Ligj Nr. 7491, datë 25.07.1991. "Për Partitë Politike" Republika e Shqipërisë. Neni 18.

[11] Hofmeister, W. and Grabow, K. (2011). Political Parties Functions and Organisation in Democratic Societies. Konrad Adenauer Stiftung. Singapore. Fq, 16.

Figura 2.



Figura 3.



3. Drejtësia dhe diskursit politik, kusht për përfaqësimin politik të qytetarëve

Sipas Rouls një shoqëri është e rregulluar mirë në qoftëse është e ndërtuar dhe vepron sipas parimeve të drejtësisë "drejtësia është virtyti i parë i institucioneve sociale". Rëndësinë që shpalos drejtësia dhe respektimi i ligjit e mbron më mirë Sokrati i cili megjithëse e dinte se ishte dënuar padrejtësisht i bindej ligjeve të qytetit të tij. Ai thoshte se ligjet janë nëna dhe babai im dhe se ekzistencën e vet ai ia dedikonte polisit dhe ligjeve.[12] Dekarti po ashtu në veprën e tij "Bisedë për Metodën" thekson rëndësinë e bindjes së ligjeve dhe zakoneve të vëndit tij.[13] Koncepti dhe rëndësia e drejtësisë janë themelore për shtetin demokratik dhe për të drejtat e njeriut, pa një sistem të drejtësisë kurrsesi pushtetin nuk do ta kishte populli dhe përfaqësimi do të legjitimohej

[12] Hersh, Zh. (1993). Habia filozofike. Tiranë: Dituria. Fq, 17.
[13] Dekart. (1997). Bisedë për Metodën. Tiranë: Elena Gjika. Fq, 23.

nga diktatori. Kur thuhet se pushteti është i popullit, përcaktohet një koncept për burimet dhe për legjitimitetin e pushtetit. Në këtë aspekt pushteti është legjitim vetëm kur jepet nga poshtë, vetëm nëse është një shprehje e vullnetit të popullit.[14]

Një shtet ligjor në një sistem demokratik është kusht që përfaqësimi i qytetarëve të realizohet mbi bazën e premisave që vet qytetari cakton. Themelet e legjitimitetit nuk japin vërtetësi, japin një të drejtë. Populli ka gjithmonë të drejtë jo në kuptimin që nuk gabon kurrë, po në kuptimin që ai ka gjithmonë të drejtën të gabojë dhe se e drejta për të gabuar i takon atij që gabon për vete, në dem të vet.[15] Në rast se populli shqiptar gabon në zgjedhjen e përfaqësuesve kjo është përgjegjësia e tij (popullit) që i ka zgjedhur, dhe dëmet e asaj zgjedhje do vazhdojnë deri në zgjedhjet e reja. Pikërisht për këtë arsye klasa politike duhet të punojë nëpërmjet dialogut, informimit, bisedimeve me qytetarët dhe t'u sigurojë atyre transparencë dhe ligjshmëri, për zgjedhje të drejta në të ardhmen.

Siç e përmëndëm edhe më sipër pa drejtësi nuk ka përfaqësim legjitim, pa respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejtën e votës, të shprehjes, zgjedhje të lira dhe të ndershme, lirinë e veprimit të medias etj, nuk do të kishte përfaqësim të legjitimuar. Shoqëria shqiptare një shoqëri që ka përjetuar ndryshime drastike në sistemin politik, një shoqëri e cila mund të themi se është në momentet e fundit të një tranzicioni të gjatë dhe problematik. Një shoqëri e cila disponon kuadrin ligjor të nevojshëm, klasën politike të maturuar por problematike, pjesmarrje të popullsisë në zgjedhje por jo në raportin 100%. Përveç problemeve të tjera që mund të ketë shoqëria shqiptare, ajo çalon edhe në komunikimin ndërmjet elitës dhe shoqërisë, në diskursin politik.

Diskurs është i ndikuar nga klima politike, niveli i klimës politike kushtëzon edhe nivelin e diskursit politik. Duke iu referuar raporteve të organizatave ndërkombëtare, shpeshherë në të kaluarën vëndi ynë karakterizohej nga një klimë politike me nivele të larta të armiqësisë partiake. Nivel i ulët i diskutimeve publike për çështje thelbësore, dhunë episodike në periudhën para e pas-zgjedhore dhe konflikte partiake për rezultatet zyrtare që u përhapën si metastaza në konfliktin e gjatë politik ndërmjet qeverisë dhe partive opozitare.[16] Për më tepër Institutit Demokratik Amerikan (NDI) në Deklaratën për Misionin e Vlerësimeve parazgjedhore në Shqipëri përcaktoi se klima politike shqiptare karakterizohet nga elementët e mësipërm në ciklet zgjedhore para zgjedhjeve të fundit në Shqipëri (2013). Sepse së fundmi ndjesia e dallueshme e publikut për t'u përfshirë më shumë në dialogun me partitë politike, dhe si rezultat treguesit premtues se partitë politike po përfshijnë diskutimet e politikave në fushatat e tyre, kanë nxitur një klimë politike më dinamike se sa në ciklet e kaluara.[17]

Ligjërimi politik është ai i cili formon ndërgjegjjen politike të popullit, kulturën politike, pjesmarrjen dhe angazhimin e tij në politike, si rrjedhojë e këtij formimi shpesh herë opinion publik në shqipëri e percepton klasën politike si të papjekur politikisht kjo si rrjedhojë e ligjërimit politik ndaj palëve, akuza të ndërsjellta fyerje, jo bashkëpunim etj. Analisti Bendi Kajsiu thekson se shoqëria shqiptare paraqet krizë të përfaqësimit e cila vjen si pasojë e faktit se secila nga dy partitë kryesore e artikulon "popullin" në raport me një kërcënim që trupëzohet nga kundërshtari politik, çka prodhon edhe nivel të lartë konflikti.

---

[14] Sartori, G. (1998). Ç'është demokracia. Tiranë: Dituria. Fq, 22.

[15] Sartori, G. (1998). Ç'është demokracia. Tiranë: Dituria. Fq, 23.

[16] NDI.Deklaratë misioni i vlerësimit parazgjedhor në shqipëri. Mars 22, 2013

[17] Ibid

Kjo bën që qytetarët të tjetërsohen nga proçesi dhe partitë politike duke e bërë edhe më të vështirë për këto të fundit të përfaqësojnë subjektet ekzistuese apo të sendërtojnë subjekte të reja. Sa më pak shoqëria dhe grupe brenda saj artikulohen nëpërmjet procesit politik apo partive politike, aq më shumë ato formësohen në kundërshtim me to. Për pasojë ligjërimi anti-politik.[18] Partitë politike dhe liderët janë protagonistët kryesorë për të formuar në mënyrë dinjitoze diskursin politik i cili informon qytetarët të bëjnë zgjedhjen e duhur dhe të legjitimojnë përfaqësimin.

Partitë politike mund të nxitin besimin publik në proçesin zgjedhor duke u dhënë mundësi votuesve që të bëjnë zgjedhje të informuara. NDI jep rekomandime për mënyrën se si duhet të veprojnë partitë politike. a) Partitë politike duhet të komunikojnë me njëra-tjetrën në mënyrë konstruktive, përmes debateve neutrale, të moderuara dhe forumeve të tjera të ngjashme, të nxjerrin në pah dallimet mes tyre për sa i përket politikave thelbësore dhe çështjeve politike, dhe të heqin dorë nga fjalimet dhe sjelljet e tjera që denigrojnë kundërshtarët dhe ulin besimin e publikut te procesi politik. b) Partitë politike duhet të zgjerojnë dhe të thellojnë komunikimin e politikave të tyre te qytetarët në mënyrë që t'u japin një vizion se si mund të minimizohen pengesat sociale dhe ekonomike dhe të rriten mundësitë. c) Partitë politike nuk duhet të ofrojnë përfitime materiale të drejtpërdrejta për qytetarët në këmbim të votës.

4. Konkluzione

Ky punim nxjerr si problematikë ekzistencën apo jo të një përfaqësimi të ligjshëm dhe sa më dinjitoz të shoqërisë, popullit shqiptar në instancat më të larta të shtetit. Kjo problematikë mund të eleminohet vetëm me mbarëvajtjen e dy sferave të veçanta, një është ajo e elitës, përfaqësuese e popullit dhe tjetra është sovrani, masa e shoqërisë. Konkluzionet e rëndësishme në të cilat ka arritur ky studim është evidentimi i faktorëve të cilët do të mundësojnë ose do të cënojnë përfaqësimin e ligjshëm të popullit. Identifikimi i këtyre faktorëve na bën të kuptojmë se çfarë është e rëndësishme për arritjen e një përfaqësimi politik të legjitimuar. Faktorët që garantojnë dhe bëjnë të mundur përfaqësimin politik të vullnetit të popullit do t'i klasifikojmë në disa grupime në varësi të fushës të cilët ata i përkasin.

Një grupim do të përmbledhë faktorë që do t'i referohen sferës së elitës, thelbi i të cilës do të jenë organizatat politike. Përfaqësimi do të realizohet vetëm nëse do të kemi:

- Ekzistencën e një sistemi demokratik
- Ekzistencën e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme
- Ekzistencën e financimeve të ligjshme të partive politike
- Standarde demokratike në proçeset e fushatave elektorale

Kjo përsa i përket organizatave politike dhe proçeseve zgjedhore, pra drejtësia që duhet të mbartin në vetvete veprimet e asaj pjese të shoqërisë e cila kategorizohet si elitare dhe përgjegjëse për të ardhmen e shoqërisë.

Në një grupim tjetër do të jenë ato faktorë të cilat do të përfshijnë shoqërinë, sepse pa përkushtimin dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë vullneti i tyre nuk do të vihej kurrë në zbatim. Që një përfaqësim politik të jetë sa më legjitim është e nevojshme ekzistenca:

- E nje diskursi politik, dialogu ndërmjet palëve
- E vetëdijes politike të popullsisë shqiptare
- Shoqëria civile aktive dhe vepruese

[18] Kajsiu, B. Kriza e Përfaqësimit: I Gjithë Faji është i Politikës.

- Pjesmarrje, angazhim dhe reagim i shoqërisë
- Komunikim politik ndërmjet dy sferave të shoqërisë, elitës dhe masës
- Artikulim i interesave të shoqërisë mbi përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien që duhet të karakterizojë vendimmarrësit.

Por grupimi më i rëndësishëm do të jetë ai i përfshirjes së parimeve të drejtësisë dhe shtetit ligjor. Faktorët më të rëndësishëm që duhet të ekzistojnë janë ata faktorë që i referohen ekzistencës së drejtësisë, ligjit, për këtë arsye është e rëndësisshme ekzistenca e:

- Një sistemi të drejtësisë i cili mbron të drejtat e njeriut
- Një sistemi të drejtësisë i cili mbron të drejtat politike
- Një sistemi të drejtësisë i cili mbron dhe garanton të drejtën e votës

Për t'i dhënë temës rëndësinë e merituar e mbyllim duke pohuar se **legjitimiteti ekziston atëherë kur ai vjen vetëm nga poshtë**.

5. Bibliografia

Berlin, Isaiah (1996): *Idetë filozofike të shekullit XX dhe katër ese për lirinë,*

Onufri, Tiranë, përkthyes Bashkim Shehu.

Budge, I. "Electoral volatility: Issue effects and basic change in 23 post-war

democracies" 1." Electoral Studies 1(2). 1982

Dahl, R. (2005). *Poliarkia – pjesëmarrja dhe opozita.* Tiranë: Pegi.

Dalton, R. J. (2002). "Political cleavages, issues, and electoral

change." Comparing democracies 2.

Dekart. (1997). Bisedë për Metodën. Tiranë: Elena Gjika.

Hasimja, E. (2008). Teoritë e demokracisë. Shënime.

Hersh, Zh. (1993). Habia filozofike. Tiranë: Dituria.

Hofmeister, W. and Grabow, K. (2011). Political Parties Functions and

Organisation in Democratic Societies. Konrad Adenauer Stiftung. Singapore.

IDEA / "Handbook "Funding of Political Parties and Election Campaigns"

http://.idea.int/publications/funding_parties/index.cfm

Ikonomi, L. (2010). Filozofia e së drejtës. Tiranë: Onufri.

Kajsiu, B. Kriza e Përfaqësimit: I Gjithë Faji është i Politikës.

Kitschelt, H. (2010). "The Comparative Analysis of Electoral and Partisan

Politics: A Comment on a Special Issue of West European Politics." est European

Politics 33(3)

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë.

Krasniqi, A. (2007). Partitë Politike. Nocione politike. Shënime.

Krasniqi, A. (2009). "Zgjedhjet në Shqipëri 1991-2008", Tiranë.

Krasniqi, A. (2010) "Zgjedhjet dhe administrimi zgjedhor në Shqipëri". Tiranë:

AFR/AIIS.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998.
Ligj Nr. 8580, datë 17.2.2000. "Për Partitë Politike". Republika e Shqipërisë.
Lijphart, A. (1984). "Democracies: Patterns of majoritarian and consensus government in tëenty-one countries."
NDI. Deklaratë misioni i vlerësimit parazgjedhor në shqipëri. Mars 22, 2013.
ODIHR website, "Legislative support", at: <http://www.osce.org/odihr/43613>.
OSCE/ODIHR, Venice Commission. (2011). Guidelines on Political Party Regulation. Poland: POLIGRAFUS.
Pitkin, H.D. (1967). The Concept of Representation. Berkeley and Los Angeles: University of California Press.
Refah Partisi (The welfare Party) and Others v. Turkey (40/1993/435/514) (European Court of Human Rights, February 13, 2003), paras. 87-89.
Sartori, G. (1998). Ç'është demokracia. Tiranë: Dituria,
Stumpf, S. *Filozofia.* Tiranë: Toena.
The Universal Declaration of Human Rights.

FJALORI DHE NDIKIMI I TIJ NË MËSIMIN E GJUHËS ANGLEZE

PhD Kozeta Hyso
Departamenti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti " IsmailQemali' Vlorë
E-mail: kozetahyso1@gmail.com

Abstract

Vocabulary is one of the three main elements in a certain language (words, pronunciation, and grammatical content). Therefore, it is important to argue how influentialisteachinginstructedvocabulary in education and more precisely in our classes.
Taking in consideration the new tendencies, which give priority to the idea that the spontaneous form of learning vocabulary is the key to success in enhancing language awareness, questionnaires and surveys show that, instructed vocabulary teachingis in the top position.

Abstrakt

Fjalori është një nga tre elementët bazë të çdo gjuhe (fjalëve, shqiptimit dhe përmbajtjes gramatikore). Gjithsesi, është e rëndësishme të evidentojmë mësimdhënien e udhëzuar të tij, në tërësi, sidomos në klasë.
Duke marrë në konsideratë, prirjet e reja, të cilat mbështesin idenë se i mësuari rastësor i fjalorit, është çelësi i suksesit në përsosjen e vetëdijesimit gjuhësor, çështjet dhe analizat e bëra, i japin mësimdhënies së udhëzuar të fjalorit, rolin e rëndësisë së veçantë.

Keywords: Vocabulary, spontaneous, instructed, strategies, effective, students, survey, languageawareness..

Mësimi i rastësishëm dhe i udhëzuar i fjalorit

Shumë studime janë bërë mbi përkufizimin e të mësuarit të fjalorit në mënyrë rastësore. Nation (2001;232),[1] i referohet të mësuarit të rastësishëm pa një qëllim specifik, si strategji për të mësuar fjalorin. Një person mund të zhvillojë

[1]Nation,I. S. P. (2001). Learning Vocabulary in Another Language. Cambridge: Cambridge University Press

aftësinë e përvetësimit të fjalorit duke u futur në kontakt me gjuhën dhe veçanërisht me pjesët e leximit. Meara e vendos mësimin e fjalorit në kategori të ndryshme. Në opinionin e tij, i mësuari rastësor është produkt i të mësuarit krejt tjetër nga ai i të mësuarit të udhëzuar, i cili hartohet nga mësuesit apo nga vet studentët.

Disa e përkufizojnë mësimin rastësor të fjalorit, si diçka që mësohet pa i dhënë rëndësinë e duhur anës gramatikore apo gjuhësore dhe duke u përqendruar te format komunikuese të përgjithshme, pa specifikuar forma të veçanta. Nga këndvështrimet e përmendura më parë, i mësuari rastësor i fjalorit mund të përcaktohet si metodë e të mësuarit nga leximi, dëgjimi, i foluri apo i shkruari, ku vëmendja kryesore e studiuesve të gjuhës fokusohet në informacionet e pjesëve apo të gjithë tekstit. Kjo metodë përfshin mësimin nga i lexuari aktiv, marrjen pjesë në biseda, dëgjimin e historive, shikimin e filmave, pra shfrytëzimin e të gjitha mundësive të kontaktit me gjuhën, si në klasë dhe jashtë saj.(Nation 2001;232).

Nga ana tjetër mësimi i fjalorit, i udhëzuar nga mësuesi është forma tradicionale. Elliot e quan atë, metodë të planifikuar të mësimit të fjalorit, e shënjuar për të përzgjedhur detyrat e planifikuara më parë nga mësuesi. Ndërsa (Schmid 2000-120)[2] demonstron se ai është një formë e të mësuarit të përcaktuar më parë, që kryesisht e përqendron vëmendjen te informacioni që do mësuar. Megjithëse ai përcakton mundësitë më të mëdha për përvetësimin e tij, si formë e vështirë e të mësuarit, pasi bazohet në anën mekanike.

Por në vazhdim të kësaj, fjalori i mësuar në klasë ka në qendër mësuesin. E thënë në përgjithësi, mësimi iudhëzuar i fjalorit është një metodë që përdor mjete që kanë të bëjnë direkt me mjete e mësimit të kuptimit të fjalëve, që mund të jenë fjalorë, lista fjalësh të shkruara apo shpjegime të drejtpërdrejta të fjalorit. Ka një marrëdhënie të caktuar midis mësimit të udhëzuardhe atij rastësor të fjalorit.

Të dy, si i mësuari i fjalorit në mënyrë të qëllimshme ashtu dhe ai rastësor kanë avantazhet dhe kufizimet e veta. I mësuari rastësor i fjalorit ndodh me ato grupe njerëzish që kanë njohuri të avancuara të gjuhës, ndërsa i mësuari i udhëzuar kështillohet në ata që janë fillestar në mësimin e gjuhës.(Laufer&Hulstijn 2001,1-26)[3]. Megjithëse i mësuari rastësor i fjalorit besohet të jetë më efikas, ushtrimi i vetëm i tij në klasë bëhet i vështirë pasi kërkonshumë kohë dhe për rrjedhojë përdorimi i tij bëhet i ngadalshëm e gradual.

Aktualisht çdo klasë e mësimit të gjuhës i përdor të dyja format, duke i parë ato të pandashme. Nuk mund të ndjehesh i plotësuar në mësimdhënien e fjalorit nëse ke realizuar vetëm një aspekt të mësimit të tij. Ashtu siç funksionon tradicionalisht, në fillim mësuesi jep fjalët e reja, më pas i shpjegon ato në gjuhën amtare dhe pas kësaj ai jep ushtrime të caktuara për të parë aplikimin e këtyre fjalëve në situata praktike. Këto hapa janë kategorizuar si forma të mësuarit, të qëllimshme të fjalorit. Mësuesit i lënë studentët të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, me qëllim që të përdorin fjalët e mësuara dhe kjo formë

[2]Schmitt, N. (2000). Vocabulary in language teaching. Cambridge: Cambridge University Press.

[3]Laufer, B., &Hulstijn, J. (2001). Incidental Vocabulary Acquisition in a Second Language: the Construct of Task-induced Involvement. Applied Linguistics,

konsiderohet si i mësuari rastësor i fjalorit. Sipas vëzhgimeve në situata reale, mësuesit i përdorin të dyja format në mënyrë të ndërgjegjshme apo edhe rastësisht.

Po kështu ka një marrëdhënie midis mësimit rastësor të fjalorit dhe faktorëve rastësor dhe të qëllimshëm. Te studiuesit e gjuhës së huaj mungesa e kontakteve me anglisht folësit bënë që ata të ndjejnë mangësi të progresit të tyre në këtë proces dhe nganjëherë kjo gjë bëhet shkak i mos suksesit të tyre në gjuhën përkatëse. Mënyra më e mirë është kontakti me njerëzit që e kanë anglishten gjuhën e tyre amtare, pra në rrethana praktike. Megjithatë shumica prej tyre nuk e kanë këtë mundësi. Në këto kushte palët e interesuara, në rastin konkret mësuesit dhe studiuesit e gjuhës duhet të krijojnë vetë mundësitë, tjera duke punuar shumë me tekste që të jenë të ekspozuar ndaj fjalorit dhe marrjes së njohurive, me larminë e fjalëve të reja dhe përdorimin e tyre në kontekste sa më të gjëra.

Krashen (1989,440-464)[4] thekson dhe beson në idenë që për ti dhënë forcën e duhur mësimit të fjalorit, duhet të merremi më shumë më tekste që mbartin interes, janë të kuptimshëm dheme të tillë tekste të zëvendësojmë pjesët gramatikore. Në pohimet e Krashen(1989,440-464) gjejmë rëndësinë që ai i jep pikërisht teksteve të kuptimshëm dhe atyre që ngjallin interes në mësimin e gjuhës së huaj. Pra, pa kuptimin e plotë të termave të fjalorit, procesi përvetësimit të gjuhës nuk mund të ndodhë. Ai rekomandon që një fjalor i larmishëm dhe i gjerë duhet tu vihet në dispozicion studiuesve të gjuhës, me qëllim që ata te ecin drejt perfeksionimit të saj.

Krashen(1989,440-464)[5] në sugjerimin e tij pedagogjik këshillon që studiuesit e gjuhës duhet të bëjnë vetë lexime të konteksteve të ndryshme, pasi kjo influencon direkt si një lloj i mësuari rastësor. Pas disa studimeve që (Swain 2005,471-474)[6] bëri në klasa të ndryshime të mësimit të gjuhës së huaj theksojë idenë, që faktorët e jashtëm që nxisin kuptueshmërinë janë më të rëndësishëm në përvetësimin e fjalorit se sa faktorët e brendshëm, që do të thotë që, me gjithë rëndësinë që kanë faktorët e brendshëm të udhëzuar nga mësuesit, ato nuk janë të mjaftueshëm për perfeksionimin e përvetësimit të fjalorit.

Hipotezat mbi faktorët e jashtëm të kuptueshmërisë, orientojnë studiuesit e gjuhës që të mos ti japin rëndësinë e duhur anës sintaksore të gjuhës, por të rendin pas njohjes të kuptimit. Megjithatë, kur studentët flasin ata duhet të përpiqen të modifikojnë shprehitë e tyre, që të bëhen të kuptueshëm për bashkëbiseduesin. Pikërisht gjatë këtij procesi, ata mund të mësojnë fjalorin, duke përfshirë kuptimin, gramatikën, pra në formën e të mësuarit rastësor. Nëse studiuesit e gjuhës duan të fitojnë profesionalizëm, duhet të praktikojnë më shumë vetveten në përdorimin e formave të ndryshme foljore, në mundësinë e kooperimit me të tjerët në formë bisedash. Patjetër që studiuesit

---

[4]Krashen,,S., 1989. We acquire vocabulary and spelling by reading: Additional evidence for the input hypothesis. Modern Language Journal

[5]Krashen,,S., 1989. We acquire vocabulary and spelling by reading: Additional evidence for the input hypothesis. Modern Language Journal

[6]Swain, M. (2005). The output hypothesis: Theory and research. In E. Hinkel (Ed.), The hand book of research in second language teaching and learning (pp. 471-483). Mahwah, NJ: Lawrence Erlbaum

mund të perfeksionohen më shpejt në një gjuhe të dytë, nëse ata do të kenë mundësi ta praktikojnë atë me folës që e kanë këtë gjuhë amtare.
Ka edhe një lidhje midis të mësuarit rastësor të gjuhës me fjalorë dhe të mësuarit të pavarur. Sipas saj, studiuesit janë autodidakt, me një qëndrim pozitiv për atë që bëjnë, plotësisht të ndërgjegjshëm, me një kapacitet për reflektim dhe me një gatishmëri për t´u vetë menaxhuar. Me fjalë të tjera studiuesi autodidakt di çfarë të mësojë, si të mësojë, kur të mësojë dhe të marrë përgjegjësi për atë që bënë. Vetë menaxhimi është një proces konstruktiv dhe aktiv, ku studiuesit vendosin objektiva për arritjet e qëllimit që i kanë vënë vetes, përpiqen të monitorojnë veten, njohuritë e tyre, të motivohen dhe përshtaten në shërbim të tij. Zakonisht janë gjashtë karakteristika kryesore të mësuarit të pavarur sipas (Hedge 2000,76)[7] Studiuesit duhet të dinë:

1. Të shfrytëzojnë të dy variantet e të mësuarit brenda dhe jashtë klasës
2. Të përballen me informacionin.
3. Të kenë një mendim kritik dhe aktiv për mësimin
4. Të mos kufizohen vetëm në një tekst të dhënë, por të vlerësojnë dhe të zgjedhin tekstin e duhur për tu thelluar më shumë.
5. Të përshtatin strategjitë e mësuara për të përmirësuar efektet.
6. Të jenë të aftë të organizojnë kohën dha ta bëjnë atë sa më efektive.

Marrëdhëniet midis të mësuarit rastësor dhe bashkëpunimit në aktivitetet në klasë janë të rëndësishme. Për një kohë të gjatë teoritë e bashkëpunimit në klasë kanë qenë produktive. Piaget 1999:159)[8] ka qenë i bindur që mësimi i gjuhës së huaj varet shumë nga bashkëpunimi i realizuar si në një situatë reale. Kjo do të thotë që zhvillimi i të kuptuarit njohës ndërtohet në një kooperim midis studiuesit dhe gjërave që mund të shikohen.
Një tjetër linguist Vigotsky (1978,The Development of Higher Psychological Processes 123)[9] insiston në marrëdhëniet midis personave. Ai del në përfundimin që gjuha zhvillohet kryesisht nga një bashkëpunim shoqëror midis njerëzve në një ambient favorizues e mbështetës, që i nxit studiuesit drejt një perfeksionimi të mëtejshëm të saj. Sipas teorisë së tij, bashkëpunimi përfshin të gjitha bisedat e zhvilluara midis studiuesve e të tjerëve në situata të caktuara.
Megjithatë për shumicën e studiuesve të gjuhës së huaj kjo mundësi është e pakët (bashkëpunimi me folës të kombit përkatës) kështu që mundësia e tyre e vetme është bashkëpunimi brenda klasës, dëgjimi i të tjerëve, debati për çështje të ndryshme, ndarja e mendimeve me ta etj. Përmes këtij lloj bashkëpunimi studentët rrisin mundësinë e zgjerimit të fjalorit, kur ata dëgjojnë apo bisedojnë me njëri tjetrin. Bashkëpunimi mbetet kryesor në zgjerimin e njohurive të fjalorit në një gjuhë të huaj. Janë dy lloj bashkëpunimesh në klasë, mësues–student dhe student-student. Këto bashkëpunime realizohen në katër forma kryesore (Lightbown & Spada (1999,116-128).[10]

---

[7]Hedge Teaching and learning in the language classroom 2000
[8]Piaget, Jean. "The Language and Thoughtof the Child." Ed Martins Fontes Pedagogy. 1999.
[9] L. S. Vygotsky The Development of Higher Psychological Processes, 1978
[10]Lightbown, P. And Spada, N. (1999) How Languages are Learned. NewYork: Oxford University Press. Second Edition.

1. Si fillim merren reagimet për gabimet. Kur studentët bëjnë gabime gjatë komunikimit, ata reagojnë ndaj bashkëbiseduesit. Specifikohet gabimi i konstatuar dhe bashkëbiseduesi ja vë në dukje folësit, duke e korrigjuar atë menjëherë.P.sh. *:" i readed a bookyesterday".* Koha e shkuar e read është read,përsëri dhe kjo i vihet në dukje folësit. Ndryshimi ka të bëjë me ndryshimin e të gjithë ligjëratës të folësit duke shmangur tërësisht gabimet. P.sh.:
   Whatyoulikebest?
   What do youlikebest?
   Yes ,What do youlikebest?
2. Procesi i sqarimit ndodh kur ligjërata e folësit nuk është kuptuar pasi, folësi në ligjëratën e tij bënë gabime dhe kështu dëgjuesi bënë korrektimet dhe riformulon atë.P.sh. "i ´ve been to Londonforfifteen time"(kemi të bëjmë me gabim të shqiptimit)
   Më fal.. *Fifty..?*
   Fifteen" (rregullon shqiptimin)
3. Ndërhyrja metalinguistike rregullon gabimet në ndërtimin gramatikor, duke ju referuar natyrës së gabimit ose përkufizimit të fjalës në përputhje me fushën leksikore.P.sh. *:" i visit myfriendyesterday"*
   Çfarë gabimi është vendosja e foljes në kohën e shkuar?.Edhe lënia e patheksuar e shkronjave ka rolin e saj në keqkuptimet apo keq interpretimet.
   - Së pari dëgjuesi merr informacionin e komplet ligjëratës.
   - Së dyti ai përdor pyetjen për të saktësuar informacionin.
   - Së treti ai i kërkon folësit te riformuloj pyetjen, i ndihmuar edhe nga ai vet. P.sh.:
     "Youhavebeen in Londonforfifteentimes" (shqiptim jo shumë i saktë)
     Me falni,sa herë ju keni qenë në Londër?
     fifteen (shqiptim i qartë)
4. Përsëritja i referohet dëgjuesit për të specifikuar gabimin e folësit dhe për të marrë informacionin e saktë. Kur dëgjuesi ngulmon nëse është *"fifteen"* apo *"fifty"* kjo është pjesa e diskutueshme. Kjo ndodh kur bashkëbiseduesit nuk e kuptojnë dot njëri tjetrin. Gjate këtij procesi, studiuesit mund të marrin informacion plotësues, për të plotësuar njohuritë e tyre me fjalor rastësor Ky diskutim mund të shfaqet në dy forma: diskutim që kërkon të shmangë gabimet në bisedë dhe diskutim që ka për qëllim riparimin e ligjëratës kundodh gabimi. Të dy këto lloje diskutimesh mund të bëhen si bashkëpunim i dy bashkëbiseduesve. Ky rregullim i dyanshëm e ka zanafillën te forma e dytë e diskutimit, që është ai rastësor dhe jo i udhëzuar.P.sh.:
   a. *The companyneedsfunds to continue*
   b. *What do youmean by FUND*
   c. *Money*
   d. *Ok*

Këtu A përmend fjalën *"funds"* dhe B rezulton që nuk e kupton. Pikërisht nga diskutimi me partnerin, B kërkon të dije kuptimin e fjalës në rrethana rastësore.

Bashkëpunimi në klasë përfshin pyetje që ne mund ti ndajmë në dy grupe, pyetje të drejtpërdrejta (të pa parapërgatitura) dhe pyetje të ditura nga mësuesi ose të përgatitura më parë.(Lightbown&Spada 1999.116). P.sh. mësuesi i pyet studentët se çfarë është sporti i tyre i preferuar, si një hap parapërgatitor për temën e sporteve që vijon. Kjo pyetje, mbart një përgjigje të ditur më parë nga mësuesi. Kjo natyrë pyetjesh zakonisht bëhet për të përforcuar njohuritë dhe përfshin përmbajtjen dhe informacionin e mësuar, të tilla si koha, vendi, personazhet etj. Dhe së fundi janë komentet meta linguistike që kanë të bëjnë me linguistikën në vetvete. Ky studim nuk ka për qëllim këtë.

Cilat fjalë dhe çfarë duhet të jepet në procesin e mësimdhënies?

Pika më kryesore në mësimin e fjalorit është përzgjedhja e fjalëve nga mësuesi për ti dhënë për diskutim. Është e lehtë për mësuesin ti thjeshtëzojë disa fjalë dhe ti çojë ato në një nivel më të ulët për t'ia sjellë më pranë studentëve dhe më pas të mund ti përpunojë përsëri dhe ti çojë në nivele me abstrakte. Kështu ne kemi mundësi ta përdorim me shpesh dhe në kontekste të ndryshme fjalën. Por gjithmonë ka zgjidhje për ne, pra mund të vendosim cilat fjalë të përdorim, kush e kanë shpeshtësinë më të lartë të përdorimit dhe sa shpesh përdoren ato nga folësi. Veçanërisht fjalët që janë më të përdorshme nga të rinjtë dhe që ju shkojnë më për shtatë moshës së tyre, duhet t´ju mësohen domosdoshmërisht.
Në ditët tona tekstet mësimore i japin njohuritë të përqendruara në terma të veçanta, ku secila mbart fjalorin e veçantë përkatës për të. P.sh. nëse tema ka të bëjë me kafshët edhe fjalori që i referohet atyre apo edhe në tërësi të gjitha seksionet e tjera që lidhen më të do të kenë të bëjnë me gjëra që lidhen me to, si ushqime, lloje apo gjini të tjera kafshësh. Fjalët që kanë kuptim të veçantë duhet të shmangen nga mësimdhënia në këtë fazë, pasi më shumë mund të konfuzojnë sesa të mësojnë.
Studentëve është e nevojshme tu mësohet në fillim kuptimi i fjalëve e pastaj ana e tyre gramatikore, lidhjet me fjalët e tjera apo edhe fjalë formimet. Vëmendje i duhet dhënë shqiptimit edhe gërmëzimit. Studenti duhet të dallojë shqiptimin e fjalës dhe gërmëzimin e saj (Ur 1996, p60)[11]. Gjithashtu gramatika e termave të reja ka nevojë të mësohet ngastudentët, përsëri në varësi të çfarë niveli janë. Ata duhet të mësohen të respektojnë disa rregulla të gramatikës përkatëse. P.sh. kur ju mësojmë emrat, ata duhet të mësojnë format gramatikore që lidhen me to p.sh.: shumësin, njëjësin , të rregullta, të parregullta *(girls-girl) (mouse-mice).* Kur u mësojmë foljet ndoshta ne duhet t'ju mësojmë atyre kohën e tashme e të shkuarën (veçanërisht nëse folja është e parregullt) si dhe nevojën e ndryshimit të rrënjës.
Për mendimin tim është e rëndësishme, që studentët të dinë kuptimet e drejtpërdrejta të fjalës dhe sigurisht formën e saj gramatikore. Studiuesve të gjuhës ndonjëherë kjo i duket sfiduese dhe ndonjëherë shkurajuese, për faktin që shumë fjalë mbartin më shumë se një kuptim. Në këtë aspekt është mirë që ata të dinë sinonimet e fjalëve p.sh. *(smart–inteligent)* por edhe antonimet *(rich–poor)*, lidhjen e fjalëve të të njëjtës sferë si shkollë, mësues, pushim, mjete

[11]PennyUr. 1996 a course in language teaching

mësimore, mbasi ato kanë lidhje me arsimin. Unë mendoj se njohja e fjalës dhe e kuptimit të saj shkojnë paralel.

VLERËSIMI I MODELIT TË LIDERSHIPIT TE OFICERËT DETARË

Prof.Asoc. Kristofor Lapa
kristoforlapa@gmail.com
Doc. Ermal Xhelilaj
er.xhelilaj@gmail.com

Abstrakti

Modeli i lidershipit është konsideruar një element thelbësor për përgjegjësinë dhe pozicionin e oficerëve detare. Kjo për shkak të mjedisit të vështirë, të ashpër dhe të ndërlikuar të punës që industria detare paraqet në ditët e sotme, gjë që i bën detyrat e oficerit detar të vështira për të menaxhuar dhe administruar. Nën dritën e këtyre dhënave, ky studim do të fokusohet në elementet e modelit të lidershipit të cilat duhet të karakterizojnë një oficer të ri detar në ditët e sotme, duke analizuar këndvështrime të ndryshme në lidhje me përkufizimin e konceptit të lidershipit, polemikat mbi teoritë e lidershipit dhe modelet e lidershipit në kuadrin e pozicionit të oficerëve detarë. Në këtë kontekst, autorët e studimit janë të mendimit se çdo model lidershipi pasqyron elemente pozitive dhe njëkohësisht negative; prandaj, efektiviteti i modelit të lidershipit varet nga kërkesat dhe problematikat e situatës konkrete, veçanërisht në sektorin detar, i cili karakterizohet nga një mjedis i ashpër pune në anijet tregtare dhe pasagjere.

Abstract

Leadership model is considered an essential element for the responsibility, duty and role of young maritime officers. This is due to the difficult, harsh and complex working environment that the maritime industry represents in nowadays, which makes the duties and tasks of maritime officer harder to manage as well as to administer. In light of these considerations, this study will focus on the maritime management level and leadership models which must reflect a young maritime officer today, by analysing first the diverse perspectives in connection to the leadership definition, the controversy over the leadership theories and leadership in light of maritime officers' position. The authors are of the oppinion that each leadership style has its weaknesses and strengths; therefore, the effectiveness of the leadership style depends mainly on the demand of the situation, particularly in the maritime working sector - characterized by a harsh and complex environment.

Fjalët kyçe: Lidershipi, menaxhim detar, modeli i lidershipit detar, oficerë detarë.

Hyrje

Një armatë delesh e drejtuar nga një luan është më e mirë se një armatë luanësh e drejtuar nga një dele. Aleksandri i Madh (Jane, 1915)

Kjo thënie e vjetër dhe mjaft e njohur thekson në mënyrë të dukshme rëndësinë e madhe që paraqet modeli dhe kapaciteti i lidershipit në menaxhimin dhe administrimin e burimeve njerëzore. Sipas studiuesve, udhëheqësit nuk komandojnë në përsosmëri, por ata ndërtojnë përsosmërinë (Clark, 2008); dhe kjo arrihet nëpërmjet ndërtimit të një procesi ekselent që udhëheqësi të jetë i suksesshëm në përmbushjen e objektivave organizative. Duke marrë ne konsideratë elementet e mësipërme, qëllimi i këtij hulumtimi është që të analizojë cështjen nëse ekziston një qasje e përshtatshme e lidershipit për oficerët detarë në fushën e industrisë detare. Në këtë drejtim, fillimisht do të diskutohen perspektivat e ndryshme në përcaktimin e modelit të përshtatshëm të lidershipit. Në vazhdim do të shqyrtohet cështja lidhur me polemikat që mbizotërojnë mbi teoritë e lidershipit dhe së fundi, do të ketë një analizë mbi modelin e lidershipit duke marrë parasysh funksionin e oficerëve të rinj detarë, sikurse edhe për kapitenin e anijes, oficerin e parë dhe oficerët e tjerë që punojnë në bordin e anijes. Studimi do të përfundoj me disa vërejtje dhe sugjerime të konceptuara në formën e konkluzioneve.

Pikëpamjet e ndryshme në lidhje me përkufizimin e lidershipit

Përcaktimi i përkufizimit të lidershipit është themelore për kryerjen e një vlerësimi të plotë të elementeve pozitive dhe negative që karakterizojnë modelin efikas të lidershipit. Në këtë kontekst, lidershipi përkufizohet në mënyra të ndryshme nga autorë dhe studiues të ndryshëm. Kështu, Bryman (1986) sugjeron se lideshipi përfshin një proces të ndikimit social në të cilin një person i drejton anëtarët e grupit drejt një qëllimi të caktuar (f.2). Hunt (1986) pohon se lidershipi është kapaciteti për të mobilizuar në kuadër të një konkurrence apo konflikti konkret nevoja të mundshme për një vartës, pra një marrëdhënie e stimulimit të ndërsjelltë dhe inkurajimi që mundëson kalimin nga një situatë e caktuar anarkie në një angazhim dhe rezultat pozitiv të marrëdhënies (p.238). Koontz & Weihrich (1990), i referohen lidershipit si artin që influencon njerëzit që ata të përpiqen me dëshirë dhe përkushtim në drejtim të arritjes së qëllimeve të grupit (p.344). Ingstrup & Crookall (1998), e konsiderojnë lidershipin një faktor të rëndësishëm në formimin dhe funksionimin e një organizate, komunikimin dhe zbatimin e strategjive të reja, si dhe në ndërtimin e karakterit të korporatave (fq.52-53).
Për më tepër, Dixon (2003), nënvizon se lidershipi është aftësia për të ndikuar në qëndrimet dhe sjelljet e të tjerëve për të arritur objektivat e organizatës duke përdorur maksimalisht aftësitë e tyre njerëzore (p. 95). Kohët e fundit, autorë të tjerë pohojnë se me lidership nënkuptojnë aftësinë për të krijuar atë që vartësit në fakt duan të bëjnë (Platow at al, 2007). Richard nga ana tjetër (2007), pretendon se lidershipi ekziston për të bindur vartësit të punojnë së bashku në mënyrë efektive për të arritur vizionin e përbashkët moral (p. 17). Në çdo rast, përkufizimi i paraqitur në studimin e Bellefontaine (2008a), dmth "lidershipi përmban si koncept zotërimin e një game të gjerë të aftësive duke krijuar mundësi sa më të mëdha për të mësuar, për të drejtuar, dhe për të arritur qëllimet e tyre" (p.3), mund të përkufizohet si gjithëpërfshirës, pasi përfshihen

elemente thelbesore si përkushtimi, dija, dhe arritja e qëllimit konkret, duke pasqyruar si rezultat thelbin dhe elementet bazë të një modeli të përshtatshëm të lidershipit.

Polemika mbi teoritë e lidershipit

Studimet e mëparshme të lidershipit jane bazuar kryesisht në përpjekjet e studiuesve të fushës për të identifikuar tiparet më të përshtatshme që udhëheqësit duhet të zotërojnë (Dixon, 2003). Kështu, *teoria cilësore*, duke nxitur mendimin se lidershipi është një aftesi e lindur, ka për qëllim të identifikojë tiparet fizike dhe mendore si dhe personalitetin e personit (Armstrong dhe Dawson, 1996), si pamja, inteligjenca, përshtatshmëria, agresiviteti, vetëbesimi, këmbëngulja, iniciativa, dhe bashkëpunimi (Koontz & Weihrich, 1990). Në vitet e mëvonshme kjo teori pati përmirësime të konsiderueshme duke përfshirë brenda disiplinës së saj detyrat që duhet të përfundojë një lider, faktorët që ndikojnë në situatën mes udhëheqësit dhe vartësit, si dhe tiparet e personalitetit të vartësve (Hunt, 1986). Megjithatë, në vitet 1960 u themelua *teoria progresiste* e cila ishte kryesisht e bazuar në kërkimet e Fielder (1967). Kjo teori nxjerr në pah qasjen se të bëhesh një lider kërkon jo vetëm atribute personale dhe personalitete, por edhe një ndërveprim aktiv mes këtyre elementeve dhe situatave të ndyshme tranzicioniale.
Në vitet 1980 u themelua *teoria transformuese,* e cila e vendos theksin te emocionet, vlerat, etikën dhe nevojat e vartësve, si dhe me përcaktimin e qëllimeve konkrete afatgjata (Northouse 2004), ndërsa në vitet në vijim u krijua teoria ndërvepruese duke u fokusuar kryesisht në menaxhimin organizativ (Richard, 2007). Gjithësesi, duke u bazuar në elementet e mësipërme mund të theksohet se emëruesi i përbashkët i të gjitha këtyre teorive është se udhëheqësit efektiv kanë karakter të mirëformuar, vendosmëri dhe njohuri të cilat e ndihmojnë të përballoj në mënyrë efikase situata të ndryshme (Platow et al, 2007). Nga diskutimi i mësipërm duket se ekzistojnë polemika dhe diversitet mendimi ndërmjet studiuesve lidhur me përkufizimin e lidershipit. Duke marrë parasysh këto problematika, mund të konkludohet se teorisë cilësore i mungon qartësia dhe mbështetja akademike në shpjegimin e përkufizimit të lidershipit, sepse është e vështirë për të gjithë udhëheqësit të posedojnë tërësinë e tipareve pozitive karakterizuese, ndërsa nga ana tjetër jo-udhëheqësit mund të zotërojnë shumicën ose të gjitha prej tyre. Po ashtu, paqartësia mbizotëron edhe për të gjitha qasjet e lartpërmendura në lidhje me konceptualizimin e disa aspekteve të procesit të lidershipit; sesi këto qasje e shpjegojnë lidhjen midis modeleve dhe situatave të ndryshme, si dhe; mungesën e aplikimit të elementeve praktik (Northouse, 2004). Për më tepër, fuqia e vërtetë e lidershipit nuk i atribuohet vetëm udhëheqësit, por vjen gjithashtu edhe nga sinergjia e njerëzve dhe vartësve që punojnë së bashku drejt një objektivi të përbashkët (Richard, 2007).
Në çdo rast, mendimi i autorëve është se teoria e modelit të lidershipit i sugjeruar kryesisht nga autorë të tillë si Blake dhe Mouton, Dixon, Reddin, Harshey, Koontz & Weihreich dhe e analizuar dhe shpjeguar në mënyrë efikase nga Bellefontaine, ndoshta pasqyron mekanizmin më të mirë përmes të cilit analiza e modelit të lidershipit të përshtatshëm për mjedisin e punës në fushën e detarisë të oficerëve detarë, dhe marrëdhëniet e këtij pozicioni konkret me

menaxhimin e burimeve njerëzore mund të kuptohet më mirë. Për qëllimin e këtij hulumtimi, do të analizohen katër modelet themelore të lidershipit në bazë të aplikimit të modelit të autoritetit autokratik, demokratik, laissez faire, dhe paternaliste (Bellefontaine, 2008b).

Në *qasjen autokratike*, udhëheqësi shihet si një person i cili urdhëron dhe pret pajtueshmëri (Dikson, 2003); ai është dogmatik dhe pozitiv, dhe udhëhiqet nga aftësia për të dhënë shpërblime dhe njëkohësisht ndëshkim (Koontz & Weihrich, 1990). Duke përcaktuar se çfarë do të bëhet, nga kush, në çfarë kohe dhe në çfarë mënyre (Armstrong dhe Dawson, 1996), ky model i lidershipit i jep udhëheqësit pavarësi të madhe për udhëheqjen, por krijon de-motivimin dhe tjetërsim të karakterit të personelit vartës (Bellefontaine, 2008b). Për më tepër, ky përafrim është konsideruar si një frenues i performancës dhe jo si një motivues, dhe efikasiteti i tij është i kufizuar në raste emergjente dhe në ndryshime radikale (Richard, 2007).

Udhëheqësi demokratik konsultohet me vartësit për veprimet dhe vendimet dhe inkurajon pjesëmarrjen e tyre (Koontz & Weihrich, 1990). Ai udhëhiqet nga përpjekjet pozitive për të nxitur një mjedis bashkëpunimi ku të gjithë anëtarët e ekipit mund të arrijnë potencialin e tyre më të lartë (Clark, 2008), duke krijuar kështu një mënyrë të re në të cilën fuqizimi, risia dhe liria për të vepruar janë karakteristikat kryesore (Northouse, 2004). Pjesëmarrja në grup në vendosjen e objektivave dhe hartimin e strategjive është thelbësore në këtë model (Armstrong dhe Dawson, 1996), sepse ndihmon në motivimin dhe angazhimin, por në të njëjtën kohë konsiderohet problematik sepse ai mund të vonojë procesin e vendimmarrjes (Bellefontaine, 2008b).

Modeli tolerant i lidershipit është përafrimi ku udhëheqësi u ofron vartësve një shkallë të konsiderueshme të pavarësisë, duke i lënë ata të caktojnë objektivat e tyre dhe të zbulojnë mënyrat e tyre për arritjet e tyre (Dikson, 2003). Një nga atributet e këtij përafrimi është se lideri mund të delegojë autoritetin dhe detyrat ndaj vartësve (Ingstrup & Crookall, 1998). Udhëheqësi në këtë model mund të jetë një koordinator i cili ofron informacion thelbësor ndaj vartësve, dhe çfarë është më e rëndësishme, ai vepron si një pikë kontakti me ambientin e jashtëm të grupit të punës (Koontz & Weihrich, 1990).

Përsa i përket *modelit paternalist* të lidershipit Bellefontaine (2008b) saktësisht vëren se udhëheqësi vepron si një "figurë kryefamiljari" në lidhje me vartësit e tij. Ai punon për të ndihmuar, për të udhëhequr, për të mbrojtur dhe për të mbajtur pasuesit e tij, të punojnë së bashku si anëtarë të një familje (Peterson 2008). Përveç kësaj, udhëheqësi në këtë lloj lidershipi promovon një mirëbesim të plotë ndërmjet vartësve të cilin ai e motivon me shpërblime dhe disa ndëshkime (Dixon, 2003). Udhëheqësi paternalistë merr vendime dhe mban në kontroll të ngushtë politikat e organizatës, por në të njëjtën kohë mund të konsultohet, duke lejuar komunikimin me shkallët më të larta dhe perspektivat nga vartësit e tij (Bellefontaine, 2008b).

Lidershipi në këndvështrimin e pozicionit të oficerit detar

Një model i lidershipit efektiv është thelbësor për pozicionin e oficerëve detarë të cilët operojnë në bordin e anijes. Që në fillim të detyrës së tyre, shumica e oficerëve të rinj detarë, që nuk kanë eksperiencë, dhe përgjithësisht duket një tendencë e tyre për të treguar një sjellje të ashpër ndaj vartësve të tyre, që i çon

ata të drejtojnë me një dorë të hekurt, duke komanduar me pajtueshmëri dhe bindje pa marrë parasysh punën e vartësve dhe kushtet shëndetësore, nivelin e lodhjes, ose mendimet e tyre në lidhje me çështje të rëndësishme. Ndonjëherë ndëshkimi në bordin e anijes konsiderohet mekanizmi më i përshtatshëm për të bërë vartësit të përputhen edhe për detyrat jashtë fushës së tyre të kopetencave, të tilla si urdhërimin e një detari të lodhur i cili ka punuar për njëzet orë rresht në bordin e anijes për të bërë punë shtesë. Delegimi i autoritetit për pjesën më të madhe të kohës është i ndaluar nga oficerë të rinj detarë, edhe kur kjo lejohet nga rregulloret, dhe vetëm komunikimi hierarkik me vartësit në përgjithësi është i lejuar.

Edhe pse oficerët detare, si udhëheqës, duhet të karakterizohen në përgjithësi nga një tip autokratik i udhëheqësit, përsëri sjellja e oficerëve të rinj detarë përgjithësisht konsiderohet një autokraci e papërshtatshme dhe joefektive; sepse, në bordin e anijes nuk është vetëm zyrtari i lartë që duhet të shihet si udhëheqës, por edhe oficerët me shkallë hierarkike më të ulët, kadetët dhe marinarët duhet të demonstrojnë një lidership efikas në qoftë se anija në tërësi duhet të funksionojë normalisht (Richard, 2007). Për më tepër, siç vëren Eisenhower, ju nuk duhet të udhëhiqeni duke qëndruar me çekan mbi kokën e njërëzve - ky është sulm, jo udhëheqje (Lewis, 2006). Richard (2007) po ashtu pohon se sjellja e ashpër duhet të shmanget nga një udhëheqës i mirë, dhe që në vend të kësaj, njohja, respekti dhe inkurajimi duhet të promovohet në mesin e anëtarëve të ekuipazhit. Përveç kësaj, udhëheqja e shkëlqyer varet kryesisht nga bashkëpunimi i vazhdueshëm dhe mbështetja, delegimi i suksesshëm i autoritetit, dhe bazuar në efektivitetin e komunikimit. (Platow at al, 2007; Ingstrup & Crookall, 1998).

Për nje lidership të mirë tipare të tilla si pjekuria, takt, drejtësia, integriteti, besimi, guximi, vullnet i mirë, dhe sinqeriteti duhet të jenë elementet themelore mbizotëruese (Clark, 2008). Bellefontaine (2008c) vë në dukje se stabiliteti emocional dhe inteligjenca, si dhe pasioni, janë tipare kryesore për një udhëheqje superiore. Në këtë kontekst, Koontz & Weihrich, (1990) e konsiderojnë të rëndësishme të kuptuarit themelor të njerëzve, dhe theksojnë se udhëheqësi zhvillohet si përbërës themelor i lidershipit (p.345). Së fundmi, Northouse (2004) pohon se udhëheqësit e mirë respektojnë dhe u shërbejnë të tjerëve, për të ndërtuar një bashkëpunim të mirë, dhe për të promovuar paanshmërinë. Në këtë drejtim, mund të theksohet se të gjitha këto tipare të rëndësishme janë thelbësore për modelin e lidershipit të oficerëve detarë.

Megjithatë, nga diskutimi i mësipërm, duhet të merret në konsideratë mendimi se ndoshta nuk ekziston një model i përsosur i lidershipit i cili mund të jetë i përshtatshëm për të gjitha llojet e situatave. Prandaj, efektiviteti i modelit të lidershipit varet nga kërkesa e situatës; veçanërisht, në mjedisin detar të punës në anije, që nënkupton rrezik të lartë për aksidente, motit të ashpër dhe kushtet e punës, përgjegjësitë shtesë, rritjen e nivelit të lodhjes dhe stresin, si dhe izolimin social. Dhe kështu, qasja autokratike e udhëheqjes "mund të jetë vetëm kur vendimet e duhura duhet të bëhen shpejt dhe me vendosmëri; si dhe kur ekziston mungesa totale e disiplinës midis vartësve. Nga ana tjetër, mendimi mbizotërues është se qasja demokratike mund të jetë më e përshtatshme për një udhëheqje te mirë (Dixon, 2003), por në situata të ndryshme "mund të jetë i paefektshëm ndaj vendimmarrjes së shpejtë (Bellefonten, 2008b). Në mënyrë të ngjashme, pavarësisht faktit se qasja tolerante e lidershipit mund të përafrojë tipare efektive të nevojshme për një udhëheqje të mirë, përsëri kjo përqasje

mund të ofroj drejtim dhe disiplinë minimale, veçanërisht, për situata të jashtëzakonshme dhe të rrezikshme.

Konkluzione

Si rezultat, ekzistojnë mendime të ndryshme ndërmjet studiuesve në-përcaktimin e modelit të lidershipit të përshtatshëm për do situatë. Në çdo rast, përkufizimi i sugjeruar nga Bellefontaine në studimin e tij mbi menaxhimin e burimeve njerëzore është konsideruar më gjithëpërfshirës dhe efikas, për shkak se ajo përfshin komponentët thelbësorë të lidershipit dhe përmban thelbin e subjektit. Përveç kësaj, teori të shumta të lidershipit të propozuara nga shumë hulumtues çojnë në konkluzione të paqarta dhe konfuzion dhe ndoshta polemika të mëdha ekzistojnë ndërmjet studiuesve në analizimin, përcaktimin dhe vlerësimin e artit të lidershipit.
Në këtë këndvështrim, teoria e modelit të lidershipit në bazë të "përdorimit të autoritetit" i cili konsiston në qasjen paternaliste, autokratik, demokratik, dhe tolerante, pasqyron ndoshta mekanizmin potencial nëpërmjet të cilit analizat mbi modelin e lidershipit të oficerëve të rinj detarë dhe marrëdhëniet e lidershipit me menaxhimin e burimeve njerëzore mund të kuptohet më mirë. Përvoja e punës ndërmjet oficerëve të rinj detarë reflekton një stil autokratik të udhëheqjes, i cili nga diskutimi i mësipërm është konsideruar i paefektshëm dhe i pafrytshmëm. Së fundi, cdo model lidershipi zotëron dobësitë dhe pozitivitetet e tij. Prandaj, *efektiviteti i modelit të lidershipit varet nga kërkesa dhe kriteret e situatës,* veçanërisht në sektorin detar – i cili karakterizohet nga një mjedis i ashpër dhe i rrezikshem i punësimit.

Referencat

Armstrong, P. & Daëson, C. (1996). *People in organizations.* (5th ed.). Kings Ripton, U.K.: ELM Publications

Bellefontaine, N.A. (2008a). *Human Resource Management: Leadership Skills and the Circle of Performance*. Unpublished lecture handout, Ëorld Maritime University, Malmo, Sëeden

Bellefontaine, N.A. (2008b). *Human Resource Management: Leadership*. Unpublished lecture handout, Ëorld Maritime University, Malmo, Sëeden

Bellefontaine, N.A. (2008c). *Human Resource Management: Becoming an Effective Leader*. Unpublished lecture handout, Ëorld Maritime University, Malmo, Sëeden

Blanchard, K.H., Zigarmi, P. & Zigarmi, D. (1985). *Leadership and the one minute manager: increasing effectiveness through situational leadership.* (1ST ed.). Neë York: Morroë

Bryman, A. (1986). *Leadership and Organizations.* London; Boston: Routledge & K. Paul

Clark, D. R. (2008). *Concepts of Leaderships*. Retrieved August 25, 2008 from the Ëorld Ëide Ëeb:http://nëlink.com/~donclark/leader/leadcon.html

Clark, D. R. (2008). *Leadership – Character and Traits*. Retrieved August 24, 2008 from the Ëorld Ëide Ëeb: http://nëlink.com/~donclark/leader/leadchr.html

Dixon, R. (2003). *The management task.* (3rd ed.). Boston, MA; Oxford: Butterëorth-Heinemann

Fielder, F.E. (1967). *A theory of Leadership Effectiveness*. London; Neë York: McGraë-Hill Book Co.

Hunt, J.Ë. (1986). *Managing people at ëork: a manager's guide to behavior in Organizations.* London; Neë York: McGraë-Hill Book Co.

Ingstrup, O. & Crookall, P. (1998). *The three pillars of public management: secrets of sustained success.* Montreal; London: McGill-Queens University Press.

Jane, F.T. (1915). *The British Battle Fleet: Its Inception and Groëth Throughout the Centuries to the Present Day,* as cited from the article Alexander the Great. Retrieved August 22, 2008 from the Ëorld Ëide Ëeb: http://en.ëikiquote.org/ëiki/Alexander_the_Great

Koontz, H. & Ëeihrich, H. (1990). *Essentials of management.* (5th ed.). Neë York: McGraë-Hill Publishers.

Kotter, J.P. (1996). *Leading change.* Boston, MA, USA: Harvard Business School Press

Leëis, J.J. (2006). Leadership Quotes – Ëisdom Quotes: Quotations to inspire and challenge. Retrieved August 21, 2008 from the Ëorld Ëide Ëeb: http://ëëë.ëisdomquotes.com/cat_leadership.html#cat

Northouse, P.G. (2004). *Leadership Theory and Practice.* Thousand Oaks, Cal.: Sage Publication, Inc.

Platoë at al, (2007). The Neë Psychology of Leadership. *Scientific American Mind*, August 2007 Issue.

Peterson, M. (2008). *Leadership Styles.* Retrieved August 21, 2008 from the Ëorld Ëide Ëeb: http://ezinearticles.com/?Leadership-Styles&id=207329

Richard, J. (2007). *Leadership throughout: hoë to create successful enterprise.* London: The Nautical Institute

DOMOSDOSHMËRIA PËR RIORGANIZIMIN E NDARJES ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE NË KUADRIN E AUTONOMISË SË PUSHTETIT VENDOR

MSC OLJANA HOXHAJ
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Departamenti i Drejtësisë
oljana.hoxhaj@gmail.com

Abstrakt

Pushteti vendor kushtëzon mbarëvajtjen e shtetit dhe të demokracisë në tërësi. Konsolidimi i shtetit ka ecur paralelisht me reformat e rëndësishme politike të karakterit administrativ-territorial. Nëse bëjmë një retrospektivë të veprimtarisë së shtetit shqiptar, kuptojmë se aktet e para që sanksiononin në mënyrë të detajuar ndarjen administrative dhe kompetencat e organeve përkatëse, kishin një qasje perëndimore edhe pse ky proçes reformimi është realizuar një shekull më parë. Shqipëria synon të ecë me të njëjtat standarte si vendet e përparuara evropiane, ndaj ajo ka implementuar Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale. Është diskutuar gjerësisht për domosdoshmërinë e ndarjes të re administrative-territoriale.Kjo reformë duhet të konsiderohet si një instrument për të adoptuar më mirë raportin ndërmjet qytetarit me territorin ku jeton, me administratën, si dhe me proçesin e decentralizimit të pushtetit vendor. Qëllimi i këtij punimi është vlerësimi i impaktit që do të sjellë në shoqërinë shqiptare reforma e re, kriteret mbi të cilat u hartua dhe hapat që u ndoqën deri në finalizimin e saj.

Fjalët kyçe: reformë administrative, decentralizim, kushtetutë, pushteti vendor

Abstract

The local government does condition the ongoing of a state and the overall democracy. The consolidation of a country has always been going along with the important political reforms of administrative -territorial nature. If we could take a look back at the albanian state's activity , we would realise the very first

acts that sanctioned in a detailed way the administrative division and the competences of its own organs had a western approach even though this reformation was done a century ago. As Albania intends to move at the very same standards as the most advanced countries do, it has implemented the european card of the local independence. It has been largely discussed about the new administrative - territorial divison. This reform has to be considered as an intrument in order to adopt a better relationship between the citizen and its own territory and administration as well as the decentralisation process of local government. This work's objective is to evaluate the impact that the new reform will have on the albanian society, criterions on which it has been drawn and the steps that have been taken to its finalisation.

Keywords: administrative reform, decentralization , constitution, local government

1. Hyrje

1.1 Një vështrim në retrospektivë mbi organizimin dhe ndarjen administrative të pushtetit vendor

Shteti i pavarur shqiptar e ka filluar veprimtarinë e tij, përmes ligjeve për organizimin e pushtetit vendor, gjë që dëshmon konceptet e klasës politike të kohës, për rëndësinë e organizimit të qeverisjes vendore në shtet. Një nga ligjet e para të tij, *"Kanuni i përtashëm i administratës civile të Shqipërisë"*, i miratuar më 22 nëntor 1913, përfaqëson edhe një nga aktet më të rëndësishme që doli nga qeveria e Vlorës. Për here të parë, ai sanksionoi me hollësi ndarjen e re administrative të Shqipërisë dhe rregulloi kompetencat e organeve përkatëse sipas përvojës perëndimore, larg nga praktikat e vjetra turke.[1] Në bazë të këtij ligji, Shqipëria ndahej në prefektura, nënprefektura dhe krahina, të cilat drejtoheshin përkatësisht nga prefekti, nënprefekti dhe krahinari. Pranë tyre vepronin dhe këshillat, të cilët ishin organe të zgjedhura nga populli.[2]
Kushtetuta sanksionon si njësi bazë të qeverisjes vendore, komunat e bashkitë. Ato janë padyshim shprehja më e qarte institucionale e autonomisë lokale që promovon ajo. Autonomia e tyre do të mbetej një fiksion i thjeshtë juridik, nëse nuk do të organizoheshin në formë demokratike. Ligji që rregullon veprimtarinë e pushtetit vendor, sanksionon ekzistencën e organeve të zgjedhura, të cilat operojnë në një juridiksion të përcaktuar. Organet përfaqësuese të njësive bazë të qeverisjes vendore janë këshillat, të cilat zgjidhen me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të fshehta.[3] Organi ekzekutiv i bashkisë ose i

---

[1]Omari L, Anastasi A, (2008)"E DrejtaKushtetuese", ABC, Tiranë, faqe 331
[2]Omari L, Luarasi A (1998)"Historia e Shtetit dhe së Drejtës në Shqipëri", Luarasi, Tiranë, faqe 71
[3]Neni 109/1, Ligji nr.8652, datë 31.07.2000"Për organizimin dhe funksionimin e QeverisjesVendore", FletoreZyrtare nr.25, viti 2000.

komunës është kryetari, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga populli në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni[4], pra me votim të përgjithshëm dhe të fshehtë.

2. Metodat

Për realizimin e këtij punimi kam aplikuar metoden cilësore, e cila është siguruar nga burime dytësore, kryesisht libra, nga një vështrim i detajuar mbi legjislacionin kushtetues shqiptar si dhe nga studimi analitik i revistave periodike të hartuara nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, që kanë në objektin e trajtimit të tyre ndarjen administrative-territoriale. Një rëndësi të konsiderueshme kanë raportet dhe rekomandimet e realizuara nga grupet e interesit, në të cilat pasqyrohen projektet[5] dhe alternativat se si duhet të realizohet kjo reformë.

3. Riorganizimi administrativ-territorial në periudhën pas viteve '90 dhe domosdoshmëria e rishikimit të hartës territoriale të vendit

Rishikimi i ndarjes administrative të Shqipërisë, është konsideruar si një ambicje e madhe. Përpjekjet për të ndryshuar hartën e njësive vendore, kanë filluar një dekadë më parë. Sistemi administrativ në vitin 1990 përbëhej nga 26 rrethe, 539 fshatra të bashkuar, 67 qytete dhe 2848 fshatra. Në vitin 2000 kishim 36 rrethe dhe në vitin 2001, u bashkuan në 12 qarqe. Shqipëria përpara reformës kishte një sistem administrativ të përbërë prej 12 qarqe, 65 bashki 308 komuna dhe më shumë se 3000 fshatra. Këto të dhëna na shërbejnë për të kuptuar se pavarësisht nga ndryshimi i motiveve politike, rishikimi i ndarjes administrative është një proçes i vazhdueshëm.
Nga ndryshimet e thella demografike të pas viteve '90, rezulton se më shumë se 1/3 e komunave dhe bashkive kanë humbur deri në gjysmën e popullsisë. Raporti mes territorit dhe njeriut ka ndryshuar thellësisht në pjesën më të madhe të vendit dhe organizimi administrativ nuk është një raport strikt, por përkundrazi, një raport elastik, që merr parasysh, në rradhë të parë, lëvizjen e lirë, shkaqet dhe pasojat e saj.[6] Sa më e vogël të jetë njësia vendore aq më të larta dhe të pamotivuara janë shpenzimet administrative që paguhen dhe sa më e madhe është njësia, aq më e ulët, përgjithësisht është kostoja e shërbimeve për frymë.

---

[4]Neni109/2,3, Ligji nr. 8652, datë 31.07.2000"Për organizimin dhe funksionimin e QeverisjesVendore", FletoreZyrtare nr. 25, viti 2000
[5] Studim për Shoqatën e Komunave të Shqipërisë, (Dhjetor 2012) "Reforma Territoriale në Shqipëri", Projekti nr.122210310
[6] Revistë periodike, (2002) "Pushteti Vendor"Gentgraphic, Tiranë, faqe 8

Kur synohet rishikimi i ndarjes territoriale të vendit, të gjithë duhet të analizojmë problemet me të cilat do të shoqërohet ky ndryshim. Reforma mund të realizohet vetëm përmes një njësie vendore të fortë, solide dhe të pranuar nga komuniteti.[7]Intensiteti i debatit politik ndikon në masë jo të vogël edhe në mënyrën dhe mekanizmat që do të nevojiteshin për adoptimin e çdo reforme në një shoqëri me demokraci përfaqësuese. Në rastin e reformës territoriale, e cila lidhet ngushtësisht me balancat elektorale, acarimi i klasës politike e bën atë edhe më të kushtueshme, si dhe rrit riskun për zbatimin e saj.

4. Projektet dhe hapat e ndjekur në kuadrin e finalizimit të reformës administrative- territoriale

Fillimisht, rishikimi i ndarjes territoriale në Shqipëri u iniciua në një klimë të favorshme, ku vullneti politik për reformat e rëndësishme ekzistonte, madje, ne disa raste ishte konkretizuar. Kjo bëri që të skicohej një proçes i drejtpërdrejtë, ku qeveria në bazë të një studimi mbështetur mbi të dhënat e vitit 2002 dhe duke respektuar kërkesat kushtetuese dhe ligjore për konsensus komunitar, të nxirrte një hartë të rishikuar administrative, e cila pas diskutimeve politike, të miratohej në parlament përpara zgjedhjeve vendore 2003. Nevoja për rishikimin e ndarjes administrative-territoriale nuk është kundërshtuar asnjëherë si nga forcat politike, ashtu dhe nga ekspertë të pavarur të fushës.[8]Në Konferencën Ndërkombëtare të Decentralizimit, mbajtur në maj 2003, u arrit në përfundimin se rishikimi i ndarjes administrative-territoriale duhet të bëhej pas zgjedhjeve vendore të vitit 2003. Gjithashtu u pranua që për garantimin e reformës, proçesi do të shtrihej në afatin dy vjeçar, ku të kombinoheshin bashkimi i njësive vendore nëpërmjet forcës së ligjit, me vullnetarizmin që njësitë vendore të zgjedhin rastin për bashkim. Ky model u pranua dhe u adaptua edhe nga ekspertë të Këshillit të Evropës, që e kishin ndjekur dhe ishin pjesë e proçesit që në fillim. Kështu lindi nevoja për një ligj rregullator për të garantuar proçesin drejt ndarjes së re.[9]

Nëse analizojmë përmbajtjen e tij, kuptojmë se qëllimi është përcaktimi i kritereve që nevojiten për vlerësimin e efektshmërisë së njësive vendore që do të suprimohen, përcaktimi i kushteve të domosdoshme për riorganizimin e ndarjes administrative-territoriale të Republikës së Shqipërisë, si dhe

---

[7] Me iniciativën e qeverisë së kohës, dy komuna, ajo e Bushatit dhe e Barbullushit në Shkodër, u bashkuan me vullnetin e komuniteteve dhe të zgjedhurve vendor, duke respektuar identitetin e tyre kulturor e historik. Ky bashkim u realizua me më shumë se 90 vota në Parlament, nga 84 të nevojshme.

[8]Cuçi B, (2003) Koment "Pse një ligj rregullator" Botim i Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Gentgraphic, Tiranë, faqe 20

[9]Projekt-Ligji "Kriteret dhe kushtet që do të ndiqen për riorganizimin e ndarjes administrativo-territoriale të Republikës së Shqipërisë"

instrumentet dhe afatet kohorë që nevojiten për realizimin e këtij qëllimi.[10] Me interes për t'u trajtuar janë kriteret për shkrirje dhe kriteret për të vlerësuar zgjidhjen alternative për bashkim. Njësia vendore do të të quhet e paefektshme kur popullsia e njësisë vendore është nën shtatë mijë banorë.[11]
Ndërsa kriteret për bashkim të detyrueshëm të njësive vendore të paefektshme konsistojnë në faktin se bashkimi nuk duhet të ndikojë te kufijtë aktual të qarqeve, popullsia e njësive vendore të bashkuara duhet të jetë mbi shtatë mijë banorë, ndërsa distanca e vendbanimeve periferike nga qendra e njësisë vendore duhet të jetë më pak se njëzetë kilometra. Njësitë që bashkohen duhet të kenë lidhje tradicionale historike-gjeografike.[12]Me qëllim nxitjen e bashkimit vullnetar të njësive vendore gjatë proçesit tranzitor të reformës, njësitë vendore që bashkohen vullnetarisht do të subvencionohen nga shteti nëpërmjet:
a.Rritjes së grantit të pakushtëzuar në masën 10% nga shuma e llogaritur sipas kushteve të vitit paraardhës për njësinë vendore përkatëse, për tre vjet rresht, pa cënuar shumën e grantit për njësitë e tjera.
b.Prioritetit në shpërndarjen e grantit të kushtëzuar për investime, duke bërë të detyrueshëm financimin e njësive vendore që paraqesin vullnet për bashkim, me këto fonde.
c.Investimeve direkte të qeverisë, duke oorientuar investimet për përmirësimin e infrastrukturës kombëtare, në zonat që do të preken nga riorganizimi territorial vullnetar.[13]

4.1 Reforma administrative-territoriale e vitit 2014 në Shqipëri

Progresi i Shqipërisë si kandidate për në Bashkimin Evropian, i ka zgjeruar edhe më tepër objektivat që lidhen me fuqizimin e pushtetit vendor. Ndryshimet demografike dhe reformat në kuadër të decentralizimit të ndodhura në këto njëzetë vitet e fundit, tregojnë se rregullimi ligjor i ndarjes administrative nuk i përshtatet shumë realitetit me të cilët përballen njësitë vendore. Kjo parë në dy këndvështrime, si në rastin e njësive vendore që janë përballur më një zhvillim ekonomik, urbanistik dhe rritje të konsiderueshme të popullsisë ashtu dhe në rastin e njësive të tjera të vogla, kryesisht në zona malore ku popullsia është zvogëluar dhe nuk ka pasur zhvillime domethënëse.
Komisioni i posaçëm parlamentar për reformën administrative-territoriale ka paraqitur pesë variantet e hartës së re për ndarjen administrative territoriale. Varianti i parë i propozuar përcakton ndarjen e hartës në 30 njësi, varianti i

---

[10]Neni 1 i Projekt-Ligjit "Kriteret dhe kushtet që do të ndiqen për riorganizimin e ndarjes administrativo-territoriale të Republikës së Shqipërisë"
[11] Neni 3 i Projekt-Ligjit "Kriteret dhe kushtet që do të ndiqen për riorganizimin e ndarjes administrativo-territoriale të Republikës së Shqipërisë".
[12] Neni 4 i Projekt-Ligjit "Kriteret dhe kushtet që do të ndiqen për riorganizimin e ndarjes administrativo-territoriale të Republikës së Shqipërisë"
[13] Neni 5 i Projekt-Ligjit "Kriteret dhe kushtet që do të ndiqen për riorganizimin e ndarjes administrativo-territoriale të Republikës së Shqipërisë"

dytë propozon ndarje në 39 njësi, varianti i tretë në 47 njësi, i katërti në 75 njësi vendore, kurse i pesti dhe i fundit në 63 njësi. Objektivi është krijimi i njësive funksionale që të kenë në të njëjtën kohë edhe lidhje sociale, ekonomike, historike e kulturore me njëra-tjetrën. Ofrimi i shërbimeve të plota dhe funksionale publike, si dhe distanca mes territorit ishin kritere të tjera, të cilat u morën në konsideratë.[14]

Në kushtet aktuale të Shqipërisë, pas marrjes së statusit të vendit kandidat në BE, ishte i domosdoshëm një reformim në kuadrin e rritjes së cilësisë. Pyetja shtrohet nëse u zgjodh alternativa më e mirë e mundshme dhe nëse kjo reformë do ta realizojë aspiratën e vendit tonë për një menaxhim më të mirë të territorit, për shërbime më cilësore dhe për ezaurimin e një sfide të karakterit politik, që nëse rezulton e suksesshme, me shumë gjasa do e lehtësojë afrimin drejt Evropës. Pavarësisht se harta e re administrative-territoriale me 61 bashki, është tashmë e miratuar, vlen të konsiderohen dhe përpjekjet e subjekteve të ndryshme, që shpesh herë ishin oponentë dhe kritikë të projektit të miratuar.

4.2 Rekomandimet nga grupet e interesit për një reformë efikase dhe kritikat ndaj variantit final

Shoqata e Komunave, si oponente dhe kritike e projektit final, paraprakisht kishte miratuar një paketë rekomandimesh për institucionet qëndrore:

Si rekomandim i parë që do të kontribuonte në suksesin dhe rezultatet e qëndrueshme të një reforme administrative–territoriale, do të ishte arritja e konsensusit politik në parim për këtë reformë. Ky konsensus do të lehtësonte proçesin e realizimit të reformës dhe do të nxiste më tej përfshirjen e kryetarëve të komunave dhe bashkive, të cilët nuk do të ndikoheshin nga qëndrimi i partive politike ku ata aderojnë. Nisja e reformës administrative ka synim të përmirësojë kapacitetin e qeverisjes vendore, përmes një ristrukturimi të komunave dhe bashkive brenda kufijve të qarkut. Synimi për të ruajtur gjysmën e njësive vendore aktuale,[15]është një hap i rëndësishëm drejt decentralizimit politik dhe administrativ që nevojitet. Ky numër do të ishte i nevojshëm që njësitë vendore të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre sipas legjislacionit shqiptar, duke respektuar kulturën, traditën dhe historikun e tyre.[16]

Reforma territoriale duhet të krijojë hapësira për marrjen e masave paraprake për t'i paraprirë proçesit, duke lënë vend për fleksibilitet dhe preferenca sipas kushteve lokale në një kombinim me vendimarrjen në nivel qëndror. Për këtë

---

[14]Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Bledi Çuçi ka deklaruar se këto janë pesë variantet që ne propozojmë dhe sigurisht që jemi të hapur të diskutojmë me komisionin të gjitha variantet, në mënyrë që ai të ketë hapësirën e duhur për të marrë parasysh më të mirin.

[15]Afërsisht 160 njësi të qevesisjes vendore

[16]Rekomandime të Shoqatës së Komunave për Reformën Territoriale, Miratuar në Komitetin Drejtues të ShKSh, në mbledhjen e datës 25 prill 2013

arsye ne propozojmë që procesi i reformës të jetë i ndarë në dy faza vullnetare dhe të detyrueshme. Fazë e parë vullnetare, do të përfshinte miratimin nga parlamenti të udhëzimeve qëndrore duke përcaktuar dhe rezultatin e përgjithshëm. Ky hap do të pasohej nga një periudhë dy vjeçare për konsultimet lokale në bazë qarku dhe bashkimet vullnetare mes komunave dhe bashkive. Propozimet për ndryshime në hartën administrative në çdo qark duhet të vijnë nga Këshillat e Qarqeve, në bashkëpunim me Prefektin. Qytetarët duhet të informohen dhe të përfshihen në proçes.
Gjatë kësaj faze, qeveria qendrore duhet të sigurojë iniciativa nxitëse financiare për të inkurajuar pjesëmarrjen vullnetare, për shembull, alokimi i transfertave të kushtëzuara dhe granteve konkurruese për njësitë e bashkuara. Synimi do të ishte bashkimi vullnetar i një numri të konsiderueshëm njësish në kohë për zgjedhjet vendore të 2015. Periudha deri në zgjedhjet e ardhshme vendore (2019), do të mundësojë rregullimin me ligj për njësitë që nuk do të bashkohen. Ato do të kenë kohë dhe do të jetë faza e dytë e proçesit të reformës. Nëse do të ketë një angazhim për një reformë administrative deri në 2019 do të bënte që faza e parë të ishte më rezultative.[17]
Këto rekomandime të Shoqatës së Komunave nuk u çmuan të arsyeshme të ishin pjesë e reformës së miratuar. Gjithsesi, për nga argumentimi, plotësia e të dhënave studimore dhe lobimi që bënë në institucionet mediatike, mendoj, se e kanë ndihmuar komisionin parlamentar dhe grupet e punës së çdo rangu, për të treguar seriozitet dhe kujdes të veçantë në miratimin e variantit përfundimtar.

5. Decentralizimi dhe autonomia vendore në kuadrin e integrimit evropian

Proçesi i decentralizimit është një proçes shumë kompleks dhe i vështirë. Ritmet dhe tendenca e zhvillimit të tij është nga treguesit më të rëndësishëm të transformimit të shoqerisë së centralizuar në një shoqëri vetëzhvilluese dhe shumëdimensionale. Ecuria e këtij proçesi është një tregues i përparimit apo ngadalësimit të ndryshimeve të domosdoshme të vendit. Për realizimin e strategjisë së decentralizimit është jetike që përfaqësuesit e pushtetit qendror të kuptojnë se kalimi i kompetencave dhe përgjegjësive në organet e qeverisjes vendore, krijon më shumë mundësi që shërbimet t'i ofrohen njerëzve, që kontrolli i tyre mbi përdorimin e taksave dhe fondeve, të jetë më i drejtpërdrejtë.[18] Organet e qeverisjes vendore në këtë proçes kanë një rol kyç.
Decentralizimi nuk duhet të kuptohet thjesht si kalim kompetencash dhe të drejtash, por si marrje përsipër e përgjegjësive dhe detyrimeve që këto organe nuk i kanë patur më parë. Pra, kjo nënkupton përballje me kërkesat e

---

[17]Rekomandime të Shoqatës së Komunave për Reformën Territoriale, Miratuar në Komitetin Drejtues të ShKSh, në mbledhjen e datës 25 prill 2013
[18]Revistë periodike Nr.4, (2004) "Pushteti Vendor"Botim i Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Gentgraphic, Tiranë, faqe 6-7

komunitetit, të cilat deri në momentin e marrjes së kompetencave, i përcilleshin pushtetit qëndror. Objektivat dhe detyrat në zbatim të strategjisë së decentralizimit mbeten ende një sfidë e qeverisjes qëndrore dhe vendore, një standart, i cili duhet të jetë në përputhje me aspiratat e Shqipërisë në kuadrin e integrimit në Bashkimin Evropian. Decentralizimi duhet të synojë gjithashtu aksesin e komunitetit në politikat vendimmarrëse si dhe rritjen e efektivitetit të qeverisjes vendore. Në thelb ky proçes ka impakt në të gjithë komponentët e jetës duke përfshirë ndërtimet[19], transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë vendore[20], transferimn e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve në pronësi të qeverisjes vendore[21] dhe një sërë shërbimesh të tjera.

5.1 Autonomia vendore në përqasje me standartet evropiane

Në themel të legjislacionit shqiptar u vendosën standartet e arritura nga bashkësia ndërkombëtare, me adoptimin e ***Kartës evropiane të autonomisë lokale,*** miratuar në 1985. Parimet e saj, që i detyrojnë shtetet të respekojnë autonominë dhe pavarësinë e pushtetit vendor, u shndërruan në parime bazë të shtetit shqiptar. Autonomia e organeve të qeverisjes vendore nuk është vetëm një autonomi administrative. Ajo paraqitet si autonomi politike, normative dhe financiare. I rëndësishëm është fakti se autonomia u njihet në mënyrë të barabartë të gjitha njësive vendore, sipas niveleve të tyre. Nga pikëpamja polito-administrative, organet e pushtetit vendor janë të pavarura në ushtrimin e funksioneve të tyre. Ato nuk kanë varësi politike nga ndonjë organ tjetër shtetëror. Prefekti, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave, ka karakter bashkërendues me organet vendore, por jo karakter epror. Pra, është një organ i ngarkuar kryesisht me kompetenca kontrolli ndaj qeverisjes vendore.[22]
Autonomia normative shprehet në faktin se organet e të gjitha njësive të qeverisjes vendore nxjerrin vendime, urdhra dhe urdhëresa. Të drejtat dhe funksionet e tyre janë të rregulluara më hollësisht nga ligji. Karakteri territorial përbën aspektin më thelbësor të tyre. Aktet e tyre kanë fuqi detyruese për të gjitha subjektet që jetojnë dhe veprojnë brenda njësisë territorial që përfaqëson organi përkatës. Ndërsa, autonomia financiare konsiderohet si një nga aspektet më të rëndësishme të autonomisë vendore, por njëkohësisht edhe si një nga aspektet më problematike e delikate. Ajo përbën një garanci, jo vetëm për realizimin e asaj vetë, por edhe për arritjen e autonomisë politike, normative dhe administrative. Kushtetuta përcakton se njesitë e qeverisjes vendore janë persona juridikë dhe kanë buxhet të pavarur.[23] Në praktikë njësitë vendore

---

[19]Ligji nr. 8991, datë 23.01.2003"Për disa ndryshime në ligjin "Për urbanistikën"
[20]Ligji nr. 8744, datë, 22.02.2001"Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë vendore"
[21]VKM nr. 81, datë 11.02.2004 "Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve në pronësi të qeverisjes vendore"
[22]Ligji nr. 8927, datë, 25.07.2002 "Për prefektin"
[23] Neni 111 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

kanë kaluar vështirësi për krijimin e hallakve pranë bashkive dhe komunave, që do të realizojnë grumbullimin e taksave dhe tarifave vendore.[24]

Përfundime

Domosdoshmëria kombëtare e një reforme administrative është pika ku konvergojnë qëndrimet e të gjitha forcave politike, për të mundësuar mirëadministrimin e pushtetit vendor dhe kryerjen me efikasitet të shërbimeve ndaj qytetarëve. Pika në të cilën shumë prej tyre ndahen, konsiston në projeksionin numerik, duke e lidhur këtë pashmangshmërisht me zonat e ardhshme elektorale, me përllogaritjet dhe me interesat e ngushtë politikë. Në këtë punim jam munduar të trajtoj rëndësinë e kësaj reforme, që ka një impakt thelbësor në shoqërinë tonë. Mendoj se kjo reformë i duhet Shqipërisë sepse kushtet aktuale diktojnë ndjekjen e politikave më bashkëkohore.
Në këtë kuadër, disa prej faktorëve që sollën këtë reformë konsistojnë te ndryshimet demografike, mosefiçenca e administatës së mëparshme, mungesa e cilësisë së shërbimeve të ofruara, pamjaftueshmëria profesionale si dhe synimi për të përqasur standartet vendase me kërkesat dhe standartet e Bashkimit Evropian. Ndarja territoriale është një instrument për të ndërtuar një raport të drejtë në tre komponentë: mjedis gjeografik, popullsi, zhvillim ekonomik. Një pjesë e konsiderueshme e njësive vendore nuk i plotësonin parametrat e nevojshme për t'u vetëqeverisur, duke u bërë frenuese për zhvillimin ekonomik e social të vendit në përgjithësi. Fragmentizimi i skajshëm i territorit ndikoi në formimin e njësive vendore me popullsi shumë të vogël. Rrjedhimisht, reforma territoriale administrative e vitit 2014 ishte një hap i domosdoshëm për vendin tonë, pasi përmes saj garantohet potencialisht dhe realisht decentralizimi i qeverisjes vendore.

Literatura:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998

Ligji nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", Fletore Zyrtare nr. 25, viti 2000

Omari L, Anastasi A, (2008) : "E Drejta Kushtetuese", ABC, Tiranë

Studim për Shoqatën e Komunave të Shqipërisë, (Dhjetor 2012) "Reforma Territoriale në Shqipëri", Projekti nr.122210310

Omari L, Luarasi A (2007)"Historia e Shtetit dhe së Drejtës në Shqipëri", Luarasi, Tiranë

[24]Omari L, Anastasi A, (2008) : "E Drejta Kushtetuese", ABC, Tiranë, faqe 340

Revistë periodike Nr.3, (2002) “Pushteti Vendor”Botim i Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Gentgraphic, Tiranë
Revistë periodike Nr.4, (2004) “Pushteti Vendor”Botim i Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Gentgraphic, Tiranë
Karta Evropiane e Autonomisë Vendore, botim i Këshillit të Evropës, Stasbourg, Shkurt 1991
Projekt-Ligji “Kriteret dhe kushtet që do të ndiqen për riorganizimin e ndarjes administrativo-territoriale të Republikës së Shqipërisë”.
Ligji 8653, datë 31.07.2000 ’Për ndarjen administrative-territoriale të njësive vendore në Republikën e Shqipërisë’
Brahimi F, Muço L, (2009), “Manual për marrëdhëniet e njësive vendore me publikun”, AlbPAPER, Tiranë
Rekomandime të Shoqatës së Komunave për Reformën Territoriale, Miratuar në Komitetin Drejtues të ShKSh, në mbledhjen e datës 25 prill 2013
Ligji nr. 8991, datë 23.01.2003”Për disa ndryshime në ligjin “Për urbanistikën”
Ligji nr. 8744, datë, 22.02.2001”Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë vendore”
VKM nr. 81, datë 11.02.2004 “Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve në pronësi të qeverisjes vendore”
Ligji nr. 8927, datë, 25.07.2002 “Për prefektin”

VLERËSIMI I REALIZIMIT TË NEVOJAVE BAZË TË PACIENTËVE NË SPITALIN RAJONAL TË VLORËS PËR PERIUDHËN 15 MAJ-15 QERSHOR 2013

Msc. Ms Rozeta Luci, Msc.Brunilda Subashi, Msc. Glodiana Sinanaj, Mnd. Denada Selfo, Msc. Saemira Durmishi

Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali", Fakulteti i Shëndetit Publik.

University of Vlora "Ismail Qemali", Faculty of Public Health

rozarisilia@gmail.com

Abstrakt

Hyrje *"Nevoja e pacientit"* është një koncept dinamik që ndryshon me kalimin e kohës dhe me përparimin e sëmundjes. Nga shumë studime del se *nevojat kryesore* të pacientëve të hospitalizuar janë: besimi, komunikimi, informimi, edukimi, vetë-kujdesi dhe suporti.

Materiale dhe metodat Ky eshte nje studim transversaltal, deskriptiv. Të dhënat u mblodhën për nivelin e realizimit të nevojave bazë të pacientit. Ky studim u realizua, në Spitalin Rajonal të Vlorës, në periudhën kohore 15 maj deri në 15 qershor 2013, ku u përfshinë pacientë prej këtyre reparteve. U përdorën pyetësorë të strukturuar prej të cilëve u morën informacione mbi të dhënat e përgjithshme të pacientëve dhe opinioni që kishte pacienti mbi kujdesin infermieror që realizohej tek ai.

Rezultatet: Femra ishin 63 ose 48% dhe meshkuj 67 ose 51%. Numri më i madh i pacientëve kanë qenë me semundje të aparatit tretës 29.8%. Më pas vijnë sëmundjet e brendëshme me 17.7%, me sëm. kardiake ose 14.4%, me trauma të ndryshme ishin 13% e pacientëve. Tek pacientët që kanë patur vështirësi respiratore, familjarët kanë kryer ndërhyrjet për përmirësimin e frymëmarrjes në 46.6%, kurse infermieri është kujdesur për 52.1% të pacientëve. Pacientët që nuk realizonin dot lëvizjen, ndihmoheshin në 61,3% të rasteve prej familjarëve, 28.2% prej infermierëve dhe 2.4% prej sanitarëve. Infermieri ka ndërhyrë për të lehtësuar dhimbjen "shpesh" në 28.7% të rasteve dhe "gjithmonë" në 27.8% të pacientëve. Në 55.7% të rasteve, temperaturën e mat infermieri dhe në 18.3% e mat familjari. Pacientët kanë "mjaftueshëm" besim 45.8% e tyre dhe "shumë besim" 38.2% e pacientëve. Vetëm 9.9% kanë "pak besim' dhe 4.6% kanë "aspak besim" në punën e infermierit.

Konkluzionet: Infermieri kryen më shumë teknikat e terapisë. Të gjitha procedurat e tjera zënë një peshë shumë të vogël në përditshmërinë e punës së infermierit.

Fjalët kyç: pacientë, infermierë, nevoja bazë, vlerësim.

Abstract

Introduction The need of the patient is a dynamic concept that changes over time and with disease progression. From many studies it appears that the major

needs of hospitalized patients are: trust, communication, information, education, self-care and support.
Materials and methods This is a transversal and descriptive study. The data were gathered for the evaluation of the level of performance based on patient needs. This study was conducted in Vlora Regional Hospital, in the period 15 May to 15 June 2013. Were used structured questionnaires and were taken information for the general data of patients and the opinion that the patient had for the level of the fulfillment of the nursing care.
Results Females were 63 or 48% and men 67 or 51%. The largest number of patients, 29.8% was with the digestive tract deseases. Then come the internal diseases by 17.7%, with cardiac deseases were 14.4%, with various trauma were 13% of patients. In patients who have had respiratory difficulties, family members have conducted interventions to improve breathing in 46.6%, while nurses took care for 52.1% of patients. Patients, who could not realize the movement, were assisted in 61.3% of cases from relatives, in 28.2% of cases from nurses and 2.4% from cleaning staff.
The nurse has intervened to alleviate the pain "often" in 28.7% of cases and "always" in 27.8% of patients. In 55.7% of cases, temperature is measured by the nurse and in 18.3% family member measures it. Patients have "enough" of their trust and 45.8% "much trust" 38.2% of patients. Only 9.9% have "little faith" and 4.6% have "no trust" in the work of the nurse.
Conclusions The nurse conducts more therapy techniques. All other procedures occupy a very small weight in the daily work of the nurse.

Key words patients, nurses, basic needs, evaluation.

Hyrje

"Nevoja e pacientit" është një koncept dinamik që ndryshon me kalimin e kohës dhe me përparimin e sëmundjes. Gjithashtu thuhet se "nevojat e pacientëve" ndryshojnë në përputhje me traditat shpirtërore dhe kulturore të pacientëve. Shumë studime treguan se nevojat kryesore të pacientëve të hospitalizuar janë: besimi, komunikimi, informimi, edukimi, vetë-kujdesi dhe mbështetja (suporti). Në këtë kuptim, mos realizimi i "*nevojave të pacientëve*" të hospitalizuar ushron një ndikim negativ në rezultatin e sëmundjes dhe imponon një barrë të madhe financiare për Sistemin Shëndetësor Kombëtar në secilin vend. Hulumtimet e fundit kanë konfirmuar dëshirën e pacientëve dhe dëshirën që ata kanë për të marrë pjesë në kujdesin e tyre. Rëndësia e të kuptuarit të vlerësimit të nevojave të pacientëvetë hospitalizuar, duhet të nxisin profesionistët e shëndetit për të siguruar kujdes efikas për pacientët. [1]
Sipas Maslout, sjellja njerezore mund të shpjegohet si një motivim për të kënaqur nevojat. Ai i organizoi nevojat njerëzore në pesë kategori: nevojat fiziologjike, nevojat e sigurisë, nevojat e dashurisë dhe përkatësise, nevojat për vlerësim dhe për vetëaktualizim. ***Nevojat bazë*** janë fiziologjike (ushqimi, pija etj) dhe psikologjike (nevojat për siguri, dashuri, perkatësi dhe vlerësim). [2]
Funksioni unik i infermierit është që të ndihmojë individin e sëmurë në kryerjen e aktiviteteve që kontribuojnë në shëndetin apo rikuperimin e tij (ose në një vdekje të qetë) në mënyrë për të ndihmuar ata që të arrijnë pavarësinë sa më shpejt të jetë e mundur, një aktivitet që individi do ta kryente pa ndihmë në qoftë se do te kishte forcën, vullnetin ose njohuritë e nevojshme. [3]

Materiale dhe metoda

Ky eshte nje studim transversaltal, prospektiv, deskriptiv, kuantitativ. Të dhënat u mblodhën për nivelin e realizimit të nevojave bazë të pacientit. Ky studim u realizua në tri pavione të Spitalit Rajonal të Vlorës, SRV, përkatësisht në Pavionin e Patologjisë, Kirurgjisë dhe Terapisë Intensive në periudhën kohore 15 maj deri në 15 qershor 2013. Në këtë studim u përfshinë pacientë prej këtyre reparteve te cilët iu nënshtruan intervistave dhe pyetësorëve specifikë. U përdorën pyetësorë të strukturuar. Mostra për kete studim konsistoi në 131 pacientë, të ndarë sipas pavioneve si më poshtë; P. Patologjisë 55 pacientë, P. Kirurgjisë 54 pacientë, RTI 22 pacientë. U përfshi një nr. më i vogël i pacientëve nga RTI për vetë specifikat e sëmundjeve që këta pacientë paraqisnin (një gjendje të rëndë shëndetësore të pacientëve dhe një nr. më i ulët i shtretërve ne këtë shërbim).
Nga pyetësori u morën informacione mbi të dhënat e përgjithshme të pacientëve si mosha, gjinia, gjëndjen e përgjithshme të pacientit, motivin e shtrimit, sëmundjet që e shoqëronin, pavionin e shërbimit, dhe opinioni që kishte pacienti mbi kujdesin infermieror që realizohej tek ai, si: niveli i ndërhyrjes së infermierit në rast të problemeve respiratore, në realizimin e ushqyerjes, në eleminimin (urimin), ndërhyrjet për përmirësimin e dhimbjes, matjeve të temperatures, realizimin e lëvizjeve të pacientit, realizimin e higjenës në kushte spitalore dhe mbi besimin që kanë pacientët tek ndërhyrjet e infermierit.

Rezultatet

Të dhënat statistikore për shpërndarjen e moshës së pacientëve

N	**Valid**	129
	Missing	2
	Mean	49.3721
	Std. Error of Mean	1.67050
	Median	50.0000
	Std. Deviation	18.97328
	Variance	359.985
	Range	74.00
	Minimum	9.00
	Maximum	83.00
Percentiles	25	34.5000
	50	50.0000
	75	65.0000

Sipas tabelës shihet se mosha në këtë studim është plotësuar si opsion nga vetë pacientët dhe në këtë rast është njësi skalare. Në tabelën e mësipërme janë përcaktuar njësitë e dispersionit të moshës, si mesatarja 49.37vjec, mesorja =50, percentilet, kufiri i sipërm 83 vjec dhe i poshtëm 9 vjec, deviacioni standart 18.97328 dhe varianca = 359.985.



Figura 1 Paraqitja grafike e shpërndarjes sipas gjinisë
Nga grafiku i më sipërm shohim se nga131 pacientë që janë marrë në studim gjithsej (ku 1 prej tyre nuk është përgjigjur pyetjes për gjininë), shpërndarja rezulton e tillë:
Femra ishin 63 ose 48%
Meshkuj 67 ose 51%



	Kardiake	Respiratore	Brendshme	Trauma	Veshka	Sem Ap Tretes	Sem te Gjakut	Sis Nervor
Percent	14.5	8.4	17.6	13	6.9	29.8	2.3	7.6
Frequency	19	11	23	17	9	39	3	10

Figura 2 Grafiku i shpërndarjes së pacientëve sipas patologjive në shtrim
Nga grafiku i mësipërm shohim se numri më i madh i pacientëve kanë qenë me semundje të aparatit tretës gjithsej 39 ose 29.8%. Më pas vijnë sëmundjet e brendëshme me 23 pacientë ose 17.7%, 19 ishin pacientë me sëm. kardiake ose 14.4%. Me trauma të ndryshme ishin 17 pacientë ose 13%,



Figura 3 Grafiku i shpërndarjes së pacientëve sipas pavioneve.
Nga sa paraqitet në grafik shohim se nr. më i madh i pacientëve të marrë në studim është në pavionin e kirurgjisë, 55 ose 42 %. Në patologji janë marrë 54 pacientë ose 41.2%. Në RTI (reanimacion) janë marrë 22 ose 16.8%

Tabela 2 Procedura, ku ka asistuar infermieri

Procedura_Asistuar_Infermieri					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Ndryshim Pozicioni	27	20.6	20.9	20.9
	Shoqerimin ne Tualet	6	4.6	4.7	25.6
	Ushqyerje	6	4.6	4.7	30.2
	Terapi	85	64.9	65.9	96.1
	Higjenen	3	2.3	2.3	98.4
	Ekzaminime	2	1.5	1.6	100.0
	Total	129	98.5	100.0	
Missing		2	1.5		
	Total	131	100.0		



Figura 4 Paraqitja grafike sipas procedurës për të cilën është asistuar prej infermierit

Nga të dhënat e tabelës dhe grafiku shohim se tek pacientët, infermieri kryen më shumë teknikat e terapisë me 64.9% dhe ndryshimin e pozicionit të të sëmurit në 20.6% të rasteve.

Të gjitha procedurat e tjera zenë një peshë shumë të vogël në përditshmërinë e punës së infermierit. Infermierët zënë një kohë të madhe vetëm për realizimin e terapisë.

Tabela3 Paraqitja e të dhënave për praninë e vështirësisë respiratore * dhe kush ndihmoi në përmirësimin e frymëmarrjes

			Kush_Ndihmoi_Frymemarrjen			
			Familjari	**Infermieri**	**Tjetër**	**Total**
Veshtiresi në Frymemarrje	**Po**	Count	**34**	**38**	**1**	**73**
		% ëithin Veshtiresi_Frymemarrje	**46.6%**	**52.1%**	**1.4%**	**100.0%**
		% Kush_Ndihmoi_Frymemarrjen	**89.5%**	**97.4%**	**6.7%**	**79.3%**
		% of Total	**37.0%**	**41.3%**	**1.1%**	**79.3%**
	Jo	Count	**4**	**1**	**14**	**19**
		% ëithin Veshtiresi_Frymemarrje	**21.1%**	**5.3%**	**73.7%**	**100.0%**
		% Kush_Ndihmoi_Frymemarrjen	**10.5%**	**2.6%**	**93.3%**	**20.7%**
		% of Total	**4.3%**	**1.1%**	**15.2%**	**20.7%**
	Total	Count	**38**	**39**	**15**	**92**
		% ëithin Veshtiresi_Frymemarrje	**41.3%**	**42.4%**	**16.3%**	**100.0%**
		% Kush_Ndihmoi_Frymemarrj	**100.0%**	**100.0%**	**100.0%**	**100.0%**

		en % of Total	**41.3%**	**42.4%**	**16.3 %**	**100.0 %**



Figura 5 Paraqitja grafike e të dhënave për praninë e vështirësisë respiratore dhe kush ndihmoi në përmirësimin e frymëmarrjes

Nga të dhënat e tabelës dhe grafiku më sipër shohim se tek pacientët që kanë patur vështirësi respiratore, familjarët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ndërhyrjet për përmirësimin e frymëmarrjes në 34 pacientë ose 46.6%, kurse infermieri është kujdesur për 52.1% të pacientëve.

Figura 6 Grafiku dhe tabela e të dhënave për ndihmën që ka dhënë infermieri në ushqyerjen e pacientit.



	Asnjehere	Rralle	Ndonjehere	Shpesh	Gjithmone
Frequency	72	14	30	11	3
Percent	55	10.7	22.9	8.4	2.3

Grafiku i mësipërm pasqyron shpërndarjen e gadishmërisë që ka patur infermieri për të dhënë ndihmën pacientit në ushqyerje.

Kështu nga 131 pacientë, 130 i janë përgjigjur pyetjes dhe prej tyre rezulton se 72 ose 55% nuk janë ndihmuar asnjeherë në ushqyerje nga infermieri, 14

pacientë ose 10.7% e kanë marrë "rrallë" ndihmën nga infermieri, 30 pacientë ose 22.9% janë ndihmuar 'ndonjëherë' në ushqyerje prej infermierit, 11 pacientë ose 8.4% janë ndihmuar "shpesh" nga infermieri për të realizuar ushqyerjen. 2.3% e pacientëve janë ndihmuar "gjithnjë" në ushqyerje prej infermierit.

Tabela 4 Mënyra si urinon pacieni * Kush ka ndihmuar në realizimin e urinimit

Tabela: Mënyra si urinoni * Kush ka ndihmuar në realizimin e urinimit							
			Ndihme_Urinimi				
			Infermieri	Familjaret	Vete	Sanitari	Total
Urinoni	Normal	Count	5	20	44	1	70
		% ëithin Urinoni	7.1%	28.6%	62.9%	1.4%	100.0%
		% ëithin Ndihme_Urinimi	41.7%	51.3%	74.6%	7.1%	56.5%
		% of Total	4.0%	16.1%	35.5%	.8%	56.5%
	Me kateter	Count	7	15	9	13	44
		% ëithin Urinoni	15.9%	34.1%	20.5%	29.5%	100.0%
		% ëithin Ndihme_Urinimi	58.3%	38.5%	15.3%	92.9%	35.5%
		% of Total	5.6%	12.1%	7.3%	10.5%	35.5%
	Nuk e kontrollon i dot	Count	0	3	5	0	8
		% ëithin Urinoni	.0%	37.5%	62.5%	.0%	100.0%
		% ëithin Ndihme_Urinimi	.0%	7.7%	8.5%	.0%	6.5%
		% of Total	.0%	2.4%	4.0%	.0%	6.5%
	Tjeter	Count	0	1	1	0	2
		% ëithin Urinoni	.0%	50.0%	50.0%	.0%	100.0%
		% ëithin Ndihme_Urinimi	.0%	2.6%	1.7%	.0%	1.6%
		% of Total	.0%	.8%	.8%	.0%	1.6%
	Total	Count	12	39	59	14	124
		% ëithin Urinoni	9.7%	31.5%	47.6%	11.3%	100.0%
		% ëithin Ndihme_Urinimi	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
		% of Total	9.7%	31.5%	47.6%	11.3%	100.0%



Figura 7 Grafiku i mëposhtëm tregon shpërndarjen e mënyrës së urinimit dhe kush ka ndihmuar në realizimin e urinimit te pacienti.

Nga të dhënat e tabelës dhe grafiku i mësipërm shohim se kur pacienti ka urinuar normal në 62.9% të rasteve e ka realizuar vete urinimin dhe në 28.6% të rasteve është ndihmuar prej familjarëve të tij.

Kur urinimi kryhej me kateter 35.5% e tyre janë ndihmuar prej infermierit dhe në një vlerë më të lartë, 38.6% prej familjarëve.Vetë e kanë realizuar 20.5% e pacientëve dhe ajo që bie dukshëm në sy është se në 29.5% të rasteve pacientët janë ndihmuar prej sanitarëve. Në rastet kur pacienti nuk e kontrollon dot urinimin, ndihma e infermierit ka munguar totalisht.

Tabela 5 Të dhënat për realizimin e lëvizjeve prej pacientit * dhe nga cilët ndihmoheshin në këto lëvizje

			Ndihme_Levizjeje				
			Infermieri	**Sanitarja**	**Familjari**	**Tjeter**	**Total**
Realizoni_Levizjet	**Po**	Count	22	2	51	9	84
		% ëithin Realizoni_Levizjet	26.2%	2.4%	60.7%	10.7%	100.0%
		% ëithin Ndihme_Levizjeje	62.9%	66.7%	67.1%	90.0%	67.7%
		% of Total	17.7%	1.6%	41.1%	7.3%	67.7%
	Jo	Count	13	1	25	1	40
		% ëithin Realizoni_Levizjet	32.5%	2.5%	62.5%	2.5%	100.0%
		% ëithin Ndihme_Levizjeje	37.1%	33.3%	32.9%	100.0%	100.0%
		% of Total	10.5%	.8%	20.2%	8%	32.3%
	Total	Count	35	3	76	10	124
		% ëithin Realizoni_Levizjet	28.2%	2.4%	61.3%	8.1%	100.0%
		% ëithin Ndihme_Levizjeje	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
		% of Total	28.2%	2.4%	61.3%	8.1%	100.0%



Figura 8 Paraqitja grafike e të dhënave për realizimin e lëvizjeve prej pacientit * dhe nga cilët ndihmoheshin pacientët në këto lëvizje.

Nga tabela dhe grafiku shohim se pacientët që i kryejnë vetë lëvizjet, ndihmohen në masën 60.7% (51 pacientë) të rasteve prej familjarëve. 22 pacientë ose 26.2% e tyre ndihmoheshin prej infermierëve dhe 9 pacientë ose 10.7% ndihmoheshin prej tjetër(miqve, shokëve). Pacientët që nuk realizonin dot lëvizjen, ndihmoheshin në 61,3% të rasteve prej familjarëve, 35 ose 28.2% prej infermierëve dhe 2.4% prej sanitarëve. Edhe për ndihmën në lëvizjen e pacientit infermieri luan një rol të vogël.

Tabela 6 Të dhënat nëse kanë dhimbje *A janë ndihmuar nga infermieri për të lehtësuar dhimbjen?

			Ndihme_Infermieri_Dhimbje					
			Asnje X	**Rralle**	**Ndonje X**	**Shpesh**	**Gjithmone**	**Total**
Keni Dhimbje	**Po**	Count	14	13	20	31	30	108
		% ëithin Keni_Dhimbje	13.0%	12.0%	18.5%	28.7%	27.8%	100.0%
		% Ndihme_Infermieri_Dhimbje	60.9%	81.3%	90.9%	91.2%	96.8%	85.7%
		% of Total	11.1%	10.3%	15.9%	24.6%	23.8%	85.7%
	Jo	Count	9	3	2	3	1	18
		% ëithin Keni_Dhimbje	50.0%	16.7%	11.1%	16.7%	5.6%	100.0%
		% Ndihme_Infermieri_Dhimbje	39.1%	18.8%	9.1%	8.8%	3.2%	14.3%
		% of Total	7.1%	2.4%	1.6%	2.4%	.8%	14.3%
	Total	Count	23	16	22	34	31	126
		% ëithin Keni_Dhimbje	18.3%	12.7%	17.5%	27.0%	24.6%	100.0%
		% Ndihme_Infermieri_Dhimbje	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
		% of Total	18.3%	12.7%	17.5%	27.0%	24.6%	100.0%

Në tabelë shohim shpërndarjen e pacientëve që kanë patur ose jo, dhimbje dhe në rastet kur kanë patur, sa herë e ka dhënë ndihmën infermieri për të lehtësuar dhimbjen. Kur pacientët kanë patur dhimbje gjithsej 108 ose 85.7%, infermieri ka ndërhyrë për të lehtësuar atë "shpesh" në 28.7% të rasteve dhe "gjithmonë" në 27.8% të pacientëve.



Figura 9 Të dhënat nëse kanë dhimbje *A janë ndihmuar nga infermierët për të lehtësuar dhimbjen?

Në grafik shohim se kur pacientët kanë patur dhimbje gjithsej 108 ose 85.7%, infermieri ka ndërhyrë për të lehtësuar atë 'shpesh' në 28.7% të rasteve dhe 'gjithmonë' në 27.8% të pacientëve.

Tabela 7 Të dhënat kush e mat temperaturën

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	**Infermieri**	73	55.7	62.4	62.4
	Familjari	24	18.3	20.5	82.9
	Vete	5	3.8	4.3	87.2
	Tjeter	15	11.5	12.8	100.0
	Total	117	89.3	100.0	
Missing		14	10.7		
	Total	131	100.0		



Figura 10 Grafiku i shpërndarjes kush e mat temperaturën
Grafiku dhe tabela pasqyrojnë se kush e realizon procedurën e matjes së temperaturës te pacienti. Shihet se në 55.7% të rasteve, temperaturën e mat infermieri dhe në 18.3% e mat familjari.

Figura 11 Besimi që kanë pacientët në punën e infermierit



Nga tabela dhe grafiku shohim se panvarsisht nivelit dhe cilësisë së kujdesjeve, pacientët kanë mjaftueshëm besim 45.8% e tyre dhe shumë besim 38.2% e pacientëve. Vetëm 9.9% kanë pak besim dhe 4.6% kanë aspak besim në punën e infermierit.

Konkluzionet

- Mesatarja e moshës së marrë në studim ishte 49.37vjec. Femra ishin 63 ose 48% dhe meshkuj 67 ose 51%. Numri më i madh i pacientëve kanë qenë me semundje të aparatit tretës gjithsej 39 ose 29.8%. Më pas vijnë sëmundjet e brendëshme me 23 pacientë ose 17.7%, 19 ishin pacientë me sëm. kardiake ose 14.4%. Me trauma të ndryshme ishin 17 pacientë ose 13%.
- Nr. më i madh i pacientëve të marrë në studim është në pavionin e kirurgjisë, 55 ose 42 %. Në patologji janë marrë 54 pacientë ose 41.2%. Në RTI (reanimacion) janë marrë 22 ose 16.8%.
- Tek pacientët që kanë patur vështirësi respiratore, familjarët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ndërhyrjet për përmirësimin e frymëmarrjes në 34 pacientë ose 46.6%, kurse infermieri është kujdesur për 52.1% të pacientëve.
- Rezulton se 55% e pacientëve nuk janë ndihmuar asnjeherë në ushqyerje nga infermieri, 14 pacientë ose 10.7% e kanë marrë "rrallë" ndihmën nga infermieri, 30 pacientë ose 22.9% janë ndihmuar 'ndonjëherë' në ushqyerje prej infermierit, 11 pacientë ose 8.4% janë ndihmuar "shpesh" nga infermieri për të realizuar ushqyerjen. 2.3% e pacientëve janë ndihmuar "gjithnjë" prej infermierit.

- Kur pacienti ka urinuar normal në 62.9% të rasteve e ka realizuar vete urinimin dhe në 28.6% të rasteve është ndihmuar prej familjarëve të tij. Kur urinimi kryhej me kateter 35.5% e tyre janë ndihmuar prej infermierit dhe në një vlerë më të lartë, 38.6% prej familjarëve.Vetë e kanë realizuar 20.5% e pacientëve dhe ajo që bie dukshëm në sy është se në 29.5% të rasteve pacientët janë ndihmuar prej sanitarëve.
- Pacientët që nuk realizonin dot lëvizjen, ndihmoheshin në 61,3% të rasteve prej familjarëve, 35 ose 28.2% prej infermierëve dhe 2.4% prej sanitarëve. Edhe për ndihmën në lëvizjen e pacientit infermieri luan një rol të pakët.
- Kur pacientët kanë patur dhimbje gjithsej 108 ose 85.7%, infermieri ka ndërhyrë për të lehtësuar atë "shpesh" në 28.7% të rasteve dhe "gjithmonë" në 27.8% të pacientëve.
- Në 55.7% të rasteve, temperaturën e mat infermieri dhe në 18.3% e mat familjari.
- Panvarsisht nivelit dhe cilësisë së kujdesjeve, pacientët kanë "mjaftueshëm besim: 45.8% e tyre dhe "shumë besim" 38.2% e pacientëve. Vetëm 9.9% kanë "pak besim" dhe 4.6% kanë "aspak" besim në punën e infermierit.

Rekomandimet

- Përpara se të dizenjohen dhe të përcaktohen strategjitë e kujdesit dhe suportit të pacientit, duhet të identifikohen prej infermierëve dhe pacientëve cilat janë problemet me të cilat ata përballen sipas këndvështrimit të tyre.
- Përmirësimi i kushteve të punës dhe infrastrukturës spitalore duke rritur kështu nivelin e shërbimit dhe përmirësimit të
- Menaxhuesit e reparteve duhet të mëshojnë në forcimin e frymës së bashkëpunimit në grup dhe të inkurajojnë mardhëniet e mira brenda ekipit me qëllim rritjen e aftësive të infermierëve për të ndihmuar njëri-tjetrin.
- Drejtuesit e pavioneve duhet të organizojnë, përcaktojnë dhe të ndajnë detyrat tek infermierët sipas kompetencave dhe përgjegjësive që detyra u ngarkon.

Literatura

Needs of hospitalized patients, Health Science Journal, VOLUME 5, ISSUE 1

(2011)

Theodhori Karaj: Psikologjia e zhvillimit të femijës, botimi II 2010 fq.35.

Virginia Henderson1966, "Principet dhe Praktika ne Infermieri" fq.166.

RËNDËSIA E RUAJTJES SË PRIVATËSISË SË PACIENTËVE TË HOSPITALIZUAR

Rudina Çerçizaj, Emirjona Kiçaj
Fakulteti i Shëndetit Publik
rudina_2005@hotmail.com

Abstract

Hyrje: Ruajtja e të dhënave personale të pacientit mund të kontribuojë në mënyrë sinjifikante në sigurimin e një besimi më të mirë midis pacientit dhe personelit infermieror.
Qëllimi: Të vlerësohet respektimi i privatësisë tek pacientët për të kuptuar nëse disa nga normat legjislative të lidhura me privatësinë praktikohen prej personelit infermieror.
Objektivat specifikë: Të përcaktohet nëse pacientët janë të informuar për mënyrën si përpunohen të dhënat e tyre. Të vlerësohet respektimi i privatësisë së pacientëve të shtruar sipas reparteve të shërbimit në këtë spital.
Materiale dhe metoda: Ky është një studim Cross – Sectional i realizuar në Spitalin Rajonal, Vlorë në periudhën *Maj 2013*. Në këtë studim u përfshinë 100 pacientë. Për këtë studim është përdorur një pyetësor i vetëadministruar.
Rezultatet: Mosha mesatare e pjesmarrësve ishte 48.24 vjeç. 47% femra dhe 53% meshkuj. 58% referuan se nuk ishin të informuar për mënyrën e përpunimit të dhënave, 36% kanë referuar respektimin e plotë të privatësisë prej infermierëve, 83% kanë referuar se janë thirur në emër të plotë me zë të lartë prej personelit infermieror në prani të personave të panjohur.
Konkluzionet: Përdorimi i perdeve ndarëse nuk përbënte një nga veprimet paraprake të cdo infermieri përpara se të realizonte procedurën infermierore. Reparti ku pacientët kanë ndjerë më shumë respektimine privatësisë është Terapia Intesive.

Fjalët kyçe: Privatësi, Të dhëna personale, Infermier

Hyrje: Ruajtja e privatësisë është një nga të drejtat bazë jo vetëm e pacientit por e gjithë shoqërisë. Ruajtja e kësaj të drejtë, duke respektuar informacionet individuale shëndetësore të cdo pacienti, është një nga detyrimet etike dhe legale të personelit infermieror si një nga pjestarët e shërbimit shëndetësor.
Cdo infermiere duhet të kuptojë dhe të respektojë në të njëjtën kohë privatësinë e pacientit. Si profesioniste e ardhshme, lidhja e personelit infermieror me pacientët është një nga hapat më të rëndësishme për të fituar dhe besimit e pacientit gjatë këtsaj marrëdhënie interactive.

Qëllimi i studimit: Të vlerësohet respektimi i privatësisë tek pacientët e shtruar në spitalin Rajonal, Vlorë për të kuptuar nëse disa nga normat legjislative të lidhura me privatësinë praktikohen prej personelit infermieror në mënyrë të tillë që të sugjerohen ndërhyrjet e duhura nëse do të jetë e nevojshme.

Objektivat specifikë:

- Të përcaktohet nëse pacientët janë të informuar në lidhje më mënyrën se si përpunohen të dhënat e tyre.
- Të përcaktohet sesi pacientët referojnë respektimin e privatësisë në ambjentin e spitalit prej personelit infermieror.
- Të vlerësohet respektimi i privatësisë së pacientëve të shtruar në spitalin Rajonal sipas reparteve të shërbimit shëndetësor në këtë spital.

Metodologjia e studimit: Ky është një studim *deskriptiv Kros Seksional*, i realizuar në Spitalin Rajonal, Vlorë gjatë periudhës kohore *Maj 2014*. Në këtë studim u përfshinë pacientët e shtruar në Spitalin Rajonal Vlorë. Në këtë studim morën pjesë *100 pacientë* të shtruar në:

- Repartin e Patologjisë (20 pacientë)
- Repartin e Kirurgjisë (20 pacientë)
- Repartin e Terapisë Intesive (20 pacientë)
- Spitalin Infektiv (20 pacientë)
- Shërbimin Obtetrikë - Gjinekologjisë. (20 paciente)

Pjesëmarrësit në këtë studim u zgjodhën në mënyrë *rastësore*.
Nga ky studim u përjashtuan pacientët e moshave pediatrike të shtruar në repartin e Pediatrisë.
Informacion për pyetësorin e përdorur:
Për këtë studim kam përdorur një pyetësor të vetë administruar, të cilin e kam përgatitur pasi kam realizuar një studim të kujdesshëm të literaturës.
Pyetësori ishte anonim. Përbëhej nga 5 elementë si:
Grupi i parë i pyetjeve përbën informacionin në lidhje me të dhënat personale të pjesmarrësve të përfshirë në studim: mosha,gjinia, vendbanimi, niveli arsimor dhe profesioni.
Grupi i dytë i pyetjeve përbën informacionin në lidhje me shtrimin në spital: eksperienca e pare e qëndrimit në spital apo jo si dhe ditëqëndrimet e pjesmarrësve në spital dhe numri i shtretërve të dhomës ku pacientët kanë marë shërbimin shëndetësor spitalor, shërbimi ku janë ofruar përkujdesjet shëndetësore.
Grupi i tretë i pyetjeve përbën informacionin në lidhje me mënyrën sesi pacientët e kanë perceptuar respektimin e privatësisë. Ky grup përfshin 4 pyetje në lidhje me: mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, respektimin e privatësisë, përdorimin e perdeve ndarëse, zbulimin e pjesëve të ndryshme trupore gjatë ofrimit të shërbimit shëndetësor,
Grupi i katërt i pyetjeve përbën informacioin në lidhje me perceptimin e pjesmarrësve kundrejt respektimit të privatësisë gjatë identifikimit të

pacientëve: përdorimin e emrit të plotë të pacientit në prani të personave të tjerë .
Grupi i pestë i pyetjeve përbën informacinin në lidhje me perceptimin e pjesmarësve kundrejt respektimit të privatësisë gajtë mbledhjes së të dhënave të pacientëve.
Përpara shpërndarjes së pyetësorit tek pacientët kam realizuar një *punë pilot* në 10 pacientë. Këtyre pacientëve u shpërndava pyetësorin dhe pasi pashë se pyetësori ishte i kuptueshëm për ta më pas këtë pyetësor e shpërndava dhe në 90 pacientët e tjerë.
Plotësimi i pyetësorëve u realizua në mënyrë vullnetare prej pacientëve.

Prezantimi i rezultateve te studimit.

Tabela 1. Shpërndarja e pjesmarësve sipas të dhënave socio demografike.

Variablat	Numri	%	Mesatarja	SD
Mosha (në vite)	100	100%	45.8	1.402
Gjinia				
Mashkull	47	47		
Femër	53	53		
Vendbanimi				
Qytet	54	54		
Fshat	46	46		
Statusi i punësimit				
I papunë	41	41		
Punëtorë	17	17		
Nënpunës	8	8		
Aktivitet personal	12	12		
Grup inaktiv	22	22		
Shpeshtësia e shtrimit në spital				
Hera e parë	23	32.9		
Shtrime të mëparshme	12	17.1		
Niveli arsimor				
Më pak se 8 vite	21	21		
8 vite	23	23		
12 vite	40	40		
16 vite	12	12		
Mbi 16 vite	4	4		
Ditëqëndrimet në spital				
Dita e parë	15	15		
2 – 3 ditë	33	33		

4 – 5 ditë	20	20
6 – 7 ditë	11	11
8 – 9 ditë	9	9
Mbi 10 ditë	12	12
Numri i shtretërve në dhomën e shtrimit		
Me 1 shtrat	0	0
Me 2 shtretër	33	33
Me 4 shtretër	31	31
Me 6 shtretër	36	36

Në këtë studim 24% e pjesmarrësve ishin të grupmoshës mbi 65 vjec, 19% e tyre ishin të grupmoshës 46 – 55vjec, 17% ishin të grupmoshës 36 – 45 vjec, 14% ishin 18 – 25 vjec, 13% ishin 26 – 35 vjec dhe po prapë 13 % ishin të grupmoshës 56 – 65 vjec.
47% e pjesmarrësve janë femra dhe 53% janë meshkuj.
54% e pjesmarësve jetojnë aktualisht në qytet dhe 46% e tyre jetojnë në fshatrat përreth qytetit të Vlorës.
40% e pjesmarrësve janë me 12 vite shkollë, 23% janë me 8 vite shkollë, 21% janë me më pak se 8 vite shkollë, 12% me 6 vite shkollë dhe vetëm 4% e tyre ishin mbi 16 vite shkollë.
41% e pjesmarrëse ishin të papunë, 22 % ishin grup inaktiv, 17% ishin punëtorë, 12% kishin aktivitet personal dhe 8% e tyre ishin nënpunës administrate.
57% e pjesmarrësve kanë patur dhe shtrime të tjera të mëparshme dhe 43 % e tyre janë shtruar për herë të parë në spital.
33% e pjesmarrësve kanë qënduar2-3ditë,20%e pjesmarrësve kanë qëndruar 4-5ditë,15%e pjesmarrësve e kanë pasurë ditën e parë,12%e pjesmarrësve kanë qëndruar mbi 10ditë,11%e pjesmarrësve kanë qëndruar 6-7ditë dhë9% e pjesmarrësve kanë qëndruar 8-9ditë.
36% e pacientëve kanë qëndruar në dhoma me 6 shtretër,33% e pacientëve kanë qëndruar në dhoma me 2 shtretër,31% e pacientëve kanë qëndruar në dhoma me shtretër.
Grafiku 1.Perpunimi i te dhenave personale dhe repartit te sherbimit te ofruar.



15% e pacientëve në repartin e patologjis nuk janë të informuar në lidhje me mënyrën e përpunimit të të dhënave dhe 5% janë të inforumur.10% e pacientëve në repartin e kirurgjis nuk janë te informuar në lidhje me mënyrën e përpunimit të të dhënave dhe 12% janë të informuar.5% e pacientëve në repartin e terapisë intesive nuk janë të informuar në lidhje me mënyrën e përpunimit të të dhenave dhe 15% janë të informuar. 12% e pacientëve ne repartin e maternitetit nuk janë të informuar në lidhje me mënyrën e përpunimit të të dhënave dhe 8% janë të informuar.16% e pacientëve ne repartin e infektivit nuk janë të informuar në lidhje me mënyrën e përpunimin të të dhenave dhe 4% janë të informuar.

Grafiku 2. Perceptimi i privatesise prej personelit infermieror sipas reparteve.



5% e pacientëve ne repartin e patologjis mendojn se është respektuar privatësia prej personelit infermieror ,10% e pacientëve po por jo ne mënyrë të

plotë.dhe 5% e tyre mendojn jo aspak.6% e pacientëve ne repartin e kiurgjis mendojn se është respektur privatësia prej personeli infermieror,9% e pacienëve po por jo ne mënyrë të plotë dhe 5% e tye mendojn jo aspak.11% e pacientëve ne repartin e terapis intesive mendojn se është respektuar pivatësia prej personelit infermieror, 8% e pacientëve po por jo ne mënyrë të potë dhe 1% e tyre jo aspak.8% e pacientëve ne repartin e maternitetit mendojn se është espektuar privatësia pej personelit infermieror,4% e pacentëve po por jo ne mënyrë të plotë dhe 8%e tyre mendojn jo aspak.6% e pacentëve ne repartin e infektivit mendojn se është respektuar privtatësia pej personelit infermieror ,11% e pacientëve po por jo ne menyrë të plotë dhe 3% jo aspak.

Grafiku 3. Përdorimi i perdeve ndarëse gjatë ofrimit te shërbimit dhe reparteve.



20% e pacientëve në repartin e patologjis mendojn se nuk janë përdoru perde ndarëse gjatë ofrimit të shërbimit.20% e paciemtëve në repartin e kirurgjis mendojn se nuk janë përdorur perde ndarëse gjatë ofrimit të shërbimit.20% e pacientëve në repartin e terapis intesive mendojn se nuk janë pëedorur perde ndarëse gjatë ofrimit të shërbimit.20% e pacientëve ne repartin e maternitetit mendojn se nuk janë persorur perde ndarëse gjatë ofrimit të shërbimit.20% e pacientëve ne repatin e infektivit mendojn se nuk janë përdorur perde ndarëse gjatë ofrimit të shërbimit.

Grafiku 4. Zbulimi i pjesëve trupore prej personelit infermieror në prani të personave të tjerë dhe repartit të shërbimit të ofruar.



Grafiku 5. Ndjesia e pacientëve për perceptimin e situatës ku janë zbuluar pjesë të tjera të trupit në prani të personave të tretë.



42% e pacientëve nuk janë ndjerë ne siklet ,29% e pacintëve janë ndjerë paksa në siklet dhe 29% e tyre janë ndierë shumë në siklet.

Grafiku 6. Përdorimi i emrit të plotë prej infermierit me zë të lartë në prani të personave të tretë.



33 ose 40% e e personave të cilëve u është drejtuar me zë të lartë në emër dhe mbiemër në prani të personave të tretë e kanë perceptuar përdorimin e plotë të emrit si një mënyrë që nuk e ka demtuar privatësinë e tyre. 20 (24%) e tyre e kanë perceptuar përdorimin e merit të plotë si mungesë të ruajtjes së privatësisë dhe 30 (36%) nuk janë të siggurt në këtë drejtim.

Grafiku 7. Paraqitja grafike e shpërndarjes së pjesmarrësve sipas tansmetimit të informacionit në lidhje me patologjinë e tyre tek personat e tretë.



43% e pacientëve mendojn se nuk është bërë transmetimi i informacionit tek personat e tretë,30% mendojn se është bërë transmetimi i informacionit tek personat e tertë dhe 27% e pacientëve nuk e din.

Grafiku 8. Paraqitja grafike e shpërndarjes së pjesmarrësve sipas pyetjes: Cili pjestar I ekipit mjekësor ka realizuar transmetimin e të dhënave tek personat e tr
etë.



10% e pacientëve mendojn se trasmetimi I të dhënave është realizuar nga mjeku kurues,19% e pacientëve mendojn se transmetimi I të dhënave është realizuar nga infermieri I dhomës,1% e pacientëve mendojn se transmetimi I të dhënave është realizuar nga k/infermieri ,70%e pacientëve nuk e din se nga kush është bërë transmetimi i të dhënave .

Grafiku 10. Perceptimi i respektimit të privatësisë sipas herëve të shtrimit.



Konkluzionet

Realizimi i këtij studimi duke u bazuar në numrin e pacientëve jo shumë të madh nuk lejon gjeneralizimin e plotë të rezulateteve.
Megjithatë ajo që vihet re nga studimi i realizuar, se është shumë e nevojshme realizimi i një pune shumë të madhe prej personelit infermieror deri sa normat legjislative në lidhje me ruajtjen e privatësisë të aplikohet gjerësisht gjatë përkujdesjeve infermierore.
Ajo që u vu re gjatë këtij studimi ishte se përdorimi i perdeve ndarëse nuk përbënte një nga veprimet paraprake të cdo infermieri përpara se të realizonte

procedurën e kërkuar infermierore tek pacientët tek të gjitha repartet ku u shpërnda pyetësori.
Reparti ku pacientët janë shprehur se kanë ndjerë më shumë respektimine privatësisë është ai i Terapisë intesive.
70% e të intervistuarve u shprehën se nuk kishin informacion se cili pjestar i ekipit mjekësor kishte ransmetuar të dhënat e tyre tek familjarët. 19% referuan se ishte infermieri i dhomës ai që kishte transmetuar të dhënat.
Shpesh herë infermieri përdor emrin e plotë të pacientit dhe në prani të personave të tretë të cilët nuk kanë patur asnjë lidhje me pacientët e shtruar.

Referencat

American Nurses Association. (2001). Code of ethics for nurses with interpretive statements. Retrieved January 4, 2005, from http://www.nursingworld.

LIGJ Nr.9887, datë 10.3.2008 PËR Mbrojtjen e të dhënave personale nw Republikwn e Shqipwrisw

LIGJ Nr.10 107, Datë 30.3.2009 PËR KUJDESIN SHËNDETËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Karta e tw drejtave tw pacientit Qendra kombëtare e cilësisë sigurisë dhe akreditimit të institucioneve shëndetësore Sektori i sigurise të drejtave të pacientit, manaxhimit të rreziqeve dhe gabimeve mjekësore www.qkcsaish.gov.al.

Privacy e infermiere. Paola Gobi 2003 ISBN 88- 386-1620-5 fq. 24 – 25;

Deshefy-Longhi, T., Dixon, J., Olsen, D., & Grey, M. (2004). Privacy and confidentiality ssues in primary care: Views of advanced practice nurses and their patients. Nursing Ethics.

McCloskey, B., Grey, M., Deshefy-Longhi, T., & Grey, L. (2003). APRN practice patterns in primary care. Nurse Practitioner.

Robling, M., Hood, K., Houston, H., Pill, R., Fay, J., & Evans, H. (2004). Public attitudes towards the use of primary care patient record data in medical research without consent: A qualitative study. Journal of Medical Ethics.

BENCI L., Le professioni sanitarie (no mediche) aspetti giuridici, deontologici e medico – legali McGraw – Hill, Milano 2002.

Erickson J, Millar S. (2005).Caring for patients while respecting their privacy: renewing our commitment. Online Journal of Issues in Nursing. Available at http://nursingworld.org/ojin/topic27/tpc27_1.htm Accessed March 20, 2007

Fowles JB, Kind AC, Craft C, Kind EA, Mandel JL, Adlis S.(2004). Patients' interest in reading their medical record: relation with clinical and sociodemographic characteristics and patients' approach to health care. Arch Intern Med 164(7)

Wiant T. (2005).Information security policy's impact on reporting security incidents. Computers & Security; 24(6)

Survey on data security breach discloses veterans' medical information. (2006). Available at: www. healthprivacy.org/infourl _ nocat 2303 /infourl_nocat_show. htm?doc_id=374199 Accessed May 12, 2007.

Bishop L, Holmes B, Kelley C. (2005). National Consumer Health Privacy Survey. California HealthCare Foundation Oakland. Available at: www.chcf.org Accessed May 12, 2007

Massachusetts General Hospital Privacy and Confidentiality Committee, 2004)(Exhibit B).

Delvecchio G et al (2008). Privacy e professionisti in sanità Guidapratica. Centro Scientifico Editore, Torino.

Coronato S et al (2006). La tutela della privacy nelle attività sanitarie. Edizioni Luigi Pozzi, Roma.

Gobbi P (2003). Privacy e professione infermieristica, Mc Graw Hill, Milano;

Benci L (2005). Aspetti giuridici della professione infermieristica: elementi di legislazione sanitaria. McGraw Hill, Milano;

NJË VËSHTRIM KRAHASUES I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR ME ATË TË DISA VENDEVE NORDIKE NË LIDHJE ME FITIMIN, HUMBJEN, RIFITIMIN DHE SHTETËSINË E SHUMËFISHTË

Ulvin Veizaj
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Fakulteti i Shkencave Humane
Departmenti i Drejtësisë
veizajulvin@yahoo.com

Abstract

This paper presents some of natonality issues, which are regulated by domestic legislation comparing with the relevant legislations of some Scandinavian countries such as Finland, Sweden and Denmark. In this context, several important aspects of Albanian legislation comes out, related to the nationality issues. Among them, there are mentioned some conditions to be fulfilled to renounce Albanian nationality; acquistions of Albanian nationality by naturalization, adoption, birth and through the principle of jus soli; dual nationality; etc. Also comes out, that Denmark is a country with a clearly stand against citizenship reforms, providing almost no access to Danish nationality and also by not accepting multiple nationality. Its legal framework related to this topic, still retains the old tradition of Danish nationality. In a different way are the viewpoints of Sweden and Finland on citizenship issues, which have more favorable conditions and facilities in the naturalization process. Both these countries have taken a big step in ratifying the European Convention on Nationality (1997) and by accepting dual citizenship.

Keywords: nationality, naturalization process, dual citizenship, jus soli, jus sanguinis, stateless persons

Hyrje

Me anë të këtij punimi synohet të bëhet një analizë rreth disa çështjeve të shtetësisë, që paraqet legjislacioni i vendit tonë dhe legjislacionet e disa vendeve nordike si Finlanda, Suedia dhe Danimarka. Thuhet disa vende, sepse në këtë trajtim nuk përfshihen Norvegjia dhe Islanda.
Menjëherë pas hyrjes, në pikën I, jepet një panoramë e legjislacionit shqiptar aktual në lidhje me fitimin e shtetësisë shqiptare, rifitimin, lënien e saj, natyralizimin nëpërmjet qëndrimit të rregullt, martesës, birësimit dhe shtetësinë e dyfishtë.
Në pikën II, paraqitet modernizimi i çështjeve të shtetësisë në Suedi në kudër të zhvillimit të reformave në fillim të këtij mijëvjeçari. Theksi vihet në qëndrimin më pozitiv që sjell Suedia, duke u orientuar drejt politikave të BE duke sjellë një qasje të saj në Konventën Evropiane për Shtetësinë të vitit 1997[1]. Me rëndësi shihen lehtësirat në natyralizim, inkurajimi i integrimit të të huajve, etj.
Pika III trajton Finlandën, e cila përveç lehtësirave në natyralizim, fokusohet te barazia gjinore. Gjithashtu këtu përmendet, se Finlanda tregohet mjaft e kujdesshme në rastet e përjashtimit (heqjes) së shtetësisë për ata persona që kanë probleme me respektimin e legjislacionit të shtetësisë.
Danimarka si trajtim i fundit, jo për nga rëndësia, por për nga radhitja, paraqet specifika krejt të ndryshme nga të parat. Ajo është më hemetike ndaj reformave të shtetësisë. Qëndrimi i saj është goxha "fanatik" përsa i përket zbatimit të parimit jus soli dhe çështjeve të tjera që do të paraqiten gjatë trajtimit të kësaj pike.
Ky punim ka një karakter përmbledhës krahasues. Këtu janë vendosur përballë njëri-tjetrit argumente, të cilët evidentojnë respektimin e lirive dhe të drejtave politike, civile e sociale të individëve, që janë apatridë, imigrantë dhe emigrantë. Për arritjen e këtij punimi janë përdorur si burime kryesore legjislacionet e vendeve përkatëse të marra në shqyrtim. Ndërsa si burime dytësore, tekste nga autorë, që kanë shkruar përreth këtyre çështjeve duke interpretuar legjislacionet e lartëpërmendura, të cilët do të përmenden në bibliografi.
Si sintezë qëndron një pikë e fundit konkluduese, e cila shprehet më shumë në formën e mendimeve të lira dhe opinineve përfundimtare.

I. Kuadri ligjor për shtetësinë shqiptare

Konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, aktet ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi për shtetësinë shqiptare janë ato të pothuajse 10-15 viteve më parë ku shihet qartë pozicionimi shtetëror ndaj kësaj çështje që rregullon një sërë të drejtash politike, civile e sociale për individët. Duke marrë shkak nga ligji për shtetësinë shqiptare i vitit 1998[2], shihet se dispozitat e tij kanë pësuar një ndryshim të lehtë dhe janë pasqyruar në ligjin e ndryshuar për shtetësinë në

[1] Konventa Evropiane për Shtetësinë, hyri në fuqi në 06.11.1997. Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8942, datë 19.09.2002
[2] Ligji nr. 8389 "Për shtetësinë shqiptare" është miratuar në dt. 05.08.1998, gati më pak se katër muaj më parë se të miratohej "Kushtetuta e RSH" në dt.28.11.1998

vitin 1999[3]. Amendimet e bëra te ky i fundit paraqesin gjithashtu dhe pikëpamjet kushtetuese, ku në thelb qëndrojnë çështjet e ligjit të vitit 1998. Për zbatim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore kanë dalë një sërë aktesh nënligjore[4] të cilat përcaktojnë dokumentet, procedurat dhe afatet në lidhje me çështjet e shtetësisë. Shihet se zbatimi i parimit jus sanguinis qëndron në thelb të fitimit të shtetësisë shqiptare, ku për të qenë shtetas shqiptar mjafton të jesh i lindur nga prindër me shtetësi shqiptare, qoftë nga një nënë apo nga një baba shqiptar. Për emigrantët e lindur jashtë vendit nga të paktën një prind shqiptar, është e nevojshme, që personi të regjistrohet në zyrat e selive konsullore dhe diplomatike shqiptare jashtë vendit. Menjëherë pas regjstrimit në selitë diplomatike, i linduri jashtë vendit bëhet pjesë e Regjistrit të Gjendjes Civile Shqiptare. Në këtë mënyrë ky person do të jetë subjekt i mbrojtjes diplomatike shqiptare dhe nuk do t'i mungojë identifikimi si shtetas shqiptar. Përsa i përket zbatimit të parimit jus soli Republika e Shqipërisë tregohet e hapur ndaj procedurave të dhënies së shtetësisë duke respektuar Konventën në lidhje me Statusin e Personave Pashtetësi, e cila është ratifikuar në 23 qershor 2003, duke u dhënë mundësinë e marrjes së e shtetësisë çdo personi, i cili lind në territor shqiptar nga prindër të huaj me qëndrim të ligjshëm në Shqipëri, kuptohet me pëlqimin e prindërve. Përjashtim nga ky rregull bëhet për ata të lindur në Shqipëri nga prindër, të cilët ndodhen në vendin tonë në mënyrë të jashtëligjshme, që edhe pse mund të dëshirojnë, nuk mund të regjistrojnë fëmijën e tyre si shtetas shqiptar. Nga ky parim përfitojnë edhe ata persona të cilët janë të lindur nga prindër pashtetësi ose me shtetësi të panjohur. Natyralizimi si mundësi për krijimin e një lidhje juridike të të huajve me shtetin shqiptar qëndron në disa standarte, ku si fillim i huaji duhet t'i drejtohet shtetit shqiptar me një kërkesë për fitimin e shtetësisë. Gjithashtu duhet të ketë plotësuar disa kushte si, arritja e moshës madhore, rezidencë të ligjshme jo më pak se pesë vjet banimi, të nxjerr të ardhura financiare për jetesë, të sigurojë banimin, të mos ketë qenë i dënuar për vepra penale të cilat parashikojnë dënim me më shumë se tre vjet heqje lirie, të dijë shqip dhe të mos cënojë sigurimin dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë. Martesa me një shtetas shqiptar është një mundësi e cila lehtëson fitimin e shtetësisë shqiptare me anë të një natyralizimi më të lehtësuar. Do të mjaftonin vetëm tre vjet martesë dhe një vit rezidencë e ligjshme në Shqipëri, që bashkëshorti i huaj të bëhej shtetas shqiptar. Pra shtetas shqiptar me natyralizim quhet, personi që e fiton atë dhe

---

[3] Ligji nr. 8442, dt. 21.01.1999 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8389, dt. 05.08.1998 "Për shtetësinë Shqiptare".

[4] Ka disa udhëzime të përbashkëta të Ministrit të Rendit Publik (nr. 925 dt. 03.03.1999), Ministrit të Punëve të Jashtme (nr. 337/1 dt. 08.03.1999), Ministrit të Drejtësisë (nr. 728/1 dt. 25.03.1999) dhe Ministrit të Financave (nr. 583/3 dt. 05.03.1999) "Për procedurat që ndiqen për fitimin e shtetësisë shqiptare. Gjithashtu udhëzimi i Ministrit të Rendit Publik (nr. 3583 dt. 27.11.2001) dhe Ministrit të Punëve të Jashtme (nr. 6252 dt. 10.12.2001) "Për procedurat dhe dokumentacionin për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare".

kryen betim formal para nëpunësit të zyrës civile, për të qëndruar besnik ndaj shtetit shqiptar për respektimin e kushtetutës e ligjeve të vendit tonë. Dhënia dhe heqja e shtetësisë konfirmohet me dekret presidencial dhe botohet në fletoren zyrtare. Si mundësi e fitimit të shtetësisë shqiptare do të përmendet edhe birësimi ku prindër me shtetësi shqiptare mund të birësojnë një të mitur me shtetësi tjetër ose pashtetësi. Shtetësia është një atribut i pandashëm juridik i çdo shtetasi shqiptar. Ajo në asnjë lloj mënyre nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare, përveç se me dëshiren e vet personit. Personi nuk mund të zhvishet nga kjo e drejtë, e cila lidhet kaq ngushtë me të, nëse vet personi nuk heq dore prej saj pasi të ketë mbushur moshën 18 vjeç ose të jetë pajisur me një shtetësi të dytë, ose t'i jetë premtuar një shtetësi tjetër në rrugë zyrtare e bazuar mbi dokumenta që e provojnë atë. Si kujtesë përmenden vitet 1992-1998 ku shumë shqiptarë duke mos qenë në dijeni të problemeve që sillte pashtetësia, kanë hequr dorë në mënyrë vullnetare prej saj. Një gjë e tillë ka ndodhur edhe si pasojë e mungesës së rregullimit ligjor, i cili nuk vinte ndonjë kriter për heqjen dorë nga shtetësia, përveç moshës madhore. Dispozitat kalimtare dhe të fundit i kanë dhënë fund problemit të sipërpërmendur duke u ridhënë shtetësinë shqiptare të gjithë atyre personave që kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare para se ky ligj të hynte në fuqi. Së fundmi, kanë të drejtë të rifitojnë shtetësinë shqiptare ata persona të cilët janë pashtetësi, sepse nuk i'u është dhënë shtetësia tjetër e premtuar brenda një kohe të arsyeshme. Duke u munduar të tregonim kujdes në analizimin e kuadrit ligjor shqiptar mbi çështjet e shtetësisë, do të shihnim se dyshtetësia në vendin tonë nuk ndalohet. Këtë mendim e bazojmë mbi disa argumente; së pari, të gjithë jemi në gjendje të sjellim shembuj ku ne vet njohim shtetas shqiptarë, që e kanë një shtetësi të dytë. Pra, kjo gjë përligj fare mirë atë që shtetasi shqiptar mund të jetë shtetas i një shteti tjetër[5]. Së dyti duke u nisur nga dispozitat për birësimin[6], shohim se kur i mituri i huaj birësohet, atij nuk i privohet shtetësia e origjinës. Gjithashtu bashkëshortit të huaj që fiton shtetësinë shqiptare, nuk i vihet si kusht heqja dorë nga shtetësia e mëparshme, përveç se një gjë e tillë do t'i kërkohej nga shteti i origjinës.

II. Suedia dhe qëndrimi i saj ligjor i moderuar mbi shtetësinë

Instrumenti i Qeverisë Suedeze (Regeringsformen), jep drejtimet kryesore me të cilat shteti suedez qeveriset dhe parashikon në kapitullin 8 neni 2, se dispozitat që lidhen me shtetësine suedeze janë të përcaktuara në ligj. Dispozitat gjenden në ligjin e shtetësisë suedeze. Pra ligji për shtetësinë suedeze në dispozitat e tij përcakton qartë fitimin, humbjen si dhe procedurat e shtetësisë. Për një kohë të gjatë tradita ius sanguinis ka qenë dominante në Suedi. Reformat e viteve 1924, 1950 e 2001 e kanë lënë të paprekur jus sanguinis si rregull primar, edhe pse parimi i vendbanimit fitoi rëndësi me ligjin

[5] Neni 3, ligji nr. 8389, dt 05.08.1998 "Për shtetësinë shqiptare".
[6] Neni 12/1, ligji nr. 8389, dt 05.08.1998 "Për shtetësinë shqiptare".

për shtetësinë në vitin 2001. Një fëmijë fiton shtetësinë suedeze prej lindjes nëse nëna e tij është shtetase suedeze. Nuk përbën ndonjë rëndësi të caktuar nëse fëmija është i lindur në Suedi apo jashtë territorit suedez ose nëse ajo është lindur brenda një martese ligjore ose martese të jashtëligjshme. Në qoftë se nëna është e huaj, fitimi i shtetësisë bëhet i mundur vetëm nëse ka një baba suedez dhe s'përbën rëndësi nëse fëmija është i lindur në Suedi apo i lindur në martesë. Ligji i vitit 2001 ka sjellë një qëndrim të ri dhe ka modernizuar shoqërinë suedeze. Pranimi i dyshtetësisë dhe pranimi i parimit të vendbanimit nisin pikërisht këtu. Aplikimi i ligjit nuk bazohet më në bashkëpunimet nordike[7]. Ligji ndjek Konventën Evropiane për Shtetësinë të 1997 dhe sot shtetësia e dyfishtë është pranuar plotësisht në çdo situatë. Një person që është i lindur jashtë vendit dhe që nuk ka jetuar ndonjeherë në Suedi apo nuk ka qenë ndonjeherë në Suedi, nën rrethana që nuk tregojnë një lidhje me vendin, zakonisht humbet shtetësinë e tij sipas kufizimeve statutore në moshën 22 vjeç. Humbja e shtetësisë përfshin gjithashtu edhe fëmijët e tij, përveç nëse prindi tjetër ende mban shtetësinë suedeze. Kjo është e vetmja mënyrë që shtetësia suedeze mund të humbas në mënyrë të pavullnetshme. Fitimi i shtetësisë suedeze me njoftim është një procedurë formale e thjeshtuar në të cilin një person mund të bëhet shtetas suedez, nëse ai i plotëson kërkesat e caktuara ligjore. Kjo procedurë zbatohet për finlandezët, norvegjezët, danezët dhe islandezët, të cilët gëzojnë lehtësira. Një person, i cili plotëson kërkesat ligjore nuk mund t'i mohohet shtetësia. Një person, i cili nuk plotëson kushtet ligjore për fitimin nga njoftimi duhet të aplikojë për natyralizim, që të bëhet një shtetas suedez. Suedia nuk ka pengesa të larta për natyralizim krahasuar me vende të tjera. Mundësitë e aplikimit për natyralizim janë mjaft bujare. Kushtet për natyralizim kanë mbetur në thelb të njëjtat dhe ndryshimet e bëra, shpesh kanë dobësuar kushtet për natyralizim. Disa kërkesa për aplikantët janë shfuqizuar në vitin 1976, por edhe më parë. Ish kërkesa për gjuhën u hoq në 1970. Megjithatë disa kërkesa janë rritur, për shembull prova e kërkesave mbi identitetin dhe kërkesa e mirësjelljes dhe sigurisë në vend. Kur ligji i shtetësisë i vitit 1950 hyri në fuqi, bëri që burrat dhe gratë të gëzojnë një pozitë të barabartë sipas ligjit të shtetësisë. Mundësia për të marrë shtetësinë suedeze përmes martesës është shfuqizuar nga ligji i vitit 1950, por në qoftë se një aplikant është i martuar me një suedez apo që jeton në kushte që ngjan me martesën mund t'i jepet nga kërkesat për natyralizim.

III. Rregullimi i çështjeve të shtetësisë nga Finlanda

Finlanda miratoi ligjin e ri për shtetësinë në vitin 2003. Parimet kryesore të implementuara në këtë akt janë, pranimi i shtetësisë së shumëfishtë, parandalimi i pashtetësisë dhe barazia gjinore. Dispozitat për natyralizim janë

---

[7] Shtetësia suedeze, që nga fundi i shekullit XIX, ka qenë trajtuar nëpërmjet bashkëpunimeve nordike. Megjithatë, Suedia e ka braktisur këtë bashkëpunim përmes ligjit për shtetësinë të vitit 2001.

më të detajuara dhe janë futur metoda të reja për fitimin e shtetësisë për grupe të caktuar personash. Ligji finlandez për shetësinë ka qenë tradicionalisht i bazuar në parimin jus sanguinis, ndërsa parimi jus soli ka patur një aplikim të kufizuar në legjislacionin finlandez. Fëmijët e fitojnë shtetësinë finlandeze në lindje si pasojë e shtetësisë finlandeze të prindërve të tyre. Burrat dhe gratë janë të vendosur në një pozicion pothuajse të barabartë, ku një fëmijë do të fitonte shtetësinë finlandeze nga të dy, si nga një nënë finlandeze dhe ashtu edhe nga një baba finlandez. Fitimi i shtetësisë me lindje nga një prind me shtetësi finlandeze bëhet automatikisht në të gjitha rastet, përveç kur fëmija është i lindur jashtë vendit, jashtë martese, nga një baba finlandez dhe një nënë e huaj. Një rast i parimit ius sanguinis pas lindjes, kur një fëmijë është i lindur jashtë martese me një baba finlandez e nënë të huaj, është kur prindërit martohen më vonë. Vetëm atëherë fëmija automatikisht do të fitojë shtetësinë finlandeze nëpërmjet martesës së prindërve. Praktikat ius soli për fëmijë të caktuar të lindur në Finlandë kanë evoluar si pasojë e zhvillimit të legjislacionit për shtetësinë finlandeze dhe parandalimi i pashtetësisë është marrë në konsideratë të rëndësishme në kuadër të ligjit për shtetësinë. Fëmijët e gjetur dhe fëmijë të tjerë, shtetësia e të cilëve është e panjohur ose fëmijë të cilët nuk mund të marrin shtetësinë e prindërve të tyre, automatikisht fitojnë shtetësinë finlandeze me lindje. Më 1 qershor 2003, kur ligji i ri për shtetësinë hyri në fuqi, toleranca e shtetësisë së shumëfishtë u prezantua si një parim themelor. Një shtetas finlandez me marrjen e shtetësisë së dytë nuk e humb shtetësinë finlandeze. Nuk kërkohet për shtetasit e huaj që fitojnë shtetësinë finlandeze të heqin dorë nga shtetësisa e tyre e mëparshme. Natyralizimi diskrecionar, dmth marrja nga aplikimi, është mënyra kryesore e marrjes së shtetësisë finlandeze për personat të cilët nuk kanë fituar shtetësinë finlandeze si pasojë e parimit ius sanguinis ose ius soli. Pengesa për marrjen e shtetësisë finlandeze me natyralizim diskrecionar nuk mund të konsiderohet si jashtëzakonisht e lartë, edhe pse kërkesa normale e banimit në ligjin e ri u ngrit nga pesë në gjashtë vjet qëndrimi të vazhdueshëm në Finlandë. Në kontrast me ligjin e vjetër të shtetësisë, kërkesa për një jetesë të garantuar u hoq në ligjin e ri dhe aftësitë gjuhësore u përfshinë në mënyrë specifike. Një numër përjashtimesh zbatohen në lidhje me kushtet për natyralizimin diskrecionar, në veçanti shqetësim tregohet përsa i përket periudhës së kërkuar të qëndrimit në Finlandë. Grupet për të cilat zbatohen përjashtime janë refugjatët, personat pa shtetësi, bashkëshortët, ish-shtetasit finlandezë, shtetasit nordikë, bashkë-aplikantët dhe fëmijët e shtetasve finlandezë. Shtetësia finlandeze gjithashtu mund të fitohet me deklaratë. Kjo mundësi vlen edhe për grupe të caktuara të personave nën kushte të caktuara p.sh., ish-shtetas finlandezë, shtetasit nordikë dhe të rinjtë që kanë jetuar në Finlandë për një kohë të gjatë. Shtetësia finlandeze mund të humbas për një numër të kufizuar arsyesh, por kurrë nuk mund të humbas nëse një humbje e tillë do të çonte në pashtetësi. Informacionet e dhëna, që janë false ose mashtruese, në mënyrë që të përfitohet shtetësia finlandeze mund të çojnë në humbjen e shtetësisë finlandeze për një aplikant kryesor, si dhe për një fëmijë bashkë-aplikant. Për më tepër, një person mund të humbas shtetësinë e

tij finlandeze në qoftë se ajo është dhënë në bazë të shtetësisë së babait dhe atësia është anuluar më vonë. Një person do të humbas automatikisht shtetësinë e tij finlandeze pas një kthimi mbi moshën 22 vjeçare, nëse personi ka lidhje të pamjaftueshme me Finlandën. Së fundi, një fëmijë që ka fituar shtetësinë finlandeze si një fëmijë i gjetur ose si një person me shtetësi të paqartë, automatikisht humbet shtetësinë finlandeze, në qoftë se shtetësia e tij e huaj është qartësuar para se të mbush pesë vjeç. Vendet nordike janë përpjekur për të arritur uniformitet në lidhje me rregullat e shtetësisë që kur ka filluar bashkëpunimi. Megjithatë kohët e fundit, ka pasur një ndryshim në këtë qasje dhe vendet nordike duket se tani po shkojnë në mënyra të ndryshme. Finlanda dhe Islanda kanë ndjekur Suedinë për pranimin e plotë të shtetësisë së shumëfishtë, ndërsa Danimarka dhe Norvegjia i kanë mëshuar parimit tradicional duke shmangur këtë status.

IV. Danimarka në divergjencë me tendencat evropiane për shtetësinë.

Ndryshe nga shumë vende të tjera evropiane, Danimarka nuk e ka reformuar ligjin e saj për shtetësinë në fillim të mijëvjeçarit të ri. Danimarka nuk ka ndjekur tendencat evropiane në ligjin e shtetësisë për të lehtësuar natyralizimin, për të zgjeruar të drejtën për dhënien e shtetësisë. Ajo nuk ka pranuar shtetësinë e shumëfishtë dhe nuk ka futur elementë si ius soli në ligjin e saj të shtetësisë. Danimarka vitet e fundit ka bërë që kushtet për fitimin e shtetësisë të jenë të rrepta, duke ofruar një akses jo të lehtë për shtetësinë daneze. Legjislacioni ekzistues mbi shtetësinë është zakonisht i bazuar në traditat për shtetësinë daneze. Ligji danez për shtetësinë e ka origjinën e vet në kushte politike, të cilat na çojnë prapa në shekullin XVIII. Kur Danimarka u bë një vend demokratik në 1849, Mbreti humbi autoritetin e tij ekskluziv për të dhënë natyralizimin. Siç edhe kushtetuta përcaktonte, qytetarët e huaj tani e tutje mund të fitojnë *indfødsret* vetëm me statusin e indigjenit (ius indigenatus). Gjatë kësaj kohe *indfødsret* është parë gjithnjë si një shtetësi ose koncept i shtetësisë, duke i bashkangjitur këtij statusi të drejtat politike. Aktualisht ligji i shtetësisë në fuqi në është ai i ligjit të vitit 1950 edhe pse i ndryshuar disa herë, sidomos gjatë dhjetë viteve të fundit. Që nga fundi i viteve 1890, ligji danez për shtetësinë ka qenë i bazuar në Bashkëpunimin Nordik. Deri kohët e fundit, ligjet nordike për shtetësinë kanë qenë pothuajse identike. Fundi i homogjenitetit nordik në lidhje me ligjin e shtetësisë, ndër të tjera, u shkaktua nga disa prej vendeve nordike ku u ndryshuan qëndrimet e tyre lidhur me tolerimin e shtetësisë së shumëfishtë. Tradicionalisht të gjitha vendet nordike nuk e miratonin këtë status. Shtetasit të cilët humbnin shtetësinë e tyre në rastet e fitimit vullnetar të një shtetësie tjetër dhe në rastet e natyralizimit, u kërkohej normalisht të hiqnin dorë nga shtetësia e tyre e mëparshme në momentin e aplikimit. Megjithatë që prej tolerimit të shtetësisë së shumëfishtë ky fakt u bë i pranueshëm nga Konventa Evropiane për Shtetësinë e vitit 1997. Suedia, Finlanda dhe Islanda kanë reformuar ligjet e tyre për shtetësinë dhe pranuan

shtetësinë e shumëfishtë si kryesor parim, ndërkohë që Danimarka e ka hedhur poshtë me forcë këtë ndryshim duke mbajtur qëndrim negativ ndaj këtij statusi. Danimarka u është përgjigjur ndryshe disa aspekteve të tjera të reja lidhur me sfidat që rrjedhin nga globalizimi dhe imigracioni duke rritur relativisht barrierat e saj të natyralizimit. Kështu Danimarka është i vetmi vend nordik që kërkon një qëndrim të përgjithshëm prej nëntë vjetësh dhe një kërkesë sjellje, përjashtuar nga natyralizimi në mënyrë të përhershme të huajt (në masën që ata kanë qenë të dënuar me burg për tetëmbëdhjetë muaj apo më shumë). Kërkesat e gjuhës daneze janë bërë edhe më të rrepta, si fillim në qershor të vitit 2002 dhe më pas në dhjetor 2005. Efekti dha një rënie të menjëhershme të numrit të natyralizimeve nga 2002 në 2003 dhe një rënie të krahasueshme në vitin 2007, ku kërkesat e reja të gjuhës filluan të aplikohen. Rënia ishte e menjëhershme për shkak të një dispozite të re në bazë të së cilës aplikantët për natyralizim duhet të jenë vetëmbështetës në kuptimin se, ata nuk mund të kanë marrin përfitime sociale për më shumë se një vit brenda pesë viteve të fundit.

V. Konkluzine

Duke parë qëndrimet e Shqipërisë dhe tre shteteve nordike Finlandë, Suedi dhe Danimarkë në lidhje me çështjet e shtetësisë kuptohet se Shqipëria ka një përqasje me Finlandën dhe Suedinë në lidhje me natyralizimin, edhe pse shteti shqiptar nuk është vend anëtar i BE, ndërsa Danimarka qëndron veçmas. Ajo ka një shkallë më të lartë vështirësie si për natyralizimin e të huajve në Danimarkë, ashtu edhe për bashkëshortët e shtetasve danezë emigrantë. Gjithashtu përveç Danimarkës që nuk e njeh parimin jus soli, të tre shtetet e tjerë janë zbatues të parimit jus soli dhe jus sanguinis njëkohësisht. Përsa i përket lënies së shtetësisë secili shtet ka specifika të veçanta duke nisur që nga heqja dorë prej saj me kërkesë të vet individit deri te humbja e saj në rrethana të tilla, që bëjnë të humbas lidhja e individit me shtetin. Shqipëria tregon një afrim të madh ndaj dyshtetësisë duke e pranuar atë, njësoj si Finlanda e Suedia, të cilat e kanë përqafuar këtë parim vetëm nëpërmjet ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare duke devijuar nga bashkëpunimi tradicional nordik. Edhe në këtë rast Danimarka refuzon shtetësinë e shumfishtë duke theksuar se nëse shtetasi danez është i interesuar për fitimin e një shtetësie tjetër, duhet të heq dorë nga ajo e origjinës. Secili shtet i marrë në studim rregullon çështjët e shtetësisë duke u nisur nga tradita, bashkëpunimet rajonale, lëvizjet imigratore dhe tendencat evropiane, etj.

Bibliografi

Konventa Evropiane për Shtetësinë, hyri në fuqi në 06.11.1997.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 2006.

Ligji nr. 8389, datë 05.08.1998 “Për shtetësinë shqiptare”.

Ligji nr. 108, datë 2003 për “Të huajt”.

Puto A., E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë, 2010.
Omari L., Parime dhe institucione të së drejtës publike, Tiranë 2004.
Canaj E., Bana S., E Drejta e Bashkimit Evropian, Tiranë, 2011.
Bellander, I. (1996), 'Le droit Suedois de la nationalite', in B. Nascimbene (ed.), Nationality Law in the European Union, 629-671. London: Butterworths.
1 May 2005 Ordinance (2004:294) with instructions for the Swedish Migration Board (förordningen (2004:294) med instruktion för Migrationsverket). New Ordinance.
1 July 2005 Law 2005:451: Amendment to the Citizenship Act (2001:82). Automatic acquisition for some children born after insemination introduced; possibility to notification introduced for some children born after insemination
31 March 2006 Law (2005: 722): Amendment to the Citizenship Act (2001: 82). New institutional orders appeal to special migration courts.
Peltoniemi P. (2003), 'Dual Citizenship Possible in June', Suomen Silta/Finland Bridge 2003 (2). www.suomi-seura.fi.
Rosas A. & M. Suksi (1996), 'Finnish nationality law', in B. Nascimbene (ed.), Nationality laws in the European Union, 267-307. Milano: Butterworths/Giuffre`.
2003 359/2003 Nationality Act (Kansalaisuuslaki) Acceptance of multiple nationality. Further promotion of gender equality and prevention of statelessness. Inclusion of language requirement and abolishment of requirement of guaranteed livelihood. Approximation of an adopted child's rights to that of a biological child.
2004 799/2004 Nationality Decree (Valtioneuvoston asetus kansalaisuudesta) Inclusion of clear rules on hoë to prove required language skills.
Baubock R., et al., Acquisition and Loss of Nationality, Policies and Trends in 15 Europian States, Amsterdam, 2006.
Chartier G., Anarchy and Legal Order, Cambridge, 2013.
Convention Relating to the Status of Stateless Persons (adopted 28 September 1954, entered into force 6 June 1960)

7 June 2004 Consolidated Act No. 422 on Danish Nationality (Bekendtgørelse af lov om dansk indfødsret)

PËRPARËSITË DHE TË METAT E TIK NË MËSIMDHËNIEN E GJUHËVE TË HUAJA

PhD. Veneranda Hajrulla

Department of Foreign Language Teaching

University "Ismail Qemali"
Albania

venerandahajrulla@yahoo.com

ABSTRACT

The recognition and implementation of ICT in teaching constitutes an integration challenge for our society. Implementation of technologies in training and education, includes learning advantages that provide a rich, stimulating environment, supported by a combination of multimedia resources.
Seen in this context, the Teaching of Foreign Languages through Information and Communication Technology, takes a double value, not only for facilitating and accelerating the process of knowledge acquisition, but above all, for the construction of communication bridges and global coexistence, which will lead the integration process forward.
The purpose of this paper is the reflection of experience and interaction of students and teachers at the University of Vlora, of teachers and pupils in different high schools in Vlora Region, in their first initiatives of using ICT *in foreign language teaching.*

Key Words: ICT, online communication, PBL, blog, e-mail, e-schools

ABSTRAKT

Çështja e njohjes dhe zbatimit të TIK në mësimdhënie përbën një sfidë integrimi për arsimin. E themi këtë duke marrë parasysh potencialin shumëplanësh të mjeteve të kësaj teknologjie dhe rolin gjithnjë e më vendimtar që ato po marrin në ridimensionimin e marrëdhënieve njerëzore anembanë globit.
Kështu po ndodh edhe me shoqërinë shqiptare në këtë etapë të gjatë por të domosdoshme afrimi ekonomik, shoqëror, intelektual, kulturor e shpirtëror drejt Evropës. Në këtë kontekst mësimdhënia veçanërisht e gjuhëvë të huaja përmes

Teknologjisë së Informacionit e Komunikimit, merr një vlerë të dyfishtë, jo vetëm për lehtësimin dhe përshpejtimin e procesit të përvetësimit të dijeve dhe shprehive në gjuhën dhe kulturën e huaj, *por mbi të gjitha për ndërtimin e urave të komunikimit e bashkëjetesës globale, që do ta çojnë përpara procesin e integrimit.*
Ky punim është një reflektim mbi disa eksperienca të mësuesve të ciklit parauniversitar si dhe studentëve të Universitetit të Vlorës, në përpjekjet e para për përdorimin e teknologjisë në MGJH.

Fjalë Kyçe: TIK, komunikim online, blog, e-mail, MBP, parime pedagogjike,e-shkolla.

Hyrje

Përparësitë e komunikimit online për qëllime gjuhe janë dokumentuar edhe në literaturë kërkimore. Ndër përparësitë themelore të TIK është fakti se mjedisi i të mësuarit përmes rrjetit kompjuterik, u siguron mësuesve dhe studentëve burime të vlefshme materialesh autentike, të cilat ata mund t'i eksplorojnë dhe integrojnë gjatë punës. Studentët shfrytëzojnë një mori burimesh referenciale si, fjalorë online, programe përkthimi, enciklopedi, etj., që u lehtësojnë atyre procesin e leximit. Mjafton të përmendim mundësitë për të shfletuar thuajse falas gazeta dhe revista elektronike në gjuhën e huaj, shënime e përmbledhje leksionesh apo analiza veprash, për t'u përgatitur paraprakisht për orën pasardhëse të mësimit.

1. Përparësitë e të mësuarit *online*

1. Së pari, rrjeti kompjuterik shërben si një mjet i dobishëm komunikimi. Zhvillimet në këtë drejtim kanë hapur rrugë të reja lidhjesh midis studentëve të gjuhës nëpër botë. Në këtë kontekst duam të shtojmë se interneti ka shtuar mundësitë për ndërveprim midis studentëve pa ndërprerje, pa trysni kohore apo tension shoqëror, madje edhe mes të ashtuquajturve nxënës/ studentë të heshtur a pasivë në orën e mësimit. Mjedisi *online* nxit edhe komunikimin mësues - student (p. sh. veprimtaritë me *email*) duke mundësuar dhënien e *fidbekut* për probleme që lindin në çast.
2. TIK u siguron studentëve mjete dhe teknika për zhvillimin e shprehive gjuhësore. Studentët kanë mundësi të ekspozohen ndaj një sërë programesh për përmirësimin e të lexuarit, të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit dhe thellimin e njohurive gramatikore. Përdorimi i teknologjisë në gjuhën e huaj, promovon aftësitë komunikative të studentëve duke i vendosur në komunikim me njëri-tjetrin në gjuhën e huaj.

3. Mjedisi i rrjetit bën, gjithashtu, të mundur një formë të re të të nxënit të gjuhës – të mësuarit në distancë. Në të vërtetë, ai ka hapur dyert e të mësuarit për studentët e mbarë globit duke i aftësuar ata të komunikojnë, diskutojnë, analizojnë dhe zgjidhin probleme online, të mendojnë në mënyrë kritike e të marrin njohuri në kushtet e shtëpisë pa qenë të pranishëm në klasë. Vlerë të paçmuar ka të mësuarit e gjuhëve të huaja në distancë, pasi jo kushdo e ka mundësinë e studimit jashtë shtetit, ku mund të formohet nga ana gjuhësore dhe kulturore.
4. MGJH me anë të teknologjisë *online* sjell në klasë, më afër studentëve, kulturën e vendit ku flitet gjuha. Të mësuarit e gjuhës është një dukuri socio-kulturore shumëplanëshe. Për këtë arsye, një nga parimet bazë pedagogjike të mësimdhënies së saj lidhet me studimin e gjuhës në kontekstin kulturor për vetë natyrën e ndërvarur që ka gjuha me kulturën.
5. Interneti ka një fuqi të jashtëzakonshme motivuese për arritjen e objektivave mësimorë. Është provuar se kërkimet e orientuara në të, rritin kënaqësinë e nxënësve/ studentëve, i bëjnë ata më veprues e më produktivë.

Analiza jonë do të ishte e njëanshme nëse mohojmë, apo lëmë mënjanë një sërë pengesash dhe të metash që dalin gjatë përdorimit të TIK në procesin në fjalë.

1. Sfida kryesore është ajo e mundësisë së përdorimit të internetit apo, siç njihet teknikisht, aksesi ndaj rrjetit. Studentët duhet të kenë, para së gjithash, mundësi ta përdorin lirisht rrjetin, në të kundërt, shfaqen probleme. Një situatë e ngjashme po përpiqet të kapërcehet në Shqipëri. Shpesh pengesat janë të një karakteri financiar dhe kanë të bëjnë me ngritjen e rrjetit në shkollë, i cili mund të ketë kosto të lartë, si dhe investimet për trajnime, pasi përdorimi i internetit në gjuhën e huaj, kërkon një lloj kompetence mbi teknologjinë dhe shprehitë kompjuterike si nga nxënësit, edhe nga mësuesit.
2. Kërkimi i materialeve *online* mund edhe të kthehet në një veprimtari zhgënjyese për shkak të kohës së gjatë të kërkimit dhe mundimit shpeshherë të kotë. Arsyet që çojnë në situata të tilla janë të ndryshme: shumë e kanë të vështirë ta lexojnë informacionin mbi ekranin e kompjuterit; gjithashtu në çast mund të bombardohesh me një lumë informacioni me pak ose aspak kontroll mbi cilësinë dhe saktësinë e përmbajtjes, gjë që e bën të domosdoshme nevojën për ekspertizë teknike si nga mësuesi, ashtu edhe nxënësi
3. Komunikimi në internet vështirësohet për shkak të ngadalësimit të rrjetit në periudhën e pikut të përdorimit. Probleme të tilla teknike të shpejtësisë dhe besueshmërisë së programeve mund të çojnë në dështimin e orëve të mësimit.

4. Një tjetër sfidë në zbatimin e TIK në mësimdhënien në MGJH, janë edhe ndryshimet në këndvështrimin pedagogjik. Mjedisi i teknologjizuar i mësimdhënies së gjuhës së huaj, krijon dimensione të reja të mësimdhënies dhe të nxënit, të ndryshme nga hapësirat e klasës tradicionale. Në mjedisin e ri mësuesi nuk është më një ekspert i njohurive, por drejtues dhe lehtësues i proceseve të të nxënit. Nxënësit, nga ana e tyre, marrin përgjegjësi për të nxënit e gjuhës, bëhen më veprues dhe të pavarur. Ndryshimet në pedagogjinë e punës, në rolet e reja të mësuesve dhe nxënësve/ studentëve kanë sjellë jo pak konfuzion në kontekstet e mësimit të gjuhës së huaj përmes teknologjisë. Kështu, për shembull, studimet tregojnë se në shumicën e klasave tradicionale, studentët janë mësuar me stilin tradicional, i dominuar ky nga mësimdhënia me në qendër mësuesin dhe tekstin.[1] Prandaj, zbatimi i metodologjive të reja të mësimdhënies që vendosin në qendër nxënësin, kërkon rivlerësim të të dy aktorëve në mjedisin e ri.

Përfundimisht, mendimi ynë është se, me gjithë këto pengesa, ajo çfarë ofron teknologjia *online* në mësimdhënien e gjuhës së huaj, është aq dobiprurëse, saqë nuk mund të anashkalohet. Çështja është se, *së pari,* duhen gjetur ekuilibrat e pranueshëm midis përdorimit të TIK dhe mjeteve tradicionale për të bërë një kalim të arsyeshëm në formatin modern, pa hedhur poshtë përparësitë e traditës (dërrasa e zezë, shumë e dashur për mësuesin dhe studentin) dhe, *së dyti,* ky mjedis i ri i teknologjizuar duhet të integrohet në kurset e gjuhës e, për këtë, si studentët dhe mësuesit të përgatiten për një rrugë të gjatë e të vazhdueshme kualifikimi profesional e teknik, ndërsa studentët mund të përfitojnë nga teknologjia vetëm nëse veprimtaritë nëpërmjet saj përputhen me nevojat dhe interesat e tyre.

1.1 Qëndrimet e mësuesve ndaj teknologjisë

E rëndësishme është të mos ngrihen pritshmëri jorealiste për sa i takon kontributit të mundshëm të teknologjisë në kurrikulën e gjuhëve të huaja, pasi ajo çfarë konstatohet në rrethet e mësuesve, bie shpesh në kundërshtim me atë që thuhet nëpër statistika apo citohet nëpër literaturë. Për hir të së vërtetës, në gjirin e mësuesve, jo rrallë ndeshet një frymë mosbesimi ndaj rolit të teknologjisë në fjalë dhe mungesë vullneti për t'i depërtuar thellë këtij nocioni në MGJH.
Pse ndodh kjo dhe a kanë të drejtë mësuesit të mendojnë kështu?
Mjaft njerëz kanë frikë nga teknologjia e re, kjo kryesisht sepse e njohin pak ose aspak, aq sa me praninë në rritje të internetit është dëgjuar të përdoret termi *teknofob* për t'iu referuar atyre që janë mosbesues ndaj zhvillimeve të reja. Për këtë grup jo të paktë mësuesish, ndër ta edhe mjaft mësues të suksesshëm, roli dhe vendi i teknologjisë shpesh konceptohet duke u parë si një metodologji e

[1] D. Conrad (1999).

paintegruar në procesin e mësimdhënies së gjuhës së huaj dhe, si e tillë, refuzohet menjëherë. Të tjerë shfaqin besimin e gabuar se teknologjia e sotme është gjithçka që na duhet të dimë, pra, teknologjia e ditëve tona është e mjaftueshme për sfidat e së nesërmes.
Nga një pyetësor i zhvilluar me mësues të gjuhëve të huaja në shkolla të mesme të qytetit të Vlorës,[2] midis qëndrimeve premtuese në mbështetje të teknologjisë, janë evidentuar edhe mjaft komente negative ndaj saj. Mësuesit nënvizojnë arsye nga më të ndryshmet si shprehje e mospajtimit të tyre për aplikimin e teknologjisë në orën e gjuhës së huaj:

- Asnjëherë nuk arrij të hyj dot në sallën e kompjuterave, pasi është gjithnjë e zënë.
- Nuk kam njohuri për teknologjinë.
- Pse na hyjnë në punë kompjuterat kur kemi tekste shumë të mira?
- Puna me kompjutera nuk është ndërvepruese; nxënësit mund ta përdori kompjuterin në shtëpi.
- Nxënësit dinë më shumë se ne.
- Teknologjia më bezdis, ndaj nuk e konceptoj fare ta përdor në klasë.
- Do të doja t'i përdorja kompjuterat më tepër, por përgatitja e materialeve më harxhon shumë kohë.
- Nuk e përdor dot teknologjinë, sepse klasat janë të mbingarkuara, shpesh mbi 37 nxënës.

Sigurisht, këto shqetësime qëndrojnë për sa kohë informacioni i mësuesve rreth konceptimit të teknologjisë si një mjet mbështetës e i domosdoshëm shoqëror në dobi të rritjes së kontakteve me gjuhën e huaj nuk është i qartë dhe i argumentuar. Për t'i inkurajuar mësuesit të fillojnë zbatimin e mjeteve teknologjike në orët e mësimit, do t'u jepnim paraprakisht disa sugjerime në përputhje me shqetësimet e ngritura prej tyre të përmendura më sipër:

1. Lidhur me problemin e parë, mësuesi duhet të planifikojë që më parë datën dhe orën kur do të zhvillojë mësim në sallën e kompjuterave.
2. Ka lloje detyrash që mund të kryhen individualisht në internet, por të tjerat kërkojnë punë në çift ose në grupe.
3. Shumë mësues e japin menjëherë këtë përgjigje ose ndihen kështu, por për hir të së vërtetës të gjithë dinë ta përdorin e-mail-in, dinë të hapin internetin dhe kaq mjafton si fillim.
4. Kjo vërejtje është e vërtetë sidomos për ata mësues që nuk kanë marrë asnjë trajnim lidhur me përdorimin e teknologjisë. Sidoqoftë, prania në klasë e nxënësve që e njohin më mirë se mësuesi teknologjinë është një

[2] Vëzhgimet dhe pyetësorët janë zhvilluar si pjesë e një studimi më të thelluar dhe kanë përfshirë të dy ciklet para /universitar.

ndihmë e madhe, pasi mësuesi mund të mbështetet tek ta. Nxënësit ndihen mirë kur u kërkohet ndihmë apo u merret mendim, pasi e konsiderojnë këtë si mundësi për të nxjerrë në pah njohuritë dhe aftësitë e tyre në këtë fushë.

5. Përdorimi i teknologjisë në klasë nuk zëvendëson përdorimin e materialeve tradicionale (dërrase, tekst), përkundrazi, ajo plotëson dhe nxit punën e rregullt në klasë nëpërmjet veprimtarive plotësuese rreth tematikave që trajton teksti, p.sh., tema "*Famous business persons*" mund të plotësohet me veprimtari ku mund të integrohen mjetet e teknologjisë online të tipit projekt me e-mail për mbledhje të dhënash, krijimi i një wiki apo blog-u rreth temës, ose vetë mësuesi krijon material elektronik shtesë për përforcimin e materialit të tekstit.
6. Kjo frikë nga teknologjia lidhet shpesh me ata mësues që kanë kaluar përvoja të dështuara në të shkuarën, ndaj ka rëndësi të madhe t'u bëhet e ditur mësuesve se ata tashmë i kanë fituar disa aftësi teknike prej përdorimit të teknologjisë në jetën personale. Mësuesit teknofobë kërkojnë inkurajim duke filluar nga përvetësimi i gjërave të thjeshta, ata duhet ta dinë se teknologjia mund të pësojë edhe avari gjatë rrugës. Për këtë ata duhet të përgatitin një plan mësimor B për të shmangur dështimin e orës se mësimit. Gjithashtu, angazhimi i këtyre mësuesve në tryeza trajnimi apo kurse *online,* inkurajon qëndrime pozitive për të ardhmen.
7. Mësuesit të bashkëpunojnë me kolegët në shkollë në forume si dhe të blejnë krahas tekstit të punës edhe materialet burimore të teknologjizuara që u bashkëngjiten atyre.
8. Për këtë kërkohen jo më shumë se katër veta për kompjuter. Në rast klasash me mbi 30 nxënës, klasa të ndahet në dysh, ndërsa njëri grup punon në kompjuter, grupi tjetër punon me shkrim, më pas këmbehen.

Të dy këtyre grupeve do t'u këshillonim të reflektojnë mbi arsye të shëndosha pedagogjike për ta përdorur ose jo teknologjinë. Si *këshilluese gjuhe*, duke punuar me administratorë shkollash që kërkojnë të blejnë me çdo kusht pajisjet më të fundit teknologjike për t'u përballur me konkurrencën, u rekomandojmë atyre të shqetësohen më parë për cilësitë e mësimdhënies në shkollat që drejtojnë, pastaj për mjetet. Në fund, na lejoni të citojmë Jones-in kur thotë: "Nuk ka rëndësi çfarë është, rëndësi ka çfarë bën me të."[3]

2 . Mjetet e të mësuarit *online* në kontekstin e mësimdhënies së gjuhës së huaj.

- *Fjalorët online*
- *Blog-u*

[3] Helena Meyer, (2009) .

- *E-mail-i*
- *E-portofoli*

Disa funksione specifike të llojeve të ndryshme të *blog* –eve në mësimdhënien e gjuhës së huaj, paraqiten të përmbledhura në një tabelë për të lehtësuar përqasjen dhe për të pohuar orgjinalitetin e secilit tip:

Tabela II.1 Disa funksione specifike të llojeve të ndryshme të *blog* –eve

Blog-u i mësuesit	***Blog-u i nxënësit***	***Blog-u i klasës***
• Jep detyra shtëpie • Bën përmbledhje të punës në klasë. • Jep *link*-e për materiale shtesë dëgjimi e leximi. • Pyetje/përgjigje rreth punës në klasë e gramatikës. • Këshilla për studim e provime.	**a.** Informacion mbi veten e familjen me foto. **b.** Praktikë shtesë shkrimi rreth temave në klasë. **c**. Komente mbi ndodhitë më të fundit. **d.** Kerkim informacioni, prezantim rreth nje çështje a problemi. **e.** Një foto blog mbi vendin e pushimeve të nxënësit/studentit.	**a.** Reagime ndaj nje filmi, artikulli, debati, në klasë. **b**. Gjërat që pëlqejnë të të bëjnë ose jo në klasë. **c**. Një projekt klase apo problem i zgjidhur .

3. Përparësitë pedagogjike të *e-mail-it* në MGJH?

E mail-i përbën një formë të komunikimit asinkron të ndërmjetësuar *online* i njohur si zanafilla e gjithë përdorimeve përmes internetit.

a) Për vetë natyrën e *e-mail-it,* studentët nuk kanë nevojë të ndodhen në klasë në një çast të dhënë për të komunikuar me të tjerë në gjuhën e huaj. Ata mund ta shkruajnë një *email* nga shtëpia, nga një bibliotekë, etj.
b) Siguron një kontekst për komunikim të mirëfilltë dhe ndërveprim autentik.
c) Zgjeron tematikat përtej atyre të trajtuara në klasë.
d) Promovon të mësuarit me në qendër studentin/nxënësin.
e) Inkurajon mundësi të barabarta për pjesëmarrje.
f) Zhvillon aftësitë e të shkruarit.
g) Lidh folësit në kohë të shkurtër e me pak shpenzime.
h) Është i thjeshtë në përdorim dhe mjaft popullor, përdoret gjerësisht.

Përfundim

Nga ky vëzhgim njohës në ciklin para dhe universitar, gjetjet dëshmojnë një mospërputhje midis rëndësisë së përdorimit të teknologjisë së internetit nga njëra anë, dhe mungesës së vullnetit për t'i dhënë jetë këtij vizioni gjatë veprimtarive mësimore gjuhësore, edhe pse rreth 85% e mësuesve rezultojnë njohës mesatarë të teknologjisë dhe e përdorin atë për nevoja vetjake.
Pavarësisht nga kjo, gjasat janë që ata të pasurojnë mjeshtëritë e tyre elektronike në vazhdim. Në këtë drejtim rrjetet sociale, si *Facebook* apo *Myspace*, kanë fituar një popullaritet të jashtëzakonshëm gjatë viteve të fundit. Për këtë, mësuesit kanë nevojë të inkurajohen të integrojnë *blog*-un, *chat*-in krahas mjeteve të tjera për të mos e kthyer mësimdhënien në një ishull të shkëputur nga realitetet e jetës së përditshme.
Çështja e integrimit të TIK në mësimdhënien e gjuhëve, përbën një problem të kohës edhe në Evropë, por në vendin tonë sfidat janë edhe më të mëdha për shkak të nevojës për ndërgjegjësim të mësuesve e nxënësve, e nevojës për mbështetje infrastrukturore e trajnime kualifikuese sistematike të tyre.

BIBLIOGRAFIA

A European area of lifelong learning: *empowering Europeans in the knowledge-based economy and society,* Bruksel, 21.11.2001.

Albanese, M. (2000). Problem-based learning: *Why curricula are likely to show little effect on knowledge and clinical skills.* Medical Education. 34: 729-738.

Baber, Eric, "*Language teaching in the Internet age*", *ELT Newsletter,* gusht 2001.

Beauvois,M.H., "*E-Talk: Attitudes and motivation in Computer- assisted Classroom Discussion*", Computers and the Humanities, (vëll28),1995,f.177-190.

Blake, R.J., *Brave New Digital Classroom-Technology and Foreign Language*

Brown, H. D. (1994). *Principles of language learning and teaching.* Eglewood Cliffs: Prentice Hall.

Ellis, R. (1984). *Classroom second language development: A study of classroom interaction and language acquisition*. New York: Pergamon Press.

Grup Autorësh (2003) Studim Paraprak mbi *Arsimimin e Gjuhës Angleze në Shqipëri.*

Haloçi, A. (2007) *Mësimi i gjuhëve të huaja në vendin tonë përballë dokumenteve të Këshillit të Evropës,* Buletini shkencor nr.57 i Universitetit të Shkodrës « Luigj Gurakuqi"

Karameta, Pëllumb,(2009) " *Shqipëria në moshën e internetit"* – UNICEF-i dhe ca të tjerë", gazeta *Shqip*, 03.07.2009.

Tan, O. S. (2003). *Problem-based learning innovation: Using problems to power learning in the 21st century*. Singapore: Thomson Learning.

Sula, Adriana, " *Integrimi i TIK në procesin edukativ*", Mësuesi,6 (2552),shtator 2010,f.1-3.

FENOMENE FONOLOGJIKE NË TË FOLMEN E LABËRISË

Zamira Alimemaj, Phd. Candidate
Departamenti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
zamiraalimema@gmail.com

Abstract

It is a fundamental principle of Albanian dialectology that the Geg/Tosk split represents the oldest and most significant dialectological division in the transition from Common Albanian to Albanian as it is historically attested. The Tosk dialect group is in general more homogenous, though it can be subdivided into a northern (from Fier to Vlora on the coast and all of inland southern Albania north of the Vjosa River), a Labërian or Lab (south of the Vjosa to Saranda), and a Çamërian or Çam (the southern tip of Albania and into Greece) dialect. The Labërian dialect is spoken in most part of the South and it has got its own grammatical and phonological features. The aim of this article is to present some of the characteristics of this dialect, especially in the field of phonology.

Key words: assimilation, dialect, phonology, characteristic.

Hyrje

Në të kaluarën, madje, edhe sot ka patur e ka mjaft hulumtime e studime mbi veçoritë e të folmeve krahinore . Këto dukuri janë trajtuar në planin historik e konkret.. Në studimet e mirëfillta shkencore gjuhësore , nisur nga këto dukuri, është hedhur dritë e është pasuruar mendimi shkencor mbi ligjësitë dhe evolucionin e shqipes. Edhe vëzhgimet e hulumtimet mbi dukuri të veçanta gjuhësore kanë pasuruar ndjeshëm materialin gjuhësor mbi këto ligjësi. Për shkak të kushteve të veçanta historike e gjeografike , edhe dukuritë e së folmes së krahinës së Labërisë pëbëjnë një material të pasur e me interes për gjuhësinë. Kjo e folme ruan forma të hershme të shqipes.. Kjo tendencë konservative edhe në fushën e gjuhës është rrjedhojë e faktorëve të lartpërmendur dhe e përpjekjeve për ruajtjen e identitetit kulturor e historik të këtij komunitet, brënda identitetit të përgjithshëm krahinor e kombëtar. E folmja e Labërisë është pjesë e së folmes së Toskërisë jugore, por brënda saj çdo krahinë e njësi krahinore ka veçoritë e veta. Kjo krahinë në të folmen e vet ka edhe veçoritë e saj të dallueshme.
Një vështrim i përgjithshëm mbi këto veçori paraqet interes sepse krahina e Labërisë është një krahinë e pagjurmuar , hetuar e vrojtuar deri tani në fushën e veçorive të gjuhësisë së folur. Në këtë shkrim do të trajtohen në mënyrë të përmbledhur disa veçori e dukuri të kësaj të folme ,kryesisht në fushën e

fonetikës. Në dialektin toskë dallohen dy nëndialekte kryesore: labërishtja dhe çamërishtja. Çamërishtja ndahet mirë nga dialektet e tjera toske me ruajtjen e grupeve *kl, gl*. Po labërishtja me toskërishten akoma nuk është studiuar se a ndahen me të vërtetë me njëra-tjetrën nga ana gjuhësore, dhe, në qoftë se po, në se ndahen. Si kufiri i labërishtes me toskërishten konsiderohet përgjithësisht lumi i Gjirokastrës dhe Vjosa. Ç'mban në të djathtë të këtyre lumenjve është Toskëri, ç'mban në të majtë është Labëri; po duket se Labëria shtrihet vende-vende dhe në anë të djathtë të këtyre lumenjve. Kur flasim p.sh. për Labëri, më shumë se në të folët e saj na vete mendja në disa elemente etnografike që e ndajnë këtë krahinë nga Toskëria tjetër. Ne e njohim më shumë Labërinë nga këngët e vallet e saj, nga kostumet, nga mënyra e jetesës. Këto dy grupe ndahen gjeografikisht te lumi i Shalësit, në jug të Delvinës.

Bërthamën e labërishtes e përbëjnë të folmet e Kurveleshit, të folmet e tjera afrohen me to por nuk janë krejtësisht të njëjta. Ndryshimet që erdhën në jetën ekonomike dhe kulturën shpirtërore si pasojë e zhvillimeve historike si dhe ndikimeve të huaja kulturore, u shfaqën edhe në fushën e gjuhës. Kështu, leksiku i përgjithshëm ka humbur fjalë të vjetra të shqipes por edhe është pasuruar me fjalë të reja, një pjesë e të cilave janë te huazuara. Edhe ajo pjesë e trashëgimisë, e cila është përcjellë gojë më gojë, është prekur nga ky fenomen. Më poshtë po përmendim disa prej ndryshimeve që u shfaqën në fushën e gjuhës në krahinën e Labërisë.

Veçori të Labërishtes

Shumë nga emërtimet e vjetra gjeografike, nga brezi në brez, kanë ndryshuar formën fonetike saqë sot është e vështirë të dallohen. Në krahinën e Labërisë ka shumë toponime që nuk mund të shpjegohen me fjalët e shqipes sot ose që kanë pësuar ndryshime të mëdha në formën e tyre. Të tilla janë emrat e maleve Çipini, Gribë, Papadhi etj.; emra kodrash e pyjesh, si: Drimua, Luath, Shkagë, Vrutka, Povël, Ranua, Varth etj.Në mijëvjeçarin e parë ndodhën shumë ndryshime. Ishte koha kur popullsia e kësaj krahine kishte braktisur politeizmin e kohëve pagane dhe kishte përqafuar besimin e krishterë e bashkë me futjen e riteve kristiane dhe harrimin pak nga pak të besimeve pagane e riteve të lidhura me to, nisën të ndryshojnë edhe emrat e njerëzve.

Nga fondi i vjetër i emrave iliro-epirotë e arbërorë janë ruajtur vetëm nje pjesë e vogël, si: Amat, Bato, Dasho, Pirro, Gent, Bardho, Dasho, Teutë, Pirro etj. Ky fond emrash u pasurua me emra kristianë me prejardhje latine e greke, si: Aleks, Mërtir, Kolë, Gjokë, Thanas, Qezar, Vitë etj., te cilët duke kaluar gojë më gojë pësuan ndryshime fonetike duke mos pasur shume dallim nga emrat autoktonë. Këtyre iu shtuan edhe emra të rinj vendas, fetarë si: Prëmto/ Prëmte (nga Shën Prenda, shenjtore shqiptare), Danë (nga Shen Dana, shenjtorja e Kaninës) dhe jofetarë, si: Dado, Dudi, Hyri, Lale, Sutë, Zogë, Zoto etj.të cilët shkonin mire me mbiemrat e familjeve prej fjalësh shqipe, si: Bufi, Madhi, Plaku, Ziu, Arapi etj. Prej tyre janë formuar kompozita të panumërta, që sot shërbejnë si mbiemra familjesh ose si toponime.

Me islamizimin e Labërisë ndodhën ndryshime të mëdha, kur emrat vetjak dhe një pjesë e llagapeve u zevendësuan me emra turko-arabë, por, pavarësisht kësaj, fondi i vjetër i emrave të krishterë është ruajtur i plotë në toponiminë dhe mbiemrat e sotëm të familjeve, duke shërbyer si një nga provat e prejardhjes ilire dhe të njësisë etnike të arbërve. Në Labëri gjenden me shumicë llagape dypjesëshe dhe patronime të ngjashme me to si nga struktura edhe nga përbërja tingullore e pjesëve përbërëse.

Po t'i vemë re këto emërtime që kanë strukture të njëjtë, janë të formuara nga dy tema nga të cilat e para është një emër vetjak, kurse e dyta emër i atit (Gjokoni, Kohila etj.) ose mbiemër familjeje (Gjimuf, Koprift, Gjozenikë etj.) Kompozita të tilla janë shumë të lashta e të përhapura në gjuhën shqipe. Një pjesë e tyre janë formuar edhe si rrjedhojë e ndryshimeve fonetike, fenomen i cili ështe mjaft i përhapur dhe i lashtë në gjuhën shqipe. Njëra prej dukurive fonetike që vihet re është kthimi i një n-je midis zanoresh në r dhe rrëgjimi i zanoreve të patheksuara në ë, si p.sh. Mërtir (Martin), Todhër (Todor) etj.; përngjashmimet dhe rëniet e bashkëtingëlloreve në kufijtë e temave si p.sh. Gjokondi (Gjokë Kondi), Likoka (Lik Koka) etj. Tek vendosja e emrave të njerëzve me interes studimi janë rastet kur gjuhësorja dhe shoqërorja pleksen me mundësi përkimi e përqasje interesante, ku gjenden emërtime sinonimike shumë të larmishme për lidhjet e marrëdhëniet e farefisnisë, përgjithësisht të lidhjeve familjare, martesore, gjinore etj. Jepen raste për kundrime të tilla të dhënat që që gjejmë në disa nga të folmet e krahinave a viseve më anësore dhe përgjithësisht ruajtëse (konservative), siç është edhe Labëria.
Temat fjalëformuese të këtyre fjalëve të përbëra u janë nënshtruar rregullave fonetike të shqipes duke kaluar gojë më gojë përmes brezave duke arritur ne formën që përdoren sot. Disa prej emrave ne Labëri kanë ngjashmëri me emërtime të Shqipërisë Veriore prandaj disa studiues mendojnë se kjo ndodh për shkak të migrimit dhe vendosjes në Labëri të fiseve nga Mirdita apo Kelmendi, por studiuesi Rami Memushaj nuk e pranon plotësisht këtë argumentim sepse nuk mund të thuhet kjo për një krahinë të tërë sepse "dukuritë e mësipërme fonetike në emrat e familjeve dhe të vendeve, që gjenden vetëm në toskërishten, përbëjnë provën e parë kundër pranisë së një elementi geg; një prove tjetër përkundër këtij mendimi eshtë edhe vetë e folmja e Labërisë, e cila, me gjithë ndonjë pike takimi me të folmen veriore, është shumë e afërt me çamërishten dhe me të folmet në të djathtë të Vjosës, si një ndër tre nëndialektet e dialektit tosk."(Memushaj,2004)

Shurdhimi

Në të folmen e Labërisë janë shurdhuar bashkëtingëlloret e zëshme në fund të fjalës dhe në mes të saj para një bashkëtingëllore të shurdhët: *shelek* (shelegu), *shtek* (shtegu), *zoq* (zogjë), *borç* (borxhi), *mleth* (mbledh), *prokof* (prokovi), *u lotht* (u lodhët), *laksht* (lagësht), si dhe para bashkëtingëlloreve hundore: *erthm* (erdhëm).
Fenomeni i shurdhimit në të folmet labe paraqet një interes të veçantë jo vetëm për zhvillimin, por edhe për kronologjinë e tij. Hasen tri faza të zhvillimit të këtij fenomeni:

a) Në fshatrat e Bregut të Poshtëm (Piqeras, Nivicë-Bubar) bashkëtingëlloret e zëshme fundore nuk shurdhohen.
b) Në Delvinë e Gjirokastër fenomeni i shurdhimit është ende në gjysmë të rrugës.
c) Në Kurvelesh, Rrëzomë ato janë shurdhuar.

Sonorizim

Ka raste kur disa bashkëtingëllore të shurdhëta bëhen të zëshme. Ky fenomen fonetik vihet re edhe në të folmen e Labërisë: *zorkadhe* (sorkadhe), *Zadiku* (Sadiku), *zixhade* (sixhade), *digan* (tigan).

Asimilimi

Është një nga dukuritë fonetike që ka vepruar dhe vazhdon të veprojë edhe sot në dialekte. Me asimilimin reduktohen grupet e tingujve, duke u shkrirë me njëri-tjetrin e duke na dhënë një tingull tjetër që i ruan tiparet e dy të parëve ose te njërit prej tyre. Në të folmen e Labërisë vihen re raste të ndryshme asimilimesh. Po renditim disa lloj asimilimesh:

A) Asimilime vokalike: a) progresive: *kraharuar* (krahëruar), *thithilopa* (thithëlopa), b) regresive: *prefesjon* (profesion), *dorovit* (darovit), *rrutulloj* (rrotulloj).

B) Asimilime konsonantike jo në kontakt: a) regresive: *kshish* (ksish), *nisheshte* (niseshte)

C) Asimilime konsonantike në kontakt:

a) Asimilime të pjesshme. Ndër më karakteristiket për këtë të folme, sidomos në fshatrat e Kurveleshit, është asimilimi i dybuzores /p/ në dybuzoren hundore /m/ para hundores /n/: *hamn* (hapnë), *imni* (jipni), *imn* (hipën), *shtymni* (shtypni), *mo e rimni* (e ripni)

b) Asimilime të plota: asimilimi i grupit *tn* në *n*: *kulloni* (kullotni), *prini* (pritni), *godin* (goditën), *grabin* (grabitën);

tm në *m*: *e pam* llafin (patmë), *u përshënem* (u përshëndetëm), *gjem* (gjetmë)

ln në *l*: *dili* (dilni), *mua*l (mualnë), *vual* (vualnë)

lln në *ll*: *duall* (duallnë), *puall* (puallnë), *i përcilli* (përcillni)

rn në *rr* dhe *r*: *muarr* (muar, muarnë), *nxuarr* (nxuarnë), *tirri* (tirrni), *mirri* (mirrni)

rrn në *r*: e *mirr* (mirrnë) të *nes zjarr* (zjarrnë)

dhn në *dh*: *hodh* (hodhnë), *mlodh* (mlodhnë)

Reduktimi i këtyre grupeve të bashkëtingëlloreve është kryer rregullisht kudo në të folme të toskërishtes, ashtu si dikur në mbarë shqipen. Në të folmet skajore të Jugut, sidomos në labërishte, ky process është sot një normë fonetike e gjallë, sepse shihet se vepron edhe në forma të dëftores së tashme: *dili* (dilni), *meri* (merrni). Në këto të folme ekzistojnë si variante edhe forma të rindërtuara, në të cilat nuk del i reduktuar grupi: *malnë* (malin), *dualnë* (dolën). Asimilimi është karakteristike edhe e të folmeve të tjara si: e folmja e Muzinës, e folmja e Gjirokastrës, e folmja e Delvinës.

Disimilimi

Disimilimi ndodh kryesisht gjate procesit te fjalëformimit apo krijimit të formave gramatikore, kur zgjerimi me parashtesa, prapashtesa apo mbaresa që kanë një bashkëtingëllore të njëjtë me rrënjën. Ky fenomen është shumë i rrallë në të folmen e Labërisë: *fëldish* (fildish), *nëmur* (numur), *birbili* (bilbili),

Fenomeni i shtimit të tingujve

Ka raste,kur si rezultat i zhvillimeve të brendshme të gjuhës, shfaqen disa fonema pa ndonjë funksion të caktuar: proteza (fonema shfaqet ne fillim të fjalës), epenteza (fonema e shtuar shfaqet ne mes të fjalës), epiteza (fonema e shtuar shfaqet në fund të fjalës): *të ndrejtën* (drejtën), *nderisa* (derisa), *hunazë* (unazë). *i dobërt* (i dobët), *shelqer* (sheqer)

Rëniet e bshkëtingëlloreve (afereza)

Ka raste kur në disa të folme, në disa grupe bashkëtingëlloresh, sidomos nga ato të formave të vjetra të kallzores e ato të së kryerës së thjeshtë, janë të paqëndrueshme, njëri prej elementeve reduktohet plotësisht, p.sh.: male (malnë), mbenë (mbetnë). Historia tregon se në faza më të hershme të zhvillimit të saj grupe të tilla bashkëtingëlloresh kanë qënë të kufizuara në numër dhe kanë pësuar ndryshime duke u reduktuar njëri nga elementet e tyre, ashtu si vërehet sot në të folmen skajore të toskërishtes: të folmet e skaji lindor (Korçës, Kolonjës, Pogradecit), ato të skajit jugor (të Labërisë, të Çamërisë, me përjashtim të së folmes së Gjirokastrës) dhe të folmet e zonave qëndrore malore (Skraparit, Përmetit, Zagorisë).
Në këto të folme ekzistojnë si variante edhe forma të vjetra të kallzores së shquar të emrave mashkullorë njëjës që u mbaron tema me bashkëtingëllore: miknë (mikun), detnë, denë (detin), dhe forma të së kryerës së thjeshtë të foljeve me bashkëtingëllore: *hipnë* (hipën), *mbathnë* (mbathën). Ky fenomen fonemik është karakteristikë për të folmen e disa fshatrave të Labërisë, kryesisht në zonën e Kurveleshit. Po sjellim disa raste:

- Tingulli *n* bie pothuajse rregullisht kur ndodhet para *xh*-së dhe para *x*-së: *pexhere* (penxhere), *texhere* (tenxhere), *u xituam* (u nxituam), *xehej* (nxehej)
- Tingujt *s* dhe *th* bien kur ndodhen para *ç*-së: *të vraç* (të vrasç), *të heç* (të hethç), *u loç* (u lothç)
- Raste te tjera: *gëshër* (gërshërë), *këcej* (kërcej), *xhesh* (xhvesh), *vështoj* (vështroj)

Metateza

Është fenomeni kur tingujt ndërrojnë vend me njëri-tjetrin. Më shpesh kjo ndodh me tingujt /r/ e /l/: *pramak* (parmak), *përkëledhi* (përkëdheli), *gërqele* (gëlqere), *Barjam* (Bajram).
Procesi i këmbimeve, sidomos në grupet *tn, ln, rn* ka qenë një tipar që e ka shoqëruar gjuhën shqipe edhe në faza më të vona të zhvillimit të saj: *muorë (muornë, morën), duolë (duolnë, dolën), të zonë (të zotnë, të zotin).*

Elizioni

Një nga karakteristikat e të folmes së Labërisë është elizioni. Përpara nyjes së përparme e bie nyja e mbrapme *a*: *kocje vogël* (kocja e vogël), *kasolle dhive* (kasollja e dhive), *vatre zjarrit* (vatra e zjarrit), *lulje bardhë* (lulja e bardhë) dhe nyja e përparme *i* pas emrash në trajtën e shquar nuk ndihet: *djali mbretit* (djali i mbretit), *parmaku portës* (parmaku i portës).

Konkluzione

E folmja e Labërisë, pare në lëvizjen dhe zhvillimin e krahinës, karakterizohet nga konservatorizmi, nga njëra anë, dhe inovacioni, nga ana tjetër. Duke qenë e folme anësore, në të janë ruajtur shumë mire disa tipare arkaike. Njëkohësisht këtu vihen re dhe një sere tiparesh që përbëjnë inovacione për toskërishten, sidomos në këndvështrimin fonemik të kësaj të folme. E folmja e Labërisë shfaq disa dukuri fonetike në sistemin bashkëtingëllor, të cilat shmangin vështirësitë e ligjërimit dhe kakofoninë që shkaktohet nga shqiptimi i disa tingujve.

Bibliografi

Gjinari, J. Dialektet e gjuhës shqipe, Tiranë, 1989

Kore, M. Gjirokastra, vështrim historik, gjuhësor, etnologjik, Tiranë, 2014

Memushaj, R. Histori e Kurveleshit, Tiranë, 2004

Totoni, M. E folmja e Bregdetit të Poshtëm, SF, 1, 1964

Totoni, M. Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit, Dialektologjia shqiptare I,

Tiranë, 1971